



BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

Raporti Vjetor 2023

P R I S H T I N Ě , Q E R S H O R 2 0 2 4

BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

Raporti Vjetor 2023

Kjo faqe është lënë qëllimisht e zbrazët

PËRMBAJTJA

Fjala e Kryetarit të Bordit	13
Fjala hyrëse e Guvernatorit	14
Bordi i Bankës Qendrore dhe Bordi Ekzekutiv	17
Struktura organizative e BQK-së, 31 dhjetor 2023	21
1. Përmbledhje ekzekutive	22
2. Mjedisi i jashtëm ekonomik	25
2.1. Eurozona dhe ekonomia globale	25
2.2. Ballkani Perëndimor	27
3. Ekonomia e Kosovës.....	29
3.1. Sektori real	29
3.2. Sektori fiskal	33
3.3. Sektori i jashtëm.....	34
3.4. Sektori financiar	36
4. Licencimi dhe rregullimi i sistemit financiar	55
4.1. Licencimi	55
4.2. Rregullimi	61
5. Mbikëqyrja e sistemit financiar	69
6. Shërbimet e siguruar për autoritetet, komunitetin financiar, dhe publikun	74
6.1. Operacionet dhe menaxhimi i parave të gatshme	74
6.2. Sistemi i Pagesave.....	84
6.3. Menaxhimi i Mjeteve	92
6.4. Teknologjia Informative	97
6.5. Regjistri i Kredive të Kosovës	97
6.6. Aktivitetet në fushën e analizave ekonomike dhe stabilitetit financiar	98
6.7. Aktivitetet kryesore në fushën e statistikave gjatë vitit 2023.....	100
6.8. Rishqyrtimi i kërkesave të institucioneve financiare të mbikëqyrura nga BQK.....	102
7. Zhvillimet e Brendshme	103
7.1. Auditimi i Brendshëm	103
7.2. Burimet Njerëzore	103
7.3. Aktiviteti i BQK-së në fushën ligjore.....	104
7.4. Funkcioni i Menaxhimit të Rrezikut	105
8. Marrëdhëniet me jashtë dhe bashkëpunimi ndërkombëtar.....	107
8.1. Marrëdhëniet Ndërkombëtare	107
8.2. Komunikimi dhe Edukimi Financiar.....	108
8.3. Asistenca teknike	109

8.4. Integrimet Evropiane	110
9. Pasqyrat Financiare	112
10. Shtojca Statistikore.....	114

LISTA E SHKURTESAVE

AB	Auditimi i Brendshëm
ACH	Sistemi Automatik i Pagesave Individuale (Automated Clearing House)
AJN	Asetet e Jashtme Neto
AKP	Agjencioni Kosovar i Privatizimit
APR	Asetet e Peshuara ndaj Riskut
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
ATK	Administrata Tatimore e Kosovës
ATM	Bankomat (angl. Automated Teller Machine)
ATP	Agjencionet për Transferimin e Parave
BB	Banka Botërore
BE	Bashkimi Evropian
BEC	Kategoritë Kryesore Ekonomike (angl. Broad Economic Categories)
BEEP	Projekti mbi Përmirësimin e Ambientit Biznesor (angl. Business Environment Enhancement Project)
BEK	Bordi Ekzekutiv i BQK-së
BERZH	Banka Evropiane për Zhvillim dhe Rindërtim
BIC	Business Identifier Code
BIS	Banka për Rregullimin Ndërkombëtar (angl. Bank for International Settlements)
BKS	Byroja Kosovare e Sigurimeve
BKT	Banka Kombëtare Tregtare
BPB	Banka për Biznes
BPV	Bruto Produkti Vendor
BQE	Banka Qendrore Evropiane
BQK	Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
CEFTA	Marrëveshja e Tregtisë së Lirë e Vendeve të Evropës Qendrore (angl. Central European Free Trade Agreement)
DJI	Dow Jones Industrial Average
DPP	Departamenti i Punës dhe Punësimit
DST	Drejtat Speciale të Tërheqjes
EFSE	Fondi Evropian për Evropën Juglindore (angl. European Fund for Southeastern Europe)
EJL	Evropa Juglindore
EULEX	Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit
EUROSTAT	Drejtorati Gjeneral për Statistika Evropiane

FKPK	Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
FSKP	Fondi Slloveno-Kosovar i Pensioneve
GBP	Funta Britanike (ang. Great Britain Pound)
IAIS	Asociacioni Ndërkombëtar i Mbikëqyrësve të Sigurimeve (angl. International Association for Insurance Supervisors)
ICAAP	Procesi i Brendshëm i Vlerësimit të Mjaftueshmërisë së Kapitalit (angl. the Internal Capital Adequacy Assessment Process)
IÇI	Indeksi i Çmimeve të Importit
IÇK	Indeksi i Çmimeve të Konsumit
IÇP	Indeksi i Çmimeve të Prodhimit
IHD	Investimet e Huaja Direkte
IHH	Indeksi Herfindahl-Hirschman
IJSHEF	Institucione Jofitimprurëse në Shërbim të Ekonomive Familjare
IMF	Institucionet Mikrofinanciare
IFJB	Institucione Financiare Jobankare
IOPS	Organizata Ndërkombëtare për Mbikëqyrje të Pensioneve (angl. International Organisation of Pension Supervisors)
KA	Komiteti i Auditimit
KEDS	Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike SH.A
KEK	Korporata Energjetike e Kosovës SH.A
KJP	Kreditë Joperformuese
KKP	Këshilli Kombëtar i Pagesave
KMA	Kthimi Mesatar në Asete
KMB	Komercijalna Banka
KMK	Kthimi Mesatar në Kapital
KTD	Korporatat Tjera Depozituese
MFPT	Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
MTPL	Sigurimi i Autopërgjegjesisë
NLB	Nova Ljubljanska Banka
NREK	Norma Reale Efektive e Këmbimit
PCB	Procredit Bank
PNI	Pozicioni Ndërkombëtar i Investimeve
POS	Pikë e Shitjes (angl. Point of Sale)
pp	Pikë Përqindje
PTK	Posta dhe Telekomoni i Kosovës

RBK	Raiffeisen Bank of Kosovo
RKK	Regjistri i Kredive të Kosovës
RTGS	Shlyerja e Pagesave në Kohë Reale (angl. Real Time Gross Settlement)
SEBQ	Sistemi Evropian i Bankave Qendrore (angl. European System of Central Banks)
SEKN	Sistemi Elektronik i Kliringut ndër bankar
SEPA	Zona Unike e Përdorimit të Euros (angl. Single Euro Payment Area)
SFR	Franga Zvicerane (Swiss Franc)
SRK	Sistemi i Regjistrimit të Kontabilitetit
SWIFT	Shoqëria për Telekomunikim Financiar Ndërbankar Botëror (Society for Worldwide Interbank Financial Telecommunications)
TEB	Türk Ekonomi Bankasi
TMK	Treguesit e Mjaftueshmërisë së Kapitalit
TPL	Përgjegjësia ndaj Palës së Tretë (angl. Third Party Liability)
TVSH	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar
USAID	Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (angl. United States Agency for International Development)
VPN	Teknologjia e Enkriptimit dhe Lidhjeve Virtuale

LISTA E GRAFIKËVE

1.	Inflacioni në Eurozonë sipas kategorive kryesore -----	26
2.	Rritja vjetore e BPV-së në Ballkanin Perëndimor -----	27
3.	Norma e rritjes së BPV-së reale -----	29
4.	Inflacioni në Kosovë sipas kategorive kryesore -----	30
5.	Inflacioni bazë dhe i përgjithshëm -----	30
6.	Inflacioni i brendshëm dhe i importuar -----	31
7.	Regjistri i bizneseve -----	32
8.	Struktura e ndërmarrjeve të reja -----	32
9.	Eksportet, importet dhe bilanci tregtar i mallrave -----	34
10.	Struktura e eksporteve sipas kategorive -----	34
11.	Struktura e importeve sipas kategorive -----	35
12.	Remitencat -----	36
13.	Investimet e huaja direkte -----	36
14.	Vlera e aseteve të sistemit financiar të Kosovës -----	36
15.	Zërat kryesorë të aseteve të sektorit bankar -----	37
16.	Kreditë e ndërmarrjeve dhe ekonomive familjare -----	38
17.	Kreditë e reja -----	39
18.	Pjesëmarrja e kredive sipas sektorëve ekonomikë -----	39
19.	Stoku i kredive, sipas sektorëve ekonomikë -----	39
20.	Struktura e depozitave -----	40
21.	Norma mesatare e interesit në kredi dhe depozita -----	41
22.	Norma mesatare e interesit në kreditë ndaj ekonomive familjare dhe ndërmarrjeve -----	41
23.	Norma mesatare e interesit në depozita -----	41
24.	Norma mesatare e interesit në depozitat e ndërmarrjeve -----	42
25.	Norma mesatare e interesit në depozitat e ekonomive familjare -----	42
26.	Stoku i kredive, sipas normave të interesit fikse apo variable -----	42
27.	Profiti neto i sektorit bankar -----	43
28.	Të hyrat dhe shpenzimet e sektorit bankar -----	43
29.	Treguesit e profitabilitetit të sektorit bankar -----	44
30.	Treguesit e kualitetit të portfolios kreditore dhe norma e rritjes së KJP-ve -----	44
31.	Asetet e sektorit pensional -----	45
32.	Performanca e FKPK-së -----	45
33.	Investimet e FKPK-së -----	46
34.	Investimet e FSKP-së -----	46
35.	Pjesëmarrja e investimeve të fondeve pensionale -----	46
36.	Asetet e sektorit të sigurimeve -----	47
37.	Primet e shkruara dhe demet e paguara -----	49

38.	Asetet e sektorit mikrofinanciar dhe jobankar -----	51
39.	Vlera e kredive ndaj ekonomive familjare dhe ndërmarrjeve dhe rritja vjetore e kredive-----	51
40.	Rritja e kredive ndaj korporatave jofinanciare -----	51
41.	Lizingjet-----	52
42.	Norma mesatare e interesit në kredi të sektorit mikrofinanciar dhe jobankar -----	52
43.	Norma mesatare e interesit në kredi-----	52
44.	Të hyrat dhe shpenzimet e sektorit mikrofinanciar dhe jobankar-----	53
45.	Treguesit e profitabilitetit të sektorit mikrofinanciar dhe jobankar -----	53
46.	Treguesit e kualitetit të portfolios kreditore-----	54
47.	Struktura e sistemit financiar në Kosovë-----	56
48.	Rrjeti bankar sipas numrit të degëve/zyrave-----	56
49.	Shpërndarja e popullsisë në Kosovë sipas regjioneve-----	56
50.	Rrjeti i siguruesve-----	57
51.	Furnizimi me para të gatshme-----	76
52.	Pranimi i parave të gatshme -----	76
53.	Furnizimi i parave të gatshme -----	76
54.	Pranimi i parave të gatshme -----	76
55.	Furnizimi me kartëmonedha euro sipas denominimeve -----	76
56.	Furnizimi me monedha euro sipas denominimeve -----	76
57.	Pranimi i kartëmonedhave euro sipas denominimeve-----	77
58.	Pranimi i monedhave euro sipas denominimeve -----	77
59.	Eksporti i parave të gatshme-----	78
60.	Importi i parave të gatshme -----	78
61.	Eksporti i parave të gatshme-----	78
62.	Importi i parave të gatshme -----	78
63.	Kartëmonedha të papërshtatshme të tërhequra nga qarkullimi-----	79
64.	Kartëmonedha të papërshtatshme të tërhequra nga qarkullimi nga gjithsej të pranuar-----	79
65.	Kartëmonedha të papërshtatshme të tërhequra nga qarkullimi-----	79
66.	Kartëmonedha të papërshtatshme të tërhequra nga qarkullimi nga gjithsej të pranuar-----	79
67.	Kartëmonedhave të reja të futura në qarkullim-----	79
68.	Kartëmonedha të reja të futura në qarkullim nga gjithsej të furnizuara -----	79
69.	Kartëmonedha të reja të lëshuara në qarkullim -----	80
70.	Kartëmonedha të reja të lëshuara në qarkullim në raport me gjithsej të furnizuara -----	80
71.	Kartëmonedhat euro të falsifikuara të konfiskuara në qarkullim -----	80
72.	Kartëmonedhat euro të falsifikuara të konfiskuara në qarkullim -----	80
73.	Monedhat euro të falsifikuara të konfiskuara në qarkullim -----	81
74.	Monedhat euro të falsifikuara të konfiskuara në qarkullim -----	81
75.	Vëllimi i transaksioneve vendore dalëse -----	83
76.	Vlera e transaksioneve vendore dalëse-----	83

77.	Vëllimi i transaksioneve vendore hyrëse-----	83
78.	Vlera e transaksioneve vendore hyrëse -----	83
79.	Vëllimi i transaksioneve ndërkombëtare dalëse -----	84
80.	Vlera e transaksioneve ndërkombëtare dalëse -----	84
81.	Vëllimi i transaksioneve ndërkombëtare hyrëse -----	84
82.	Vlera e transaksioneve ndërkombëtare hyrëse -----	84
83.	Numri i transaksioneve në KIPS -----	86
84.	Vlera e transaksioneve në KIPS -----	86
85.	Vëllimi vjetor i transaksioneve të KIPS-it sipas llojeve të tyre -----	86
86.	Vlera vjetore e transaksioneve të KIPS-it sipas llojeve të tyre -----	86
87.	Mesatarja ditore e numrit të transaksioneve në KIPS -----	87
88.	Mesatarja ditore e vlerës së transaksioneve në KIPS-----	87
89.	Numri i transaksioneve sipas sesioneve në KIPS -----	87
90.	Vlera e transaksioneve sipas sesioneve në KIPS -----	87
91.	Raporti i kredisë brenda ditore ndaj totalit të vlerës së shlyer në RTGS -----	88
92.	Numri i kartelave të debitit sipas llojit -----	89
93.	Numri i kartelave të kreditit sipas llojit -----	89
94.	Numri i terminaleve ATM-----	89
95.	Numri i terminaleve POS-----	89
96.	Vëllimi vjetor i transaksioneve të instrumenteve elektronike të pagesave -----	90
97.	Vlera vjetore e transaksioneve të instrumenteve elektronike të pagesave-----	90
98.	Numri i transferove të kreditit në formë elektronike në raport me transferet formë letër-----	90
99.	Numri i llogarive me qasje në internet në raport me numrin e përgjithshëm të llogarive rrjedhëse --	91
100.	Portfolio e rezervave (EUR) të BQK-së -----	93
101.	Saldo përfundimtare e mjeteve në EUR të investuara sipas gjendjes së tyre, më 31 dhjetor të viteve përkatëse -----	94
102.	Saldo përfundimtare e mjeteve të investuara në USD -----	94
103.	Raporti i shpërndarjes së investimeve të portofolit në EUR të BQK-së-----	95
104.	Shpërndarja e portofolios investuese në çdo fundvit -----	95
105.	Struktura e Letrave me Vlerë sipas afatit të maturimit -----	97
106.	Struktura e investitorëve nën Ankandet e Letrave me Vlerë-----	97
107.	Normat mesatare vjetore të kthimit për vitin 2022 dhe 2023 -----	97
108.	Ankandet e letrave me vlerë në vitin 2023 -----	97
109.	Numri i hulumtimeve në sistemin e RKK-së -----	98
110.	Numri i kredive të aprovuara në sistemin e RKK-së -----	99
111.	Numri i kërkesave për raportet kreditore-----	99
112.	Struktura sipas edukimit-----	105
113.	Numri i publikimeve të BQK-së përmes kanaleve të komunikimit zyrtar, viti 2023-----	110

LISTA E TABELAVE

1.	Indikatorët bazë makroekonomikë në Eurozonë-----	25
2.	Të dhënat mbi treguesit makroekonomikë dhe bankarë për vendet e Ballkanit Perëndimor-----	28
3.	Numri i institucioneve financiare -----	37
4.	Struktura e asetëve të sektorit bankar-----	38
5.	Struktura e detyrimeve të sektorit bankar-----	40
6.	Asetet e sektorit të sigurimeve -----	48
7.	Detyrimet dhe kapitali i sektorit të sigurimeve -----	48
8.	Primet e shkruara bruto sipas klasave të biznesit -----	49
9.	Dëmet e paguara, sipas klasave të biznesit -----	50
10.	Rezultatet financiare -----	50
11.	Shpërndarja gjeografike e degëve dhe zyrave të bankave -----	57
12.	Shpërndarja gjeografike e filialeve të siguruesve-----	57
13.	Rrjeti i IMF-ve sipas shpërndarjes gjeografike -----	58
14.	Rrjeti i IFJB-ve (zyra dhe agjent) sipas shpërndarjes gjeografike -----	58
15.	Struktura e kërkesave të sistemit financiar të miratuara/refuzuara nga BQK -----	59
16.	Kërkesat e proceduara dhe në proces, gjatë vitit 2023 -----	60
17.	Numri i ekzaminimeve në banka, gjatë vitit 2023-----	69
18.	Numri i ekzaminimeve në IMF dhe IFJB-----	70
19.	Numri i ekzaminimeve të sektorit të sigurimeve-----	71
20.	Numri i ekzaminimeve të sektorit të pensioneve-----	72
21.	Numri i ekzaminimeve për pastrimin e parasë -----	72
22.	Numri i ankesave ndër vite -----	73
23.	Numri i ankesave sipas statusit -----	73
24.	Shuma dhe vëllimi i aktiviteteve të përgjithshme të operacioneve me para të gatshme-----	74
25.	Shuma e transaksioneve sipas llojeve kryesore të pagesave -----	81
26.	Niveli i depozitave të klientëve kryesorë -----	83
27.	Treguesit e përqendrimit për transaksionet e iniciuara/dërguara në KIPS, viti 2023 -----	86
28.	Rastet e procesuara në Regjistrin e Llogarive Bankare -----	87
29.	Numri i llogarive -----	89
30.	Numri i llogarive të parasë elektronike -----	90
31.	Numri dhe vlera pagesave të parave elektronike -----	90

Kjo faqe është lënë qëllimisht e zbrazët

Fjala e Kryetarit të Bordit të Bankës Qendrore

Kam kënaqësinë t'ju drejtohem në kuadër të Raportit Vjetor të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK) për vitin 2023. Ky vit ka qenë një periudhë transformuese për institucionin tonë, e shënuar nga përparime të rëndësishme në kornizën rregullative dhe ndryshime në udhëheqje të cilat do të shtyjnë përpara sektorin financiar drejt standardeve të Bashkimit Evropian (BE).

Gjatë vitit 2023, Bordi i Bankës Qendrore ka miratuar disa rregullore kritike që synonin forcimin e sektorit financiar, duke ndikuar më tej në rritjen e stabilitetit, transparencës dhe integritetit të sistemit tonë financiar. BQK u fokusua në forcimin e kornizës rregullatore si pjesë e angazhimit të vazhdueshëm për të siguruar një mjedis financiar të fuqishëm dhe të qëndrueshëm, që mbështetë rritjen e qëndrueshme ekonomike, si dhe të ngrit besimin e publikut në BQK-në.

Gjatë vitit 2023 filloi zbatimi i Rregullores për Qasjen në Llogari Pagese me Shërbime Bazike në sektorin bankar, e cila ka pasur një ndikim të thellë në përfshirjen financiare dhe uljen e kostove për grupet më të ndjeshme, përfshirë pensionistët dhe përfituesit e ndihmës sociale. Kjo gjithashtu kontribuoi në zvogëlimin e pabarazive ekonomike dhe përforcimin e stabilitetit social në Kosovë.

Në vitin 2023, gjithashtu, BQK-ja përjetoi një ndryshim të rëndësishëm në udhëheqjen ekzekutive. Pas një procesi të gjerë përzgjedhjeje, mirëpritëm një Guvernator të ri, i cili u emërua në gusht 2023. Guvernatori i ri sjell një përvojë të madhe dhe një perspektivë të re që përputhet me objektivat strategjike të Bankës Qendrore. Shpreh bindjen se nën udhëheqjen e tij, BQK-ja do të vazhdojë të arrijë objektivat e parapara me Ligjin për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës.

Duhet të theksojmë përpjekjet e jashtëzakonshme të Bordit të BQK-së gjatë një periudhe unike tranzicioni, ku nga data 29 mars deri më 9 gusht 2023 mori përsipër detyrat ekzekutive për shkak të vonesave në emërimin e Guvernatorit të ri. Kjo periudhë kërkoi që Bordi të kalonte përtej rolit të tij tradicional të qeverisjes dhe të menaxhonte drejtpërdrejt funksionet ekzekutive. Pavarësisht sfidave, Bordi siguroi vazhdimësinë dhe stabilitetin brenda institucionit, duke demonstruar përkushtim të palëkundur për qeverisje efektive, duke e luajtur rolin e kujdestarit në aktivitetet vitale të BQK-së. Bordi u kujdes që të gjitha funksionet kritike të operonin pa ndërprerje, ndërsa tranzicioni u krye i qetë dhe me sukses me përkushtimin e anëtarëve të Bordit dhe stafit tonë.

Ndërsa reflektojmë mbi arritjet e vitit 2023, ne gjithashtu shohim me optimizëm mundësitë dhe sfidat që na presin. Fokusi i Bordit do të vazhdojë të jetë në avancimin e kornizës rregullative, promovimin e përfshirjes financiare dhe mbështetjen e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik. Avancimi i sistemit të pagesave me synimin për anëtarësim në SEPA, përmirësimin e masave të sigurisë kibernetike, zgjerimin e programeve të edukimit financiar dhe përfshirjen e komponenteve të ekonomisë së gjelbër në sektorin financiar, mbeten disa nga synimet tona.

Në përfundim, dëshiroj të shpreh mirënjohjen time ndaj anëtarëve të Bordit, Guvernatorit dhe Bordit Ekzekutiv, si dhe të gjithë punonjësve të BQK-së për përkushtimin dhe punën e tyre. Gjithashtu, falënderoj publikun për besimin dhe mbështetjen e vazhdueshme, me bindjen se së bashku do të ndërtojmë një të ardhme të qëndrueshme financiare për Kosovën.

Me respekt,

Bashkim NURBOJA, Dr. Sc.,



Kryetar i Bordit
Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Kjo faqe është lënë qëllimisht e zbrazët

Fjala hyrëse e Guvernatorit

Të dashur lexues,

Kam kënaqësinë me një ndjenjë të thellë të përgjegjësisë, të paraqes Raportin Vjetor të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës për vitin 2023. Ky raport nuk reflekton vetëm punën dhe përkushtimin tonë nga detyrat e ngarkuara, por edhe sfidat dhe arritjet që kemi përjetuar së bashku gjatë këtij viti sa sfidues aq edhe të suksesshëm.

Viti 2023 ishte një vit i mbushur me sfida, mundësi, dhe arritje. Si një ekonomi e re dhe në zhvillim, Republika e Kosovës vazhdimisht përballet me ndryshime të shumta ekonomike dhe shoqërore. Por, disa nga sfidat ishin rajonale e globale, që patën ndikim në gjithë ekonominë, por të cilat, me koordinimin e duhur nder-institucional u arrit të adresohen në masë të arsyeshme. Gjatë kësaj periudhe, ne kemi punuar me intensitet të lartë vazhdueshëm në ruajtjen e stabilitetit financiar të vendit dhe për të krijuar kushtet e nevojshme për një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik. Falë përpjekjeve të pandërprera të ekipit të Bankës Qendrore dhe mbështetjes së fortë dhe të vazhdueshme nga miqtë dhe partnerët tanë ndërkombëtarë, kemi realizuar synime drejt objektivave tona. Kam kënaqësinë të konstatoj se sistemi ynë financiar është i qëndrueshëm dhe stabil, brenda parametrave relevantë të kërkuar, janë marrë masa rregullatore që integriteti i sistemit financiar dhe qasja në financa të përmirësohet, dhe me nevojën për përmirësim më tej.

Në këtë Raport, ofrojmë një analizë më të detajuar të situatës ekonomike dhe financiare të vendit, si dhe një përmbledhje të masave që kemi ndërmarrë në disa drejtime për të përmirësuar dhe fuqizuar edhe më tej sistemin financiar të vendit dhe për të rritur kredibilitetin e sistemit dhe forcuar besueshmërinë e qytetarëve. Konkretisht, shpaloset puna në drejtim të përmirësimit të infrastrukturës financiare që të jemi në hap me zhvillimet e hovshme dhe novacionet e vazhdueshme në sektorin financiar, dhe kemi rritur transparencën dhe llogaridhënien, duke ndërtuar kështu një sistem financiar më të fortë dhe më të besueshëm për të gjithë qytetarët e vendit dhe partnerët e organizatat ndërkombëtare.

Në mënyrë të veçantë, dua të theksoj rolin e rëndësishëm që kanë luajtur bashkëpunëtorët tanë ndërkombëtarë. Institucione si Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN), Banka Botërore (BB), Thesari Amerikan dhe partnerët evropianë në krye me Bankën Qendrore Evropiane kanë qenë të domosdoshëm në ofrimin e asistencës teknike dhe mbështetjes financiare në kapërcimin e sfidave me të cilat jemi përballur. Përmes këtij bashkëpunimi, kemi arritur të implementojmë praktikat më të mira ndërkombëtare që të avancojmë më tej Bankën Qendrore dhe të forcojmë më tej sistemin tonë financiar, ndërsa angazhohemi për integrim të mëtejshëm të sistemit financiar.

Përveç arritjeve institucionale, viti 2023 ka qenë një vit i rëndësishëm edhe për thellimin e marrëdhënieve tona të bashkëpunimit dhe partneritetit me Bankat Qendrore, Autoritetet Mbikëqyrëse dhe komunitetin ndërkombëtar. Jam veçanërisht krenar për bashkëpunimin e ngushtë me institucionet e Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe institucionet e shteteve të Bashkimit Evropian. Këto partneritete kanë qenë jetike për përparimin tonë dhe do të vazhdojnë të jenë një shtyllë e fortë e zhvillimit tonë në të ardhmen, bazuar në Planin Strategjik të miratuar në konsultime dhe që reflektojnë rrugëtimin tonë të përbashkët.

Në fund, dua të shpreh mirënjohjen time më të thellë për të gjithë ata që kanë kontribuar në sukseset e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës gjatë këtij viti. Falënderoj stafin tonë të dedikuar për përkushtimin e tyre të pashoq dhe punën e palodhur. Falënderoj Bordin e BQK-së për mbështetjen dhe kontributin e tyre, ndërsa një falënderim i veçantë shkon për të gjithë partnerët tanë, për mbështetjen dhe besimin e tyre të vazhdueshëm. Së bashku, ne do të vazhdojmë të punojmë për të ndërtuar një të ardhme më të ndritur dhe më të qëndrueshme për sistemin financiar, vendin, dhe qytetarët e saj.

Le të vazhdojmë të punojmë së bashku me përkushtim dhe me besim në të ardhmen e përbashkët. Unë besoj se me mbështetjen dhe bashkëpunimin tuaj të vazhdueshëm, ne mund të arrijmë çdo qëllim dhe të kapërcejmë çdo sfidë në të mirën e vendit dhe gjithë rajonit.

Me respekt dhe mirënjohje,

Ahmet ISMAILI



Guvernator dhe Kryesues i Bordit Ekzekutiv
i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës

Bordi i Bankës Qendrore dhe Bordi Ekzekutiv

Procesi i vendimmarrjes të Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK) udhëhiqet nga parimet e ligjshmërisë, profesionalizmit, pavarësisë, dhe transparencës. Vendimmarrja sipas ligjit për BQK-në ushtrohet nga Guvernatori, Bordi Ekzekutiv dhe Bordi i Bankës Qendrore.

Bordi i Bankës Qendrore

Aktivitetet e Bordit të BQK kanë qenë të orientuara në përmbushjen e kompetencave dhe detyrave të përcaktuara me Ligjin për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës. Për këtë qëllim, Bordi i Bankës Qendrore ka mbajtur takime të vazhdueshme në të cilat është informuar dhe ka diskutuar lidhur me ecuritë e përgjithshme të sistemit financiar në Kosovë. Gjithashtu, ka ushtruar mbikëqyrjen e zbatimit të politikave, si dhe mbikëqyrjen e administrimit dhe të aktiviteteve të BQK-së.

Me qëllim të sigurimit të vazhdimësisë së përmbushjes së objektivave dhe detyrave të BQK-së në pajtim me nenin 46 të Ligjit nr.03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, më 29 mars 2023, për shkak se ish-Guvernatori i kishte skaduar mandati dhe nuk kishte asnjë zëvendësguvernator të zgjedhur me mandat, Bordi i BQK-së kishte marrë vendim që posti i Guvernatorit të merret përkohësisht nga Kryetari i Bordit të BQK-së z. Bashkim Nurboja, ndërsa, dy (2) anëtarët joekzekutiv të Bordit kishin marrë përkohësisht postet e Zëvendësguvernatorëve. Si rrjedhojë, përgjatë kësaj periudhe (29.03.2023 deri me 08.08.2023), funksioni i Bordit të BQK-së ka qenë më i kufizuar. Nga data 10 Gusht 2023, pozita e Guvernatorit u plotësua, bazuar në vendimin e Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe Dekretimit nga Presidentja e Republikës.

Pavarësisht kësaj, gjatë vitit 2023, Bordi i BQK-së ka mbajtur 13 mbledhje nga së paku 10 që kërkohen me Ligjin për BQK-në, në të cilat janë marrë gjithsej 31 vendime, disa prej të cilave janë listuar në vijim.

Si një nga organet vendimmarrëse të BQK-së, duke u bazuar në rekomandimet e Bordit Ekzekutiv i kryesuar nga Guvernatori, Bordi i BQK-së ka shqyrtuar dhe ka aprovuar nxjerrjen dhe plotësimin e rregulloreve nga fusha e sistemit financiar, si në vijim:

1. Rregullore për Raportimin e Bankave;
2. Rregullore për Menaxhimin e Rrezikut të Likuiditetit të Bankave;
3. Rregullore për Raportimin e Statistikave të Instrumenteve të Pagesave;
4. Rregullore për Sistemin e Pagesave Ndërbankare të Kosovës;
5. Rregullore për Menaxhimin e Komisioneve dhe Shpenzimeve Operative të Siguruesve;
6. Rregullore për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores për Auditim të Jashtëm të Bankave;
7. Rregullore për Strukturën dhe Përdorimin e Identifikuesit Unik të Llogarisë së Pagesës për Transaksionet Kombëtare dhe Ndërkombëtar;
8. Rregullore për Operacionet me Para të Gatshme;

Bordi i BQK-së bazuar në rekomandimet e organeve përkatëse, gjithashtu ka miratuar:

1. Raportin vjetor të BQK-së për vitin 2022;
2. Pasqyrat Financiare të BQK-së për vitin 2022, dhe Raportin e Auditorit të Pavarur;
3. Buxhetin Vjetor të BQK-së për vitin 2024;
4. Raportet dhe pasqyrat periodike të gjendjes financiare të BQK-së;

5. Rregullat për Procedurat e Punës së Bordit të BQK-së;
6. Strukturën Organizative të BQK-së;
7. Planin Strategjik të BQK-së 2024-2028;
8. Planin Vjetor (të punës) të Auditimit të Brendshëm për vitin 2024;

Me qëllim të përmbushjes së kompetencave të përcaktuara me Ligjin për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, Bordi i BQK-së me kohë ka kryer të gjitha detyrat lidhur me:

1. Zbatimin e procesit të nominimeve dhe emërimeve në kuadër të kompetencave të përcaktuara me Ligjin nr.03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës. Konkretisht, është emëruar Guvernatori dhe zëvendësguvernatori, dhe është kompletuar Bordi i BQK-së me anëtarin e ri joekzekutiv;
2. Shqyrtimin e të gjitha raporteve dhe rekomandimeve të Bordit Ekzekutiv dhe Guvernatorit, me qëllim të ruajtjes së stabilitetit financiar.

Gjithashtu, Bordi i BQK-së ka ushtruar edhe detyra tjera të cilat kanë qenë në harmoni me Ligjin për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës dhe legjislacionin tjetër në fuqi.

Më 31 dhjetor 2023, Bordi i BQK-së përbëhej nga anëtarët e mëposhtëm:

- Z. Bashkim Nurboja, Kryetar i Bordit të BQK-së,
- Znj. Nora Latifi Jashari, anëtare
- Z. Nexhat Kryeziu, anëtar,
- Znj. Arta Hoxha, anëtare, dhe
- Z. Ahmet Ismaili, Guvernator/anëtar.

Komiteti i Auditimit (KA)

Komiteti i Auditimit (KA) është emëruar nga Bordi i BQK-së në përputhje me Nenin 62 të ligjit nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës. Qëllimi i KA është të ndihmojë BQK-në në përmbushjen e përgjegjësive të saj sa i përket menaxhimit të rrezikut të institucionit, kontrolleve, qeverisjes dhe aktiviteteve të ndërlidhura me to, si në vijim:

- Raportimit financiar dhe integritetit të Pasqyrave Vjetore Financiare;
- Pajtueshmërisë me ligjet, rregullat dhe Kodin e Etikës;
- Funksionimit të kontrollit të brendshëm;
- Menaxhimit të rrezikut;
- Efikasitetit dhe objektivitetit të funksionit të Auditimit të Brendshëm; dhe
- Performancës së Auditimit të Brendshëm dhe Auditorëve të Jashtëm.

Bordi i BQK-së ka përcaktuar përbërjen, përgjegjësitë dhe detyrat e Komitetit të Auditimit në Statutin e Komitetit të Auditimit të Bankës Qendrore. KA i raporton periodikisht Bordit të BQK-së. Përderisa, veprimtarinë e vet mund ta rregullojë duke iu përmbajtur çdo kërkesë të Ligjit për Bankën Qendrore dhe çfarëdo urdhërese që i jepet këtij organi nga Bordi i BQK-së.

Më 31 dhjetor 2023, Komiteti i Auditimit kishte përbërjen si në vijim:

- Znj. Nora LATIFI-JASHARI - Kryetare,
- Z. Nexhat KRYEZIU - Anëtar,
- Znj. Edona PERJUCI-UKA - Anëtare e jashtme.

Komiteti i Auditimit gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2023 ka qenë aktiv, ku përmes Bordit të BQK-së ka inkurajuar menaxhmentin që të përmirësojë dhe të nxisë respektimin e politikave, procedurave, si dhe praktikave më të mira në të gjitha nivelet organizative të BQK-së. Për periudhën në fjalë, KA ka mbajtur gjithsej tetë (8) takime nga së paku katër (4) sa kërkohen të mbahen sipas Statutit të Komitetit të Auditimit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës.

Për të përmbushur përgjegjësitë dhe detyrat e tij, KA gjatë këtij viti ka kryer punët si në vijim:

- Ofrimi i këshillave në fushat e përgjegjësisë së menaxhmentit për sistemin e kontrollit të brendshëm;
- Rishikimi i raporteve përmbledhëse të auditimit të brendshëm, gjetjet dhe rekomandimet që kanë dalë nga këto auditime;
- Rishikimi i deklaratave financiare, vlerësimi i çështjeve lidhur me opinionet e auditimit të jashtëm dhe të gjitha raportet e auditimit;
- Diskutimi i rezultateve të vlerësimit të jashtëm për funksionin e Auditimit të Brendshëm;
- Përgatitja e Planit Vjetor 2024 të Komitetit të Auditimit;
- Diskutimi dhe mbështetja e Planit Strategjik të Auditimit të Brendshëm për periudhën 2024-2026;
- Diskutimi dhe mbështetja e planit vjetor të punës së Auditimit të Brendshëm për vitin 2024 (ky dokument është miratuar nga Bordi i BQK-së);
- Rishikimi i çështjeve të ngritura nga auditimi i jashtëm;
- Është siguruar se ekziston një marrëdhënie efektive në mes të Auditimit të Brendshëm dhe Auditorit të Jashtëm;
- Sigurimi dhe fuqizimi i pavarësisë funksionale të Shefit të Auditimit të Brendshëm dhe Auditimit të Brendshëm;
- Vlerësimi mbi përshtatshmërinë e burimeve të Auditimit të Brendshëm;
- Ofrimi i këshillave mbi çështjet lidhur me rreziqet e identifikuara dhe sistemin e kontrollit të brendshëm;
- Mbajtja e të dhënave për të gjitha takimet së bashku me raportet e ofruara nga funksioni i auditimit të brendshëm dhe të gjitha të dhënat e shkruara për të gjitha çështjet dhe dëshmitë që lidhen me këto raporte, si dhe veprimet që merren nga Komiteti i Auditimit.

Komiteti i Auditimit gjatë vitit 2023, në bashkëpunim me Shefin e Auditimit të Brendshëm kanë rishikuar Statutin e Komitetit të Auditimit dhe Statutin e Auditimit të Brendshëm. Këto dokumente janë përcjellë tek Bordi i BQK-së, ku pas diskutimeve dhe komenteve përkatëse, të njëjtat janë miratuar.

Komiteti i Auditimit gjatë vitit 2023 ka mbajtur takime edhe me përfaqësues nga Banka Qendrore e Holandës lidhur me vlerësimin e jashtëm të funksionit të Auditimit të Brendshëm, me Bankën Qendrore të Austrisë (në kuadër të bashkëpunimit dhe shkëmbimit të përvojave në fushën e auditimit të brendshëm), si dhe me përfaqësues nga Fondi Monetar Ndërkombëtar, në kuadër të misionit për vlerësimin e masave mbrojtëse të BQK-së.

Bordi Ekzekutiv

Bordi Ekzekutiv i BQK-së përbëhet nga Guvernatori, që është kryesues i Bordit Ekzekutiv (BEK), dhe Zëvendësguvernatorët. Më 31 dhjetor 2023, BEK përbëhej nga dy anëtarë Ahmet Ismaili, Guvernator, dhe Dardan Fusha, Zëvendësguvernator për Operacione Bankare. Kompetencat e Guvernatorit janë të përcaktuara në Kushtetuten e vendit dhe Ligjin për BQK-në, ndërsa kompetencat e BEK janë të përcaktuara me Ligjin për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës. Guvernatori dhe BEK është i ngarkuar me administrimin dhe ushtrimin e operacioneve të BQK-së, ndërsa aktiviteti i tij mbikëqyret nga Bordi i BQK-së.

Gjatë vitit 2023, BEK ka mbajtur 35 mbledhje. Në kuadër të kompetencave të tij në relacion me Bordin e BQK-së, BEK gjatë vitit 2023 ka shqyrtuar dhe përgatitur për procedim rregullorë të aplikueshme për sistemin financiar të vendit, raportin vjetor të BQK-së, Planin Strategjik, Strukturën Organizative, si dhe raportet, pasqyrat, dhe planet financiare të BQK-së. Përveç këtyre, janë përgatitur dhe komunikuar raporte dhe informata të rregullta dhe ad hoc mbi ushtrimin e detyrave dhe kompetencave të dhëna. Shumica e vendimeve që merr Bordi i BQK-së, përgatiten dhe sponsorizohen nga Bordi Ekzekutiv ose Guvernatori, sipas detyrës zyrtare.

BEK në pajtim me legjislacionin në fuqi gjatë vitit 2023 ka miratuar dy udhëzime dhe një udhëzues të aplikueshëm për sistemin financiar të vendit. Në të njëjtën fushë të kompetencave, sa i përket sektorit financiar jobankar, ka miratuar regjistrimin e pesë institucioneve me aktivitet të këmbimit valutor dhe të një institucioni me aktivitet të kredihënies. Ndërsa, sa i përket sektorit bankar, i ka miratuar një banke licencën për ushtrim të aktivitetit të ndërmjetësimit në sigurime, ndërsa ka proceduar me likuditimin vullnetar të një dege të bankës së huaj. Në sektorin e sigurimeve, gjatë vitit 2023 është revokuar licenca e një ndërmjetësuesi në sigurime. Në të njëjtën periudhë, në funksion të arritjes së objektivave parësore dhe duke u bazuar në detyrat përkatëse të realizuara nga njësitë organizative përgjegjëse, në gjashtë raste janë miratuar masa mbikëqyrëse të veçanta ndaj institucioneve financiare dhe palëve të lidhura.

Këtë vit, BEK ka miratuar edhe raportin periodik lidhur me implementimin e Planit Strategjik të BQK-së për vitin 2022, ndërsa në aspektin zhvillimor afatgjatë, në fund të vitit 2023 ka përgatitur Planin e ri Strategjik për periudhën 2024-2028, si dhe strukturën e re organizative të BQK-së. BEK gjatë 2023 ka miratuar edhe nxjerrjen dhe plotësim-ndryshimin e tetë politikave dhe rregullave të brendshme, si dhe ka mbikëqyrrur raportimet e organeve të brendshme relevante për ushtrimin e kompetencave të tij. BEK ka ushtruar gjithashtu edhe detyra të tjera në pajtim me Ligjin për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës dhe legjislacionin tjetër në fuqi.

Kjo faqe është lënë qëllimisht e zbrazët

1. Përmbledhje ekzekutive

Raporti Vjetor 2023 i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK) ofron një pasqyrë të detajuar të zhvillimeve kryesore ekonomike dhe financiare, aktivitetet kryesore të BQK-së, performancën e sistemit financiar gjatë vitit raportues, pasqyrat financiare dhe mendimin e Auditorit të Jashtëm. Përmes këtij raporti, BQK vazhdon të sigurojë transparencë dhe llogaridhënie në menaxhimin e burimeve financiare dhe politikave të zbatuara në pajtim me kërkesat ligjore dhe standardet e përcaktuara. Në vijim shkurtimisht përmbledhen disa prej tyre.

Ekonomia globale dhe ajo e Eurozonës përjetuan sfida të mëdha gjatë vitit 2023. Ngadalësimi i kërkesës së jashtme, inflacioni i lartë dhe rritja e kostos së financimit, pas shtrëngimit të politikës monetare, ndikuan negativisht në rritjen ekonomike. Ekonomia e Eurozonës shënoi një rritje modeste prej 0.4%, kryesisht për shkak të konsumit post-pandemik dhe rënies së importit të mallrave si rezultat i dobësimit të prodhimit dhe kërkesës së brendshme.

Ekonomia e Kosovës tregoi rezistencë ndaj sfidave globale, duke shënuar rritje të BPV prej 3.3% (ASK, 2023), dhe atë në disa sektorë kyç. Sektori real, përfshirë prodhimin dhe shërbimet, vazhdoi të zgjerohet. Qeveria ndërmoi hapa për të forcuar sektorin fiskal dhe për të përmirësuar bilancin tregtar, ndonëse ky i fundit mbeti i ndjeshëm ndaj zhvillimeve globale duke shënuar deficit të llogarisë rrjedhëse prej 7.6%. Sektori financiar mbeti i qëndrueshëm, me institucionet financiare që ruajtën shëndetin e tyre financiar dhe ofruan mbështetje për zhvillimin ekonomik të vendit.

Gjatë vitit 2023, BQK-ja vazhdoi të zbatojë strategjitë e saj për mbikëqyrjen dhe rregullimin e sistemit financiar, për të siguruar stabilitetin dhe qëndrueshmërinë e tij. Kjo përfshiu licencimin dhe rregullimin e institucioneve financiare, mbikëqyrjen e tyre dhe sigurimin e shërbimeve të nevojshme për autoritetet dhe publikun. Mbarëvajtja dhe avancimi i sistemit të pagesave dhe menaxhimi efektiv i mjeteve ishin ndër prioritetet kryesore të BQK-së.

BQK ka vazhduar të rregullojë dhe mbikëqyrë sistemin financiar përmes licencimit të institucioneve të reja financiare dhe mbikëqyrjes së institucioneve ekzistuese. Kjo ka përfshirë përmirësimin e standardeve dhe kritereve të licencimit për të siguruar që institucionet financiare të jenë në përputhje me kërkesat ligjore dhe rregullative.

Mbikëqyrja e institucioneve financiare është një nga funksionet kryesore të BQK-së, e cila përfshin monitorimin e vazhdueshëm të performancës dhe qëndrueshmërisë së tyre. Gjatë vitit 2023, BQK ka ndërmarrë masa për të siguruar që institucionet financiare të operojnë në mënyrë të qëndrueshme dhe të përmbushin standardet e kërkuara të kapitalizimit dhe likuiditetit.

BQK ka siguruar një sërë shërbimesh për autoritetet publike, komunitetin financiar dhe publikun, duke përfshirë menaxhimin e operacioneve me para të gatshme, funksionimin e sistemit të pagesave dhe menaxhimin e mjeteve financiare. Këto shërbime kanë për qëllim të mbështesin funksionimin e qëndrueshëm të sistemit financiar dhe të përmirësojnë efikasitetin e tregut, si dhe të rrisin përfshirjen financiare.

BQK ka forcuar kapacitetet e saj të brendshme përmes auditimit të brendshëm dhe menaxhimit të rreziqeve, në zbatim të rekomandimeve ndërkombëtare. Bashkëpunimi ndërkombëtar u avancua si një aspekt thelbësor, me një agjendë intenzive të intensifikimit të bashkëpunimit me marrëdhëniet e konsoliduara dhe me zgjerimin e rrjetit bashkëpunues me banka qendrore të vendeve të ndryshme dhe me institucionet financiare ndërkombëtare dhe partnerë tjerë relevantë. Këto përpjekje kanë synuar rritjen e efektivitetit dhe efikasitetit të funksionimit të BQK-së në funksione mandatare dhe integrimin më të thellë në strukturat financiare evropiane dhe globale.

BQK ka intensifikuar bashkëpunimin me institucione financiare ndërkombëtare dhe ka marrë pjesë në projekte të ndryshme asistence teknike dhe integrimi evropian. Këto aktivitete kanë për qëllim përmirësimin e kapaciteteve të BQK-së dhe rritjen e nivelit të edukimit financiar në vend.

Auditimi i Brendshëm është një funksion thelbësor që ofron siguri të arsyeshme për Bordin e Bankës Qendrore, Komitetin e Auditimit dhe Bordin Ekzekutiv për të siguruar se mekanizmat e kontrollit të brendshëm janë dizajnuar dhe funksionojnë në mënyrë efektive. Në vitin 2023, Auditimi i Brendshëm ka përgatitur Planin Strategjik të Auditimit për periudhën 2024-2026 dhe ka vazhduar të mbikëqyrë implementimin e rekomandimeve të dhëna nga vlerësimet e jashtme.

Raporti përmban gjithashtu pasqyrat financiare të BQK-së për vitin 2023, duke ofruar transparencë dhe llogaridhënie në menaxhimin e burimeve financiare. Performanca financiare e BQK-së reflekton menaxhimin e kujdesshëm dhe të qëndrueshëm të aseteve dhe detyrimeve të saj, si dhe angazhimin për të përmbushur objektivat strategjike. Si rezultat, i saj, pasi që u plotësuan kushtet ligjore dhe u arrit pragu financiar, do të mund të realizohet shpërndarja e të ardhurave mbi kufirin e lejuar, përkatësisht transferimi i tyre në buxhetin shtetëror.

Në përfundim, Raporti Vjetor 2023 i BQK-së dëshmon përkushtimin e vazhdueshëm të BQK-së për të ruajtur stabilitetin financiar dhe për të mbështetur zhvillimin ekonomik të Kosovës. Përmes politikave të qëndrueshme dhe bashkëpunimit ndërkombëtar, BQK mbetet një faktor kyç në sigurimin e një sistemi financiar të shëndetshëm dhe të qëndrueshëm në vend. Raporti ofron një pasqyrë të qartë të përpjekjeve dhe arritjeve të BQK-së, duke reflektuar angazhimin e saj për transparencë dhe përgjegjshmëri. Kjo përmbledhje ekzekutive synon të ofrojë një vështrim të shpejtë dhe gjithëpërfshirës të aktivitetit të BQK-së gjatë vitit 2023, duke theksuar rëndësinë e politikave të zbatueshme dhe masave të ndërmarra për të mbështetur një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik dhe financiar në Kosovë.

Për më tutje, kemi kënaqësinë t'ju ftojmë të shqyrtoni pjesë të raportit për informacion më të zgjeruar mbi çështjet kryesore që adreson raporti.

2. Mjedisi i jashtëm ekonomik

2.1. Eurozona dhe ekonomia globale

Ekonomia e Eurozonës shfaqti brishtësi përgjatë vitit 2023, ndikuar nga ngadalësimi i kërkesës së jashtme, rëndimi i inflacionit në fuqinë blerëse të ekonomive familjare, dhe rritja e kostos së financimit pas shtrëngimit të politikës monetare. Sipas të dhënave preliminare nga Eurostat, ekonomia e Eurozonës vlerësohet të ketë shënuar rritje prej 0.4 përqind në vitin 2023 që mund t'i atribuohet momentumit post-pandemik të konsumit si dhe rënies së importit të mallrave si pasojë e dobësimit të prodhimit dhe kërkesës së brendshme për mallra. Në anën tjetër, rritja e kostos së financimit dhe zbehja e kërkesës së jashtme ndikuan që investimet dhe eksporti i mallrave të kontribuojnë negativisht në rritjen ekonomike. Në terma sektorialë, ngadalësimi i aktivitetit ekonomik ishte me bazë të gjerë, duke u ndjerë më shumë në industrinë prodhuese, e cila u ballafaqua me sfida si pasojë e rënies së kërkesës së brendshme dhe asaj të jashtme për mallra. Kurse, u evidentuan dinamika pozitive sa i përket vlerës së shtuar nga sektori i shërbimeve të informimit dhe komunikimit.

Ngadalësimi i aktivitetit ekonomik në vitin 2023 ishte më evident në nivel tremujor, kur ekonomia e Eurozonës stagnoi në tremujorin e tretë dhe u tkurr për 0.1 përqind në tremujorin e fundit të vitit. Ndër përcaktuesit kryesor të ecurisë së rritjes ekonomike në nivel tremujor u veçuan ndryshimet në inventar, që rezultuan me kontribut negativ si pasojë e reduktimit të stokut të akumuluar nga ndërmarrjet. Dinamikat e aktivitetit ekonomik përbrenda Eurozonës në vitin 2023 ishin heterogjene me tetë vende që hynë në recesion, duke përfshirë Gjermaninë që shënoi -0.3 përqind tkurrje, Austrinë me -0.8 përqind (shih Tabelën 1), etj, ndërsa vendet tjera shënuan rritje marginale të aktivitetit ekonomik.

Përballë një sfondi me tensione gjeopolitike, kushte të shtrënguara të financimit, dhe dobësim të tregtisë globale, projeksionet e Bankës Qendrore Evropiane (BQE) sugjerojnë për rritje ekonomike prej 0.9 përqind në 2024. Kjo bazohet në supozimet për rritje të konsumit privat si rezultat i rritjes së të ardhurave të ekonomive familjare dhe ngadalësimit të inflacionit, si dhe rimëkëmbjes graduale të eksporteve me përmirësimin e tregtisë globale. Sipas BQE-së, këto dinamika, krahas pritjeve për lehtësim të politikës monetare, parashihet të diktojnë ecurinë e rritjes ekonomike përgjatë periudhës afat-mesme. Projeksionet e BQE-së rekomandojnë për rritje ekonomike prej 1.4 dhe 1.6 përqind në vitet 2025 respektivisht 2026.

Tabela 1. Indikatorët bazë makroekonomik në Eurozonë

Përshkrimi	BPV reale (%)				Inflacioni (%)				Papunësia (%)			
	2021	2022	2023	2024p	2021	2022	2023	2024p	2021	2022	2023	2024p
Eurozona	5.9	3.4	0.4	0.9*	2.6	8.4	5.4	2.5*	7.7	6.8	6.5	6.6
Austria	4.2	4.8	-0.8	0.3	2.8	8.6	7.7	3.6	6.2	4.8	5.1	5.3
Franca	6.4	2.5	0.7	0.7	2.1	5.9	5.7	2.5	7.9	7.3	7.3	7.7
Gjermania	3.2	1.8	-0.3	0.1	3.2	8.7	6.0	2.4	3.7	3.1	3.1	3.1
Greqja	8.4	5.6	2.0	2.2	0.6	9.3	4.2	2.8	14.7	12.5	11.1	10.3
Italia	8.3	4.0	0.9	0.9	1.9	8.7	5.9	1.6	9.5	8.1	7.7	7.5
Spanja	6.4	5.8	2.5	2.1	3.0	8.3	3.4	3.1	14.8	12.9	12.2	11.6

Burimi: Eurostat (Qershor, 2024), Banka Qendrore Evropiane (Qershor 2024), dhe Komisioni Evropian (Maj 2024).

*Të dhënat janë sipas vlerësimeve dhe parashikimeve të Bankës Qendrore Evropiane (Qershor 2024). Parashikimet për vitin 2024 për vendet e Eurozonës janë bazuar në të dhënat e Komisionit Evropian (Maj 2024).

Tregu i punës vazhdoi të tregojë qëndrueshmëri në vitin 2023, përkundër shqetësimeve për rritje të papunësisë si pasojë e ngadalësimit të ndjeshëm të aktivitetit ekonomik. Norma mesatare e papunësisë në Eurozonë shënoi 6.5 përqind (shih Tabelën 1), që paraqet normën vjetore më të ulët historikisht. Sikurse në vitin paraprak, edhe në vitin 2023 u shënuar rritje e shkallës së punësimit, mirëpo, kjo nuk u reflektua në rritje të numrit të orëve të punës. Kjo shpjegohet nga reduktimi i

orëve të punës për të ruajtur numrin e punëtorëve, duke shmangur vështirësitë e mëvonshme në gjetjen e punëtorëve.

Edhe tregu i punës shfaqti dallime në baza sektoriale në vitin 2023. Mungesa e punëtorëve si një ndër pengesat kryesore në sektorin e prodhimit, u zbut, ndërsa në sektorin e shërbimeve, përkundër përmirësimeve të lehta, vazhdoi të mbetet më e shprehur. Përkundër rënies së produktivitetit për punëtor (-0.1 përqind), pagat nominale për punëtor shënuan rritje prej 6.2 përqind, duke sinjalizuar kështu për vazhdim të presioneve për rritje të pagave, presione të absorbuara pothuajse tërësisht nga bizneset, gjë që evidentohet nga rënia e margjinave të fitimit të bizneseve në Eurozonë.


Inflacioni në Eurozonë në vitin 2023 u ngadalësua në 5.4 përqind nga 8.4 përqind sa ishte një vit më parë (shih Grafikon 1), mbështetur nga rënia e çmimeve të energjisë, dhe ngadalësimi i çmimeve të ushqimit dhe mallrave tjera jo energjetike. Ecuria e çmimeve në 2023 vazhdoi të ndikohet nga lehtësimet në zingjirët e furnizimit dhe rritja e sigurisë së furnizimit me energji. Ndërsa, përgjatë vitit u intensifikua ndikimi ngadalësues nga ana e kërkesës si rezultat i shtrëngimit të politikës monetare dhe dobësimit të besueshmërisë dhe fuqisë blerëse të konsumatorëve.

Përkundër ngadalësimin, inflacioni mbeti i lartë në sektorin e shërbimeve si një ndër kontribuuesit kryesor në ecurinë e çmimeve, i nxitur kryesisht nga rritja e pagave në këtë sektor. Këto dinamika u reflektuan edhe në inflacionin bazë që në vitin 2023 rezultoi me një përshpejtim në 4.9 përqind krahasuar me 3.9 përqind sa ishte në vitin 2022.

Projeksionet e BQE-së sugjerojnë për vazhdim të ngadalësimin të inflacionit, me normën mesatare vjetore të inflacionit në Eurozonë që pritet të sillet rreth 2.5 përqind në 2024 dhe 2.2 përqind në 2025. Faktorët që pritet të mbështesin këtë ngadalësim përfshijnë vazhdimin e lehtësimeve në zingjirët e furnizimit, stabilizimin e çmimeve të energjisë, ndikimin e shtrëngimit të politikës monetare në kërkesën e brendshme, si dhe pritshmëritë për ndikim të limituar të konfliktit në Lindjen e Mesme dhe pengesave në transport në Detin e Kuq në çmimet e mallrave bazë në tregjet ndërkombëtare.

Shtrëngimi i politikës monetare nga BQE, i iniciuar në korrik të vitit 2022, vazhdoi edhe përgjatë vitit 2023, duke rezultuar në rritje kumulative prej 400 pikë bazë të normave kyçe të interesit deri në shtator 2023. Ngadalësimi i vazhdueshëm i inflacionit rriti pritshmëritë e tregut për lehtësim të politikës monetare, . Përkritazi me këto zhvillime BQE vendosi të ulë normën e interesit për 0.25 pikë bazë në qershor 2024, duke theksuar se ecuria e politikës monetare do të vijojë të përcaktohet nga ecuria e çmimeve dhe efektiviteti i transmetimi të politikës monetare. . Për më shumë, sipas Anketës së Kreditimit Bankar, viti 2023 u karakterizua me shtrëngim të vazhdueshëm të standardeve të kreditimit ndaj të gjitha segmenteve, megjithëse nga fundi i vitit u evidentua ngadalësim në ritmin e shtrëngimit. Standardet e kreditimit ndaj bizneseve u shtrënguan përgjatë vitit si pasojë e rritjes së rrezikut të perceptuar nga bankat sa i përket perspektivës së ekonomisë, karakteristikave të huamarrësve, dhe rritjes së kostos së financimit. Në anën tjetër, edhe kërkesa për kredi shënoi rënie në të gjitha segmentet, me kërkesën për kredi nga bizneset që u ndikua kryesisht nga rritja e normave të interesit dhe rënia e investimeve fikse. Ndërsa, kërkesa për kredi nga ekonomitë familjare u ndikua nga zhvillimet në tregun e patundshmërive, rritja e normave të interesit, dhe rënia e besueshmërisë së konsumatorëve.

Grafik 1. Inflacioni në Eurozonë sipas kategorive kryesore



Burimi: Eurostat (2024)

2.2. Ballkani Perëndimor


Aktiviteti ekonomik në vendet e Ballkanit Perëndimor (BP) në vitin 2023 shënoi rritje të ngadalësuar prej 3.0 përqind në krahasim me 4.1 përqind sa ishte vitin e kaluar (shih Grafikon 2 dhe Tabelën 2), ndikuar kryesisht nga ngadalësimi i aktivitetit ekonomik në vendet e BE-së dhe politikave monetare të aplikuara për të frenuar inflacionin. Rritja ekonomike më e lartë në rajon u shënuar në Mal të Zi (6.0 përqind), e mbështetur nga performanca e mirë e turizmit dhe rritja e konsumit, pastaj ishte Kosova dhe Shqipëria (3.3 përqind)

Rritja më e ulët u shënuar në Maqedoninë e Veriut (1.0 përqind), ndikuar kryesisht nga ngadalësimi i investimeve (shih Grafikon 2). Vlen të ceket që vendet e rajonit patën rënie të kërkesës për eksport për shkak të rritjes së ngadalësuar ekonomike të BE-së. Importi i mallrave të konsumit mbeti i lartë për shkak të konsumit privat, i cili kishte kontributin kryesor në rritjen reale të BPV-së. Projektionet e FMN-së për vitin 2024 sugjerojnë për rritje mesatare prej 3.2 përqind për rajonin e BP. Ngadalësimi i aktivitetit ekonomik në Eurozonë, partneri kryesor tregtar i rajonit dhe burim i rëndësishëm për investime, gjithashtu, pritet të jetë faktor përcaktues në dinamikën e përgjithshme ekonomike të vendeve të BP.

Norma mesatare e inflacionit në vendet e BP në vitin 2023 u ngadalësua në 7.7 përqind nga 11.6 përqind sa ishte në vitin 2022. Norma më e lartë e inflacionit ishte në Serbi (12.0 përqind), ndërsa Kosova kishte normën më të ulët të inflacionit prej 4.9 përqind (shih Tabelën 2), e ndikuar nga ngadalësimi i rritjes së çmimeve të mallrave, përfshirë çmimet e ushqimit dhe energjisë. Bankat qendrore në vendet e rajonit, katër prej të cilave kanë valutat e tyre, kanë mbajtur të pandryshuara normat e interesit duke pasur parasysh ngadalësimin e inflacionit në vitin 2023. Në Shqipëri, pas vlerësimit të monedhës gjatë vitit 2023, në takimin e fundit të mbajtur në në qershor të vitit 2024, Banka e Shqipërisë ka vendosur të mbajë të pandryshuar normën bazë të interesit në nivelin 3.25 përqind. Po kështu, në Maqedoninë e Veriut, në vazhdimësi të shtrëngimit të kushteve të financimit, në tetor 2023, norma bazë e interesit mbeti e pa ndryshuar në nivelin prej 6.3 përqind. Ndërkohë, të dhënat e Bankës Qendrore të Serbisë tregojnë se norma e interesit në Serbi është rritur në nivelin 6.5 përqind.

Aktiviteti kredidhënës në vendet e rajonit dhe në Kosovë, në përgjithësi është rritur në nivel më të ngadalësuar krahasuar me një vit më parë, me përjashtim të Bosnjë dhe Hercegovinës. Ngadalësimi i kreditimit është ndikuar prej politikave monetare më konservative të aplikuara nga bankat qendrore të rajonit për të frenuar inflacionin në vitin 2023. Norma më e lartë e rritjes së kreditimit u shënuar në Kosovë me 13.0 përqind, ndjekur nga Mali i Zi me 7.7 përqind dhe Bosnjë e Hercegovinë me 5.5 përqind (shih Tabelën 2). Kreditë jo-performuese shënuan rënie pothuajse në të gjitha vendet e rajonit, me përjashtim të Serbisë që kishte rritje marginale. Rënia më e theksuar ishte në Mal të Zi dhe në Bosnjë dhe Hercegovinë, ndërsa Kosova ishte i vetmi vend që kishte nivel të ngjashëm të kredive jo-performuese kundrejt vitit paraprak (shih Tabelën 2).

Grafik 2. Rritja vjetore e BPV-së në Ballkanin Perëndimor



Burimi: Eurostat, dhe Agjencitë Statistike të vendeve të Ballkanit Perëndimor (2024).

*Projektionet e FMN-së (WEO Prill 2024).

Tabela 2. Të dhënat mbi treguesit makroekonomik dhe bankarë për vendet e Ballkanit Perëndimor

Përshkrimi	BPV reale (%)				Inflacioni (%)				Balanci i llogarisë rrjedhëse (% e BPV)				Rritja e kreditimit (%)				Kreditë jo-performuese (%)				Papunësia (%)			
	2020	2021	2022	2023	2020	2021	2022	2023	2020	2021	2022	2023	2020	2021	2022	2023	2020	2021	2022	2023	2020	2021	2022	2023
Kosova	(5.3)	10.7	4.3	3.3	0.2	3.4	11.6	4.9	(7.0)	(8.7)	(10.6)	(7.6)	7.1	15.5	16.0	13.0	2.7	2.3	2.0	2.0	26.0	20.8	12.6	n/a
Maqedonia e Veriut	(4.7)	4.5	2.2	1.0	1.2	3.4	14.0	9.0	(2.9)	(2.8)	(6.1)	0.7	4.2	8.8	10.3	4.8	3.3	3.1	2.8	2.7	16.4	15.4	14.4	14.3
Mali i Zi	(15.3)	13.0	6.4	6.0	(0.5)	2.5	11.9	8.7	(26.1)	(9.2)	(12.9)	(11.4)	3.8	3.1	8.8	7.7	5.9	6.8	6.3	5.8	n/a	n/a	n/a	n/a
Shqipëria	(3.3)	8.9	4.8	3.3	2.2	2.3	6.6	5.3	(8.7)	(7.7)	(6.0)	(3.7)	6.9	8.8	6.1	3.1	7.7	5.4	4.8	4.6	11.7	11.4	11.1	11.0
Bosnja dhe Hercegovina	(3.0)	7.4	4.2	1.8	(1.1)	2.0	14.0	6.1	(2.8)	(1.8)	(4.3)	(4.3)	0.3	4.1	3.3	5.5	6.1	5.8	4.5	3.8	15.9	17.4	15.4	13.3
Serbia	(0.9)	7.7	2.5	2.5	1.8	4.0	11.7	12.0	(4.1)	(4.3)	(6.9)	(2.6)	11.9	9.7	7.1	1.1	3.7	3.6	3.0	3.2	9.7	11.0	9.4	9.5

Burimi: Eurostat, Fondi Monetar Ndërkombëtar, Agjencitë Statistikore, dhe Bankat Qendrore të vendeve të Ballkanit Perëndimor (2024)

Sa i përket Tregut të këmbimit valutor, në vitin 2023, monedha e euros u vlerësua kundrejt dollarit amerikan, lirës turke dhe sterlinës britaneze, duke u zhvlerësuar kundrejt lekut shqiptar dhe frangut zviceran, ndërsa mbeti pothuajse e pandryshuar ndaj denarit maqedonas dhe dinarit serb.


3. Ekonomia e Kosovës

3.1. Sektori real

3.1.1 Bruto Prodhimi Vendor

Ekonomia e Kosovës, sipas vlerësimeve tremujore të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), në vitin 2023 shënoi rritje prej 3.3 përqind (shih Grafikon 3). Rritja u mbështet nga konsumi i qëndrueshëm, investimet dhe eksporti i shërbimeve. Megjithatë, rënia e eksportit të mallrave, si dhe rritja e importit të mallrave dhe shërbimeve, ndikuan që rritja e aktivitetit ekonomik të jetë më e ngadalësuar krahasuar me vitin paraprak.

Grafik 3. Norma e rritjes së BPV-së reale



Burimi: ASK (2024)

Konsumi, si komponenta kryesore e kërkesës së brendshme, në vitin 2023 kontribuoi me 3.9 pikë përqindje në rritjen reale të BPV-së krahasuar me 2.9 pikë përqindje sa ishte në vitin 2022. Rritja e konsumit mund të shpjegohet përmes rritjes së burimeve të financimit të konsumit, ngadalësimit të rritjes së çmimeve, si dhe përmirësimit të besimit të konsumatorëve. Investimet kontribuan pozitivisht në rritjen reale të BPV-së me 1.1 pikë përqindje krahasuar me -1.4 pikë përqindje të vitit 2022, kryesisht si pasojë e rritjes së investimeve publike.

Sa i përket eksporteve neto, dinamikat që karakterizuan sektorin e jashtëm të ekonomisë, veçanërisht bilancin tregtar të mallrave dhe shërbimeve, ndikuan në një kontribut negativ prej 1.6 pikë përqindje në rritjen e BPV-së. Eksporti i mallrave dhe shërbimeve kontribuoi me 2.4 pikë përqindje, ndërsa importi i mallrave dhe shërbimeve kontribuoi negativisht me 4.1 pikë përqindje në rritjen reale të BPV-së. Rritja e deficitit tregtar ishte rezultat i rritjes së importit të mallrave dhe shërbimeve për 5.9 përqind (importi i mallrave shënoi rritje reale për 2.8 përqind, ndërsa, importi i shërbimeve shënoi rritje për 20.2 përqind), si dhe rënies së eksportit të mallrave për 6.5 përqind. Ndërsa, rritja e vizitave të diasporës në Kosovë rezultoi në rritje reale të eksportit të shërbimeve për 11.0 përqind.

Sa i përket vitit 2024, projeksionet e BQK-së sugjerojnë se aktiviteti ekonomik do të shënojë rritje prej 3.9 përqind. Disa faktorë që pritet të ndikojnë në këtë rritje janë të ardhurat nga diaspora dhe stabilizimi i çmimeve në tregjet ndërkombëtare, që mund të ndikojnë në rritjen e besimit të konsumatorëve dhe investitorëve. Kërkesa e brendshme pritet të ketë një kontribut prej 6.3 pikë përqindje në rritjen e BPV-së, ndërsa eksportet neto pritet të kontribuojnë negativisht me 2.4 pikë përqindje.

Konsumi, si komponenta kryesore e kërkesës së brendshme, pritet të kontribuojë me 3.2 pikë përqindje në rritjen e BPV-së, e mbështetur nga rritja e remitencave, kompensimi i punonjësve dhe kredive individuale/personale. Investimet pritet të kontribuojnë me 3.1 pikë përqindje, me një kontribut të rëndësishëm nga investimet publike. Eksporti i mallrave dhe shërbimeve pritet të ndikojë pozitivisht në rritjen e BPV-së me 1.9 pikë përqindje, mbështetur nga rritja e eksportit të shërbimeve, sidomos shpenzimeve të diasporës në Kosovë. Ndërsa, importi i mallrave dhe shërbimeve pritet të kontribuojë negativisht me 4.2 pikë përqindje, ndikuar më shumë nga importi i shërbimeve.


Megjithatë, ecuria e tensioneve gjeopolitike dhe ngadalësimi i mundshëm i aktivitetit ekonomik në BE, përtej pritjeve, paraqesin rreziqe të mundshme ndaj rritjes së aktivitetit ekonomik në vend. Poashtu, luhatjet e çmimeve së fundmi (prill dhe maj 2024), si rezultat i intensifikimit të tensioneve gjeopolitike, rrisin pasiguritë rreth ecurisë së inflacionit dhe rrjedhimisht normave të interesit me implikime potenciale në besueshmërinë e konsumatorëve dhe investitorëve që mund të ndikojë në ngadalësim të vazhdueshëm të aktivitetit ekonomik në Eurozonë dhe në vend.

3.1.2 Çmimet

Përgjatë vitit 2023, çmimet në Kosovë ndoqën trend ngadalësimi ndikuar kryesisht nga stabilizimi i ofertës, çmimeve të mallrave bazë në tregjet ndërkombëtare, dhe ngadalësimi i aktivitetit ekonomik që uli presionet nga ana e kërkesës. Shkalla e inflacionit në vitin 2023 rezultoi në ngadalësim në 4.9 përqind nga 11.6 përqind sa ishte në vitin 2022. Ky ngadalësim i atribuohet rënies së çmimeve të energjisë në tregjet ndërkombëtare, ngadalësimit të rritjes së çmimeve të ushqimit dhe shërbimeve, dhe në masë më të vogël lehtësimeve në çmimet e mallrave tjera. Megjithatë, kontributi kryesor në këtë shkallë inflacioni vazhdoi të gjenerohet nga kategoria e ushqimit dhe pijeve joalkoolike me 3.4 pikë përqindje (shih Grafikon 4), marrë parasysh peshën në shportën e konsumit (38.2 përqind) dhe rritjen e çmimeve të kësaj kategorie (8.6 përqind). Në kuadër të kategorisë së ushqimit, rritje me ritëm të ngadalësuar vazhdoi të shënohet në çmimet e shumicës së kategorive me përjashtim të vajrave dhe yndyrave që rezultuan në rënie vjetore, dhe me rritjen më të lartë të shënuar në çmimet e perimeve, frutave, sheqerit, dhe prodhimeve ushqimore. Në anën tjetër, kontributi nga energjia ishte negativ (-0.4 pikë përqindje) si rrjedhojë e rënies prej 7.6 përqind në çmimet e kategorisë së përdorimit të pajisjeve për transport personal ku përfshihen karburantet. Kurse, çmimet e energjisë elektrike dhe lëndëve tjera djegëse në kuadër të kategorisë së strehimit shënuan rritje vjetore prej 7.7 përqind, që përbën rritje të ngadalësuar nga 17.2 përqind në vitin 2022.


Zbutja e presioneve inflacioniste u reflektua edhe në ngadalësimin e inflacionit bazë që rezultoi në normë mesatare vjetore prej 4.4 përqind në 2023 në krahasim me 4.9 përqind sa ishte në vitin 2022. Megjithëkëtë, ritmi i ngadalësimit të inflacionit bazë ishte më i ulët sesa ai i inflacionit të përgjithshëm, me inflacionin bazë që ishte më i lartë sesa ai i përgjithshëm pothuajse përgjatë tërë vitit (shih Grafikon 5). Kontributi kryesor në inflacionin bazë vazhdoi të shënohet nga rritja, ndonëse e ngadalësuar, e çmimeve të orendive dhe nga shërbimet e transportit. Dinamikat më të luhatshme evidente në tremujorin e fundit ishin kryesisht si rezultat i rritjes së presioneve inflacioniste në

Grafik 4. Inflacioni në Kosovë sipas kategorive kryesore



Burimi: ASK (2024)

Grafik 5. Inflacioni bazë dhe i përgjithshëm




Burimi: ASK dhe kalkulimet e BQK-së (2024)

rekreacion dhe kulturë, dhe i efektit të bazës në çmimet e shërbimeve të transportit që kishin rritje të dukshme në dhjetor 2022.

Varësia e ekonomisë së Kosovës nga importi i mallrave ushqimore dhe energjetike, si dhe norma e lartë e pjesëmarrjes së këtyre mallrave në shportën e konsumit, ndikojnë që norma e inflacionit në Kosovë të përcaktohet në masë të madhe nga çmimet e mallrave të importuara. Në vitin 2023, 4.1 pikë përqindjeje nga shkalla e inflacionit në Kosovë ishte i importuar, ndërsa 0.8 pikë përqindjeje u gjenerua nga presionet e brendshme inflacioniste (shih Grafikon 6). Përgjatë vitit 2023, u evidentua ngadalësim në presionet inflacioniste të gjeneruara brenda vendit, që përkon me dinamikat lehtësuese në shërbimet hoteliere, të mirëmbajtjes së vendbanimit, atyre të kujdesit personal, dhe në çmimet e lëndëve të ngurta djegëse.

Ngadalësimi i inflacionit të importuar u pasqyrua edhe në indeksin e çmimeve të importit (IÇIMP) që rezultoi në rritje mesatare prej 4.2 përqind në 2023 (18.7 përqind në vitin 2022). Çmimet e produkteve minerale dhe metaleve që përbëjnë rreth 25 përqind të mallrave të importuara shënuan rënie prej 2.0 dhe 4.4 përqind respektivisht. Ndërsa, u evidentua rritje në çmimet e dy kategorive me peshën më të lartë në mallrat e importuara (artikujt ushqimorë, pijet, dhe duhanin) me rritje mesatare prej 8.6 përqind, dhe gjithashtu në mjetet e transportit që shënuan rritje prej 9.1 përqind.



Burimi: ASK dhe kalkulimet e BQK-së (2024)

Në anën tjetër, indeksi i çmimeve të prodhimit (IÇP) në 2023 rezultoi me rënie prej 3.1 përqind, një ngadalësim i dukshëm kundrejt rritjes prej 9.3 përqind në 2022. Rënia kryesisht i atribuohet rënies së çmimeve të prodhimit të energjisë elektrike, gazit, avullit dhe furnizimit me ajër të kondicionuar prej 17.8 përqind. Ndërsa, u evidentua rritje e çmimeve në dy kategoritë tjera kryesore të prodhimit që përfshijnë prodhimin e produkteve minerale jometalike dhe përpunimin e produkteve ushqimore që patën rritje mesatare vjetore prej 3.6 dhe 6.8 përqind respektivisht.

Indeksi i kostos së ndërtimit mbeti pothuajse i pandryshuar duke shënuar rritje mesatare prej 0.6 përqind në vitin 2023, megjithëse ngadalësimi ishte i dukshëm nga rritja prej 20.1 përqind në vitin 2022. Çmimet e materialeve ndërtimore, që përbëjnë kategorinë me më shumë se gjysmën e peshës në këtë indeks, shënuan rënie relativisht të lehtë prej 0.5 përqind. Kurse, u evidentua vazhdim i presioneve inflacioniste në pagat në sektorin e ndërtimit që shënuan rritje vjetore prej 4.1 përqind, në çmimet e makinerive me rritje prej 5.8 përqind, dhe kostove tjera prej 5.0 përqind.

Sipas projeksioneve të BQK-së, inflacioni në vitin 2024 pritet të ngadalësohet në 2.5 përqind, bazuar në pritjet për vazhdim të stabilizimit të ofertës dhe çmimeve në tregjet ndërkombëtare, trendin e ngadalësimit të inflacionit në Eurozonë, transmetimin e shtrëngimit të kushteve të financimit në kërkesën e brendshme, etj. Megjithatë, rreziqet e ndërlidhura me inflacionin anojnë nga kahu i lartë dhe kryesisht përbëhen nga rreziqet për pengesa në zinxhirët e furnizimit si pasojë e tensioneve gjeopolitike të intensifikuara me konfliktin në Lindjen e Mesme, reduktimin e mëtejshëm potencial të sasisë së prodhimit të naftës nga OPEC+, ndikimin e migrimit potencial në paga si rezultat i ndryshimit në kushtet e punës ose liberalizimit të vizave, etj.

Sa i përket pritjeve për inflacionin, bazuar në Anketën e Kreditimit Bankar në Kosovë, pritjet e bankave komerciale për inflacion vjetor në Kosovë për vitin 2024 tregojnë për një normë prej 3.5 përqind. Ndonëse pritjet e bankave janë duke ndjekur trend rënës, ato mbesin mbi vlerat faktike

të inflacionit të përgjithshëm duke sugjeruar për pritje për një ritëm më të ulët të ngadalësimit të inflacionit.

3.1.3 Pozicioni financiar i ndërmarrjeve

Sektori i tregtisë bashkë me sektorin e industrisë përbëjnë dy sektorët ekonomikë me pjesëmarrjen më të lartë në qarkullimin e gjithsej ndërmarrjeve, indekset e të cilave¹ kanë shënuar rritje gjatë vitit 2023. Indeksi i qarkullimit në sektorin e tregtisë me pakicë ka shënuar rritje mesatare prej 12.5 përqind, ndërsa indeksi i vëllimit të prodhimit industrial ka shënuar rritje prej 20.8 përqind.


Sa i përket regjistrimit të ndërmarrjeve, në vitin 2023 u regjistruan më shumë ndërmarrje të reja dhe pati më pak mbyllje të ndërmarrjeve krahasuar me vitin 2022. Numri i ndërmarrjeve të reja të regjistruara ishte 11,422 që paraqet një rritje prej 3.6 përqind krahasuar me vitin 2022, ndërsa, u mbyllën 1,617 ndërmarrje apo 9.4 përqind më pak sesa në vitin 2022 (shih Grafikon 7).

Sektori i tregtisë mbetet sektori me numrin më të madh të ndërmarrjeve të regjistruara, duke përfaqësuar 24.2 përqind të gjithsej ndërmarrjeve të reja të regjistruara, ndjekur nga sektori i aktiviteteve profesionale me 10.6 përqind, sektori i ndërtimitarisë dhe prodhimit me nga 10.2 përqind dhe sektori i hotelierisë me 9.3 përqind, etj. (shih Grafikon 8). Krahasuar me vitin 2022, në sektorin e tregtisë u regjistruan 167 ndërmarrje më shumë, në sektorin e aktiviteteve profesionale 143, dhe në sektorin e informacionit dhe komunikimit 34. Sektorët me numrin më të vogël të ndërmarrjeve të regjistruara si krahasim me vitin 2022 ishin sektori i ndërtimitarisë me 71 ndërmarrje më pak, sektori i hotelierisë me 58, dhe ai i prodhimit me 56.

3.1.4 Tregu i punës²


Shkalla e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore në tremujorin e tretë (TM3) të vitit 2023 ishte 40.9 përqind, që përbën kufizim në analizë krahasuese, megjithatë nëse krahasojmë me periudhën e njëjtë të vitit 2022 tregon për një rritje të shkallës së pjesëmarrjes në fuqinë punëtore për 2.0 pikë përqindje. Megjithatë, ky nivel vlerësohet si relativisht i ulët për shkak të një pjese të konsiderueshme të popullsisë në moshë relativisht të re (nxënës, studentë), si dhe punonjësve të dekurajuar dhe personave që nuk janë aktiv në kërkim të punës.

Grafik 7. Regjistri i bizneseve



Burimi: ASK (2024)

Grafik 8. Struktura e ndërmarrjeve të reja



Burimi: ASK (2024)

¹ Baza e të dhënave të ASK-së/Statistikat Afatshkurtra të Tregtisë me Pakicë dhe Statistikat Afatshkurtra të Industrisë.

² Të dhënat e fundit për tregun e punës janë për tremujorin e parë të vitit 2023.

Sipas Anketës së Fuqisë Punëtore të ASK-së, shkalla mesatare e punësimit³ në TM3 të vitit 2023 ishte 36.6 përqind, që paraqet një rritje vjetore prej 1.9 pikë përqindje. Shkalla e punësimit ishte më e lartë te meshkujt, me 53.9 përqind, një rritje vjetore prej 3.1 pikë përqindje në krahasim me vitin paraprak, ndërsa, përqindja e femrave të punësuar ishte 20.2 përqind, një rritje vjetore prej 1.1 pikë përqindje në krahasim me vitin 2022.

Gjithashtu, sipas të dhënave nga anketa e lartpërmendur, popullsia e moshës 35-44 vjeç ka normën më të lartë të punësimit (46.5 përqind), ndërsa grup-mosha 15-24 vjeç (siç ASK i kategorizon) ka normën më të ulët të punësimit (18.7 përqind). Sipas nivelit arsimor, shkalla më e lartë e punësimit rezultoi të jetë në mesin e fuqisë punëtore me arsim të lartë, pasuar nga ata me arsim të mesëm.

Diktuar edhe nga struktura e ekonomisë, shkalla e punësimit është më e lartë në sektorin e tregtisë (19.9 përqind e të punësuarve), pasuar nga sektori i ndërtimitarisë (12.6 përqind), sektori i arsimit (10.0 përqind), sektori i prodhimit (9.1 përqind), etj. Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2022, të dhënat tregojnë për një rritje në pjesëmarrjen e të punësuarve në sektorët e tregtisë, ndërtimitarisë, arsimit dhe prodhimit.

Statistikat zyrtare të tregut të punës tregojnë se shkalla mesatare e papunësisë⁴ në TM3 të vitit 2023 ishte 10.6 përqind, një nivel më i ulët sesa në periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Në baza gjinore, tregu i punës në Kosovë karakterizohet nga një shkallë më e lartë e papunësisë te femrat (18.6 përqind) sesa tek meshkujt (7.0 përqind). Sidoqoftë, edukimi ka përmirësuar perspektivat në tregun e punës në Kosovë, ku shkalla e papunësisë më e lartë është për personat pa shkollim (rreth 27.0 përqind, ndërsa më e ulëta për ata me arsimim terciar 7.2 përqind).

3.2. Sektori fiskal

Gjatë vitit 2023, sektori fiskal u karakterizua me rritje të konsiderueshme të të hyrave dhe shpenzimeve buxhetore. Të hyrat buxhetore⁵ arritën vlerën neto prej 2.84 miliardë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 14.4 përqind. Rritja e të hyrave buxhetore ishte si rezultat i rritjes së aktivitetit ekonomik, normës ende të lartë të inflacionit, si dhe përpjekjeve për formalizimin e ekonomisë, duke kontribuar në bilanc primar buxhetor prej 0.2 përqind të BPV-së kundrejt bilancit primar buxhetor prej -0.2 përqind të BPV-së në vitin paraprak.

Tek të hyrat tatimore, pothuajse të gjitha kategoritë shënuan rritje. Rritja më e lartë është shënuar te të hyrat tatimore direkte, të cilat arritën vlerën prej 490.3 milionë euro, apo 18.5 përqind më shumë krahasuar me vitin 2022. Të hyrat tatimore indirekte shënuan rritje prej 11.0 përqind, duke arritur vlerën prej 2.08 miliardë euro. Ndërkohë, të hyrat jo-tatimore shënuan gjithashtu rritje prej 26.0 përqind duke arritur vlerën prej 344.2 milionë euro.

Shpenzimet buxhetore⁶ gjithashtu shënuan rritje dyshifrore prej 13.1 përqind, duke arritur vlerën prej 2.82 miliardë euro. Kategoria që shënoi rritjen më të lartë ishte ajo e shpenzimeve kapitale me 32.2 përqind apo në vlerë prej 554.4 milionë euro. Shpenzimet rrjedhëse shënuan gjithashtu rritje prej 9.3 përqind me vlerë prej 2.27 miliardë euro. Në kategorinë e shpenzimeve rrjedhëse, shpenzimet qeveritare për mallra dhe shërbime (përfshirë shpenzimet komunale) shënuan rritje për 17.9 përqind apo 423.8 milionë euro, ndërsa shpenzimet qeveritare për paga shënuan rritje për 17.5 përqind apo në terma nominal në vlerë prej 766.6 milionë euro. Subvencionet dhe transferet shënuan rritje të ngadalësuar prej 1.3 përqind duke arritur vlerën prej 1.08 miliardë euro.

³ Shkalla e punësimit paraqet përqindjen e popullsisë në moshë pune që është e punësuar.

⁴ Shkalla e papunësisë është përqindja e fuqisë punëtore që nuk është e punësuar.

⁵ Në kuadër të të hyrave buxhetore nuk përfshihen pranimet nga financimi.

⁶ Në kuadër të shpenzimeve buxhetore nuk përfshihen pagesat për financim.

Borxhi publik në vitin 2023 ishte në vlerë prej 1.66 miliardë euro apo për 5.1 përqind më i ulët në krahasim me vitin paraprak. Në raport me BPV-së, përqindja e borxhit publik u ul në 17.2 përqind krahasuar me 19.9 përqind sa ishte vitin e kaluar. Për shkak të rritjes së likuiditetit të Qeverisë, borxhi i brendshëm publik shënoi rënie prej 12.8 përqind (i cili ishte 970.2 milionë euro). Në anën tjetër, borxhi i jashtëm publik shënoi rritje prej 8.1 përqind duke arritur nivelin prej 692.9 milionë euro apo 41.7 përqind të gjithsej borxhit publik.

Shuma e shpallur në ankande gjatë vitit 2023 arriti vlerën prej 145.0 milionë euro apo 40.8 përqind më pak krahasuar me vitin 2022, ndërsa shuma e pranuar ishte 106.9 milionë euro ose 52.2 përqind më pak sesa në vitin 2022. Edhe kërkesa për të investuar në bono dhe obligacione qeveritare ishte më e ulët për 50.2 përqind krahasuar me vitin paraprak. Norma mesatare e interesit në Letrat me Vlerë të Qeverisë së Kosovës shënoi rritje, duke arritur 3.35 përqind krahasuar me 2.81 përqind në vitin 2022. Struktura e Letrave me Vlerë të Qeverisë së Kosovës në vitin 2023 dominohej kryesisht nga letrat me vlerë me afat maturimi prej tre vitesh, duke përbërë 51.7 përqind të gjithsej letrave me vlerë, që ndryshon nga struktura e vitit të kaluar që dominohej nga letrat me vlerë prej pesë vitesh dhe përbënin 46.9 përqind të gjithsej letrave me vlerë.


3.3. Sektori i jashtëm

Sektori i jashtëm në Kosovë u karakterizua me zvogëlim të deficitit kundrejt vitit paraprak në të dy llogaritë e bilancit të pagesave - llogarinë rrjedhëse dhe llogarinë financiare. Në zvogëlimin e deficitit të llogarisë rrjedhëse ndikoi kryesisht rritja e bilancit të shërbimeve, si dhe të ardhurave parësore dhe dytësore. Ndërsa, llogaria e mallrave, si një ndër kategoritë përcaktuese të dinamikave në llogarinë rrjedhëse, shënoi rritje të deficitit.

Deficiti i llogarisë rrjedhëse në vitin 2023 arriti vlerën prej 738.4 milionë euro apo 7.6 përqind e BPV-së, duke shënuar rënie vjetore prej 19.5 përqind në krahasim me vitin e kaluar. Deficiti tregtar i mallrave sipas llogarisë rrjedhëse shënoi rritje prej 7.3 përqind, duke arritur vlerën prej 4.6 miliardë euro. Në të njëjtën kohë, rritja e bilancit pozitiv në llogarinë e shërbimeve për 18.6 përqind, llogarisë së të ardhurave parësore për 58.4 përqind dhe të ardhurave dytësore për 8.8 përqind, zbutën deri në një masë ndikimin negativ të dinamikave në tregtinë e mallrave.


Eksporti i mallrave në vitin 2023 shënoi rënie vjetore prej 6.2 përqind duke arritur vlerën prej 863.1 milionë euro (shih Grafikon 9). Struktura e mallrave sipas kategorive mbeti kryesisht e pa ndryshuar. Rënia e eksportit të mallrave u ndikua nga eksporti i produkteve minerale, me rënie prej 52.5 përqind kundrejt vitit paraprak, si dhe artikujve tjerë të prodhuar që kontribuan me rënie prej 24.9 përqind, kryesisht për shkak të zvogëlimit të eksportit në tregun e SHBA-së. Metalet bazë patën

Grafik 9. Eksportet, importet dhe bilanci tregtar i mallrave



Burimi: ASK (2024)

Grafik 10. Struktura e eksportit të mallrave, sipas kategorive



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës dhe Publikimet e BQK-së (2024)

poashtu rënie prej 15.2 përqind, pjesërisht për shkak të çmimeve në tregjet ndërkombëtare dhe dobësimin të kërkesës në tregun e jashtëm (shih Grafikon 10). Të dhënat nga Dogana e Kosovës tregojnë se në vitin 2023, eksporti u dominua nga produktet e dyshekëve, energjia elektrike, dyert dhe dritaret nga plastika, dhe metalet bazë. Partnerët kryesorë për eksport të mallrave në vitin 2023 ishin vendet e BP me 39.8 përqind dhe vendet e BE-së me 32.3 përqind, me Gjermaninë që vazhdon ta ketë peshën kryesore me 10.8 përqind të gjithsej eksporteve. Ndërkohë që struktura e mallrave të eksportuara mbeti e koncentruar gjeografikisht, Kosova rezultoi të ketë ruajtur shtrirjen në eksportin e mallrave në gjithsej 140 shtete.


Vlera e gjithsej mallrave të importuara gjatë vitit 2023 arriti në vlerë prej 5.9 miliardë euro apo 61.3 përqind e BPV-së, një rritje vjetore prej 4.9 përqind. Rritja e importit gjatë vitit 2023 kryesisht i atribuohet dinamikave të çmimeve në tregjet ndërkombëtare, por edhe rritjes së sasisë dhe peshës së mallrave të importuara të cilat rezultojnë të kenë shënuar rritje për 11.6 respektivisht 8.3 përqind. Struktura e mallrave të importuara mbeti e pa ndryshuar, e dominuar nga produktet minerale,

artikujt ushqimorë dhe makineritë përfshirë pajisjet shtëpiake (shih Grafikon 11). Në kuadër të strukturës së importeve, mallrat e ndërmjetme vazhdojnë të kenë pjesëmarrjen më të lartë në gjithsej mallrat e importuara në vend (46.4 përqind), ndërsa mallrat konsumuese kanë një pjesëmarrje më të ulët (32.5 përqind). Pjesëmarrja e mallrave kapitale mbetet ende e ulët (10.3 përqind), megjithatë shënoi rritje vjetore prej 13.2 përqind. Të dhënat nga Dogana e Kosovës tregojnë se në vitin 2023, importi u dominua nga vajrat motorike, tubat prej çeliku dhe automjetet. Importi i mallrave vazhdon të ruajë strukturën gjeografike të njëjtë, me 43.0 përqind të mallrave të importuara nga vendet e BE-së, 15.7 përqind nga vendet e rajonit, 14.8 përqind nga Turqia, 11.0 përqind nga Kina, etj.

Tregtia në shërbime gjatë vitit 2023 u karakterizua me rritje të bilancit pozitiv, që arriti vlerën prej 1.6 miliardë euro apo 16.9 përqind e BPV-së. Eksporti i shërbimeve shënoi rritje prej 18.4 përqind, duke arritur vlerën prej 2.9 miliardë euro. Kontribut kryesor në rritjen e eksportit të shërbimeve kishte eksporti i shërbimeve të udhëtimit, që u karakterizua me rritje prej 17.7 përqind dhe arriti në 2.2 miliardë euro. Dinamikat në këtë kategori kryesisht reflektojnë shpenzimet e diasporës në Kosovë, por edhe rritjen e numrit të udhëtarëve me 14.0 përqind dhe rritjen e numrit të fluturimeve me 7.0 përqind krahasuar me vitin paraprak.⁷ Rritja vjetore e shërbimeve të teknologjisë informative dhe shërbimeve të tjera të biznesit gjithashtu kontribuoi pozitivisht. Në anën tjetër, importi i shërbimeve shënoi rritje prej 18.2 përqind dhe arriti vlerën prej 1.3 miliardë euro, ndikuar nga rritja e importit të shërbimeve të udhëtimit për 39.2 përqind që përbën rreth 46.8 përqind të gjithsej importit të shërbimeve. Pas liberalizmit të vizave në janar të vitit 2024, pritjet që importi i shërbimeve të udhëtimit të shënojë rritje, gjë që mund të ndikojë në bilancin e shërbimeve dhe rrjedhimisht në rritjen e bilancit negativ të llogarisë rrjedhëse.

Bilanci i të ardhurave parësore këtë vit arriti vlerën prej 183.0 milionë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 58.4 përqind. Kjo rritje u ndikua kryesisht nga të ardhurat e kompensimit të punëtorëve, bilanci i të cilave arriti vlerën prej 338.0 milionë euro, një rritje prej 18.0 përqind krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Në të njëjtën kohë, bilanci i të ardhurave nga

Grafik 11. Struktura e importit të mallrave, sipas kategorive



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës dhe Publikimet e BQK-së (2024)

⁷ Të dhënat rreth numrit të udhëtarëve dhe fluturimeve nga Autoriteti i Aviacionit Civil i Republikës së Kosovës

investimet ishte negativ në vlerë prej 155.8 milionë euro si pasojë e kthimit të dividendës nga investimet e huaja direkte.

Vlera e remitencave të pranuar në vitin 2023 arriti në 1.3 miliardë euro, një rritje prej 9.9 përqind krahasuar me vitin paraprak, apo 13.9 përqind e BPV-së (shih Grafikon 12). Tri shtetet kryesore nga ku dërgohen remitencat mbesin të pandryshuara, ku prin Gjermania me 38.2 përqind të total remitencave, Zvicra me 18.8 përqind dhe SHBA me 7.3 përqind. Dërgesat e remitencave sipas kanaleve formale (bankat dhe institucione tjerat) kanë shënuar rritje prej 7.3 përqind, sikurse edhe ato sipas kanaleve të tjera që shënuan rritje prej 17.4 përqind.


Në kuadër të llogarisë financiare, IHD-të hyrëse në vitin 2023 shënuan rritje vjetore prej 15.3 përqind dhe arritën vlerën prej 844.3 milionë euro (8.7 përqind e BPV-së) (shih Grafikon 13). Sektori i patundshmërisë vazhdon të prijë në pjesëmarrje me 60.6 përqind të gjithsej IHD-ve hyrëse, që si sektor megjithatë, shënoi rënie të lehtë prej 3.4 përqind krahasuar me vitin paraprak. Këtë vit është vërejtur rritje e lehtë e IHD-ve hyrëse në sektorin financiar përfshirë sigurimet dhe furnizimin me energji elektrike. Tri shtetet kryesore prej nga vijnë IHD-të hyrëse janë Gjermania me 22.6 përqind të gjithsej IHD-ve hyrëse, Zvicra me 20.8 përqind, dhe ShBA-të me 7.9 përqind. IHD-të dalëse apo investimet direkte të rezidentëve nga Kosova në vendet tjera shënuan rritje prej 8.0 përqind në vitin 2023, duke arritur vlerën prej 189.2 milionë euro në krahasim me 175.2 milionë euro sa ishin në vitin 2022. Rreth 82.0 përqind apo 155.1 milionë euro e investimeve direkte jashtë vendit janë të orientuara në sektorin e patundshmërisë dhe janë të destinuara kryesisht në vendet e rajonit. Gjatë viteve të fundit është shënuar rritje e investimeve direkte me origjinë nga Kosova edhe në vendet e BE-së, veçanërisht në Gjermani, të cilat arritën vlerën prej 17.8 milionë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 9.1 përqind.

3.4. Sektori financiar

3.4.1 Karakteristikat e përgjithshme


Sistemi financiar në vend ka vazhduar të zgjerohet me ritëm të lartë edhe në vitin 2023, duke mbyllur vitin me rritje vjetore të përsheptuar të aseteve. Sistemi u zgjerua përkundër rreziqeve që buruan nga faktorët e përkeqësuar

Grafik 12. Remitencat




Burimi: BQK (2024)

Grafik 13. Investimet e huaja direkte



Burimi: BQK (2024)

Grafik 14. Vlera e aseteve të sistemit financiar të Kosovës



Burimi: BQK (2024)

makroekonomik, të ndikuar nga situata gjeopolitike, si dhe efektet e akumuluarra të inflacionit. Ndërsa, zhvillimet në vitin vijues janë subjekt i dinamikave në treguesit makroekonomik, të cilat pritet të jenë më pozitive, si dhe kapacitetit të ngritjes së fondeve përmes rritjes së depozitave dhe sigurimit të financimit nga jashtë.

Gjatë këtij viti, asetet e sistemit financiar u rritën për 1.22 miliardë euro apo për 12.4 përqind duke arritur vlerën prej 11.1 miliardë euro. Sektori bankar vazhdon të ketë kontributin kryesor në rritjen e asetëve, përkundër ngadalësimit të shkallës së rritjes, përderisa të gjithë sektorët tjerë u karakterizuan me rritje të përshpejtuar vjetore (shih Grafikon 14).

Numri i institucioneve financiare u shtua në 136 nga 131 sa ishte një vit më parë, dy nga këto ishin institucione financiare jo bankare, dy ndihmësve financiar dhe një ndërmjetës në sigurime (shih Tabelën 3).

Tabela 3. Numri i institucioneve financiare

Përshkrimi	2019	2020	2021	2022	2023
Bankat komerciale	10	11	11	12	12
Siguruesit	13	13	12	12	12
Fondet pensionale	2	2	2	2	2
Ndihmësit financiar	50	57	53	59	61
Ndërmjetësuesit në sigurime	18	18	19	16	17
Institucionet mikrof financiare dhe financiare jobankare	29	29	30	30	32

Burimi: BQK (2024)


3.4.2 Sektori Bankar

Asetet

Asetet e sektorit bankar në vitin 2023 arritën vlerën e 7.54 miliardë eurove, që përkon me një rritje vjetore prej 11.5 përqind apo për 1.9 pikë përqindje më e ulët nga rritja e vitit paraprak (shih Grafikon 15). Kjo dinamikë u ndikua nga aktiviteti kreditues - si aktiviteti kryesor i sektorit bankar - i cili u rrit me ritëm më të ngadalësuar se viti paraprak. (shih Tabelën 4). Ambienti i normave më të larta të interesit në tregje ndërkombëtare ndikoi që zëri i investimeve në letrat me vlerë të rritet me ritëm më të shpejtë, ndërsa, zërat me kthim më të ulët si bilanci në bankat tjera dhe zëri i parasë së gatshme dhe bilancit me BQK-në shënuan ngadalësim të rritjes. Konkretisht, investimet në letra me vlerë shënuan rritje vjetore prej 19.0 përqind krahas rritjes prej 9.8 përqind në vitin paraprak. Kurse, zëri i parasë së gatshme dhe bilancit me BQK-në shënoi ngadalësim të rritjes, në 3.9 përqind nga 4.5 përqind rritje në vitin paraprak.

Shkalla e koncentrimin në tregun bankar edhe këtë vit mbeti në nivel të ngjashëm, me tendencë të lehtë rënëse në disa nga treguesit e koncentrimin. Asetet e pesë bankave më të mëdha zvogëluar lehtë peshën e tyre në 84.3 përqind të gjithë asetëve të sektorit nga 84.9 përqind sa ishte në vitin paraprak. Ndërsa, tri bankat më të mëdha kanë zvogëluar lehtësisht koncentrimin e tyre në treg, në 52.3 përqind nga 52.7 përqind një vit më parë. Hyrja në treg e bankës së tretë vendore në vitin

Grafik 15. Zërat kryesorë të asetëve të sektorit bankar, në milionë euro



Burimi: BQK (2024)

2022, ndikoi që bankat vendore të rrisin pjesëmarrjen në asetet e sektorit për 0.6 pikë përqindje, duke arritur pjesëmarrjen prej 15.7 përqind në fund të vitit 2023. Indeksi Herfindal-Hirschman(HHI)⁸ për asetet e sektorit bankar zbriti marginalisht në 1,391.5 pikë nga 1,393.1 pikë sa ishte në vitin e kaluar.

Tabela 4. Struktura e aseteve të sektorit bankar

Përshkrimi	2019		2020		2021		2022		2023	
	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)
Paraja e gatshme dhe bilanci me BQK-në	622.5	13.1%	790.6	14.8%	839.9	14.1%	877.4	13.0%	911.8	12.1%
Bilanci me bankat komerciale	440.6	9.3%	562.2	10.5%	496.1	8.3%	575.2	8.5%	600.0	8.0%
Letrat me vlerë	526.5	11.1%	584.3	10.9%	685.0	11.5%	752.1	11.1%	895.0	11.9%
Kreditë bruto	3,031.9	63.7%	3,246.6	60.6%	3,748.6	62.9%	4,348.5	64.3%	4,913.8	65.2%
Asetet Fikse	98.9	2.1%	116.4	2.2%	127.4	2.1%	136.1	2.0%	149.5	2.0%
Asetet Tjera	40.1	0.8%	53.2	1.0%	62.7	1.1%	71.4	1.1%	71.0	0.9%
Gjithsej	4,760.5	100%	5,353.4	100%	5,959.6	100%	6,760.6	100.0%	7,541.1	100.0%


Burimi: BQK (2024)

Kreditë

Aktiviteti kreditues i sektorit bankar gjatë vitit 2023 shënoi rritje vjetore prej 13.0 përqind, që ishte më i larti në rajon (pothuajse dyfish, shih tabela 2), megjithatë përkon me shkallë më të ulët të rritjes vjetore prej 3.0 pikë përqindje krahasuar me vitin paraprak. Ky zhvillim kryesisht reflekton ecurinë e rritjes së kreditimit për ndërmarrje (korporatat jo-financiare), ndërsa kreditë për ekonomitë familjare shënuan rritje më të lartë se një vit më parë. Sipas Anketës së Kreditimit bankar (AKB), dinamikat e kreditimit u ndikuan nga kërkesa kreditore, ndërkohë që oferta kreditore kishte ndryshime marginale. Në fund të vitit 2023, gjithsej stoku i kredive arriti në 4.91 miliardë euro nga 4.35 miliardë euro sa ishte një vit më parë.

Kreditë ndaj ndërmarrjeve (korporatat financiare) shënuan rritje vjetore prej 10.1 përqind, që si gjendje (stok) është për 5.6 pikë përqindje më ulët se në vitin e kaluar, por nga një bazë më e lartë (shih Grafikon 16), duke arritur vlerën prej 2.96 miliardë euro. Ngadalësim të rritjes së kreditimit kishte pothuajse në të gjithë sektorët ekonomik në kuadër të kredive për ndërmarrjet, veçanërisht në sektorët me peshë më të lartë në kreditim, siç janë tregtia, prodhimi, dhe ndërtimtaria (shih Grafikon 17). Bankat deklaruan standarde kreditore kryesisht të pandryshuara, si për ndërmarrjet e mëdha ashtu dhe për NVM-të. Ndërsa kishte rritje të kërkesës për kredi deri në një masë nga NVM-të, kërkesa nga ndërmarrjet e mëdha mbeti kryesisht e pandryshuar. Rritja më e ngadalësuar e kreditimit për ndërmarrje është në linjë me zhvillimet e përgjithshme makroekonomike dhe orientim drejt frenimit të inflacionit, përkatësisht me rritjen më të ngadalësuar të BPV-së krahasuar me një vit më parë.

Grafik 16. Kreditë e ndërmarrjeve dhe ekonomive familjare



Burimi: BQK (2024)


⁸ Indeksi Herfindahl-Hirschman (HHI) është një numër që tregon sa i përqendruar është një treg: sa më i lartë numri, aq më pak kompani e kontrollojnë atë treg, dhe aq më pak konkurrencë ka.

Kreditimi ndaj sektorit të tregtisë kishte kontributin më të lartë në rritjen e gjithsej kreative për segmentin e korporatave jofinanciare përkundër ngadalësimit të shkallës së rritjes në 8.3 përqind nga 11.8 përqind të një viti më parë. Sektori i prodhimit në vitin 2023 shënoi rritje (neto) dukshëm më të ngadalësuar vjetore prej 5.9 përqind nga 29.4 përqind sa ishte në vitin paraprak. Në vitin e kaluar, ky sektor kishte peshën më të lartë në rritjen e gjithsej kreditimit për ndërmarrjet, ndikuar edhe nga mbështetja nga masat subvencionuese të qeverisë në kuadër të pakos së ringjalljes ekonomike (shih Grafikon 18). Kreditimi ndaj sektorit të ndërtimitarisë gjithashtu shënoi rritje vjetore më të ulët (15.9 përqind) në krahasim me një vit më parë (25.8 përqind). Ky ngadalësim mund t'i atribuohet edhe shkallës së lartë të inflacionit në vitin e kaluar që nxiti rritjen e çmimit të materialeve ndërtimore, me efekt në ritmin ose ngadalësimin e punimeve ndërtimore.. Sektori i bujqësisë, i cili ka pjesëmarrje të ulët në gjithsej kreditimin e sektorit bankar, u karakterizua me rritje të përshpejtuar vjetore prej 25.8 përqind në krahasim me 9.9 përqind të vitit paraprak.

Kreditë e reja gjatë vitit 2023 shënuan rritje vjetore prej 9.9 përqind nga 6.5 përqind rritje në periudhën e njëjtë të vitit paraprak, duke arritur vlerën prej 2.11 miliardë euro (shih Grafikon 19). Ky trend rritës u përcaktua nga kreditë e reja të ekonomive familjare të cilat shënuan rritje prej 14.1 përqind nga 2.4 përqind në vitin paraprak, përdërisa segmenti i ndërmarrjeve u karakterizua me rritje me të ngadalësuar prej 7.1 përqind nga niveli 9.6 përqind i vitit të kaluar. Në kuadër të ndërmarrjeve, ngadalësim të shkallës së rritjes kishin kreditë e reja me karakter investues të cilat u rritën për 3.6 përqind nga 9.0 përqind sa ishte rritja e vitit të kaluar, ndërsa kreditë me karakter jo-investues shënuan rritje vjetore prej 5.6 përqind nga 7.8 përqind në vitin 2022, megjithëse me peshë më të ulët në gjithsej portfolion e kreative të reja ndaj këtij segmenti.


Stoku i kreative për ekonomitë familjare në vitin 2023 shënoi rritje vjetore në 17.3 përqind nga 16.7 përqind në vitin paraprak. Kjo dinamikë u ndikua nga trendi rritës i kreative të reja personale/individuale, të cilat shënuan rritje vjetore prej 23.2 përqind nga rënia prej 6.3 përqind

Grafik 17. Pjesëmarrja e kreative sipas sektorëve ekonomikë, 2023




Burimi: BQK (2024)

Grafik 18. Stoku i kreative sipas sektorëve ekonomikë



Burimi: BQK (2024)

Grafik 19. Kreditë e reja, ndryshimi vjetor



Burimi: BQK (2024)

në vitin e kaluar. Në bazë të të dhënave aktuale, nuk mund të disagregohen qëllimi i tyre, por një shumicë si kredi personale kanë vlera të larta (pra mbi 10,000 euro), dhe ato përdoren për qëllime investuese, megjithëse nuk plotësojnë definicionin të quhen kredi hipotekare. Ndërsa, kreditë e reja që me definicion konsiderohen hipotekare shënuan rënie vjetore prej 11.3 përqind nga rritja prej 13.5 përqind e një viti më parë. Fakti që IHD-të hyrëse në sektorin e patundshmërisë treguan tendencë rënëse shtoi dhe aspektin e rënies së kredive të reja hipotekare, përveç efektit të bazës së rritjes më të lartë në vitin paraprak, mund të sugjerojnë për tendencë të rënies së investimeve të përgjithshme në patundshmëri, të ndikuara prej normave të interesit, si dhe çmimeve të patundshmërive.

Detyrimet dhe burimet vetanake

Financimi i aktiviteteve të sektorit bankar është i mbështetur nga depozitat e klientëve dhe kapitali vetanak. Në dhjetor 2023, depozitat kishin pjesëmarrje prej 81.3 përqind në gjithë strukturën e detyrimeve dhe kapitalit vetanak të sektorit (shih Tabelën 5). Mjetet vetanake që përbejnë komponentën e radhës me pjesëmarrjen më të lartë, rritën pjesëmarrjen për 1.0 pikë përqindje në 11.4 përqind, si rezultat i rritjes së profitit, posaqërisht në dy vitet paraprake.

Tabela 5. Struktura e detyrimeve të sektorit bankar


Përshkrimi	2019		2020		2021		2022		2023	
	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)
Bilanci nga bankat tjera	67.0	1.4%	90.4	1.7%	113.2	1.9%	199.9	3.0%	183.8	2.4%
Depozitat	3,908.1	82.1%	4,360.7	81.5%	4,901.8	82.2%	5,553.3	82.1%	6,129.0	81.3%
Huatë tjera	42.1	0.9%	43.1	0.8%	39.1	0.7%	31.6	0.5%	33.3	0.4%
Detyrimet tjera	179.8	3.8%	202.2	3.8%	220.1	3.7%	252.0	3.7%	287.5	3.8%
Borxhi i ndërruarur	43.4	0.9%	46.9	0.9%	42.3	0.7%	23.0	0.3%	45.0	0.6%
Metet vetanake	520.1	10.9%	610.2	11.4%	643.1	10.8%	701.3	10.4%	862.4	11.4%
Gjithsej detyrimet dhe burimeve vetanake	4,760.5	100.0%	5,353.4	100.0%	5,959.6	100.0%	6,760.6	100.0%	7,541.1	100.0%

Burimi: BQK (2024)

Depozitat

Depozitat e sektorit u karakterizuan me rritje vjetore dyshifrore edhe gjatë vitit 2023, por me ritëm më të ngadalësuar krahasuar me një vit më parë. Në dhjetor 2023, vlera e gjithsej depozitave arriti në 6.13 miliardë euro, që paraqet rritje vjetore prej 10.4 përqind, apo për 2.9 pikë përqindje më e ulët se në vitin paraprak. Depozitat e ekonomive familjare, që dominojnë strukturën e gjithsej depozitave, u karakterizuan me rritje vjetore prej 11.3 përqind nga 8.2 përqind në vitin 2022, duke dhënë kontributin më të lartë në rritjen e gjithsej depozitave (shih Grafikon 20). Ndërsa, trendi ngadalësues i rritjes u përcaktua nga ngadalësimi i rritjes së depozitave të korporatave financiare dhe jo-financiare, si dhe zvogëlimi i depozitave të korporatave publike, të cilat në vitin paraprak kishin rritje të theksuar. Depozitat e ndërmarrjeve ngadalësuan rritjen në 12.9 përqind nga 18.9 përqind të një viti më parë. Depozitat filluan ngadalësimin e rritjes në muajt e fundit të vitit 2023, përderisa gjysma e parë e vitit u karakterizua me rritje më të lartë. Sa i përket strukturës së depozitave sipas maturitetit, rritja e normave të interesit në këto dy vite ndikoi që depozitat e afatizuara të rriten në pjesëmarrje për 1.3 pikë përqindje, ndërsa ato të transferueshme dhe të kursimit të zvogëlojnë lehtësisht pjesëmarrjen për 0.3 dhe 1.0 pikë përqindje të gjithsej depozitave.

Grafik 20. Struktura e depozitave, në përqindje




Burimi: BQK (2024)

Normat e interesit


Rritja e normave të interesit në nivel global gjatë vitit 2023 është përkthyer në rritje të presioneve konkurruese për të siguruar financim të qëndrueshëm. Rrjedhimisht, normat e interesit në depozita u prekën në një magnitudë më të lartë se normat e interesit në kredi të reja, duke qenë edhe shkak i pozicioneve fillestare të tyre, që ishin përgjithësisht të larta në kredi, dhe rrjedhimisht me hapësirë më të kufizuar për t'u rritur tutje, dhe niveleve paraprake veçse të ulëta në depozita. Në dhjetor të këtij viti, norma e interesit në kredi arriti në 6.3 përqind nga 6.6 përqind sa ishte në fillim të vitit, ndërsa, norma mesatare e interesit në depozita u ngrit në 3.1 përqind nga 1.9 përqind sa ishte në fillim të vitit 2023. Rrjedhimisht, margjina e interesit kredi-depozitë u ngushtua në 3.2 pikë përqindje nga 3.9 pikë përqindje sa ishte në dhjetor 2022 (shih Grafikon 21).

Grafik 21. Norma mesatare e interesit në kredi dhe depozita




Burimi: BQK (2024)

Grafik 22. Norma mesatare e interesit në kreditë ndaj ekonomive familjare dhe ndërmarrjeve



Burimi: BQK (2024)

Grafik 23. Norma mesatare e interesit në depozita




Burimi: BQK (2024)

Sidoqftë, pas vendimit nga BQE për të mos rritur tutje normat bazë të interesit, bankat në Kosovë kanë ndalur gjithashtu rritjen e normës së interesit në kredi, përkatësisht, kanë filluar gradualisht zbritjen e tyre, përderisa presionet konkurruese kanë nxitur rritjen tutje të normave të interesit në depozita. Në vitin 2023, norma e interesit në kredi të reja arriti mesataren prej 6.5% nga 6.0% sa ishte në vitin 2022. Ndërsa, norma mesatare e interesit në depozitat e reja u rrit në 2.3% në vitin 2023 nga 1.7% sa ishte në vitin 2022.

Norma mesatare e kredive të ndërmarrjeve shënoi rënie të lehtë vjetore prej 0.03 pikë përqindje në dhjetor 2023, duke qëndruar në 6.5 përqind. Ndërsa, norma mesatare e interesit në kreditë ndaj ekonomive familjare është rritur për 0.24 pikë përqindje, në 6.2 përqind (shih Grafikon 22).


Në kuadër të kredive për ekonomi familjare, normat më të favorshme të interesit janë aplikuar për kreditë hipotekare, në mesatare prej 5.3 përqind, duke qenë se konsiderohen me rrezik më të ulët për shkak të mbulesës me pronën e paluajtshme – subjekt i financimit (hipotekë). Kurse, kreditë konsumuese/individuale vazhdojnë të kenë norma më të larta të interesit prej mesatarisht 6.4 përqind sa ishin në dhjetor 2023.

Grafik 24. Norma mesatare e interesit në depozitat e ndërmarrjeve, sipas kategorive



Burimi: BQK (2024)


Grafik 25. Norma mesatare e interesit në depozitat e ekonomive familjare, sipas kategorive



Burimi: BQK (2024)

Normat e interesit në depozita filluan trendin rritës që nga muaji qershor i vitit 2022 dhe i njëjti trend rritës vazhdoi edhe përgjatë vitit 2023. Norma mesatare e interesit në depozita për korporatat jofinanciare është rritur për 1.2 pikë përqindje brenda vitit, duke arritur në 3.7 përqind në dhjetor 2023. Rritja e normave të interesit për depozitat e ekonomive familjare ishte më e ulët, për 0.6 pikë përqindje, duke arritur në 2.5 përqind në dhjetor 2023 (shih Grafikët 24-25).

Figura 26. Stoku i kredive, sipas normave të interesit fikse apo variabile (në përqindje)



Burimi: BQK (2024)

Ndryshimet në normat bazë të interesit janë reflektuar edhe në segmentet tjera të tregut bankar e financiar, por në nivele të ndryshme. Norma ndërbankare e riblerjes (*repo rate*), e përcaktuar nga BQK në tregun ku linjat kreditore lëshohen ndërmjet bankave bazuar në letrat me vlerë të Qeverisë si kolateral, ka vazhduar të ndjekë vendimet e politikës monetare të BQE-së duke qenë në të njëjtën linjë me nivelin e normave bazë të përcaktuara në Eurozonë.

Dinamika e normave të interesit në tri-katër vitet e fundit, kanë ndryshuar edhe strukturën e kredive sipas llojit të normave të interesit. Në veçanti, është rritur pjesëmarrja e kredive me norma variabile të interesit, të cilat kryesisht bazohen në normën Euribor. Pjesëmarrja e kredive me normë variabile pothuajse është dyfishuar nga fundviti 2019, duke arritur në 33.8 përqind të gjithsej portfolios kreditore në dhjetor 2023 (shih Grafikon 26).

Performanca e sektorit bankar


Profitabiliteti i sektorit bankar në vitin 2023 u ndikua asimetrikisht nga rritja e normave të interesit, me disa banka që patën një rritje substanciale të fitimeve nga rritja e të ardhurave nga interesi në kredi, dhe të tjera që u përballën me shpenzime më të larta të interesit dhe administrative, dhe rrjedhimisht shënuan rritje më të ulët të profitit.

Në fund të vitit 2023, profiti neto i gjithsej sektorit arriti në 155.3 milionë euro, që megjithatë përkon me një rritje më të ngadalësuar vjetore prej 10.7 përqind nga rritja prej 19.4 përqind e vitit paraprak (shih Grafikon 27). Rezultati i tillë financiar reflekton rritjen e të hyrave nga interesi në kredi përdorues ngadalësimi i rritjes së profitit në raport me dy vitet e kaluara është ndikuar nga rritja e lartë e shpenzimeve të interesit dhe atyre administrative. Presionet konkurruese për tërheqje dhe mbajtje të depozitorëve kanë afektuar më shumë bankat më të vogla, përdorues, bankat më të mëdha kanë përfituar nga baza e gjerë e depozituesëve. Ndërsa, me rritje të shpenzimeve administrative janë përballur të gjitha bankat, duke reflektuar rritjen e përgjithshme të çmimeve dhe kompensimin e punëtorëve në një ambient konkurrues (shih Grafikon 28).

Në rritjen e të hyrave, kontributin kryesor e kishin të hyrat nga interesi, që përfaqësojnë 74.5 përqind të gjithsej të hyrave. Në kuadër të të hyrave nga interesi, arkëtimet nga interesi në kredi kontribuan kryesisht në këtë rritje, kategori e ndikuar prej rritjes së theksuar të kreditimit dhe njëkohësisht normave të rritura të interesit në kredi në vitet e fundit. Të hyrat nga letrat me vlerë kanë shënuar poashtu rritje si rezultat i rritjes së investimeve në këtë kategori që ka siguruar kthime më të larta, përdorues, plasmanet me bankat kanë shënuar rritje dukshëm më të ngadalësuar në raport me vitin paraprak. Kategoria e të hyrave nga jo interesi, kryesisht nga tarifat dhe komisionet, shënoi rritje më të ngadalësuar vjetore prej 3.2 përqind nga rritja prej 8.0 përqind një vit më parë, duke arritur vlerën prej 95.7 milionë euro në fund të vitit 2023.


Shpenzimet e sektorit bankar këtë vit arritën vlerën në 279.6 milionë euro, e karakterizuar me rritje më të përshpejtuar vjetore prej 21.5 përqind nga rritja prej 12.4 përqind një vit më parë (shih Grafikon 28). Kontributin më të lartë në këtë rritje kishte rritja e shpenzimeve të përgjithshme dhe administrative, si dhe shpenzimeve të interesit. Kategoria me peshën më të lartë në gjithsej shpenzimet, ajo e shpenzimeve të përgjithshme dhe administrative me pjesëmarrje prej 56.1 përqind, u rritën për 15.9 përqind nga 12.1 përqind rritje në vitin e kaluar, dhe arritën vlerën në 156.8 milionë euro në fund të vitit 2023. Rritja e kësaj kategorie kryesisht reflekton rritjen e shpenzimeve të personelit. Tutje, shpenzimet e interesit shënuan rritje vjetore prej 55.4 përqind nga rritja prej 9.1 përqind në vitin paraprak, që i atribuohet rritjes së normave të interesit në të gjitha kategoritë që krijojnë shpenzime të interesit dhe njëkohësisht rritjes së stokut të depozitave.

Grafik 27. Profiti neto i sektorit bankar, në milionë euro



Burimi: BQK (2024)


Grafik 28. Të hyrat dhe shpenzimet e sektorit bankar



Burimi: BQK (2024)

Rritja më e lartë e shpenzimeve krahasuar me rritjen e të hyrave ndikoi që raporti i shpenzimeve ndaj të hyrave të sektorit të jetë më i lartë në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit paraprak (shih Grafikon 28). Dinamika e tillë e profitit ndikoi që edhe Kthimi në Kapital të jetë më i ulët, përkatësisht në raportin prej 19.7 përqind nga 20.6 përqind një vit më parë. Ndërsa kthimi në asete mbeti në nivelin e njëjtë prej 2.5 përqind (shih Grafikon 29).

Grafik 29. Treguesit e profitabilitetit të sektorit bankar




Treguesit e shëndetit financiar

Sektorit bankar ndër vite ka arritur të siguroj nivel të lartë të kapitalizimit dhe likuiditetit, si dhe të mbaj nivel të ulët të kredive jo-performuese. Nivelet e këtyre indikatorëve, përtej kërkesave rregullatore, i japin përparësi sektorit në absorbimin e humbjeve të mundshme që do të shkaktoheshin në rast të ndonjë goditje të mundshme makroekonomike dhe financiare.

Përkundër disa faktorëve sfidues si inflacioni i lartë, kushtet më të shtrënguara të financimit, të cilat paraqitën rreziqe të shtuara, ndikuan koston e financimit dhe fuqinë blerëse, ato u përballuan me sukses dhe nuk u materializuan në performancën e sektorit bankar nga sistemi financiar. Kapaciteti i ripagimit mbeti i mirë dhe i qëndrueshëm, i mbështetur nga qasje e kujdesshme dhe prudente, mbështetur edhe nga rritja e pagave dhe burimeve tjera të financimit.

Megjithëse, konform pritjeve si rezultat i rreziqeve të shtuara, vlera e kredive joperformuese shënoi rritje, ku ekspozimet jo-performuese u rritën për 12.1 përqind krahasuar me rritjen prej 4.3 përqind një vit më parë, raporti i kredive jo-performuese qëndroi në nivelin e njëjtë të ulët prej 2.0 përqind, për shkak të rritjes së theksuar të kreditimit. Mbulueshmëria me provizione nga humbjet e mundshme nga kreditë u zvogëlua paksa në 147.1 përqind nga 151.7 përqind sa ishte në vitin paraprak, për shkak të rritjes më të lartë të vlerës së kredive jo-performuese sesa i vlerës së provizioneve të ndara për mbulimin e kredive (shih Grafikon 30).

Grafik 30. Treguesit e kualitetit të portofolios kreditore dhe norma e rritjes së KJP-ve



Pozicioni i kapitalit në vitin 2023 është rritur në 16.5 përqind nga 15.5 përqind një vit më parë si rezultat i profitit të qëndrueshëm dhe nivelit të ultë të shpërndarjes së dividendës. Asetet e peshuara me rrezik shënuan rritje prej 13.4 përqind, ndërsa kapitali shënoi rritje më të lartë vjetore prej 20.5 përqind për shkak të qasjes kapitalizuese, dinamikë që u reflektua në rritje të treguesit të mjaftueshmërisë së kapitalit. Përkundër nivelit të lartë të likuiditetit dhe burimit të qëndrueshëm të financimit siç janë depozitat, rreziku i likuiditetit kërkon monitorim të vazhdueshëm, duke marrë parasysh rrethanat e tregut. Sektorit bankar shënoi ndryshime në strukturën e financimit dhe investimeve në përpjekje të vazhdueshme të adaptimit ndaj kushteve të reja të krijuara në treg, si rritja e koston të financimit dhe njëkohësisht rritja e mundësive atraktive për investim. Presionet konkurruese në sigurim të depozitave pritet që të ndikojnë disa banka të përshtatin strukturën e tyre të financimit duke u

mbështetur në financimin nga klientët institucional. Në anën tjetër, rritja e kostos oportune të mbajtjes së parasë së gatshme dhe mundësitë më të mëdha për kthim nga investimet në tregje të jashtme, mund të nxisin investime në mjete më pak likuide, por me kthim më të lartë.


Rrjedhimisht, paraqitet nevoja për monitorim më të afërt të lëvizjes së depozitave dhe përbërjes së tyre në raport me koncentrimin në depozitorë të mëdhenj, si dhe cilësisë së përgjithshme të investimeve. Në dhjetor 2023, raporti i likuiditetit kishte vlerën prej 34.7 përqind, që paraqet rënie të lehtë prej 1.8 pikë përqindje, krahasuar me vitin e kaluar. Rënia e lehtë e raportit i atribuohet rritjes më të theksuar të detyrimeve afatshkurtëra prej 10.0 përqind ndikuar nga rritja e depozitave, sesa rritjes së mjeteve likuide prej 4.6 përqind, që është rezultat i zvogëlimit të bilanceve në llogari rrjedhëse, plasmanëve dhe depozitave në bankat vendore, si dhe investimeve në obligacione qeveritare vendore. Raporti kredi-depozitë në vitin 2023 është rritur në 80.2 përqind nga 78.3 përqind sa ishte në vitin paraprak, për shkak të rritjes më të theksuar të kreditimit sesa depozitimit. Në anën tjetër, treguesi i mbulimit me likuiditet në fund të vitit 2023, u rrit dukshëm dhe qëndroi në 279.7 përqind nga 228.2 përqind sa ishte në fillim të këtij viti.

3.4.3 Sektori pensional

Asetet e sektorit pensional shënuan rritje të lartë në vitin 2023 pas ngadalësimit të theksuar një vit më parë. Përkundër efekteve negative si rezultat i tensioneve gjeopolitike dhe presioneve inflacioniste që shkaktuan luhatshmëri në tregjet financiare, të dy fondet pensionale shënuan kthim pozitiv nga investimet, duke përfituar nga normat e larta të interesit të afektuara nga efektet e politikave të shtrenguara monetare në luftën kundër inflacionit.


Sektori pensional i Kosovës dominohet nga asetet e Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës (FKPK), me pjesëmarrje prej 99.7 përqind. Në vitin 2023, vlera e aseteve të FKPK arriti në 2.71 miliardë euro, që përkon me një rritje vjetore prej 12.1 përqind krahasuar me 2.4 përqind sa ishte vitin e kaluar (shih Grafikon 31). Rritja e lartë ishte rezultat i kthimit pozitiv nga investimet në sektorin e jashtëm. Poashtu, të hyrat nga kontributdhënësit kanë vazhduar trendin rritës, me theks të veçantë në dy vitet e fundit, që ndër tjerash, reflekton rritjen e nivelit të pagave, përfshirë përshtatjen ndaj inflacionit, si dhe rritjen e pagave të shërbyesve civil në fillim të vitit 2023. Realizimi i kthimit pozitiv në investime, veçanërisht në TM4 të vitit 2023 që ishte në vlerë prej 40.1 milionë euro, u ndikua pozitivisht nga rritja e vlerës së aksioneve që janë afektuar nga sinjalet e politikave monetare për mosrritje tutje të normave bazë të interesit. Kthimi bruto kumulativ nga investimet në vitin 2023 arriti në 87.7 milionë euro. (shih Grafikon 32).

Grafik 31. Asetet e sektorit pensional, në milionë euro



Burimi: BQK (2024)

Grafik 32. Performanca e FKPK-së



Burimi: FKPK (2024)


Fondi Slloveno-Kosovar i Pensioneve (FSKP), që përbën 0.3 përqind të gjithsej aseteve pensionale, gjithashtu realizoi kthim pozitiv nga investimet në vitin 2023 në vlerë prej 817.0 mijë euro nga humbjet prej 788.6 mijë euro të një viti më parë, përdërisa vlera e çmimit të aksionit në ditën e fundit të vitit 2023 arriti në 196⁹ euro nga 181 euro sa ishte në ditën e fundit të vitit 2022.

Vlera e kontributeve të reja që sektori pensional arkëtoi në vitin 2023 shënoi rritje vjetore prej 18.5 përqind nga 13.1 përqind një vit më parë dhe arriti në 286.8 milionë euro nga 242.1 milionë euro sa ishte në vitin paraprak. Vlera e arkëtimeve të FKPK-së arriti në 286.2 milionë euro, ndërsa të FSKP-së në 667.0 mijë euro.


Asetet e FKPK-së janë të investuara kryesisht në tregun e jashtëm, në fonde të përbashkëta, me pjesëmarrje prej 74.5 përqind në gjithsej portfolion investuese. Investimet në portfolion e fondeve të përbashkëta janë rritur dukshëm duke arritur vlerën 2.01 miliardë euro, ndërsa pjesa tjetër e investimeve është e diversifikuar në tregun e brendshëm (shih Grafikët 33 dhe 35). Përdërisa investimet në tregjet e jashtme janë rritur, ato në tregun vendor shënuan rënie, me përjashtim të parasë së gatshme dhe bilancit të mbajtur në BQK, i cili shënoi rritje. Investimet në letra me vlerë të Qeverisë së Kosovës në fund të vitit 2023 zbritën në 447.1 milionë euro duke zvogëluar pjesëmarrjen në 16.5 përqind të gjithsej portfolios investuese nga 23.0 përqind pjesëmarrje një vit më parë. Kategoria e çertifikatave të depozitit në bankat vendore zbriti në 90.1 milionë euro, duke zvogëluar pjesëmarrjen në 3.3 përqind të gjithsej investimeve nga 5.7 përqind një vit më parë.

Struktura e portfolios investuese e FSKP-së është ngjashëm e diversifikuar me atë të FKPK-së, duke qenë kryesisht e orientuar në tregun e jashtëm, më konkretisht në aksione që përbëjnë 77.2 përqind të portfolios investuese dhe pjesa tjetër në para të gatshme, që përbëjnë 2.4 përqind të gjithsej investimeve (shih Grafikun 34 dhe 35). Kurse, investimet brenda vendit janë


Grafik 33. Investimet e FKPK-së



Grafik 34. Investimet e FSKP-së



Grafik 35. Pjesëmarrja e investimeve të fondeve pensionale



⁹ Vlera bazë e aksionit të FKPK-së = 1.0 € kurse vlera bazë e aksionit të FSKP-së = 100.0 €.

kryesisht të fokusuar në letra me vlerë të Qeverisë së Kosovës që përfaqësojnë 18.0 përqind të gjithësej portfolios investuese. Pjesa tjetër e mjeteve të mbajtura në vend që përbëhet nga paraja e gatshme dhe depozitat e mbajtura në bankat komerciale përbëjnë 2.4 përqind të portfolios investuese.


3.4.4 Sektori i sigurimeve

Sektori i sigurimeve gjatë vitit 2023 u karakterizua me rritje dyshifrore, kryesisht si rezultat i rritjes së primeve të shkruara. Sektori është duke performuar me kthim pozitiv financiar për të tretin vit me radhë për dallim nga humbjet e realizuara në vitet e mëparshme. Pavarësisht zgjerimit të sektorit, niveli i ndërmjetësimit dhe densitetit është zgjeruar me ritëm më të ngadalësuar ndër vite. Shprehur përmes primeve të shkruara bruto në raport me BPV-në, ndërmjetësimi i sektorit vazhdon të qëndrojë në nivel relativisht të ulët krahasuar me mesataren e vendeve të zhvilluara, duke qëndruar këtë vit në 1.52 përqind nga 1.51 përqind sa ishte në vitin 2022. Ngjashëm, i ulët mbetet edhe niveli i densitetit, i matur përmes primeve të shkruara për kokë banori, i cili këtë vit shënoi vlerën prej 82.6 euro nga 75.5 euro sa ishte në 2022.¹⁰

Tregu i sigurimeve në Kosovë karakterizohet me shkallë më të ulët të koncentrimit krahasuar me atë bankar dhe mikrofinanciar. Mirëpo, në vitet e fundit kemi rritje të lehtë të koncentrimit, veçanërisht në asete, si rezultat i likuidimit të dy siguruesve (një në vitin 2019 dhe një tjetër gjatë vitit 2021). Krahasuar me një vit më parë, Indeksi Herfindahl¹¹ për primet e shkruara bruto (PShB) në 2023 shënoi rritje, në 992 pikë nga 981 pikë sa ishte një vit më parë. Po i njëjti indeks, i kalkuluar duke marrë për bazë asetet e tregut të sigurimeve, tregon vlera më të ulëta, por krahasuar me një vit më parë rezultojnë të jetë rritur për 27 pikë bazë në nivelin 954 pikë në fund të vitit 2023. Në të njëjtën kohë, indeksi CR5¹² për vitin 2023, i llogaritur në raport me PShB për sektorin e sigurimeve, rezultojnë 59.6 përqind nga 58.2 përqind në vitin 2022, ndërsa, i llogaritur në raport me asetet, rezultojnë 55.3 përqind nga 53.5 përqind në vitin 2022. Pra, rritja e lehtë e koncentrimit si në raport me asetet ashtu edhe primet e shkruara bruto reflekton zvogëlimin e numrit të siguruesve në vitet e fundit, ndërsa koncentrimi më i lartë në tregun e siguruesve të cilët ofrojnë shërbime të sigurimit 'jetë' rezultojnë i tillë për shkak të numrit të ulët të tyre.

Asetet e sektorit të sigurimeve përfaqësuan 2.7 përqind të gjithësej aseteve të sistemit financiar në fund të vitit 2023, ngjashëm me vitin paraprak. Vlera e tyre arriti në 304.1 milionë euro, që paraqet

Grafik 36. Asetet e sektorit të sigurimeve



Burimi: BQK (2024)

¹⁰ Sipas statistikave të fundit të publikuara në databazën e Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (Organization for Economic Co-operation and Development (OECD)), niveli i densitetit në vitin 2022 në 38 vende të kësaj organizate (27 evropiane, përfshirë SHBA-të, Japoninë, dhe Australinë) ishte 3,722 euro (prime të shkruara për kokë banori), kurse niveli i depërtimit (ndërmjetësimit) në treg gjatë kësaj periudhe qëndroi në 9.3 përqind.

¹¹ Indeksi Herfindahl është llogaritur me formulën në vijim: $HI = \sum_{i=1}^n (s_i)^2$, ku S paraqet pjesëmarrjen e kompanisë në gjithësej mjetet (primet e shkruara bruto) të tregut të sigurimeve, n është gjithësej numri i institucioneve në sektorin përkatës. Në qoftë se indeksi shtrihet ndërmjet intervaleve 1,000 – 1,800 njësi, niveli i koncentrimit në sektorin e sigurimeve konsiderohet i pranueshëm.

¹² Indeksi CR5 (Concentration Ratio of the top 5 firms (Shqip: Raporti i koncentrimit të top 5 kompanive)) kombinon pjesëmarrjen në treg të 5 siguruesve me vlerat më të larta të aseteve në raport me gjithësej asetet e sektorit dhe PSHB ndaj gjithësej PSHB të sektorit.

rritje vjetore prej 12.7 përqind (shih Grafikon 36). Në kuadër të aseteve, rritjen më të theksuar e shënoi kategoria e depozitave të mbajtura në bankat komerciale, që janë kryesisht në formë të depozitave të afatizuara, të cilat burojnë nga shitja e primeve. Kategoria e dytë për nga pesha, ajo e Letrave me Vlerë të Qeverisë së Kosovës, gjithashtu shënoi rritje. Zërat tjerë bilancor që nuk kanë peshë të madhe në gjithsej asetet shënuan rënie, me përjashtim të kategorisë ‘asetet tjera’ dhe ‘pjesa e risiguruesit për rezerva teknike’ që shënuan rritje, kjo e fundit pasi që ndikohet nga ecuria e primeve të shkruara dhe dëmeve të ndodhura (shih Tabelën 6). Megjithatë, cilësia e asteteve dhe treguesve kyç mbetet ende për t’u përmirësuar dhe arritur nivele më të qëndrueshme.

Tabela 6. Asetet e sektorit të sigurimeve (në milionë euro)

Përshkrimi	2022	2023	Ndryshimi vjetor	Pjesëmarrja 2022	Pjesëmarrja 2023
Paraja dhe depozitat në BQK	4.9	4.4	-11.8%	1.8%	1.4%
Depozitat në bankat komerciale	126.2	140.9	11.6%	46.8%	46.3%
Letrat me vlerë	45.6	50.9	11.5%	16.9%	16.7%
Huatë dhe të arkëtueshmet	20.2	18.8	-7.2%	7.5%	6.2%
Pjesa e risiguruesit për rezerva teknike	28.9	42.9	48.3%	10.7%	14.1%
Investimet në prona	7.1	6.2	-11.8%	2.6%	2.0%
Asetet tjera	36.8	40.2	9.2%	13.6%	13.2%
Gjithsej tregu	269.7	304.1	12.7%	100.0%	100.0%

Burimi: BQK (2024)

Sigurimet “jojetë” shënuan rritje vjetore prej 12.8 përqind dhe përfaqësuan 91.6 përqind të gjithsej aseteve të sektorit në fund të vitit 2023. Ndërsa sigurimet ”jetë”, që përbëjnë pjesën e mbetur të aseteve, shënuan rritje vjetore prej 12.0 përqind.

Sa i përket detyrimeve të sektorit, provizionet teknike dhe matematike përbëjnë pjesën më të madhe me gjithsej 66.2 përqind, pasuar nga ekuiteti me 24.7 përqind dhe zërat tjerë bilancor me peshë më të ulët (shih Tabelën 7). Vlera e kapitalit të sigurimeve ka shënuar rritje dukshëm më të lartë krahasuar me një vit më parë si rrjedhojë e fitimit të lartë të realizuar në vitin 2023. Për më tepër, operimi me fitim për të katërtin vit me radhë ka ndikuar në zvogëlim gradual të humbjeve të trashëguara nga vitet e kaluara. Si rrjedhojë, vlera e humbjeve të akumuluar ndër vite nga sektori u zvogëlua në 39.6 milionë euro në 2023 nga 44.9 milionë euro sa ishin në vitin 2020.

Tabela 7. Detyrimet dhe kapitali i sektorit të sigurimeve (në milionë euro)

Përshkrimi	2022	2023	Ndryshimi vjetor	Pjesëmarrja 2022	Pjesëmarrja 2023
Rezervat teknike	172.5	201.3	16.7%	64.0%	66.2%
Kreditë dhe detyrimet nga letrat me vlerë të pavaruara	0.0	0.0	-100.0%	0.0%	0.0%
Llogarite tjera të pagueshme	23.8	23.2	-2.4%	8.8%	7.6%
Detyrimet tjera	5.5	4.6	-16.6%	2.0%	1.5%
Gjithsej kapitali i aksionarit	67.9	75.1	10.5%	25.2%	24.7%
Gjithsej tregu	269.7	304.1	12.7%	100.0%	100.0%

Burimi: BQK (2024)

Vlera e primeve të shkruara nga siguruesit në vitin 2023 arriti në 146.5 milionë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 9.4 përqind, krahasuar me 14.1 përqind sa ishte në vitin 2022. Rritja më e ngadalësuar e primeve të shkruara krahasuar me vitin 2022 kryesisht reflekton ecurinë e primeve të kategorisë ‘aksidenti dhe shëndeti’ në kuadër të sigurimit vullnetar. Kjo kategori e primeve ka shënuar rritje dukshëm më të ngadalësuar si në vlerë të primeve të shkruara e poashtu edhe në volum të policave të shitura, kryesisht atyre shëndetësore (shih Tabelën 8). Ngadalësimi i rritjes së këtyre të fundit i atribuohet kryesisht efektit të bazës së rritur dukshëm në dy vitet paraprake, që ndër të tjera, mund të jetë efekt i post-pandemisë.

Struktura e primeve të shkruara vazhdon të dominohet nga primet e sigurimit “jo-jetë” të cilat në dhjetor 2023 përfaqësuan 95.5 përqind të gjithsej primeve të shkruara. Vlera e primeve të shkruara nga sigurimi “jojetë” në vitin 2023 arriti në 139.9 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 9.5 përqind. Rritja e vlerës së primeve rezultoi nga rritja e volumit të policave të shitura në vitin 2023, të cilat arritën në 1.48 milionë polica, një rritje vjetore prej 12.3 përqind.¹³ Bruto primet e shkruara “jojetë” vazhdojnë të dominohen nga primet e detyrueshme me një pjesëmarrje prej 59.1 përqind, ndërsa pjesa tjetër përfshin primet vullnetare. Produktet e sigurimeve të detyrueshme shënuan rritje vjetore prej 9.7 përqind, ndikuar kryesisht nga produktet “MTPL” (shih Tabelën 8). Kurse, në kuadër të sigurimit vullnetar, rritjen më të lartë e shënoi kategoria e sigurimit ‘Kasko’.


Tabela 8. Primet e shkruara bruto sipas klasave të biznesit (në milionë euro).

Aktiviteti	2022	2023	Ndryshimi vjetor	Pjesëmarrja: 2022	Pjesëmarrja: 2023
Gjithsejtë Jo-jetë	127.7	139.9	9.5%	95.2%	95.5%
<i>Sigurimi i detyruar</i>					
MTPL	63.2	69.2	9.5%	47.1%	47.3%
TPL+	3.6	4.1	14.0%	2.7%	2.8%
Sigurime kufitare	8.4	9.2	9.6%	6.3%	6.3%
<i>Sigurimi vullnetar</i>					
Aksident dhe shëndet	28.4	30.3	6.9%	21.1%	20.7%
Kasko	8.6	10.4	20.8%	6.4%	7.1%
Kredi dhe garancione	7.6	8.7	13.7%	5.7%	5.9%
Zjarri dhe dëmtime të tjera në pronë	6.0	6.6	10.2%	4.5%	4.5%
Përgjegjësi civile të përgjithshme	1.9	1.3	-31.6%	1.4%	0.9%
<i>Gjithsej jetë</i>	6.4	6.6	3.5%	4.8%	4.5%
Gjithsej tregu	134.0	146.5	9.4%	100.0%	100.0%

Burimi: BQK (2024)

Vlera e primeve të shkruara nga siguruesit “jetë” në vitin 2023 arriti në 6.6 milionë euro, që paraqet vlerë më të lartë për 3.5 përqind krahasuar me vitin 2022. Këto prime përfaqësojnë 4.5 përqind të gjithsej vlerës së primeve bruto të shkruara nga siguruesit.

Dëmet e paguara nga sektori i sigurimeve, ku përfshihen dëmet e siguruesve dhe Byrosë Kosovare të Sigurimit (BKS), këtë vit shënuan rritje vjetore për 11.6 përqind nga 5.4 përqind sa ishin një vit më parë, duke arritur vlerën në 71.7 milionë euro në fund të vitit 2023. Nga gjithsej shumën e dëmeve të paguara, 65.7 milionë euro ishin dëmet të paguara nga siguruesit, ndërsa 6.1 milionë euro dëmet të paguara nga BKS. Kurse, dëmet e paguara nga risiguruesit marrin pjesë me 16.5 përqind në gjithsej shumën e dëmeve të paguara nga siguruesit¹⁴. Rritja më e lartë e dëmeve të paguara nga sektori i sigurimeve në vitin 2023 kryesisht reflekton rritjen e dëmeve të paguara për kategoritë ‘sigurimi në pronë’, ‘MTPL’ dhe ‘aksidenti dhe shëndeti’ (shih Tabelën 9).



¹³ Përfshihet vetëm sigurimi “jojetë”.

¹⁴ Nuk përfshihet BKS-ja.

Vlera e dëmeve të paguara nga siguruesit “jetë” në vitin 2023 arriti në 1.5 milionë euro nga 1.1 milionë euro një vit më parë, që paraqet një rritje vjetore prej 29.5 përqind. Kjo rritje i artibuhet rritjes së dëmeve të paguara për nënkategoritë ‘jeta e kombinuar’ (kombinim i sigurimit ‘jetë’ për periudhë të caktuar kohore me mundësi vazhdimi), ‘jeta e debitorit’ (shlyerje të detyrimeve në rast të vdekjes së policëmbajtësit, aplikohet kryesisht nga bankat – sigurim i kredive), dhe ‘sigurimi i mbijetesës’ (shpërblim me mjete financiare pas maturimit të policës së sigurimit), e cila ka filluar të aplikohet në katër vitet e fundit.

Raporti i dëmeve të paguara ndaj primeve të shkruara në vitin 2023 u përkeqësua për 1.0 pikë përqindje krahasuar me një vit më parë, duke u rritur në 49.0 përqind (shih Grafikon 37). Kjo erdhi si rezultat i rritjes më të lartë të dëmeve të paguara krahasuar me normën e rritjes vjetore të primeve të pranuar (shih Tabelat 8 dhe 9).

Tabela 9. Dëmet e paguara, sipas klasave të biznesit (në milionë euro)

Aktiviteti	2022	2023	Ndryshimi vjetor	Pjesëmarrja: 2022	Pjesëmarrja: 2023
<i>Gjithsej Jojetë</i>	63.2	70.3	11.2%	98.2%	97.9%
<i>Sigurimi i detyruar</i>	0.0	0.0			
MTPPL	30.9	34.4	11.3%	48.1%	47.9%
TPL+	0.3	0.3	-4.3%	0.5%	0.4%
Sigurime kufitare, FG, MoU	8.8	6.1	-31.2%	13.7%	8.5%
<i>Sigurimi vullnetar</i>	0.0	0.0			
Aksident dhe shëndet	13.0	15.7	20.3%	20.3%	21.8%
Kasko	5.5	6.3	15.5%	8.5%	8.8%
Kredi dhe garancione	1.8	0.9	-50.2%	2.9%	1.3%
Sigurime në pronë	2.7	6.5	140.9%	4.2%	9.1%
Sigurimi mallit në tranzit	0.0	0.0	36.0%	0.0%	0.0%
Përgjegjësi e përgjithshme	0.0	0.0	-45.4%	0.0%	0.0%
<i>Gjithsej jetë</i>	1.1	1.5	29.5%	1.8%	2.1%
Gjithsej tregu	64.3	71.7	11.6%	100.0%	100.0%

Burimi: BQK (2024)

3.4.4.1 Performanca e sektorit të sigurimeve

Sektori i sigurimeve vitin 2023 e përmbylli me fitim neto prej 11.0 milionë euro, rritje e theksuar në raport me fitimin prej 2.1 milionë euro në vitin paraprak (shih Tabelën 10). Siguruesit “jo-jetë” shënuan fitime në vlerë prej 10.0 milionë euro krahasuar me vlerën prej 2.5 milionë euro në vitin e kaluar.

Tabela 10. Rezultati financiar (në milionë euro)

Përshkrimi	2019	2020	2021	2022	2023
Sigurimet Jojetë	-5.1	2.0	5.8	2.5	10.0
Sigurimet Jetë	0.5	0.3	0.5	-0.4	1.0
Gjithsej tregu	-4.7	2.3	6.3	2.1	11.0

Burimi: BQK (2024)

Ndërsa, siguruesit “jetë” shënuan fitim në vlerë prej 1.0 milionë euro kundrejt humbjeve në vlerë prej 413.1 mijë euro një vit më parë. Fitimi më i lartë i realizuar në vitin 2023 është rrjedhojë e rritjes më të lartë të arkëtimit nga primet e shkruara në raport me rritjen më të ngadalësuar të shpenzimeve, përkatësisht ‘dëmeve të ndodhura’ dhe shpenzimeve operacionale (që përfshijnë shpenzimet për personelin dhe ato administrative). Megjithatë, ecuria e trajtimit, rezervimit dhe pagesës së dëmeve mbetet në fukusin e lartë të BQK-së.

3.4.5 Sektori mikrofinanciar dhe jobankar

Sektori mikrofinanciar dhe jobankar gjatë vitit 2023 shënoi rritje të lartë të aktivitetit mbështetur nga huamarrjet nga sektori i jashtëm si burim kryesor i financimit. Performanca financiare e sektorit shënoi rritje përkundër kostos më të lartë të financimit të ndikuar nga ambienti i përgjithshëm global i normave më të larta të interesit. Vlera e aseteve të sektorit në fund të vitit 2023 arriti në 540.2 milionë euro duke shënuar rritje vjetore prej 34.8 përqind (shih Grafikon 38)¹⁵. Kreditë vazhdojnë të dominojnë strukturën e aseteve të sektorit mikrofinanciar me pjesëmarrje prej 66.7 përqind, pasuar nga lizingjet me 17.9 përqind dhe paraaja e mbajtur në sektorin bankar me 9.5 përqind pjesëmarrje. Ndërsa, pjesa tjetër e aseteve prej 5.9 përqind përbëhet kryesisht nga paraaja e gatshme dhe asetet tjera (përfshirë asetet fikse).


Kreditë

Aktiviteti kreditor i sektorit mikrofinanciar dhe jobankar ka shënuar trend rritës në vitet pas pandemisë, me theks të veçantë në vitin 2023, ku vlera e kredive arriti në 360.5 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 25.9 përqind (shih Grafikon 39).

Të dy segmentet e sektorit privat, korporatat jofinanciare dhe ekonomitë familjare, u karakterizuan me ecuri të ngjashme të rritjes së kreditimit. Kreditë ndaj ekonomive familjare këtë vit shënuan rritje vjetore prej 21.1 përqind nga 16.4 përqind sa ishin në vitin 2022, duke arritur vlerën 220.4 milionë euro. Stoku i kredive ndaj korporatave jofinanciare shënoi rritje vjetore prej 34.2 përqind nga 26.2 përqind sa ishte në vitin 2022, duke arritur vlerën prej 140.2 milionë euro.


Kreditimi ndaj korporatave jofinanciare ka ndjekur trendin rritës në të gjithë sektorët ekonomik (shih Grafikon 40). Për dallim nga sektori bankar ku stoku i kredive të bujqësisë ka pjesëmarrje

Grafik 38. Asetet e sektorit mikrofinanciar dhe jobankar




Burimi: BQK (2024)

Grafik 39. Vlera e kredive ndaj ekonomive familjare dhe ndërmarrjeve dhe rritja vjetore e kredive



Burimi: BQK (2024)

Grafik 40. Rritja e kredive ndaj korporatave jofinanciare, sipas sektorëve të ekonomisë



Burimi: BQK (2024)


¹⁵ Nga nëntor 2023, dy institucione financiare janë riklasifikuar nga ndihmës financiar në ndërmjetës tjerë financiar (IMF dhe IFJB). Ky riklasifikim ka ndikuar që të rrisë vlerën e aseteve në sektorin mikrofinanciar, konkretisht në zërin e bilancit me bankat tjera, dhe të afektojë pasqyrën e të hyrave, rritje të theksuar të të ardhurave nga shërbimet.

të ulët në gjithësej portfolion kreditore të korporatave jofinanciare, në sektorin mikrofinanciar dhe jobankar, kreditë bujqësore kanë peshë më të madhe (25.0 përqind), duke dhënë kështu kontributin më të lartë në rritjen e kreditimit ndaj korporatave jofinanciare (shih Grafikun 39). Vlera e kredive ndaj sektorit të bujqësisë arriti në 35.0 milionë euro që përkon me rritje vjetore prej 30.0 përqind. Rritja e theksuar e kredive për sektorin e bujqësisë është mbështetur edhe nga garancionet kreditore nga Fondi Kosovar për Garanci Kreditore (FKGK).

Lizingjet

Lizingjet janë kategoria e dytë më e rëndësishme për nga pesha në strukturën e aseteve të sektorit mikrofinanciar dhe jobankar me pjesëmarrje prej 17.9 përqind. Aktiviteti i lizingjeve shënoi rritje vjetore prej 30.8 përqind, kurse vlera e tyre arriti në 96.4 milionë euro (shih Grafikun 41). Në rritjen e lizingjeve kontributin kryesor vazhdojnë ta kenë korporatat jofinanciare të cilat kanë dhe peshën më të madhe prej 69.4 përqind në gjithësej lizingjet, përderisa, kontributi i ekonomive familjare në lizingje ishte më i ulët.

Grafik 41. Lizingjet




Burimi: BQK (2024)

Normat e interesit


Presionet inflacioniste dhe rritja e normave të interesit në nivel global që janë reflektuar në rritje të kostos së financimit të sektorit mikrofinanciar dhe jobankar ka ndërprerë trendin rënës disavjeçar të normave të interesit në kreditë e sektorit, megjithatë nuk janë reflektuar në normat e financimit në vend. Në dhjetor 2023, norma mesatare e interesit në kreditë nga institucionet mikrofinanciare dhe institucione financiare jobankare ishte 18.62 përqind, pothuajse njëjtë me normën 18.59 përqind në vitin paraprak (Grafiku 42), përkundër që burimi i financimit të tyre është i jashtëm dhe krejtësisht i ndikuar nga tregjet. Norma e interesit për kreditë ndaj ekonomive familjare shënoi rritje për 0.5 pikë përqindje duke arritur në 21.1 përqind. Norma mesatare e interesit në kreditë konsumuese poashtu është rritur për 1.4 pikë përqindje duke arritur në 23.8 përqind, ndërsa ajo e kredive hipotekare është zvogëluar për 1.5 pikë përqindje, me një mesatare prej 15.8 përqind.

Grafik 42. Norma mesatare e interesit në kredi të sektorit mikrofinanciar dhe jobankar



Burimi: BQK (2024)

Grafik 43. Norma mesatare e interesit në kredi, sipas sektorëve ekonomikë



Burimi: BQK (2024)

Përkundër hapësirës për kushte më të favorshme të financimit, struktura e financimit dhe modeli i tyre i biznesit kufizon në masë të madhe reduktimin e ndjeshëm të normave të interesit.

Megjithatë, niveli i ndërmjetësimit dhe konkurrenca në gjithë sektorin pritet të arrijë ndikim pozitiv në këtë drejtim. Burimet e financimit me kushte më të favorshme, si dhe optimizimi i modelit të biznesit, për të ofruar financim me kushte më të përbalueshme për kredimarrësin, mbeten sfida kryesore e tyre.

Për korporatat jofinanciare, norma mesatare e interesit në kredi u rrit për 0.5 pikë përqindje, duke arritur në 15.9 përqind. Norma e interesit në kreditë ndaj sektorit të industrisë dhe shërbimeve u rritën për 0.6 dhe 1.3 pikë përqindje, duke arritur në 17.9 përqind dhe 15.1 përqind respektivisht (shih Grafikonin 43). Kurse, norma mesatare e interesit në kreditë ndaj sektorit të bujqësisë u zvogëluar në 17.0 përqind apo për 0.3 pikë përqindje nga një vit më parë.

Performanca e sektorit mikrofinanciar dhe jobankar


Në vitin 2023, sektori mikrofinanciar dhe jobankar realizoi fitim neto në vlerë prej 18.1 milionë euro apo 6.4 përqind më i lartë se në vitin paraprak, ndikuar nga rritja më e lartë në vlerë e të hyrave në raport me rritjen e shpenzimeve për shkak të rritjes së ndjeshme të kreditimit (shih Grafikët 44 dhe 45).

Si rezultat i aktivitetit kreditues, të hyrat e sektorit në vitin 2023 janë rritur për 14.7 milionë euro apo për 26.1 përqind kurse shpenzimet për 13.6 milionë euro apo për 34.7 përqind nga viti i kaluar.

Në kuadër të të hyrave, të hyrat nga interesi përfaqësojnë kategorinë kryesore me 87.0 përqind, të cilat shënuan rritje vjetore prej 22.2 përqind në vitin 2023 nga 15.9 përqind sa ishin në vitin e kaluar, kryesisht si rezultat i rritjes së lartë të kreditimit. Kategoria e të ardhurave nga jointerеси, që përbën 13.0 përqind të gjithë të hyrave, shënoi rritje vjetore prej 60.7 përqind nga 6.6 përqind një vit më parë, kjo si rezultat i rritjes së tarifave dhe komisioneve në 4.3 milionë euro nga 0.9 milionë euro sa ishin në vitin e kaluar. Përveç tjerash, ky rezultat u ndikua edhe nga ndryshimi metodologjik, ku dy institucione janë riklasifikuar në IMF/IFJB nga kategoria paraprake e Ndihmësve Financiar, që ka afektuar pasqyrat financiare në dy muajt e fundit të vitit 2023¹⁶.


Në kuadër të shpenzimeve, shpenzimet nga interesi përfaqësojnë 26.9 përqind të gjithë shpenzimeve, duke shënuar rritje vjetore prej 69.2 përqind në vitin 2023 (rritje prej 4.6 përqind nga një vit më parë), dhe ndikuan më së shumti në rritjen e gjithë shpenzimeve të sektorit.

Grafik 44. Të hyrat dhe shpenzimet e sektorit mikrofinanciar dhe jobankar



Burimi: BQK (2024)

Grafik 45. Treguesit e profitabilitetit të sektorit mikrofinanciar dhe jobankar




Burimi: BQK (2024)

¹⁶ Ky ndryshim metodologjik ka ndikuar si në vijim në pasqyrën e të hyrave të IMF/IFJB-ve: kemi rritje për 3.7 milionë euro në të hyrat e sektorit, duke afektuar nënkategorinë e të ardhurave nga jointerеси (të ardhurat nga shërbimet u shtuan për 2.9 milionë euro kurse të ardhurat tjera operative për 0.8 milionë euro)

Rritja e theksuar e kësaj kategorie është rezultat i rritjes së shpenzimeve për interes nga huamarrjet, që është burimi kryesor i financimit të aktivitetit të sektorit. Kategoria që ka peshën më të madhe në gjithsej shpenzimet e sektorit, ajo e shpenzimeve për jointeres me pjesëmarrje prej 52.5 përqind, shënoi rritje më të ulët prej 20.5 përqind nga rritja prej 21.2 përqind e një viti më parë, kjo për shkak të ngadalësimit të rritjes së shpenzimeve për personelin. Shpenzimet për provizione shënuan poashtu rritje.

Niveli i kredive joperformuese ndaj gjithsej kredive të sektorit në fund të vitit 2023 ishte 1.8 përqind, ngjashëm me një vit më parë. Megjithatë, vlera e ekspozimeve joperformuese u rrit për 20.6 përqind nga 12.4 përqind sa ishte një vit më parë, duke arritur në vlerën prej 7.5 milionë euro në fund të vitit 2023. Niveli i mbulueshmërisë së kredive joperformuese me provizione u zvogëluar për 3.4 pikë përqindje në vlerën 149.7 përqind (shih Grafikun 46) si rezultat i rritjes më të lartë të kredive joperformuese në raport me rritjen e provizioneve.

Grafik 46. Treguesit e kualitetit të portofolios kreditorë



3.4.6 Ndhmësit financiar¹⁷

Sektori i ndihmësve financiar përfaqëson vetëm 0.1 përqind të gjithsej aseteve të sistemit financiar, por, përbën numrin më të madh të institucioneve financiare në vend që përfaqësohen nga gjithsej 61 zyra të këmbimeve valutore dhe agjencioneve për transferim të parave.

Vlera e aseteve të ndihmësve financiar në fund të vitit 2023 arriti në 13.3 milionë euro. Struktura e aseteve të ndihmësve financiar përbëhet nga asetet fikse dhe tjera me pjesëmarrje prej 69.9 përqind në gjithsej asetet e sektorit, ndërsa 24.2 përqind e mjeteve të sektorit janë të mbajtura në bankat komerciale dhe pjesa e mbetur është në para të gatshme. Sektori ka nivel të ulët të borxhit: 30.6 përqind e detyrimeve dhe ekuitetit të sektorit përfaqësojnë produkte të ndryshme të borxhit si kredi, llogari të pagueshme, dhe detyrime tjera. Ndërsa, kapitali vetanak përbën rreth 67.0 përqind të gjithsej detyrimeve dhe ekuitetit të sektorit.

Sektori i ndihmësve financiar në vitin 2023 shënoi fitim neto në vlerë prej 0.6 milionë euro. Të hyrat arritën vlerën prej 7.4 milionë euro, kryesisht të hyra prej shërbimeve. Kurse, vlera e shpenzimeve arriti në 6.6 milionë euro, prej të cilave 60.5 përqind janë shpenzime të personelit, pjesa tjetër prej 39.1 përqind janë shpenzime operative dhe 0.7 përqind për interesa.

¹⁷ Nga nëntor 2023 dy institucione financiar janë ri-klasifikuar nga ndihmës financiar në ndërmjetës tjerë financiar (IMF&IFJB). Ky riklasifikim ka ndikuar që të zvogëlohen konsiderueshëm asetet e ndihmësve financiar, duke afektuar edhe pasqyrën e të hyrave.

4. Licencimi dhe rregullimi i sistemit financiar

Bazuar në Ligjin për BQK-në, objektivi parësor i saj është nxitja dhe mbajtja e një sistemi financiar stabil. BQK-ja angazhohet në arritjen e këtij objektivi përmes përmbushjes së detyrave dhe përgjegjësi si autoritet përgjegjës për licencimin, mbikëqyrjen dhe rregullimin e institucioneve financiare që operojnë në Republikën e Kosovës.

BQK-ja, në zbatim të përgjegjësi ligjore si autoritet licencues, rregullues, dhe mbikëqyrës i institucioneve financiare në vend, angazhohet në:

- Rregullimin e hyrjes në treg të investitorëve potencialë, duke përcaktuar kritere për licencimin e institucioneve financiare dhe të atyre institucioneve, që posedojnë kapital të mjaftueshëm për mbështetjen e aktiviteteve të parapara, që prezantojnë përgatitjet e duhura për vlerësimin dhe monitorimin e rrezikut, plane biznesore të qëndrueshme me synim ndikimin dhe konkurrencën në sektor, politika dhe procedura adekuate për kontrollin e tij, si dhe administratorë me nivel të lartë kualifikimi, profesionalizmi dhe etike, qasje të lehtë dhe të mirëbesimit dhe komunikimit me institucionet përkatëse shtetërore të vendit të investitorit;
- Hartimin dhe mirëmbajtjen e kornizës rregullatore të përbërë nga një tërësi kriteresh minimale dhe kërkesash rregullative të aplikueshme ndaj institucioneve financiare, në harmoni me legjislacionin primar, Direktivat Evropiane, si dhe standardet ndërkombëtare;
- Zhvillimin e një procesi mbikëqyrës efektiv, duke zbatuar parimet e mbikëqyrjes së bazuar në rrezik, nëpërmjet ekzaminimeve në vend, si dhe analizimin, vlerësimin dhe interpretimin e të dhënave të institucioneve financiare, vlerësimin e trendëve të ardhshëm financiar, si dhe mundësinë e ndërmarrjes së masave përmirësuese për zgjidhjen e problemeve të ndryshme;
- Bashkëpunimin me institucionet financiare të licencuara dhe mbikëqyrura nga BQK-ja, si dhe me autoritetet e huaja mbikëqyrëse për bankat ose autoritetet rregullatore përkatëse për institucionet jo-bankare që operojnë në territorin e Republikës së Kosovës.

Me qëllim të kryerjes së funksioneve të saj mbikëqyrëse, BQK-ja synon nivelet më të larta të integritetit, profesionalizmit, efikasitetit, transparencës dhe zhvillimit të përhershëm të kapaciteteve të saj mbikëqyrëse.

4.1. Licencimi


Sipas Ligjit për BQK-në, autoriteti i vetëm përgjegjës për rregullimin, licencimin/regjistrimin dhe mbikëqyrjen e institucioneve financiare në Republikën e Kosovës është Banka Qendrore e Republikës së Kosovës.

BQK-ja ka për qëllim që të sigurojë një proces meritator, transparent dhe gjithëpërfshirës të licencimit, i cili ndihmon për të siguruar një mjedis të sigurt, të qëndrueshëm dhe konkurrues financiar të ndërtuar mbi bazën e parimit të drejtësisë, ndershmërisë dhe barazisë. Kushtet dhe kriteret e licencimit janë të karakterit mbikëqyrës dhe nuk kanë për qëllim vendosjen e barrierave ndaj investitorëve qofshin ata të brendshëm apo të jashtëm, megjithatë shërbejnë për të siguruar që vetëm institucionet që plotësojnë kërkesat ligjore në nivelin e kërkuar, nuk ekspozojnë vendin dhe konsumatorët ndaj rreziqeve dhe sjellin vlerë të shtuar hyjnë në treg. Hyrja e investitorëve të huaj në tregun kosovar, veçanërisht në sektorin financiar, dëshmon politikën e hapur të BQK-së ndaj investimeve të huaja, pa i cenuar kërkesat ligjore, ndërsa praktika në disa raste, ka dëshmuar nevojën për rishikimin dhe avancimin e tyre, konform praktikave të kaluara dhe sfidave aktuale.

Struktura e sistemit financiar në fund të vitit 2023, sipas llojit të institucioneve financiare të licencuara dhe regjistruara që ofrojnë shërbime financiare në Kosovë, bazuar në legjislacionin e

aplikuar në Republikën e Kosovës dhe kuadrin rregullator në fuqi të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, të renditura sipas peshës së tyre në sistem është paraqitur në figurën 47.

Figura 47. Struktura e sistemit financiar në Kosovë



Burimi: BQK (2024)


Struktura e sistemit financiar të Kosovës përbëhet nga gjithsej 136 institucione financiare të licencuara dhe regjistruara, cilat ushtrojnë veprimtarinë e tyre në vend bazuar në legjislacionin e aplikuar në Republikën e Kosovës dhe në kuadrin rregullator në fuqi të BQK-së.

4.1.2 Rrjeti i sistemit financiar

Në fund të vitit 2023, bankat e ushtruan veprimtarinë e tyre në gjithsej 57 degë dhe 162 zyra brenda territorit të vendit (shih Grafikon 48). Gjatë këtij viti, me miratim të BQK-së është rritur numri i degëve për dy bankat e reja, ndërsa, numri i degëve të bankave tjera pothuajse ka mbetur i njëjtë me vitin paraprak.


Shpërndarja gjeografike e rrjetit bankar përfshin pothuajse të gjithë territorin e vendit dhe ishte pothuajse e njëjtë me vitin paraprak në raport me numrin e degëve dhe zyrave (shih Tabelën 11). Megjithatë, vazhdon të evidentohet përqendrim më i madh i degëve dhe

Grafiku 48. Rrjeti bankar sipas numrit të degëve/zyrave



Burimi: BQK (2024)

Grafiku 49. Shpërndarja e popullësisë në Kosovë sipas regjioneve



Burimi: ASK (2024)

zyrave në rajonin e Prishtinës me 36.0 përqind, ku edhe përqendrimi i popullsisë është më i madh 28.8 përqind (shih Grafikon 49).

Trendi pesëvjeçar sugjeron strategji konsistente të bankave sa i përket fokusimit gjeografik. Pra, gjatë kësaj periudhe nuk ka ndryshim të theksuar në rajonet tjera në raport me përqindjen e degëve dhe zyrave bankare dhe trendi vazhdon pothuajse në mënyrë proporcionale në të gjitha rajonet. Megjithatë, përfshirja financiare mund të rezultojë në konsiderim të kësaj shtirjeje.

Tabela 11. Shpërndarja gjeografike e degëve dhe zyrave të bankave

Përshkrimi	Regjioni i Prishtinës		Regjioni i Prizrenit		Regjioni i Pejës		Regjioni i Gjilanit		Regjioni i Mitrovicës		Gjithsej
	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	
2016	95	36%	38	15%	42	16%	52	20%	35	13%	262
2017	83	35%	37	16%	39	16%	47	20%	32	13%	238
2018	74	33%	35	16%	38	17%	44	20%	31	14%	222
2019	71	33%	35	16%	37	17%	44	20%	30	14%	217
2020	70	33%	34	16%	32	15%	41	19%	34	16%	211
2021	67	33%	34	17%	28	14%	38	19%	34	17%	201
2022	67	33%	35	17%	29	14%	39	19%	33	16%	203
2023	73	36%	37	18%	33	16%	41	20%	35	17%	219

Burimi: BQK (2024)

Siguruesit, gjatë vitit 2023 veprimtarinë e tyre e ushtruan përmes 60 degëve, njëjtë si në vitin paraprak, 415 zyrave dhe 58 agjentëve dhe brokerëve brenda territorit të vendit (shih Grafikon 50), ku vërehet një zgjerim i lehtë i rrjetit të përgjithshëm të zyrave të siguruesve në vend.

Shpërndarja gjeografike e rrjetit të siguruesve përfshin pothuajse të gjithë territorin e vendit, por, nuk përputhet me shpërndarjen gjeografike të popullsisë si në rastin e bankave. Përqendrimi i rrjetit

të siguruesve, me theks ai i degëve të siguruesve, në vitin 2023 ka përfaqësim më të lartë në rajonin e Pejës me 26.7%, i pasuar nga rajoni i Gjilanit, që si rajone nuk reflektojnë shpërndarjen gjeografike të popullsisë dhe kjo strukturë është konsistente gjatë gjashtë viteve të fundit (shih Tabelën 12).

Tabela 12. Shpërndarja gjeografike e filialeve të siguruesve


Vitet	Rajoni i Prishtinës		Rajoni i Prizrenit		Rajoni i Pejës		Rajoni i Gjilanit		Rajoni i Mitrovicës		Gjithsej
	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	
2016	11	15.3%	11	15.3%	21	29.2%	18	25.0%	11	15.3%	72
2017	13	17.8%	11	15.1%	20	27.4%	19	26.0%	10	13.7%	73
2018	14	18.9%	11	14.9%	20	27.0%	19	25.7%	10	13.5%	74
2019	13	19.4%	10	14.9%	18	26.9%	17	25.4%	9	13.4%	67
2020	13	19.4%	10	14.9%	18	26.9%	17	25.4%	9	13.4%	67
2021	12	20.0%	9	15.0%	16	26.7%	15	25.0%	8	13.3%	60
2022	12	20.0%	9	15.0%	16	26.7%	15	25.0%	8	13.3%	60
2023	12	20.0%	9	15.0%	16	26.7%	15	25.0%	8	13.3%	60

Burimi: BQK (2024)

Fondet pensionale aktivitetin e tyre e zhvillojnë vetëm përmes zyrave qendrore me lokacion në Prishtinë.

Institucionet mikrofinanciare në fund të vitit 2023, aktivitetin e tyre e ushtruan përmes 138 zyrave të shpërndara brenda territorit të vendit. Gjatë vitit 2023 është aprovuar hapja e tri (3) zyrave,

Grafiku 50. Rrjeti i siguruesve



Burimi: BQK (2024)

mbyllja e një (1) zyreje, si dhe zhvendosja e dhjetë (10) zyrave të tjera të IMF-ve. Shpërndarja gjeografike e zyrave të institucioneve mikrofinanciare vazhdon të jetë e përqendruar kryesisht në dy rajone të territorit të vendit, në rajonin e Prishtinës dhe atë të Prizrenit (shih Tabelën 13).

Tabela 13. Rrjeti i IMF-ve sipas shpërndarjes gjeografike

Përshkrimi	Regjioni i Prishtinës		Regjioni i Prizrenit		Regjioni i Pejës		Regjioni i Gjilanit		Regjioni i Mitrovicës		Gjithsej
	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	
2016	27	26%	24	23%	23	22%	19	18%	12	11%	105
2017	29	26%	26	23%	24	21%	20	18%	14	12%	113
2018	32	27%	28	23%	24	20%	22	18%	14	12%	120
2019	37	29%	30	23%	24	19%	23	18%	14	11%	128
2020	38	29%	30	23%	25	19%	23	18%	14	11%	130
2021	38	29%	30	23%	25	19%	23	18%	14	11%	130
2022	39	29%	33	24%	26	19%	24	18%	14	10%	136
2023	41	30%	32	23%	27	20%	24	17%	14	10%	138

Burimi: BQK (2024)

Institucionet financiare jobankare në fund të vitit 2023, aktivitetin e tyre e ushtruan në gjithsej 1038 zyra dhe agjentë të shpërndarë brenda territorit të vendit. Shpërndarja gjeografike e degëve dhe zyrave të rrjetit të institucioneve financiare jobankare është i përqendruar pothuajse në gjithë territorin e vendit, ku prinë rajoni i Prishtinës me 37 përqind, pasuar nga rajoni i Gjilanit me 22 përqind, dhe me rajonin e Mitrovicës që ka pjesëmarrjen më të ultë në vend (shih Tabelën 14). Këtij trendi të rritjes së zyrave dhe agjentëve të rinj i ka kontribuar hyrja në treg dhe regjistrimi i institucioneve të reja financiare që merren me shërbimin e pagesave, emetimit të parasë elektronike dhe këmbimit valutor.

Tabela 14. Rrjeti i IFJB-ve (zyra dhe agjent) sipas shpërndarjes gjeografike

Përshkrimi	Regjioni i Prishtinës		Regjioni i Prizrenit		Regjioni i Pejës		Regjioni i Gjilanit		Regjioni i Mitrovicës		Gjithsej
	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	
2016	132	29%	85	18%	101	22%	103	22%	41	9%	462
2017	154	29%	96	18%	109	21%	115	22%	52	10%	526
2018	177	30%	111	19%	122	21%	130	22%	53	9%	593
2019	219	31%	126	18%	139	20%	160	23%	65	9%	709
2020	286	33%	150	17%	165	19%	192	22%	82	9%	875
2021	340	36%	163	17%	170	18%	197	21%	80	8%	950
2022	360	36%	177	18%	174	17%	212	21%	81	8%	1004
2023	384	37%	174	17%	177	17%	228	22%	75	7%	1038

Burimi: BQK (2024)

4.1.3 Aktiviteti i licencimit

Në kuadër të përmbushjes së funksionit të licencimit dhe funksionimit normal të veprimtarive financiare, BQK-ja gjatë vitit 2023 ka shqyrtuar gjithsej 473 kërkesa, nga të cilat, gjashtë (6) aplikacione për licencim, të cilat sipas legjislacionit në fuqi kërkojnë miratim paraprak të BQK-së (shih Tabelën 15). Këtu nuk përfshihen: (i) kërkesat e shqyrtuara të bartura për vendimmarrje nga vitin 2022, (ii) shprehjet e interesimit për licencim/regjistrim, (iii) kërkesat të cilat vlerësohen mirëpo nuk janë subjekt i miratimit të BQK-së, dhe (iv) pyetjet, njoftimet dhe vlerësimet tjera të shqyrtuara nga BQK-ja. Gjatë vitit 2023, ngjashëm me vitin e kaluar, BQK-ja ka pranuar kryesisht kërkesa për regjistrim të IFJB-ve, dhe ka patur një rritje të lehtë të kërkesave nga sektori bankar. Në përgjithësi, struktura e kërkesave për licencim mbetet e ngjashme, por me një rënie të lehtë në krahasim me vitet paraprake.

Tabela 15. Struktura e kërkesave të sistemit financiar të miratuara/refuzuara nga BQK

Transaksionet	2022						2023					
	Bankë	Fonde pensionale	IMF & IFJB	Sigurues	Ndërmjet. në sigurime/ tjetër	Gjithsej	Bankë	Fonde pensionale	IMF & IFJB	Sigurues	Ndërmjet. në sigurime/ tjetër	Gjithsej
Aplikacionet	1	0	8	0	1	10	1	0	5	0	0	6
Aksionarët kryesor dhe ndryshime në kapital	4	0	13	3	5	25	5	0	6	2	0	13
Drejtorë dhe menaxherë të lartë dhe delegim funksioneve	22	0	45	26	6	99	20	0	26	47	9	112
Auditori i jashtëm	10	1	30	14	5	60	6	1	9	5	4	25
Ndryshimet në aktin e themelimit dhe/ apo statutit/ emrit	6	0	10	2	4	22	6	1	9	1	1	18
Përvetësimet e interesit të kapitalit dhe transferimi i portofolit	1	0	0	0	0	1	0	0	0	0	0	0
Zgjerim i veprimtarive financiare	1	0	5	1	0	7	0	0	3	0	1	4
Hapja, zhvendosja dhe mbyllja e degëve dhe zyrave brenda dhe jashtë vendit	11	0	44	15	0	70	29	0	42	28	3	102
Licencimi dhe regjistrimi i agjentëve/brokerëve	35	0	81	4	53	173	40	0	88	1	8	137
Tërheqja e licencimit/regjistrimit	0	0	47	4	2	53	0	0	53	1	0	54
Tjetër	0	0	1	0	1	2	0	0	1	0	1	2
Gjithsej	91	1	284	69	77	522	107	2	242	85	37	473

Burimi: BQK (2024)

Në kuadër të këtyre 6 aplikacioneve për licencim/regjistrim gjatë vitit 2023, BQK-ja ka miratuar 4 aplikacione, 1 mos miratim, dhe 1 aplikacion është bartur për procesim në vitin 2024. Në procesin licencues, përveç kërkesave ligjore dhe rregullative, BQK-ja i ka kushtuar vëmendje të veçantë vlerësimit të planit të biznesit dhe vlerës së shtuar, si dhe zbatimit të parimeve dhe rregullave bazë për qeverisje të përgjegjshme dhe efektive duke vlerësuar strukturat e tyre organizative, menaxhimin, si dhe ndarjen e përgjegjësisë.

Gjatë vitit 2023 janë marrë vendime dhe proceduar kërkesat për miratim/refuzim paraprak, si dhe ka patur kërkesa të tërhequra në mënyrë vullnetare nga vetë institucionet financiare. Gjithsej ka patur 473 kërkesa, ku 456 prej tyre kanë marrë miratim, 4 janë refuzuar, dhe 13 janë tërhequr vullnetarisht apo procedura e shqyrtimit është pushuar për moskompletim të procedurave dhe kriterëve ligjore.

Tabela 16. Kërkesat e proceduara dhe në proces, gjatë vitit 2023

Aplikacione dhe kërkesa gjatë vitit 2023	I tërhequr	Miratim	Refuzim	Gjithësej
Bankë	5	101	1	107
Aksionarët kryesor;	2	2		4
Auditori i jashtëm;		6		6
Emërimi i anëtarit të jashtëm të komitetit të auditimit		1		1
Emërimi i drejtorëve;		7		7
Emërimi i menaxherëve të lartë;		12		12
Hapja degëve dhe zyrave brenda vendit;		17		17
Licencimi/Regjistrimi i agjentëve;		40		40
Mbyllja e degëve dhe zyrave brenda vendit;	2	1		3
Ndryshimet në aktin e themelimit dhe/apo statutit;		6		6
Ndryshimi në kapital;	1			1
Zhvendosja e degëve dhe zyrave brenda vendit;		9		9
Aplikacion Fillestar			1	1
BKS		15		15
Emërimi i menaxherëve të lartë;		14		14
Zgjerim i veprimtarive financiare;		1		1
FP		2		2
Auditori i jashtëm;		1		1
Ndryshimet në aktin e themelimit dhe/apo statutit;		1		1
IFJB	2	212		214
Aksionarët kryesor;		1		1
Auditori i jashtëm;		6		6
Emërimi i drejtorëve;	1	7		8
Emërimi i menaxherëve të lartë;		11		11
Hapja degëve dhe zyrave brenda vendit;		16		16
Licencimi/Regjistrimi i agjentëve;		88		88
Mbyllja e degëve dhe zyrave brenda vendit;		1		1
Ndryshimet në aktin e themelimit dhe/apo statutit;	1	5		6
Ndryshimi në kapital;		5		5
Tërheqja e regjistrimit të agjentëve;		53		53
Zgjerim i veprimtarive financiare;		3		3
Zhvendosja e degëve dhe zyrave brenda vendit;		11		11
Aplikacion Fillestar		5		5
IMF		27		27
Auditori i jashtëm;		3		3
Emërimi i drejtorëve;		3		3
Emërimi i menaxherëve të lartë;		4		4
Hapja degëve dhe zyrave brenda vendit;		3		3
Mbyllja e degëve dhe zyrave brenda vendit;		1		1
Ndryshimet në aktin e themelimit dhe/apo statutit;		3		3
Zhvendosja e degëve dhe zyrave brenda vendit;		10		10
KS në Likuidim		1		1
Auditori i jashtëm;		1		1
KS-Jetë	1	6	2	9
Emërimi i drejtorëve;		2	1	3
Emërimi i menaxherëve të lartë;	1	4	1	6
KS-Jo jetë	5	72		77
Auditori i jashtëm;		5		5
Delegimi i funksioneve		1		1
Emërimi i drejtorëve;		11		11
Emërimi i menaxherëve të lartë;	4	23		27
Hapja degëve dhe zyrave brenda vendit;		17		17
Licencimi/Regjistrimi i agjentëve;		1		1
Mbyllja e degëve dhe zyrave brenda vendit;		1		1
Ndryshimi i emrit;		1		1
Ndryshimi në kapital;		2		2
Tërheqja e regjistrimit të agjentëve;		1		1
Zhvendosja e degëve dhe zyrave brenda vendit;	1	9		10
Ndermjetësues në Sigurime		20	1	21
Auditori i jashtëm;		3		3
Emërimi i drejtorëve;		4		4
Emërimi i menaxherëve të lartë;		1		1
Licencimi i brokerëve;		7	1	8
Ndryshimet në aktin e themelimit dhe/apo statutit;		1		1
Zgjerim i veprimtarive financiare;		1		1
Zhvendosja e degëve dhe zyrave brenda vendit;		3		3
Gjithësej	13	456	4	473

Burimi: BQK (2024)

4.2. Rregullimi

4.2.1 Korniza ligjore dhe rregullative e sistemit financiar

Hartimi i akteve të reja nënligjore dhe rishikimi i kuadrit rregullativ në fuqi synon plotësimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të tij, në funksion të realizimit të një mbikëqyrjeje më efektive dhe në zbatim të kërkesave ligjore për institucionet financiare të licencuara/regjistruara dhe të mbikëqyrura nga BQK nëpërmjet përafrimit me aktet rregullative të Bashkimit Evropian dhe me parimet bazë për mbikëqyrjen efektive të institucioneve tjera relevante ndërkombëtare.

Deri më tani, BQK-ja ka ndërtuar një kornizë rregullative për licencimin, rregullimin dhe mbikëqyrjen e institucioneve financiare të bazuar në praktikën më të mira ndërkombëtare, e mbështetur në vazhdimësi nga institucione të njohura ndërkombëtare, si Grupi i Bankës Botërore (BB), Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN), USAID, FED, Thesari Amerikan, BQE, Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZh), KfW, GIZ dhe institucione të tjera ndërkombëtare. Korniza rregullative është hartuar në pajtueshmëri me direktivat evropiane që adresojnë rregullimin e institucioneve financiare, si standardet dhe praktikën më të mira ndërkombëtare për rregullimin dhe mbikëqyrjen e institucioneve financiare. Gjithashtu, BQK-ja ka vazhduar me procesin gradual drejt përafrimit me parimet bazë për mbikëqyrjen e bankave, të nxjerra nga Bank for International Settlements (BIS), dhe parimet bazë për mbikëqyrjen e siguruesve të nxjerra nga Shoqata Ndërkombëtare e Mbikëqyrjes së Sigurimeve (International Association for Insurance Supervision - IAIS). Meqenëse, direktivat, standardet ndërkombëtare, dhe parimet e lartëcekura lidhur me rregullimin e institucioneve financiare dhe fushën e veprimtarisë së tyre janë të karakterit dinamik, kjo ndikon që hartimi i kornizës juridike të jetë një proces i vazhdueshëm dhe kompleks pasi që kërkon plotësimin dhe ndryshimin e kornizës ekzistuese ligjore dhe rregullative, si dhe kërkon një qasje adekuate në mënyrë që të studiohen me kujdes rrethanat specifike të Kosovës, për një adaptim adekuat të këtyre instrumenteve juridike ndërkombëtare në funksion të nevojave të sektorit financiar në Kosovë.

Në shtesë të kësaj, BQK ka nisur dhe ka kryesuar grupin për hartimin e ligjit për bankat, ndërsa po vazhdon aktivitetin për ligjin për shërbimin e pagesave, ligjin për institucionet mikrofinanciare (jo bankare). Gjithashtu, është në proces të shqyrtimit të ndryshimeve ligjore në fushën e sigurimeve - ligjin për autopërgjegjesinë, si dhe ka marrë pjesë në grupin punues për koncept dokumentin për tregjet e kapitalit. Këto nisma ligjore pritet të trajtohen në vitin 2024-25.

4.2.2 Korniza ligjore dhe rregullative për mbikëqyrjen e bankave

Në funksion të zhvillimit të mëtejshëm të kornizës rregullative për rregullimin e bankave, gjatë vitit 2023 janë realizuar aktivitetet si në vijim:

4.2.2.1 Draft Ligji i ri për Banka

BQK-ja ka finalizuar projektligjin për bankat që ka për qëllim të rregullojë aktivitetin bankar dhe financiar të bankave në Republikën e Kosovës, në funksion të nxitjes dhe mbarëvajtjes së një sistemi të qëndrueshëm financiar, duke siguruar një nivel të duhur të mbrojtjes së interesave të depozitorëve, përmes rregullimit të kriterëve për themelimin dhe licencimin e bankave, organizimin dhe menaxhimin e shëndoshë të bankave, mbikëqyrjes prudenciale të bankave, mbrojtjen e konsumatorëve, si dhe rimëkëmbjen, përmbylljen dhe likuidimin e bankave.

Ky projektligj që përbëhet nga 150 nene, të ndarë në katër kapituj, synon të harmonizojë kornizën ligjore për bankat në Kosovë me aktet Acquis të Bashkimit Evropian, si në vijim:

- Rregullorja mbi kërkesat prudenciale për institucionet kreditore dhe shoqëritë investuese (Rregullore 575/2013/EU, duke ndryshuar dhe plotësuar Rregulloren 648/2012/EU).

- Direktiva për qasje në veprimtarinë e institucionit kreditor dhe mbikëqyrja prudenciale e institucionit kreditor dhe shoqërisë investuese (Direktiva 2013/16/EU, duke ndryshuar dhe plotësuar Direktivën 2002/87/EC, dhe duke shfuqizuar Direktivën 2006/48/EC dhe 2006/49/EC).
- Direktiva për themelimin e kornizës së rimëkëmbjes dhe përmbylljes së institucioneve kreditore dhe shoqërive investuese (Direktiva 2014/59/EU, duke ndryshuar dhe plotësuar Direktivën 82/891/EEC, 2001/24/EC, 2002/47/EC, 2004/25/EC, 2005/56/EC, 2007/36/EC, 2011/35/EU, 2012/30/EU dhe 2013/36/EU, si dhe Rregulloren 1093/2010/EU dhe 648/2012/EU).

Ky projektligj do të zbatohet për të gjitha bankat, përfshirë degët e bankave të huaja që ushtrojnë veprimtari bankare dhe financiare, aksionarët e tyre, bordin e drejtorëve, menaxherët e lartë, punonjësit, agjentët dhe filialet e tyre, si dhe zbatohet për aspektet e kontabilitetit dhe sistemit të raportimit financiar të bankave, përfshirë kërkesat e auditimit.

4.2.2.2 Përafrimi me rregullativën e BE lidhur me menaxhimin e rrezikut të likuiditetit në banka

Gjatë vitit 2023, si pjesë e procesit të harmonizimit të kërkesave rregullative të BQK-së me standardet e Bazelit dhe Direktivat/Rregulloret Europiane, është miratuar dhe ka hyrë në fuqi Rregullorja për Menaxhimin e Rrezikut të Likuiditetit të Bankave, e cila përcakton standardet dhe kërkesat minimale për menaxhimin efektiv të rrezikut të likuiditetit nga bankat.

4.2.2.3 Korniza rregullative për vlerësimin e pronave të paluajtshme

BQK-ja ka rishikuar kornizën rregullative për vlerësimin e pronave të paluajtshme në funksion të përditësimit të kërkesave për të përmirësuar praktikën e vlerësimit të pronave të paluajtshme nga ana e institucioneve financiare. në përputhje me standardet e reja të European Valuation Standards 2016 (EVS). Ky projekt është zhvilluar me mbështetjen e këshilltarit nga Thesari Amerikan, ekspert me përvojë të gjatë në fushën e vlerësimit të pronave të paluajtshme për nevojat e bankave.

4.2.2.4 Rregullorja për rrezikun e vendit dhe rrezikun e transferit

Gjatë vitit 2023 është miratuar Rregullorja për Rrezikun e Vendit dhe Rrezikun e Transferit. Kjo rregullore adreson rrezikun e vendit që i referohet mundësisë ose rrezikut që një huamarrës i huaj (shtetëror ose tjetër) të mos jetë në gjendje ose mos të dëshirojë të përmbushë obligimet për shkak të kushteve specifike të vendit, që mund të jenë ekonomike, politike, sociale, natyrore ose ngjarje tjera, si dhe rrezikun e transferit që është një nga rreziqet e vendit.

4.2.2.5 Rregullore për procesin e vlerësimit të brendshëm të likuiditetit të bankave (ILAAP)

Gjatë vitit 2023 ka vazhduar hartimi i Rregullores për procesin e Vlerësimit të Brendshëm të Likuiditetit të Bankave (anglisht: Internal Liquidity Adequacy Assessment Process - ILAAP), e cila bazohet në Kornizën e Bazelit dhe Direktivat Europiane. Qëllimi i kësaj Rregullore është të përcaktojë procesin e vlerësimit të brendshëm të mjaftueshmërisë së likuiditetit të bankës për të siguruar që rreziqet dhe rrjedhat dalëse të pritshme janë mjaftueshëm të mbuluara nga likuiditeti i brendshëm që banka ka në dispozicion.

4.2.2.6 Rregullore për qeverisjen korporative të bankave

Gjatë vitit 2023 është finalizuar drafti i Rregullores për Qeverisjen Korporative të Bankave e cila e plotëson-ndryshon rregulloren ekzistuese për qeverisjen korporative të bankave. Kjo është arritur me mbështetjen e asistencës teknike në kuadër të Projektit për Qeverisjen Korporative të

mbështetur nga BERZh. Qëllimi i Rregullores është harmonizimi i kornizës rregullative me praktikën e mira të qeverisjes korporative të bankave, si faktor i rëndësishëm për ruajtjen e qëndrueshmërisë dhe stabilitetit të sektorit bankar në tërësi. Kjo Rregullore përcakton kërkesat minimale për aksionarët e bankave, Bordin e Drejtorëve dhe Menaxherët e Lartë lidhur me përgjegjësitë e tyre në qeverisjen korporative. Gjatë vitit 2023, janë organizuar edhe punëtoritë për stafin e BQK-së, si dhe të industrisë bankare lidhur me ndryshimet dhe kërkesat e reja të cilat rrjedhin nga drafti i ri kësaj Rregullore. E njëjta pritet që të miratohet brenda vitit 2024.

4.2.2.7 Rregullore për auditimin e jashtëm të bankave

Gjatë vitit 2023 është bërë plotësim-ndryshimi i Rregullores ekzistuese për Auditimin e Jashtëm të Bankave, dhe e njëjta është miratuar nga BQK dhe ka hyrë në fuqi në dhjetor 2023. Përmes këtij plotësim-ndryshimi, punësimi i vazhdueshëm i auditorit të jashtëm të njëjtë është harmonizuar me kërkesat për institucionet tjera jo bankare, përkatësisht është kufizuar në pesë (5) auditime të njëpasnjëshme, duke kufizuar që i njëjti auditor mund të marrë pjesë në auditimin e të njëjtës bankë, përsëri pas kalimit të afatit kohor prej të paktën dy (2) vitesh.

4.2.2.8 Rregullore për drejtorët dhe menaxherët e lartë të bankave

Me qëllim të forcimit të kriterëve të cilat kërkohen për pozitat e menaxhmentit të lartë të bankave, gjatë vitit 2023 BQK ka filluar me plotësim-ndryshimin e Rregullores ekzistuese për Drejtorët dhe Menaxherët e Lartë të Bankave, e cila është finalizuar dhe pritet që të miratohet gjatë vitit 2024.

4.2.2.9 Rregullorja për licencimin e bankave dhe degëve të bankave të huaja

Në vitin 2023 është filluar me plotësim-ndryshimin e Rregullores ekzistuese për Licencimin e Bankave dhe Degëve të Bankave të Huaja. Qëllimi i Rregullores është të përcaktojë kushtet, kërkesat, procedurat dhe afatet që duhet ndjekur për licencimin e bankave dhe/ose degëve të bankave të huaja, transaksionet që kërkojnë miratim paraprak nga BQK gjatë ushtrimit të veprimtarisë nga bankat dhe degët e bankave të huaja, si dhe detyrimet për njoftime në BQK nga bankat dhe degët e bankave të huaja gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre. Draft-Rregullorja është në proces të finalizimit dhe pritet që e njëjta të procedohet për miratim gjatë vitit 2024.

4.2.2.10 Aktivitete tjera lidhur me kornizën rregullative në fushën e bankave

Gjatë vitit 2023 ka vazhduar angazhimi në Projektin me BB (FinSAC) lidhur me avancimin e akteve rregullative për menaxhimin e rreziqeve të klimës dhe ambientit. Për këtë qëllim ka pasur takime me përfaqësues të Bankës Botërore dhe palët tjera të interesit. Aktualisht, është në proces të hartimit Letra Këshilluese për bankat lidhur me Rreziqet e klimës dhe të ambientit sipas praktikave më të mira ndërkombëtare të aplikuara në këtë fushë.

4.2.2.11 Rregullore për operacione me para të gatshme

Rregullorja për Operacione me Para të Gatshme e miratuar me 27 dhjetor 2023, me qëllim të avancojë dhe përcaktojë standardet rregullative për realizimin profesional të detyrave të institucioneve financiare në lëmin e operacioneve me para të gatshme. Rregullorja përfshinë kontrollin e sasisë së parasë në qarkullim, mbrojtjen e integritetit të sistemit financiar, luftën ndaj parasë së falsifikuar, mbrojtjen e konsumatorit, luftën ndaj aktiviteteve të shpëlarjes së parasë dhe financimit të terrorizmit, si dhe adresimin e çështjeve tjera që ndërlidhen me fushëveprimin e BQK-së. Gjithashtu, rregullorja synon të përmirësojë sistemin e pagesave, zbaton mandatin kushtetues të përdorimit të vetëm të euros si mjet ligjor, si dhe ndalon funksionimin e institucioneve financiare apo makinerive të pa licencuara nga BQK-ja. E njëjta ndalon ri-qarkullimin e kartëmonedhave prej 500€ për të dekurajuar transaksionet e mëdha me para të gatshme.

4.2.3 Korniza rregullative për Institucionet mikrofinanciare dhe jobankare

Në funksion të zhvillimit të mëtejshëm të kornizës rregullative për rregullimin e institucioneve mikrofinanciare dhe jo bankare, gjatë vitit 2023 janë hartuar draft aktet ligjore dhe nënligjore si më poshtë, miratimi i të cilave do varet nga përputhshmëria me ligjin e ri, aty ku do të ketë ndryshime.

4.2.3.1 Draft Ligji për Institucionet mikrofinanciare dhe jobankare

Gjatë vitit 2022, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve ka themeluar grupin punues për hartimin e këtij Ligji. Pjesë e këtij grupi punues është edhe një përfaqësues nga BQK. Ky grup punues ka filluar punimet e tij në finalizimin e draftit të këtij Ligji. Gjatë vitit 2023 ka vazhduar aktiviteti në drejtim të draftimit të këtij ligji ku është angazhuar edhe ekipi nga Korporata Financiare Ndërkombëtare (IFC) dhe i njëjti pritet të procedohet për miratim gjatë 2024.

4.2.3.2 Rregullorja për qeverisjen korporative të institucioneve mikrofinanciare dhe jobankare

Gjatë vitit 2023 është finalizuar Draft-Rregullorja e re për Qeverisjen Korporative, me mbështetjen e asistencës teknike në kuadër të Projektit për Qeverisjen Korporative të mbështetur nga BERZH. Në kuadër të rregullimit të qeverisjes korporative të këtyre institucioneve është hartuar edhe Letra Këshilluese, e cila do të shërbejë si një udhëzues që tregon pritshmëritë e BQK-së për zbatimin e Rregullores, dhe që nuk do të ketë qëllimin urdhërues por vetëm informues. Qëllimi i Rregullores është të përcaktojë kornizën rregullative në harmoni me praktikën e mira të qeverisjes korporative. Rregullorja përcakton kërkesat minimale për Bordin e Drejtorëve dhe Menaxherët e Lartë lidhur me përgjegjësitë e tyre në qeverisjen korporative. Gjatë vitit 2023 gjithashtu janë organizuar punëtoritë për stafin e BQK-së dhe të industrisë përkatëse lidhur me kërkesat të cilat rrjedhin nga kjo Rregullore. Rregullorja i është nënshtruar një rishikimi dhe e njëjta pritet që të procedohet për miratim brenda vitit 2024.

4.2.3.3 Rregullore për menaxhimin e rrezikut të likuiditetit për IFJB-të

Për të rregulluar çështjen e menaxhimit të rrezikut të likuiditetit për IFJB-të gjatë vitit 2023 është finalizuar Draft-Rregullorja për Menaxhimin e Rrezikut të Likuiditetit për IFJB-të. Rregullorja vendos standardet dhe kërkesat minimale për menaxhimin efektiv të rrezikut të likuiditetit nga IFJB-të, me qëllim që IFJB-të të kenë asete të lira likuide të cilësisë së lartë që mund të shndërrohen lehtë dhe menjëherë në para të gatshme, për të përmbushur detyrimet e tyre në afat. Kjo Rregullore është në fazën e procedimit për miratim nga organet vendimmarrëse dhe pritet të miratohet gjatë vitit 2024.

4.2.3.4 Rregullore për auditimin e jashtëm të IMF-ve

Rregullorja për Auditimin e Jashtëm të IMF-ve është plotësuar-ndryshuar/ për arsye të përafrimit me zhvillimet e fundit në këtë fushë, njësoj si Rregullorja për Auditimin e Jashtëm të Bankave. Përmes kësaj Rregullore, punësimi i vazhdueshëm i Auditorit të Jashtëm të njëjtë është i zgjatur në pesë (5) vite apo pesë (5) auditime të njëpasnjëshme. Gjatë vitit 2023 është përpiluar drafti final i cili pritet të miratohet nga organet vendimmarrëse të BQK-së brenda vitit 2024.

4.2.3.5 Rregullore për auditimin e jashtëm të IFJB-ve

Kjo Rregullore është plotësuar-ndryshuar për arsye të përafrimit me zhvillimet e fundit në këtë fushë. Rregullorja harmonizon punësimin e vazhdueshëm të Auditorit të Jashtëm të njëjtë në pesë (5) vite apo pesë (5) auditime të njëpasnjëshme. Gjatë vitit 2023 është përpiluar drafti, i cili pritet të miratohet brenda vitit 2024.

4.2.3.6 Rregullore për regjistrimin e institucioneve mikrofinanciare

Gjatë vitit 2023 ka filluar plotësim-ndryshimi i Rregullores për Regjistrimin e IMF-ve. Qëllimi i Rregullores është të përcaktojë kushtet, kërkesat, procedurat dhe afatet që duhet ndjekur për regjistrimin e IMF-ve për të ushtruar veprimtari financiare, përfshirë degën e IMF-ve, transaksionet që kërkojnë miratim paraprak nga BQK gjatë ushtrimit të veprimtarisë nga IMF-të, dhe detyrimet për njoftime në BQK nga IMF-të gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre. Drafti është në fazën e finalizimit dhe pritet që i njëjti të procedohet për miratim gjatë vitit 2024.

4.2.3.7 Rregullore për regjistrimin e institucioneve financiare jo-bankare

Gjatë vitit 2023 ka filluar plotësim-ndryshimi i Rregullores për Regjistrimin e IFJB-ve. Qëllimi i Rregullores është të përcaktojë kushtet, kërkesat, procedurat dhe afatet që duhet ndjekur për regjistrimin e IFJB-ve për të ushtruar veprimtari financiare, përfshirë degën e IFJB-ve, transaksionet që kërkojnë miratim paraprak nga BQK gjatë ushtrimit të veprimtarisë nga IFJB-të, dhe detyrimet për njoftime në BQK nga IFJB-të gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre. Drafti është në fazën e finalizimit dhe pritet që i njëjti të procedohet për miratim gjatë vitit 2024.

4.2.4 Korniza rregullative për siguruesit

Në funksion të zhvillimit të mëtejshëm të kornizës ligjore dhe rregullative të siguruesve dhe ndërmjetësuesve në sigurime, gjatë vitit 2023 janë hartuar aktet ligjore dhe nënligjore, si më poshtë:

4.2.4.1 Rregullore për qeverisjen korporative të siguruesve

Gjatë vitit 2023 është finalizuar drafti i Rregullores së re për Qeverisjen Korporative të Siguruesve e cila e plotëson-ndryshon rregulloren ekzistuese për qeverisjen korporative të siguruesve. Kjo është arritur me mbështetjen e asistencës teknike në kuadër të Projektit për Qeverisjen Korporative të mbështetur nga BERZh. Në kuadër të rregullimit të qeverisjes korporative të siguruesve është hartuar edhe Letra Këshilluese e cila do të shërbejë si një udhëzues që tregon pritshmëritë e BQK-së për zbatimin e Rregullores. Gjatë vitit 2023, janë organizuar edhe punëtoritë për stafin e BQK-së dhe industrisë së sigurimeve lidhur me kërkesat të cilat rrjedhin nga kjo Rregullore. E njëjta pritet që të miratohet brenda vitit 2024.

4.2.4.2 Rregullore mbi kontrollat e brendshme dhe auditimin e brendshëm të siguruesve

Në kuadër të Projektit për Qeverisjen Korporative të institucioneve financiare të mbështetur nga BERZh, gjatë vitit 2023 është finalizuar drafti i rishikuar i Rregullores ekzistuese mbi Kontrollat e Brendshme dhe Auditimin e Brendshëm të Siguruesve. Drafti final i kësaj Rregullores pritet të miratohet së bashku me Rregulloren për Qeverisjen Korporative të siguruesve brenda vitit 2024.

4.2.4.3 Rregullore për menaxhimin e rrezikut të likuiditetit të siguruesve

Rregullorja për Menaxhimin e Rrezikut të Likuiditetit të Siguruesëve vendos standardet dhe kërkesat minimale për menaxhimin efektiv të rrezikut të likuiditetit nga siguruesit, me qëllim që siguruesit të kenë asete të lira likuide të cilësisë së lartë që mund të shndërrohen lehtë dhe menjëherë në para të gatshme për të përmbushur detyrimet e tyre në afat. Kjo Rregullore është finalizuar dhe është dërguar për miratim.

4.2.4.4 Rregullore për kërkesat e mbajtjes së rrezikut dhe mbulimit përmes risigurimit

Gjatë vitit 2023 është finalizuar Rregullorja ekzistuese për Kërkesat e Mbajtjes së Rrezikut dhe Mbulimit përmes Risigurimit, në të cilën janë adresuar problematikat e identifikuara nga BQK-ja gjatë zbatimit të Rregullores nga ana e siguruesve. Kjo Rregullore është finalizuar dhe proceduar për miratim në vitin 2024.

4.2.4.5 Rregullore për menaxhimin e rrezikut operacional të siguruesve

Gjatë ekzaminimeve të realizuara tek siguruesit, është parë i nevojësh rregullimi i menaxhimit të rrezikut operacional të siguruesve. Është finalizuar drafti i kësaj rregulloreje e cila do të adresojë kërkesa shtesë për siguruesit lidhur me menaxhimin e këtij rreziku. Qëllimi i kësaj rregullore është që të përcaktoj parimet bazë për identifikimin, matjen, kontrollin dhe menaxhimin e rrezikut operacional të siguruesve, strukturën dhe komponentët e tij, si dhe kërkesat mbikëqyrëse nga BQK. Kjo rregullore është finalizuar dhe është në fazën e procedimit brenda BQK-së.

4.2.4.6 Rregullore për Sistemet e Informacionit për Siguruesit

Rregullorja për Sistemet e Informacionit për Siguruesit përcakton kriteret dhe kushtet minimale që duhet të plotësojnë siguruesit për organizimin dhe për funksionimin e sistemeve të tyre të informacionit, të cilat mundësojnë uljen e rreziqeve që mund të shkaktohet nga keqpërdorimi i sistemeve të informacionit, si dhe të ruajë besueshmërinë e këtyre sistemeve, në mbështetje të veprimtarisë së siguruesve. Kjo rregullore është finalizuar dhe është në fazën e procedimit brenda BQK-së.

4.2.4.7 Rregullore për transaksionet me persona të ndërlidhur të siguruesve

Qëllimi i rregullores për transaksionet me persona të ndërlidhur të siguruesve është të përcaktoj parimet në rastet e transaksioneve që siguruesi i bën apo synon t'i bëj me palët e ndërlidhura me atë sigurues. Me hyrjen në fuqi të kësaj rregullore do të shfuqizohet Rregulla 27 e sigurimeve. Kjo draft rregullore është finalizuar dhe është në fazën e procedimit brenda BQK-së.

4.2.4.8 Rregullore për menaxhimin e komisioneve dhe shpenzimeve operative të siguruesve

Gjatë vitit 2023 është miratuar drafti i plotësuar-ndryshuar i Rregullores ekzistuese për Menaxhimin e Komisioneve dhe Shpenzimeve Operative të Siguruesve në të cilën janë adresuar problematikat e identifikuara nga BQK-ja gjatë zbatimit të saj nga ana e siguruesve. Me këtë Rregullore përcaktohen kriteret dhe kufizimet për menaxhimin e komisioneve dhe shpenzimeve për siguruesit jo-jetë.

4.2.4.9 Udhëzimi mbi kalkulimin dhe regjistrimin e “Kostove të Shtyra të Blerjes” (ang. DAC) në Pasqyrat Financiare

Është plotësuar/ndryshuar udhëzimi ekzistues. Ky udhëzim rregullon dhe standardizon procedurën si dhe metodologjinë për kalkulimin dhe raportimin e “Kostove të Shtyra të Blerjes” në pasqyrat financiare të siguruesve. Ky Udhëzim është në fazën e procedimit për miratim brenda BQK-së.

4.2.4.10 Rregullore për licencimin e siguruesëve dhe degëve siguruesëve të jashtëm

Gjatë vitit 2023 ka filluar plotësim-ndryshimi i Rregullores për Licencimin e Siguruesëve dhe Degëve të Siguruesëve të Jashtëm. Qëllimi i saj është të përcaktoj kushtet, kërkesat, procedurat dhe afatet që duhet ndjekur për licencimin e siguruesëve/risiguruesëve dhe degët e siguruesëve/risiguruesëve të jashtëm, transaksionet që kërkojnë miratim paraprak nga BQK gjatë

ushtrimit të veprimtarisë nga siguruesit/risiguruesit dhe dega e siguruesit/risiguruesit të jashtëm, dhe detyrimet për njoftime në BQK nga siguruesit/risiguruesit dhe degët e siguruesve/risiguruesve të jashtëm gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre. Drafti është në fazën e finalizimit dhe pritet që i njëjti të procedohet për miratim gjatë vitit 2024.

4.2.4.11 Rregullore për licencimin e ndërmjetësueseve në sigurime

Gjatë vitit 2023 ka filluar plotësim-ndryshimi i Rregullores për Licencimin e Ndërmjetësueseve në Sigurime. Qëllimi i saj është të përcaktojë kushtet, kërkesat, procedurat dhe afatet që duhet ndjekur për licencimin e ndërmjetësuesëve të sigurimeve dhe risigurimeve, transaksionet që kërkojnë miratim paraprak nga BQK, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së ndërmjetësimit në sigurime, dhe detyrimet për njoftime në BQK nga ndërmjetësuesit në sigurime gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre. Drafti është në fazën e finalizimit dhe pritet që i njëjti të procedohet për miratim gjatë vitit 2024.

4.2.4.12 Rregullore për aktuarët e siguruesve

Gjatë vitit 2023 ka filluar plotësim-ndryshimi i Rregullores për Aktuarët e Siguruesëve. Përmes këtij plotësim-ndryshimi me qëllim të kufizimit të angazhimit të të njëjtit aktuar në më shumë se dy sigurues. Drafti është finalizuar dhe është proceduar për miratuar në 2024.

4.2.5 Korniza Rregulative për Fondet Pensionale

Në funksion të zhvillimit të mëtejshëm të kornizës ligjore dhe rregulative të fondeve pensionale gjatë vitit 2023 janë hartuar aktet nënligjore, si në vijim:

4.2.5.1 Rregullorja mbi pjesëmarrjen në Fondin e Pensionit dhe Kategoritë profesionale të nëpunësve

Gjatë vitit 2023 ka filluar hartimi i Rregullores mbi Pjesëmarrjen në Fondin e Pensionit dhe Kategoritë Profesionale të Nëpunësve. Qëllimi i kësaj rregulloreje është të përcaktojë kërkesat për pjesëmarrje të punonjësve në Fondet Plotësuese Pensionale të punëdhënësit sipas programeve të pensioneve të sponsorizuara nga punëdhënësit. Drafti është në fazën e finalizimit dhe pritet që i njëjti të procedohet për miratim gjatë vitit 2024.

4.2.5.2 Rregullorja mbi shuarjen e Pensioneve Individuale Suplementare

Gjatë vitit 2023 është finalizuar Rregullorja mbi Shuarjen e Pensioneve Individuale Suplementare. Kjo rregullore përcakton kërkesat që duhet të plotësohen për përfundimin e Pensionit Plotësues Individual, si dhe përcakton detyrime të caktuara për Siguruesit të Pensionit, Bordit Drejtues të tij dhe Menaxherin e Posaçëm i emëruar nga BQK. Rregullorja pritet të miratohet në vitin 2024.

4.2.5.3 Rregullore mbi përfundimin e Fondit Plotësues Pensional të punëdhënësit

Rregullorja mbi përfundimin e Fondit Plotësues Pensional të punëdhënësit është finalizuar dhe është në fazën e procedimit brenda BQK-së për miratim. Kjo rregullore përcakton kërkesat që duhet të plotësohen gjatë përfundimit të Fondit plotësues pensional të punëdhënësit, detyrat e sponsorizuesit, Bordit Drejtues të Fondit të Pensionit dhe Menaxherit të posaçëm të emëruar nga BQK-ja që të zhvillojë likuidimin dhe shpërndarjen e mjeteve të pensioneve. Rregullorja pritet të miratohet në vitin 2024.

4.2.5.4 Rregullore për mbikëqyrjen e fushës së teknologjisë informative në fondet pensionale

Kjo rregullore ka kaluar miratimin e Bordit Ekzekutiv dhe është në procedurë për miratim nga BQK-së. Qëllimi i kësaj rregulloreje është të përcaktojë kriteret dhe kushtet minimale që duhet të plotësojnë fondet pensionale për organizimin dhe për funksionimin e sistemeve të tyre të teknologjisë së informacionit për të ulur rrezikun operacional si dhe të ruajnë besueshmërinë e këtyre sistemeve. Kjo Rregullore është proceduar për miratim në vitin 2024.

4.2.6 Aktivitete tjera rregullative

Aktivitete tjera që mund të veçohen gjatë vitit 2023 janë:

- Hartimi i Udhëzimit për Kriteret për Emërimin e Administratorëve dhe Likuidatorëve të Institucioneve Financiare, i miratuar nga organet vendimmarrëse të BQK-së;
- Aktivitetet rreth raporteve, pyetësorëve dhe dokumenteve tjera të ndryshme, të pranuar nga Komisioni European, Qeveria e Republikës së Kosovës dhe organizatat tjera ndërkombëtare;

5. Mbikëqyrja e sistemit financiar

Në funksion të pasqyrimin të aktivitetit të BQK-së në fushën e mbikëqyrjes financiare konform kërkesave që dalin nga legjislacioni primar dhe sekondar përkatës, në vazhdim është paraqitur aktiviteti i mbikëqyrjes financiare sipas natyrës së institucioneve financiare.

Sektori bankar

Gjatë vitit 2023 ka vazhduar aktiviteti i ekzaminimeve të bankave, përmes ekzaminimeve në vend të bankave, me anë të aplikimit të qasjes së mbikëqyrjes së bazuar në rrezik sipas Manualit të Mbikëqyrjes së Bazuar në Rrezik për Banka.

Gjatë ekzaminimeve të plota në vend, të bankave, është vlerësuar profili i rrezikut të bankave, mënyra e qeverisjes, apetitet e bankave për të marrë rreziqe, sistemi i vendosur nga ana e tyre për të menaxhuar rreziqet, si dhe është bërë përcjellja e përmbushjes së rekomandimeve të dala nga ekzaminimet paraprake të BQK-së.

Këtë vit në banka janë kryer ekzaminimet si në vijim:

Tabela 17. Numri i ekzaminimeve në banka, gjatë vitit 2023

Institucionet	Lloji i Ekzaminimit
Banka	3 ekzaminime të plota
	4 ekzaminime të fokusuara

Burimi: BQK (2024)

Raportet e ekzaminimeve të plota janë përgatitur sipas llojit të rreziqeve bankare: rrezikut kreditor, rrezikut të likuiditetit, rrezikut të tregut, dhe rrezikut operacional.

Përveç ekzaminimeve të plota janë kryer ekzaminime të fokusuara në banka, si investimet në letra me vlerë, dhe ekspozimet e mëdha.

Si pjesë integrale e ekzaminimeve, janë dhënë 76 rekomandime përkatëse me afate kohore për zbatim, varësisht nga pesha, ndikimi, dhe ndjeshmëria e gjetjeve.

Në vazhdimësi është bërë përcjellja e përmbushjes së tyre nga banka, ku është verifikuar nëse rekomandimet janë përmbushur sipas afateve të specifikuara kohore.

Si rezultat i mbikëqyrjes prudente dhe kornizës rregullative në pajtueshmëri me Standardet e Bazelit dhe Kornizën Rregullative të BE-së, sektori bankar mbetet i shëndoshë, i kapitalizuar mirë dhe likuid, si dhe me kualitet të mirë të aseteve.

Informacione më të hollësishme rreth sektorit bankar dhe treguesve kryesor janë trajtuar në kuadër të Seksionit 3.4, përkatësisht pikës 3.4.2 të këtij raporti.

Sektori i Institucioneve Mikrofinanciare dhe Institucioneve Financiare Jobankare

Institucionet Mikro-Financiare (IMF) dhe Institucionet Financiare Jo-Bankare (IFJB) gjatë vitit 2023 vazhduan të shtojnë peshë në zhvillimin e industrisë financiare të vendit dhe si të tilla mbeten gjithnjë e më aktivë në ndërmjetësimin financiar, në kreditimin kryesisht të shtresave me të ardhura të vogla, ekonomive familjare, dhe bizneseve individuale, që jo lehtësisht gjejnë qasje në burime të financimit. Si IMF-të, e poashtu edhe IFJB-të me aktivitet kreditues, të lizingut, dhe zyrat e këmbimit të valutave, vazhduan me sukses ofrimi e produkteve të tyre në ekonomi. Fokus të rëndësishëm në tregun financiar kanë pasur edhe IFJB-të e transferit të parave dhe shërbimit të pagesave, me theks institucionet e emetimit të parasë elektronike.

Si rezultat i zgjerimit të vazhdueshëm të pikave të shërbimit të pagesave, si dhe kostove të pranueshme dhe mjaft konkurruese në ofrimin e shërbimeve të tilla, IFJB-të me aktivitet shërbimin e pagesave dhe emetimin e parasë elektronike, kanë realizuar një performancë mjaft pozitive.

Spektori i IFJB-ve ka vazhduar të karakterizohet me rritje të vazhdueshme përgjatë vitit 2023 si nga aspekti i operimit të institucioneve të reja në këtë treg, e po ashtu dhe në aspekt të lansimit të produkteve dhe shërbimeve të reja. Departamenti i Mbikëqyrjes Bankare gjatë gjithë vitit ka përcjellë performancën financiare të IMF-ve dhe IFJB-ve përmes raporteve mujore që ato kanë dorëzuar në BQK, si dhe realizimit të ekzaminimeve në vend në institucionet respektive, e me ç'rast në varësi të nevojave janë ndërmarrë veprime të nevojshme, pasuar me rekomandime konkrete për t'u zbatuar nga këto institucione. Në raste të caktuara janë ndërmarr edhe masa administrative. Në vitin 2023 në IMF dhe IFJB janë kryer ekzaminimet si në vijim:

Tabela 18. Numri i ekzaminimeve në IMF dhe IFJB.

Institucionet	Lloji i Ekzaminimit
IFJB	6 ekzaminime të plota

Burimi: BQK (2024)

Gjatë vitit 2023 janë realizuar 6 ekzaminime të plota në IFJB (shih Tabelën 18), ku konform objektivave përkatëse, mbikëqyrja e realizuar në vend në IFJB gjatë këtij viti është fokusuar në vlerësimin e menaxhimit të rrezikut, pajtueshmërisë me legjislacionin e BQK-së, politikat e brendshme të tyre, dhe vlerësimin e përgjithshëm të qeverisjes korporative institucionale. Gjithashtu, gjatë ekzaminimeve në IFJB është ekzaminuar dhe vlerësuar rreziku në fushën e teknologjisë informative, me fokus në sigurinë e përgjithshme të sistemeve, si dhe krijimit dhe plotësimit të masave të sigurisë për një funksionim të mirëfilltë të teknologjisë informative. Rrjedhimisht, reflektimet e këtyre institucioneve konform zhvillimeve pozitive në këtë sektor tregojnë për hapat e sukseseve karshi qasjes adekuate dhe mbikëqyrjes efektive të BQK-së, ku nëpërmjet ekzaminimeve përkatëse dhe rekomandimeve konkrete për implementim është arritur të reflektohet avancim në menaxhimin e riskut, kontrollave të brendshme, si dhe përmirësimin e infrastrukturës rregulluese dhe raportuese të këtij sektori.

Informacione më të hollësishme rreth sektorit mikrofinanciar dhe jobankar dhe treguesve kryesor janë trajtuar në kuadër të Seksionit 3.4, përkatësisht pikës 3.4.5 të këtij raporti.

Spektori i sigurimeve

BQK ka vazhduar aktivitetin në realizimin e detyrave dhe përgjegjësi në funksion të mbikëqyrjes prudente për sektorin e sigurimeve edhe në vitin 2023. Aktiviteti i mbikëqyrjes është realizuar përmes mbikëqyrjes në vend – ekzaminimeve dhe sistemit të monitorimit dhe analizimit të raporteve financiare. BQK është angazhuar me kapacitet të plotë në realizimin e ekzaminimeve të plota dhe të fokusuara. Qëllim i ekzaminimeve ka qenë vlerësimi i gjendjes së përgjithshme të institucioneve përkatëse në raport me profilin e rrezikut dhe pajtueshmërisë me ligjet dhe rregulloret e BQK-së, në funksion të mbrojtjes së policëmbajtësve dhe ruajtjes së stabilitetit financiar të institucioneve. Klasifikimi i siguruesve për të qenë subjekt i ekzaminimeve është bazuar në disa faktorë, duke filluar nga analizat e pasqyrave dhe treguesve financiarë, opinionit të pasqyrave financiare nga auditori i jashtëm, ekzaminimeve paraprake të realizuara, ankesave të policëmbajtësve në BQK, si dhe faktorëve tjerë relevantë. Kjo ka ndikuar në prioritizimin e institucioneve më me rrezik për të qenë subjekt i ekzaminimeve të radhës nga BQK dhe si rrjedhojë, në ngritjen e nivelit të mbikëqyrjes efektive.

Tabela 19. Numri i ekzaminimeve të sektorit të sigurimeve

Institucioni	Lloji i ekzaminimit
Sigurues	6 ekzaminime të plota
Trajtues të dëmeve	2 të fokusuara 2 ekzaminime
Ndërmjetësues	1 ekzaminim i plotë 1 i fokusuar

Burimi: BQK (2024)

Gjatë vitit 2023, BQK ka vazhduar me implementimin e Manualit të Mbikëqyrjes së Bazuar në Rrezik për Siguruesit, i cili përbën një kornizë konceptuale të avancuar lidhur me mbikëqyrjen. Kjo në funksion të harmonizimit me parimet bashkëkohore të mbikëqyrjes së sigurimeve, të zgjerimit dhe nxitjes së identifikimit të hershëm të rreziqeve të pranishme tek siguruesit, si dhe hartimin e rekomandimeve mbikëqyrëse prudente në funksion të ruajtjes së sigurisë dhe stabilitetit financiar të siguruesve. Gjithashtu, BQK u angazhua edhe në projekte me ndikim material në kornizën rregullative dhe mbikëqyrëse të siguruesve. Përkrahur nga asistenca e ofruar nga BB, BQK ka vazhduar fazat fillestare të projektit afatgjatë për përafrimin me kërkesat për kapital sipas Solvencës II. Gjatë këtij viti, nga ekipi i BB-së është arritur të finalizohet propozimi lidhur me udhërrëfyesin për përafrimin me kërkesat e kapitalit sipas Solvencës II. Poashtu, pjesë e kësaj asistence është edhe përcaktimi i primit për produktin e sigurimit të detyrueshëm nga autopërgjegjësia sipas faktorëve të rrezikut dhe procesi i përgatitjes për liberalizimin e tregut.

Sektori i sigurimeve, ka përmbyllur vitin 2023 në pajtueshmëri me kërkesat ligjore në raport me fondin garantues, aftësinë paguese dhe asetet e pranueshme në mbulim të provizioneve teknike sipas auditimit të jashtëm, duke shënuar përmirësim të mëtejshëm të rëndësishëm krahasuar me periudhat e mëhershme. Ky përmirësim nga periudha e njëjtë e vitit paraprak vjen edhe si rezultat i një performance më të mirë të siguruesve si dhe plotësimit/injektimit të kapitalit në shumë prej 1.3 milion euro nga ana e aksionarëve. Rrjedhimisht, kapitali në raport me fondin garantues për siguruesit “jo-jetë” në vitin 2023 rezulton në 129.3 përqind mbi normën e pranuar prej 100%, përderisa për siguruesit “jetë” raporti rezulton në 148.1 përqind. Megjithatë, cilësia e asetëve ose pranueshmëria e tyre është subjekt i vlerësimit të BQK-së. Mbulueshmëria e provizioneve teknike me asete të pranueshme arriti në 113.0 përqind për siguruesit “jo-jetë”, dhe 107.4 përqind për siguruesit “jetë”.

Informacione më të hollësishme rreth sektorit të sigurimeve dhe treguesve kryesor janë trajtuar në kuadër të Seksionit 3.4, përkatësisht pikës 3.4.4 të këtij raporti.

Fondet pensionale

Në funksion të ruajtjes së qëndrueshmërisë të sektorit financiar, në vitin 2023 janë zhvilluar ekzaminimet në fonde pensionale dhe banka sipas planit vjetor. Mbikëqyrja e pensioneve ka zbatuar qasjen e mbikëqyrjes bazuar në rrezik, ku vëmendje e theksuar i është kushtuar zbatimit të kërkesave të legjislacionit në fuqi, menaxhimit të fondeve, strategjisë së investimeve, efektivitetit të kontrolleve të brendshme, ruajtjes së likuiditetit adekuat, dhe rreziqeve tjera.

Sa i përket mbikëqyrjes së fondeve pensionale, gjatë vitit 2023 janë realizuar 3 ekzaminime në fondet pensionale dhe 2 ekzaminime në bankat komerciale për tërheqje fazore të pensioneve të administruara nga bankat. Fushëveprimi i ekzaminimeve ishte rishikimi dhe vlerësimi i gjendjes së përgjithshme të fondeve pensionale, pajtueshmëria me ligjet relevante dhe rregulloret e BQK-së, efektshmëria e funksionimit të kontrolleve të brendshme, dhe zbatimi i rekomandimeve të ngritura në raportet e ekzaminimit të BQK-së, me qëllim të mbrojtjes së mjeteve pensionale të kursyera nga kontribuesit dhe ruajtjes së stabilitetit financiar të fondeve.

Tabela 20. Numri i ekzaminimeve të sektorit të pensioneve

Institucionet	Lloji i Ekzaminimit
Fondet Pensionale	3 ekzaminime
Banka	2 ekzaminime

Burimi: BQK (2024)

Informacione më të hollësishme rreth sektorit pensional dhe treguesve kryesor janë trajtuar në kuadër të Seksionit 3.4, përkatësisht pikës 3.4.3 të këtij raporti.

Parandalimi i pastrimit të parasë

BQK-ja bazuar në paragrafin 4 të nenit 34 të Ligjit për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimit të Financimit të Terrorizmit, zbaton kompetencat mbikëqyrëse në institucionet financiare për sa i përket pajtueshmërisë me këtë ligj dhe me rregulloret përkatëse. Gjatë vitit 2023, BQK-ja ka vazhduar me realizimin e funksionit mbikëqyrës në institucionet financiare sa i përket pajtueshmërisë me parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, duke i realizuar 7 ekzaminime të plota. Në institucionet bankare janë realizuar 5 ekzaminime të plota, ndërsa 2 ekzaminime të plota janë realizuar në IFJB. Tabela në vazhdim paraqet numrin e ekzaminimeve të realizuara për vitin 2023.

Tabela 21. Numri i ekzaminimeve për pastrimin e parasë

Institucionet	Lloji i Ekzaminimit
Banka, IMFJB	7 ekzaminime të plota

Burimi: BQK (2024)

Për zbatim sa më efektiv në praktikë të Ligjit për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimit të Financimit të Terrorizmit është e nevojshme nxjerrja e akteve udhëzuese. Ndërlidhur me këtë, është miratuar “Udhëzuesi për kujdesin e duhur të klientit dhe faktorët që bankat dhe institucionet financiare duhet të marrin parasysh gjatë vlerësimit të rrezikut të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”.

Në aspektin e fuqizimit të bashkëpunimit dhe rritjes së kujdesit për sektorin financiar janë zhvilluar takime me Komitetin për Pajtueshmëri brenda Shoqatës së Bankave të Kosovës dhe me bankat komerciale, në të cilat takime janë shqyrtuar kërkesat lidhur me kornizën ligjore dhe operacionale të fushës. Ndërsa, në kuadër të projektit të përbashkët të BE-së dhe Këshillit të Evropës kundër Krimit Ekonomik në Kosovë (PECK III), BQK ka vazhduar me pjesëmarrje aktive në takimet e Këshillit Drejtues dhe aktivitetet tjera të projektit. Në këtë drejtim, vlen të ceket që BQK gjatë vitit 2023 në kuadër të projektit PECK III ka përfituar asistencën teknike nga ekspertët e Këshillit të Evropës për ngritjen e kapaciteteve të mbikëqyrjes së bazuar në rrezik.

Ankesat e shfrytëzuesve të shërbimeve financiare

Gjatë vitit 2023 janë pranuar, sistemuar dhe shqyrtuar ankesat e shfrytëzuesve të shërbimeve financiare në pajtueshmëri me rregulloren përkatëse, si dhe janë bërë raportimet e rregullta lidhur me aktivitetet për trajtimin e ankesave të shfrytëzuesve të shërbimeve financiare.

Këtë vit janë shqyrtuar gjithsej 792 ankesa të shfrytëzuesve të shërbimeve financiare (persona fizikë e juridikë), të cilat paraqiten të detajuara në vijim:

- Gjithsej numri i ankesave për bankat komerciale të adresuara në BQK për vitin 2023 kanë qenë 448. Ankesat më të shpeshta kanë qenë në lidhje me produktet kreditore (kredi),

përkatësisht klasifikimin në Regjistrin Kreditor të Kosovës (RKK), dhe ankesa lidhur me dyshime për keqpërdorimin e kredit kartelës;

- Gjithsej numri i ankesave për IMF-të dhe IFJB-të të adresuara në BQK për vitin 2023 kanë qenë 81. Ankesat më të shpeshta kanë qenë lidhur me produktin e kredisë, përkatësisht klasifikimin në RKK;
- Gjithsej numri i ankesave ndaj kompanive të sigurimeve të adresuara në BQK për vitin 2023 kanë qenë 246. Ankesat më të shpeshta ishin në lidhje me moskompensim të dëmit material dhe jomaterial nga sigurimi i autopërgjegjësishë TPL, mosrespektimi i afateve kohore për pagesë tek marrëveshjet jashtëgjyqësore, dhe moskompensimin e shpenzimeve mjekësore nga sigurimi shëndetësor.

Tabela 22. Numri i ankesave ndër vite

Industria financiare	Numri i ankesave sipas viteve		
	2021	2022	2023
Bankat komerciale	542	518	448
IMF / IFJB	121	87	81
Kompanitë e sigurimeve	339	262	246
Fondet pensionale	3	0	1
Kërkesa të tjera	20	6	16
Gjithsej ankesa	1,025	873	792

Burimi: BQK (2024)

Në Tabelën 21 është paraqitur numri i ankesave të shqyrtuara gjatë tri viteve të fundit, ku vërehet se numri i ankesave të pranuar dhe trajtuara në vitin 2023 është më i ulët në krahasim me dy vitet paraprake. Rënia e numrit të ankesave për shërbimet financiare krahasuar me vitin paraprak mund të interpretohet si një tregues i përmirësimit të cilësisë së shërbimit nga institucionet financiare, por edhe si rritje e efektivitetit të veprimeve të BQK-së për të adresuar shqetësimet dhe problemet e klientëve në sektorin financiar.

Nga numri i përgjithshëm i ankesave të shqyrtuara në vitin 2023, rreth 31 përqind e tyre pas trajtimit nga BQK kanë rezultuar të zgjidhura në favor të palëve që janë ankuar, ndërsa të tjerat kanë qenë qoftë ankesa të pabazuara ose të pambështetura me argumente, ose janë udhëzuar të shqyrtohen fillimisht nga institucionet financiare, në pajtim me rregullën përkatëse për ankesa. Kjo vë në pah nevojën për avancim të edukimit financiar dhe mbrojtjes së konsumatorit.

Tabela 23. Numri i ankesave sipas statusit

Industria financiare	Gjithsej ankesa	Të mbështutura	Të pa-mbështutura
Bankat komerciale	448	138	310
IMF / IFJB	81	14	67
Kompanitë e sigurimeve	246	63	183
Fondet pensionale	1	0	1
Kërkesa të tjera	16	2	14
Gjithsej ankesa	792	217	575

Burimi: BQK (2024)

6. Shërbimet e siguruara për autoritetet, komunitetin financiar, dhe publikun

6.1. Operacionet dhe menaxhimi i parave të gatshme

BQK në kuadër të operacioneve të menaxhimit të parave të gatshme siguron furnizimin e ekonomisë vendore me sasi dhe cilësi të duhur të kartëmonedhave dhe monedhave euro. Për realizimin e këtij funksioni mban dhe administron rezervat valutore, rregullon dhe përcakton standardet për institucionet financiare në lëminë e operacioneve me para të gatshme që kanë të bëjnë me kontrollin dhe riqarkullimin e kartëmonedhave dhe monedhave, ka obligimin për tërheqjen nga qarkullimi të parave të dyshuara si të falsifikuara dhe atyre të papërshtatshme për riqarkullim, si dhe përcakton kriteret për këmbimin e parave të dëmtuara.

Gjatë vitit 2023, përkundër sfidave të paraqitura, BQK përmbushi në mënyrë të suksesshme furnizimin e ekonomisë vendore me sasi dhe cilësi të duhur të kartëmonedhave dhe monedhave euro.


Tabela 24. Shuma dhe vëllimi i aktiviteteve të përgjithshme të operacioneve me para të gatshme

Llojet e transaksioneve	2019	2020	2021	2022	2023
Shuma e transaksioneve me para te gatshme (në euro)	3,582,508,222	3,145,892,125	4,066,951,506	5,212,926,592	5,880,040,716
Rritja vjetore e shumës së transaksioneve me para te gatshme	50.21%	-12.19%	29.28%	28.18%	12.80%
Pranimi i kartëmonedhave	1,697,553,870	1,449,545,855	2,087,439,200	2,499,965,400	2,735,521,340
Furnizimi me kartëmonedha	731,312,360	1,093,937,800	967,243,590	981,543,770	871,352,540
Eksporti i kartëmonedhave	1,050,000,000	475,000,000	950,000,000	1,700,000,000	2,215,000,000
Import i kartëmonedhave	100,000,000	125,000,000	60,000,000	28,500,000	44,000,000
Pranimi i monedhave	888,000	0	290,000	180,362	20,000
Furnizimi me monedha	1,324,992	1,045,470	1,367,716	1,616,060	2,414,836
Eksporti i monedhave	0	0	0	0	0
Import i monedhave	1,429,000	1,363,000	611,000	1,121,000	11,732,000
Vëllimi i transaksioneve me para te gatshme (në copë)	82,844,588	77,997,553	95,447,465	121,075,678	148,468,536
Rritja vjetore e vëllimit të transaksioneve me para te gatshme	37.37%	-5.85%	22.37%	26.85%	22.62%
Pranimi i kartëmonedhave	29,285,567	29,268,128	40,173,242	45,151,268	49,980,419
Furnizimi me kartëmonedha	16,783,917	25,258,425	19,627,266	19,016,775	19,159,994
Eksporti i kartëmonedhave	15,586,000	9,672,000	18,128,000	32,333,000	38,072,000
Import i kartëmonedhave	3,590,000	4,420,000	3,715,000	2,700,000	4,650,000
Pranimi i monedhave	670,000	0	160,500	180,185	20,000
Furnizimi me monedha	7,229,104	5,379,000	7,743,457	10,544,450	12,786,123
Eksporti i monedhave	0	0	0	0	0
Import i monedhave	9,700,000	4,000,000	5,900,000	11,150,000	23,800,000

Burimi: BQK (2024)


Krahasuar me vitin e kaluar, gjatë vitit 2023 aktivitetet e përgjithshme të operacioneve me para të gatshme shënuan një rritje grupore prej 12.80 përqind (shprehur në vlerë) dhe një rritje grupore prej 22.62 përqind (shprehur në vëllim).

Grafik 51. Furnizimimi me para të gatshme, (vlera) në milionë euro



Burimi: BQK (2024)


Grafik 52. Pranimi i parave të gatshme, (vlera) në milionë euro



Burimi: BQK (2024)


Vlera e përgjithshme e furnizimit me para të gatshme në vitin 2023, shënoi një rënie prej 11.13 përqind krahasuar me vitin 2022 (shih Grafikon 51). Struktura e parave të gatshme të furnizuara sipas denominimeve, që në radhë të parë përcaktohet nga kërkesat e sektorit bankar, gjithashtu nuk pati ndonjë ndryshim nga viti 2022 në vitin 2023.

Grafik 53. Furnizimimi i parave të gatshme, (vëllimi) në milionë copë



Burimi: BQK (2024)


Grafik 54. Pranimi i parave të gatshme, (vëllimi) në milionë copë



Burimi: BQK (2024)


Gjatë këtij viti, BQK furnizoi sektorin bankar me mbi 19.16 milionë copë kartëmonedha euro (në vlerë prej mbi 871.35 milionë euro) (Grafiku 53) dhe me mbi 12.79 milionë copë monedha euro (në vlerë prej mbi 2.41 milion euro).

Grafik 55. Furnizimi me kartëmonedha euro sipas denominimeve (numri i copëve)



Burimi: BQK (2024)

Grafik 56. Furnizimi me monedha euro sipas denominimeve (numri i copëve)



Burimi: BQK (2024)

Te kartëmonedhat euro, vëllimet e kërkesave për furnizim gjatë vitit 2023 shënuan një rritje të moderuar prej 0.75 përqind krahasuar me vitin e kaluar dhe vazhduan të dominojnë kërkesat për furnizime me denominimet me prerje prej 5, 20 dhe 100 euro të cilat përbënin rreth 82.78 përqind të kërkesës vëllimore për furnizim.


Përderisa gjatë këtij viti kërkesa për denominimet në vlerë prej 200, 100 dhe 50 euro shënuan një rënie grupore prej 11.79 përqind, kërkesa për denominimet në vlerë prej 20, 10 dhe 5 euro shënoi rritje grupore prej 11.95 përqind krahasuar me vitin e kaluar (shih Grafikon 55).

Vëllimet e kërkesave për furnizim me monedha gjatë vitit 2023 shënuan një rritje prej rreth 21.26 përqind krahasuar me vitin 2022. Kërkesa për furnizim me monedha euro këtë vit u dominua nga monedhat me vlerë të vogël prej 1, 2 dhe 5 euro cent të cilat përbënin rreth 61.47 përqind të kërkesës për furnizim (shih Grafikon 56). Krahasuar me vitin paraprak, kërkesat për denominimet prej 1, 2 dhe 5 euro cent kanë shënuar një rritje grupore prej 10.59 përqind, ndërsa kërkesat për furnizim me denominimet prej 2 euro, 1 euro dhe 50, 20 dhe 10 euro cent kanë shënuar një rritje grupore prej 43.31 përqind në raport me vitin paraprak.

Vlera e përgjithshme e parave të gatshme të pranuar si depozita shënoi një rritje prej 9.42 përqind në vitin 2023 krahasuar me vitin paraprak. Të shprehura në vlerë, depozitat e parave të gatshme arritën shumat prej afër 2.74 miliardë kartëmonedha euro dhe mbi 0.02 milionë monedha euro përkatësisht. BQK-ja pranoi nga sektori bankar mbi 49.98 milionë copë kartëmonedha (mesatarisht rreth 200,725 copë kartëmonedha në ditë), ndërsa depozitat e monedhave ishin vetëm 20,000 copë. Vëllimet e kartëmonedhave të pranuar gjatë vitit 2023 shënuan një rritje prej rreth 10.70 përqind krahasuar me vitin 2022.


Struktura e kartëmonedhave euro të pranuar gjatë vitit 2023 nuk ka pasur ndonjë ndryshim të madh nga viti paraprak, kurse siç shihet edhe në Grafikon 57, depozitat e monedhave në vitin 2023 ishin në nivel mjaft të ulët.

Grafik 57. Pranimi i kartëmonedhave euro sipas denominimeve (numri i copëve)



Burimi: BQK (2024)

Grafik 58. Pranimi i monedhave euro sipas denominimeve (numri i copëve)



Burimi: BQK (2024)

Ngjashëm me vitet e kaluara, edhe gjatë vitit 2023 paratë e gatshme të pranuar ishin në një vlerë më të lartë se sa paratë e gatshme të furnizuara. Në fakt, këtë vit paratë e gatshme neto¹⁸ (tepricat) ishin rreth 1.86 miliardë euro, shifër dukshëm më e lartë se sa në vitin e kaluar kur paratë e gatshme neto ishin rreth 1.52 miliardë euro. Kjo rritje kryesisht i atribuohet rritjes së vëllimit të depozitave të parave të gatshme nga sektori bankar në njërën anë, dhe rënies së kërkesës për paratë të gatshme në anën tjetër.


Meqë BQK mban vetëm nivelin optimal të nevojshëm të parave të gatshme për kryerjen e operacioneve, tepricat dërgohen në Eurozonë, ku pastaj përdoren për kryerjen e pagesave ndërkombëtare, si dhe përmes investimeve kthehen në mjete interes-prurëse. Neto dërgesat¹⁹ jashtë vendit të parave të gatshme në vitin 2023 arritën shumën prej 2.16 miliardë euro duke qenë më e lartë për 29.27 përqind se sa një vit më parë kur ishin 1.67 miliardë euro (shih Grafikët 59 dhe 60). Kjo rritje erdhi si rezultat i zvogëlimit të gjendjes së rezervave valutore të mbajtura në

¹⁸ Depozitat minus Tërheqjet e parave të gatshme

¹⁹ Importet minus Eksportet e parave të gatshme


BQK në një rën të anë, dhe rritjes së depozitimeve nga sektori bankar dhe rënies së kërkesës për para të gatshme në anën tjetër.

Grafik 59. Eksporti i parave të gatshme (vlera), në milionë euro



Burimi: BQK (2024)


Grafik 60. Importi i parave të gatshme, (vlera) në milionë euro



Burimi: BQK (2024)


Gjatë vitit 2023, rreth 49.98 milionë copë kartëmonedha euro të pranuar nga sektori bankar u procesuan duke u kontrolluar për autenticitet dhe duke u klasifikuar sipas shkallës së përshtatshmërisë. Kontrolli për autenticitet dhe klasifikimi sipas shkallës së përshtatshmërisë i një vëllimi kaq të madh të kartëmonedhave ka kontribuar dukshëm në mbrojtjen e integritetit të kartëmonedhave euro si dhe mundësimin e detektimit të falsifikimit duke siguruar kështu që të gjitha kartëmonedhat dhe monedhat euro të futura në qarkullim të kishin një gjendje të mirë kualitative (të përshtatshme për riqarkullim), në mënyrë që të sigurohej se këto të fundit mundën lehtë të kontrollohen për vërtetësinë e tyre.

Grafik 61. Eksporti i parave të gatshme (vëllimi), në milionë copë



Burimi: BQK (2024)


Grafik 62. Importi i parave të gatshme (vëllimi), në milionë copë



Burimi: BQK (2024)


Rreth 18.34 milionë copë kartëmonedha euro apo 36.69 përqind e numrit të përgjithshëm kartëmonedhave euro të depozituara nga sektori bankar gjatë vitit 2023 u klasifikuan si të papërshtatshme për riqarkullim (tejet të vjetërsuara/dëmtuara) dhe u hoqën nga qarkullimi duke u dërguar në bankat e Eurozonës (shih Grafikun 63). Ky vëllim i konsiderueshëm kontriboi në mënyrë të dukshme në përmirësimin e cilësisë së parave të gatshme në qarkullim në Republikën e Kosovës.

Grafik 63. Kartëmonedha të papershtatshme të tërhequra nga qarkullimi (vëllimi), në milionë copë



Burimi: BQK (2024)


Grafik 64. Kartëmonedha të papërshtatshme të tërhequra nga qarkullimi nga gjithsej të pranuar, në përqindje



Burimi: BQK (2024)


Ngjashëm me vitet e kaluara, kartëmonedhat që më së shumti u klasifikuan si të papërshtatshme për riqarkullim ishin ato të denominimeve 50, 20, 10 dhe 5 euro. Ato përbënin rreth 87.6 përqind të vëllimit të kartëmonedhave të papërshtatshme të tërhequra nga qarkullimi për shkak të përdorimit më të shpeshtë nga qytetarët (shih Grafikët 65 dhe 66).

Grafik 65. Kartëmonedha të papërshtatshme të tërhequra nga qarkullimi (numri i copëve)



Burimi: BQK (2024)


Grafik 66. Kartëmonedha të papërshtatshme të tërhequra nga qarkullimi nga gjithsej të pranuar (në përqindje)



Burimi: BQK (2024)


Cilësia e parave të gatshme në qarkullim u përmirësua gjithashtu edhe përmes furnizimit të sektorit bankar me kartëmonedha euro plotësisht të reja, të cilat u sollën nga Eurozona. Gjatë vitit 2023, BQK furnizoi sektorin bankar me më shumë se 4.02 milionë copë kartëmonedha të reja euro apo 20.99 përqind e të gjithë numrit të kartëmonedhave euro të furnizuara (shih Grafikët 67 dhe 68).

Grafik 67. Kartëmonedha të reja të futura në qarkullim (vëllimi), në milionë copë



Burimi: BQK (2024)

Grafik 68. Kartëmonedha të reja të futura në qarkullim (vëllimi) nga gjithsej të furnizuara, në përqindje




Burimi: BQK (2024)

Rreth 88.75 përqind e sasisë së kartëmonedhave të reja të furnizuara gjatë vitit 2023 ishin kartëmonedha të denominimeve me vlerë të ulët (20, 10 dhe 5 euro), me të cilat u furnizuan bankat


komerciale me qëllim të shlyerjes së transaksioneve me para të gatshme (shih Grafikët 67 dhe 70). Për më tepër, të gjitha kartëmonedhat euro me të cilat u furnizuan bankat komerciale ishin të përshtatshme për riqarkullim dhe të një cilësie të lartë.

Grafik 69. Kartëmonedha të reja të lëshuara në qarkullim (numri i copëve)



Burimi: BQK (2024)


Grafik 70. Kartëmonedha të reja të lëshuara në qarkullim në raport me gjithsej të furnizuara (në përqindje)



Burimi: BQK (2024)


Gjatë këtij viti janë identifikuar një numër prej 2,410 kartëmonedhash dhe 40,184 monedhash të falsifikuara (shih Grafikët 71 dhe 73). Pjesa më e madhe e këtyre kartëmonedhave dhe monedhave janë konfiskuar nga institucionet financiare gjatë aktivitetit të tyre të rregullt.

Grafik 71. Kartëmonedhat euro të falsifikuara të konfiskuara në qarkullim (numri i copëve)



Burimi: Agjencia e Kosovës për Forenzikë (2024)

Grafik 72. Kartëmonedhat euro të falsifikuara të konfiskuara në qarkullim, sipas denominimeve (numri i copëve)




Burimi: Agjencia e Kosovës për Forenzikë (2024)

Për dallim nga vitet paraprake kur kartëmonedhat më të falsifikuara kanë qenë ato të prerjes prej 50 dhe 100 euro, në vitin 2023 kartëmonedhat më të falsifikuara kanë qenë ato të prerjes prej 50 euro të cilat përbënin rreth 67 përqind të të gjitha kartëmonedhave të falsifikuara të tërhequra nga qarkullimi (Grafiku 72). Ndërsa, në trend me vitin e kaluar, monedha më e falsifikuar ishte ajo në prerje prej 2 euro e cila përbënte rreth 95.2 përqind të gjithë numrit të monedhave të falsifikuara të tërhequra nga qarkullimi (Grafiku 74).


BQK edhe këtë vit vazhdoi të bashkëpunojë me autoritetet në luftën kundër parave të falsifikuara. Ndërlidhur me situatën e krijuar me dukurinë e qarkullimit të monedhave 2 euro të falsifikuara, dhe në kuadër të kompetencave të saj, BQK gjatë muajit nëntor dhe dhjetor 2023 zhvilloi takime dhe aktivitete intesive me institucionet përgjegjëse të zbatimit të ligjit, me qëllim luftën kundër parave të falsifikuara dhe koordinimin ndër-institucional për luftimin e kësaj dukurie.

Grafik 73. Monedhat euro të falsifikuara të konfiskuara në qarkullim (numri i copëve)



Burimi: Agjencia e Kosovës për Forenzikë (2024)

Grafik 74. Monedhat euro të falsifikuara të konfiskuara në qarkullim, sipas denominimeve (numri i copëve)



Burimi: Agjencia e Kosovës për Forenzikë (2024)

Institucionet përgjegjëse u dakorduan për masa specifike të veprimit që parashohin ndërmarrjen e veprimeve parandaluese nga secili institucion sipas fushave të tyre të përgjegjësisë. Përpjekjet e përbashkëta ndër-institucionale nga secili institucion pa përjashtim, rezultuan me luftim të suksesshëm ndaj parasë së falsifikuar.

Në zbatim të këtyre masave, dhe në kuadër të kompetencave të saj, BQK në bashkëpunim me bankat komerciale, në fillim të muajit dhjetor filloi me zbatimin e masave specifike të veprimit si më poshtë:

- Heqja e tarifës për depozitim të monedhave në BQK, efektive prej datës 11 dhjetor 2023;
- Udhëzimi i bankave komerciale që të njëjtën praktikë ta aplikojnë edhe kundrejt klientëve të tyre;
- Sigurimi i furnizimit të ekonomisë përmes bankave komerciale me monedha plotësisht të reja të denominimeve prej 2 dhe 1 euro; dhe
- Ndryshimet rregullative sa i përket rregullimit të transportit ndër-kufitar të monedhave.

Ne aspektin rregullativ, me qëllim të parandalimit të parave të falsifikuara, luftimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, luftimin e informalitetit dhe dukurive të ndërlidhura, në pjesën e dytë të vitit 2023, përmes Rregullores për Operacione me Para të Gatshme ndër të tjera janë iniciuar dhe draftuar masat rregullative si:

- Rregullimi i transportit ndërkufitar të monedhave - Ky rregullim ka si qëllim parandalimin e futjes së parave të falsifikuara në Republikën e Kosovës, përmes të cilit rregullim personat fizikë dhe personat juridikë që nuk ushtrojnë veprimtari financiare, do të jenë të obliguar që të bëjnë deklarin e monedhave nëse bartin më shumë se 100 copë/njësi, pavarësisht që vlera e tyre është nën kufirin e deklaramit prej 10,000 (dhjetëmijë) euro.
- Ndalimi i ri-qarkullimit të kartëmonedhës prej 500 euro - Ky rregullim ka si qëllim reduktimit të rrezikut të parave të falsifikuara dhe do të kontribuojë dhe ndihmojë strategjinë kombëtare për luftimin e informalitetit dhe dukurive të ndërlidhura. Përmes këtij rregullimi ndalohet ri-qarkullimi i kartëmonedhës prej 500 euro nga institucionet financiare. Rregullimi nuk e ndalon qarkullimit e kartëmonedhës prej 500 euro ndërmjet palëve si mjet i ligjshëm i pagesës.
- Rregullimi i transportit ndërkufitar të kartëmonedhave dhe monedhave euro dhe valutave të tjera - Ky rregullim ka si qëllim të ndihmojë në luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit përmes kontrollit të parave të gatshme që hyjnë dhe dalin nga Republika e Kosovës kurse në aspektin statistikor mbledhja e të dhënave për hyrjet dhe daljet e parave të gatshme në Republikën e Kosovës përmes institucioneve financiare për mundësimin e modelimit të vlerësimit të parasë në qarkullim. Përmes këtij rregullimi,

importi dhe eksporti i kartëmonedhave dhe monedhave euro dhe valutave të tjera në Republikën e Kosovës mund të bëhet vetëm për dhe nga institucionet financiare bankare dhe jo-bankare të licencuara nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës për ushtrimin e aktiviteteve financiare bankare.

4. Rregullimi i procedurave dhe detyrimet për ofruesit e shërbimeve të depozitimit apo tërheqjes së parave të gatshme përmes makinerive që përdoren nga klienti - Përmes këtij rregullimi Institucionet financiare jo-bankare që janë të licencuara nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, të cilat ofrojnë llogari të pagesave dhe parave elektronike, duhet të marrin licencën dhe autorizimin shtesë nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës për ofrimin e shërbimit të depozitimit apo tërheqjes së parave të gatshme, apo blerjen dhe rikthimin e parave elektronike përmes makinave që përdoren nga klienti. Asnjë person fizik apo juridik nuk mund të ofrojë shërbime të depozitimit apo të tërheqjes së parave të gatshme përmes ndonjë lokacioni me shërbim fizik apo përmes ndonjë pajisje apo makine që përdoret nga klienti, në emër të ofrimit të shërbimeve financiare pa posedim të licencës dhe autorizimit nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës.
5. Rregullimi i importimit të pajisjeve ose makinave teknike-elektronike që ofrojnë shërbime të tërheqjes dhe depozitimit të parave të gatshme - Përmes këtij rregullimi synohet të rregullohet importimi i pajisjeve ose makinave teknike-elektronike për shërbime të tërheqjes dhe depozitimit të parave të gatshme ku ky aktivitet mund të bëhet vetëm nga institucionet e licencuara financiare për ofrim të aktiviteteve bankare apo institucionet financiare jo-bankare me shërbime të licencuara për para elektronike dhe shërbimet e pagesave. Asnjë person fizik apo juridik nuk mund të importojë dhe pajiset me makina teknike-elektronike për shërbime të tërheqjes dhe depozitimit të parave nëse nuk është i licencuar si institucion financiar për ofrim të aktiviteteve bankare, apo institucion financiar jo-bankar me shërbime të licencuara për para elektronike dhe shërbimet e pagesave.

6.1.1 Mirëmbajtja dhe transaksionet e llogarive të klientëve të BQK-së

BQK ofron shërbime bankare për Qeverinë e Republikës së Kosovës (përkatësisht Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve/Thesarin), Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP), dhe për institucione të tjera siç janë bankat dhe institucionet tjera financiare, subjektet publike, bankat e huaja, bankat qendrore, institucionet financiare ndërkombëtare (FMN, BB), dhe organizatat ndërkombëtare, siç është specifikuar në nenin 9 të ligjit Nr. 03/L-209 të BQK-së.

Tabela 25. Shuma e transaksioneve sipas llojeve kryesore të pagesave (në mijëra euro)

Llojet e transaksioneve	2019	2020	2021	2022	2023
Transaksionet me para të gatshme	+965,364	+354,562	+1,119,117	+1,516,986	+1,861,774
Depozita në para të gatshme	1,697,993	1,449,546	2,087,729	2,500,146	2,735,541
Tërheqje të parave të gatshme	732,629	1,094,984	968,612	983,160	873,767
Transferet vendor	+425,715	+70,305	+30,021	+34,037	+5,532
Transferet vendor ardhës	693,428	110,763	76,421	92,164	95,370
Transferet vendor dales	267,714	40,458	46,400	58,127	89,838
Transferet ndërkombëtar	-954,036	-424,086	-1,068,449	-1,444,209	-1,811,455
Transferet ndërkombëtar ardhës	1,971,668	1,794,963	1,727,337	1,728,325	1,471,546
Transferet ndërkombëtar dales	2,925,705	2,219,049	2,795,786	3,172,534	3,283,000


Burimi: BQK (2024)

BQK ka mbështetur avancimin e proceseve të kryerjes së transaksioneve dhe akordimeve të Ministrisë së Financave, Punës, dhe Transfereve (MFPT) dhe të AKP-së. Edhe gjatë vitit 2023, të gjitha pagesat ndërkombëtare u realizuan përmes rrjetit SWIFT, kurse të gjitha pagesat vendore

u realizuan përmes sistemit Kosovo Interbank Payment System (KIPS) (Sistemi i Pagesave Ndërbankare të Kosovës), duke shkurtuar kështu kohën dhe duke rritur efektivitetin e procesimit.


Përderisa pjesa më e madhe e operacioneve me para të gatshme të BQK-së në vitin 2023 u kryen në emër të/dhe për llogari të bankave komerciale, pjesa më e madhe e pagesave vendore të BQK-së janë kryer në emër të/dhe për llogari të AKP-së.

Grafik 75. Vëllimi i transaksioneve vendore dalëse, numri



Burimi: BQK (2024)


Grafik 76. Vlera e transaksioneve vendore dalëse, në milionë euro



Burimi: BQK (2024)


BQK gjatë vitit 2023 ka procesuar në emër të klientëve të saj afër 7.4 mijë urdhërpagesa dalëse vendore (një rënie prej 34.53 përqind krahasuar me vitin paraprak) (shih Grafikon 75), dhe ka pranuar për llogari të tyre afër 9.37²⁰ mijë urdhërpagesa hyrëse (një rënie prej 2.43 përqind krahasuar me vitin paraprak) (shih Grafikon 77). Shprehur në vlerë, urdhërpagesat dalëse vendore arrinin shumën prej mbi 89.84 milionë euro (një rritje prej 54.55 përqind krahasuar me vitin paraprak) (Grafiku 76), kurse, urdhërpagesat hyrëse vendore arrinin shumën mbi 95.37 milionë euro (një rritje prej 3.48 përqind krahasuar me vitin paraprak) (Grafiku 78). Numri dhe shumata më e madhe e transaksioneve vendore u krye nga BQK me urdhër dhe për AKP-në.

Grafik 77. Vëllimi i transaksioneve vendore hyrëse, numri



Burimi: BQK (2024)

Grafik 78. Vlera e transaksioneve vendore hyrëse, në milionë euro




Burimi: BQK (2024)

Sa i përket pagesave vendore dalëse, ato gjenerohen nga vetë bankat komerciale, kurse, kompanitë e sigurimit numrin më të madh të pagesave të tyre e kryejnë nëpërmes bankave komerciale. Të gjithë llogarimbajtësit e tjerë të BQK-së i shfrytëzojnë shërbimet e pagesave të ofruara nga BQK në mënyrë të kufizuar pasi që të gjithë kanë llogari në banka komerciale.

Numri më i madh i transaksioneve ndërkombëtare u krye nga BQK me urdhër dhe për llogari të Thesarit të shtetit. Në anën tjetër, duke marrë për bazë vlerën e tyre, pjesa më e madhe e transaksioneve ndërkombëtare të kryera nga BQK kishte të bënte me transferet e fondeve të bankave komerciale dhe Trustit Pensional të Kosovës.


²⁰ Shumica e pagesave ardhese me implementimin e sistemit KIPS pranohen nga BQK si të grupuara

Grafik 79. Vëllimi i transaksioneve nderkombëtare dalëse, numri



Burimi: BQK (2024)


Grafik 80. Vlera e transaksioneve nderkombëtare dalëse, shuma



Burimi: BQK (2024)


Gjatë këtij viti, BQK ka procesuar për dhe në emër të klientëve të saj afër 3,303 urdhërpagesa dalëse ndërkombëtare (një rritje prej 34.76 përqind krahasuar me vitin paraprak) (shih Grafikon 79), dhe ka pranuar për llogari të tyre afër 1,764²¹ urdhërpagesa hyrëse ndërkombëtare (një rritje prej 9.77 përqind krahasuar me vitin paraprak) (Grafiku 81). Shprehur në vlerë, urdhërpagesat dalëse ndërkombëtare arrijnë shumën prej mbi 3.28 miliardë euro (një rritje prej 3.48 përqind krahasuar me vitin paraprak) (Grafiku 80), kurse, urdhërpagesat hyrëse ndërkombëtare arrijnë shumën mbi 1.47 miliardë euro (një rritje prej 14.86 përqind krahasuar me vitin paraprak) (Grafiku 82).

Grafik 81. Vëllimi i transaksioneve nderkombëtare hyrëse, numri



Burimi: BQK (2024)

Grafik 82. Vlera e transaksioneve nderkombëtare hyrëse, shuma



Burimi: BQK (2024)

Më 31 dhjetor 2023, depozitat e institucioneve të Qeverisë së Kosovës (Thesarit/MFPT) arritën shumën prej 345.23 milionë euro, ndërsa ato të AKP-së arritën shumën prej 166.37 milionë euro, dhe së bashku përbënin rreth 38.08 përqind të depozitave që u mbajtën në BQK në fund të vitit 2023.

Tabela 26. Niveli i depozitave të klientëve kryesor (në mijëra euro)

Gjendja e llogarive	2019	2020	2021	2022	2023
Gjithsej gjendja	1,187,685	1,214,559	1,275,801	1,288,150	1,343,340
Institucionet Qeveritare	444,301	316,897	423,322	419,664	345,232
Agjencia Kosovare e Privatizimit	275,160	191,457	184,737	165,854	166,373
Bankat Komerciale + Kompanitë e Sigurimeve	419,659	571,114	593,910	575,043	594,657
Të tjera	48,566	135,091	73,832	127,589	237,078

Burimi: BQK (2024)

²¹ Shumica e pagesave ardhese kanë të bëjnë me transferët e fondeve të bankave komerciale

Bankat komerciale dhe kompanitë e sigurimeve kanë një pjesëmarrje të konsiderueshme në nivelin e depozitave në BQK që kryesisht kanë të bëjnë me kërkesat dhe obligimet ligjore dhe rregullatore. Së bashku, këto depozita përbënin 44.27 përqind të depozitave që u mbajtën në BQK në fund të vitit 2023. Më 31 dhjetor 2023, depozitat e bankave komerciale dhe kompanive të sigurimit ishin në shumën prej 594.66 milionë euro (shih Tabelën 26).

6.2. Sistemi i Pagesave

Ofrimi i sistemeve të pagesave të sigurta dhe efikase është një ndër objektivat kryesore të BQK-së. Sistemi i pagesave ndërbankare, i ndërtuar dhe nën administrimin e BQK-së, gjatë vitit 2023 ka siguruar disponueshmëri maksimale duke garantuar procesimin dhe shlyerjen e pagesave për të gjithë akterët ekonomik të vendit.

Në kuadër të përmbushjes së këtij objekti, përveç operimit të sistemit ndërbankar të pagesave, BQK i kushton vëmendje të veçantë edhe rolit mbikëqyrës dhe katalizator të mirëmbajtjes së sigurisë së sistemit dhe zhvillimit të mëtejshëm të tregut të pagesave, duke implementuar në këtë drejtim edhe Strategjinë Kombëtare për Pagesat me Vlerë të Vogël 2021-2026. Sistemet e pagesave gjatë vitit 2023 janë karakterizuar me një dinamikë të zhvillimeve si nga aspektet rregullative ashtu edhe ato operacionale dhe mbikëqyrëse. Gjatë kësaj periudhe janë përmbushur synimet kryesore në përmirësimin e kuadrit rregullativ duke u bazuar në standardet e aplikueshme ndërkombëtare.

Në këtë drejtim, në gusht 2023, BQK ka miratuar rishikimin e Rregullores për Sistemin e Pagesave Ndërbankare, e cila në masë të gjerë përcakton rregullat dhe procedurat për funksionimin e sistemit të Pagesave Ndërbankare. Gjithashtu, është rishikuar Rregullorja për Raportimin e Statistikave të Instrumenteve të Pagesave, dhe është miratuar Rregullorja për Strukturën dhe Përdorimin e Identifikuesit Unik të Llogarisë të Pagesës për transaksionet kombëtare dhe ndërkombëtare.

Gjatë vitit 2023, BQK ka përgatitur edhe Draft-Ligjin për Shërbimet e Pagesave, i cili ka për qëllim transpozimin e direktivave evropiane të rëndësishme për fushën e pagesave. Ky proces zhvillohet edhe në kuadër të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet Kosovës dhe BE-së, si kërkesë për transpozimin e direktivave dhe rregulloreve përkatëse të BE-së që ndërlidhen me lëvizjen e lirë të kapitalit dhe shërbimeve, sipas planit të paraparë me Programin Kombëtar për Integrim Evropian.


Këtë vit, gjithashtu është vazhduar me avancimin e Regjistrimit të Llogarive Bankare për të adaptuar kërkesat e reja që dolën nga procesi me llogaritë bazike dhe si rredhojë e këtij procesi, janë zgjeruar edhe disa nga funksionet e këtij regjistri.

Në përgjithësi, gjatë kësaj periudhe raportuese, sistemi i pagesave ndërbankare ka vazhduar të operojë me nivelin më të lartë të qëndrueshmërisë, sigurisë, dhe efikasitetit, që ka mundësuar kliringun dhe shlyerjen me kohë të të gjitha transaksioneve të pagesave dhe letrave me vlerë.

6.2.1 Operimi i Sistemit të Pagesave Ndërbankare


Sistemi i Pagesave Ndërbankare të Kosovës (KIPS), i cili mundëson procesimin e një sërë instrumentesh të pagesave, kliringun ndërbankar, si dhe shlyerjen e letrave me vlerë, ka vazhduar funksionimin normal dhe pa pengesa. Grafikët në vijim, paraqesin numrin dhe vlerën e transaksioneve të kryera përmes KIPS për periudhat përkatëse.

Grafik 83. Numri i transaksioneve në KIPS



Burimi: BQK (2024)

Grafik 84. Vlera e transaksioneve në KIPS (në mijëra)




Burimi: BQK (2024)

Treguesit statistikor të aktivitetit të KIPS gjatë vitit 2023 kanë reflektuar një rritje të transaksioneve në vëllim për 9.5 përqind dhe në vlerë për 7.4 përqind në krahasim me vitin paraprak, ku janë procesuar mbi 19 milionë transaksione me vlerë totale mbi 21.8 miliardë euro (shih Grafikët 83 dhe 84).


Në kuadër të KIPS realizohen pagesat përmes dy komponentëve: RTGS (Real-Time Gross Settlement) dhe ACH (Automated Clearing House). Në komponentën RTGS realizohen në kohë reale të gjitha pagesat me vlerë mbi 10 mijë euro, si dhe pagesat të urdhëruara me prioritet nga ana e klientëve. Ndërsa, në komponentin ACH realizohen të gjitha pagesat me vlerë nën 10 mijë euro ku përfshihen pagesat e rregullta-normale, pagesat masive, pagat dhe pensionet, pagesat Kos-Giro, dhe Debitimi Direkt. Krahasimi i vëllimit dhe vlerës së këtyre kategorive të pagesave për vitet e caktuara, është paraqitur në grafikët në vijim.

Grafik 85. Vëllimi vjetor i transaksioneve të KIPS-it sipas llojeve të tyre



Burimi: BQK (2024)

Grafik 86. Vlera vjetore e transaksioneve të KIPS-it sipas llojeve të tyre (në mijëra)




Burimi: BQK (2024)

Këtë vit, pagesat e rregullta (normale dhe masive) përbënin rreth 46.3 përqind të vëllimit dhe 18.5 përqind të vlerës së transaksioneve të KIPS (shih Grafikun 85). Transaksionet RTGS procedohen dhe shlyhen gjatë orarit të punës në kohë reale dhe në baza bruto. Gjatë vitit 2023, numri i tyre përbënte rreth 3.3 përqind të numrit të përgjithshëm të transaksioneve në KIPS (shih Grafikun 85), ndërsa, vlera e tyre rreth 44.2 përqind të vlerës së transaksioneve përmes KIPS (shih Grafikun 86).


Në kategorinë e pagesave për paga/pensione kemi një rritje, si në numër ashtu edhe në vlerë të transaksioneve. Në krahasim me vitin paraprak rritja në numër është 9.3 përqind, ndërsa në vlerë të transaksioneve 12.1 përqind. Krahas rritjes në vëllim dhe në vlerë të transaksioneve në krahasim me vitin paraprak, vërehet gjithashtu një rritje e mesatares ditore të transaksioneve të procesuara, si në vëllim ashtu edhe në vlerë, prej 9.5 përqind respektivisht 7.4 përqind (shih Grafikët 87 dhe 88).

Grafik 87. Mesatarja ditore e numrit të transaksioneve në KIPS



Burimi: BQK (2024)


Grafik 88. Mesatarja ditore e vlerës së transaksioneve në KIPS



Burimi: BQK (2024)


Gjatë vitit 2023, pasqyrimi i pagesave të procesuara përmes komponentës ACH, sipas sesioneve, tregon një përqendrim më të theksuar në sesionin e parë dhe të dytë të kliringut, krahasuar me sesionin e fundit. Shmangia e mbingarkesave në flukset e pagesave përgjatë sesionit të fundit të kliringut minimizon rreziqet shtesë në kuadër të funksionimit të sistemit të pagesave, prandaj, aplikohen tarifa më të ulëta për transaksionet e procesuara në dy sesionet e para (shih Grafikët 89 dhe 90).

Grafik 89. Numri i transaksioneve sipas sesioneve në KIPS



Burimi: BQK (2024)

Figura 90. Vlera e transaksioneve sipas sesioneve në KIPS



Burimi: BQK (2024)

Vlera e përgjithshme e transaksioneve të shlyera në KIPS gjatë vitit 2023 ka qenë afër 21.8 miliardë euro, ku përfshihen transaksionet e të gjithë pjesëmarrësve, përfshirë Thesarin. Nga vëllimi dhe vlera e transaksioneve të iniciuara nga të gjitha institucionet pjesëmarrëse në sistem, tre pjesëmarrësit me numrin më të madh të transfereve të iniciuara zënë 63.6 përqind të vëllimit të përgjithshëm, ndërsa të gjithë pjesëmarrësit tjerë zënë 36.4 përqind. Ndërsa, sa i përket vlerës të transfereve të iniciuara nga të gjitha institucionet pjesëmarrëse, nga vlera e përgjithshme e tyre prej 21.8 miliard transaksione, tri institucionet e para pjesëmarrëse në sistem me vlerën më të madhe të transfereve të iniciuara zënë 42.2 përqind të vlerës të përgjithshëm, ndërsa, të gjitha institucionet tjera zënë 58.8 përqind (shih Tabelën 27).

Tabela 27. Treguesit e përqendrimit për transaksionet e iniciuara/dërguara në KIPS, viti 2023

Sistemi KIPS	Vëllimi	Vlera
3 pjesëmarrës në sistem	63.6%	42.2%
pjesëmarrësit e tjerë	36.4%	58.8%
Gjithsej	19,112,699	21,833,903,859

Burimi: BQK (2024)

Raporti i vlerës së Huasë brenda-ditore për likuiditet ndaj vlerës totale të aktivitetit të sistemit RTGS për vitin 2023 rezulton rreth 4.2 përqind (shih Grafikon 91), duke reflektuar një peshë të ulët të nevojës së financimit të aktivitetit të këtij sistemi me likuiditet nga BQK, rrjedhimisht, të ekspozimit të sistemit ndaj rrezikut të likuiditetit.

6.2.2. Regjistri i Llogarive Bankare

Në kuadër të funksioneve operacionale të BQK-së, rol të rëndësishëm zë edhe Regjistri i Llogarive Bankare. Ky regjistër përfaqëson një infrastrukturë të bazës së të dhënave, e cila mundëson raportimin e të dhënave për llogaritë bankare nga ofruesit e të dhënave të llogarive (bankat komerciale), si dhe shfrytëzimin e këtyre të dhënave në funksion të zbatimit të vendimeve përmbarimore nga organet e përmbarimit dhe institucionet tjera kompetente sipas dispozitave të Ligjit për Procedurën Përmbarimore. Ky regjistër ka pasur ndikim të rëndësishëm në rritjen e efikasitetit në procedimin e lëndëve përmbarimore nga organet e procedurës përmbarimore, sidomos pas zgjerimit të funksioneve për mundësimin e procedimit elektronik të vendimeve përmbarimore.

Në regjistër gjatë vitit raportues 2023 kanë pasur qasje 47 përmbarues privatë, 117 zyrtarë nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, si dhe 13 zyrtarë nga Administrata Tatimore e Kosovës, përmes të cilit kanë shkëmbyer me bankat komerciale 23,159 raste të procedurës përmbarimore, prej të cilave 18,023 janë mbyllur (shih Tabelën 28).

Tabela 28. Rastet e procesuara në Regjistrin e Llogarive Bankare

Statusi i rasteve	2022	2023	Në ngritje/Në rënje (%)
Të hapura	22,066	23,159	4.95%
Të mbyllura	16,678	18,023	8.06%

Burimi: BQK (2024)


6.2.3 Mbikëqyrja dhe analizat e sistemeve të pagesave

Mbikëqyrja e sistemeve të pagesave dhe shlyerjeve është një funksion i BQK-së, ku objektivat e sigurisë dhe efikasitetit promovohen duke monitoruar sistemet ekzistuese dhe të planifikuara, duke i vlerësuar ato kundrejt objektivave dhe sipas nevojës duke nxitur ndryshime.

Në funksion të mbikëqyrjes dhe zhvillimit të analizave të sistemeve të pagesave, gjatë vitit 2023 BQK ka vazhduar monitorimin e sistemit të pagesave përmes raportimeve periodike të pranuar nga bankat komerciale dhe IFJB-të që kryejnë shërbime të pagesave dhe parasë elektronike. Këtë vit është rishikuar Rregullorja për Raportimin e Statistikave të Instrumenteve të Pagesave me qëllim ngritjen e kualitetit të të dhënave statistikore në kuadër të analizave të sistemit të pagesave si mbështetje për vendimmarrje strategjike.

Gjithashtu, këtë vit është rishikuar analiza vjetore mbi përdorimin e kartelave në Kosovë, e cila përveç informacioneve që kanë të bëjnë me shpërndarjen socio-demografike të kartelave të cilat përdoren nga qytetarët e Kosovës dhe faktorëve relevantë të cilët kanë ndikuar në shpërndarjen e tillë, përfshin edhe informacionet lidhur me llojet e kartelave, përdorimin e kartelave në terminale

Grafik 91. Raporti i kredisë brenda ditore ndaj totalit së vlerës së shlyer në RTGS



Burimi: BQK (2024)


të ndryshme, përfshirë ato online. Analiza vjetore mbi përdorimin e kartelave në Kosovë publikohet në baza të rregullta vjetore në faqen zyrtare të internetit të BQK-së.

Në kuadër të përgatitjes së analizave dhe raporteve periodike për statistikën e pagesave janë përgatitur dhe publikuar raportet e rregullta vjetore dhe mujore lidhur me numrin dhe vlerën e pagesave të sistemit të pagesave ndërbankare, mbi depozitat e bankave komerciale dhe rezervat, mbi instrumentet me para të gatshme dhe jo me para të gatshme, si dhe raporti krahasues mbi instrumentet e pagesave elektronike (Kosova në krahasim me vendet e Evropës Qendrore dhe Juglindore) të cilat gjithashtu publikohen në faqen zyrtare të internetit.

6.2.4 Instrumentet e pagesave dhe infrastruktura bankare për shërbime të pagesave


Raportimet e bankave për instrumente të pagesave tregojnë se deri në fund të dhjetorit të vitit 2023 numri i kartelave të debitit arriti mbi 1.4 milionë, ndërsa, numri i kartelave të kreditit arriti në rreth 180 mijë. Krahasuar me një vit më parë, numri i kartelave të debitit është rritur për 10.6 përqind, ndërsa, te numri i kartelave të kreditit është vërejtur një rënie prej 0.9 përqind (shih Grafikët 92 dhe 93).

Grafik 92. Numri i kartelave të debitit sipas llojit



Burimi: BQK (2024)


Grafik 93. Numri i kartelave të kreditit sipas llojit



Burimi: BQK (2024)


Infrastruktura e terminaleve ka vazhduar të zgjerohet, ku evidentohet rritje e numrit të bankomatëve/ATM gjatë këtij viti në krahasim me vitin paraprak (shih Grafikun 94). Rritje e lehtë është shënuar edhe në numrin e terminaleve në pikat e shitjes/POS (shih Grafikun 95).

Grafik 94. Numri i terminaleve ATM



Burimi: BQK (2024)

Grafik 95. Numri i terminaleve POS




Burimi: BQK (2024)

Krahas rritjes së numrit të terminaleve dhe instrumenteve të pagesave, në vitin 2023, nga të dhënat statistikore vërehet se ka pasur rritje të përdorimit të instrumenteve të pagesave elektronike. Numri i pagesave të kryera përmes shërbimit të internetit/e-banking arriti në mbi 9.7 milionë transaksione, që krahasuar me vitin paraprak paraqet rritje për 17 përqind, me një vlerë që arriti në mbi 21.4 miliardë euro apo një rritje vjetore prej 13 përqind (shih Grafikët 96 dhe 97).

Viti 2023 u karakterizua me një trend në rritje të përdorimit të pagesave me kartelë. Numri i pagesave në pikat e shitjeve/POS është rritur për 33.7 përqind, ndërsa në vlerë është evidentuar rritje krahasuar me vitin paraprak për 37.6 përqind. Tërheqjet në bankomate/ATM gjithashtu tregojnë rritje në numër dhe vlerë krahasuar me vitin paraprak, me numrin e tërheqjeve në bankomate/ATM që është rritur për 7.6 përqind, ndërsa në vlerë për 12.4 përqind (shih Grafikët 96 dhe 97).


Këshilli Kombëtar i Pagesave, i ri-funksionalizuar ka adresuar nevojat kryesore për zhvillim dhe avancim të infrastrukturës, në bashkërendim me institucionet përkatëse për rritje të qasjes në financa dhe përfshirjes financiare, me qëllim reduktim të parasë së gatshme me efekte pozitive.

Grafik 96. Vëllimi vjetor i transaksioneve të instrumenteve elektronike të pagesave



Burimi: BQK (2024)

Grafik 97. Vlera vjetore e transaksioneve të instrumenteve elektronike të pagesave




Burimi: BQK (2024)

Nga raportimet e bankave rezulton se në fund të vitit 2023, numri i përgjithshëm i llogarive bankare të klientëve arriti rreth 2.51 milionë, që paraqet një rritje prej 5.9 përqind krahasuar me fundin e vitit 2022. Rreth 98.5 përqind e llogarive janë të rezidentëve, ndërsa rreth 1.5 përqind të jorezidentëve (shih Tabelën 29).

Rritja e pagesave elektronike përgjatë viteve reflektohet edhe në mënyrën e realizimit të transfereve të kreditit. Transferet në formë letër vazhdimisht janë në rënie kundrejt atyre në formë elektronike.

Gjatë vitit 2023, transferet e iniciuara në formë letre përbënin 15 përqind, ndërsa ato në formë elektronike përbënin 85 përqind të gjithëj transfereve të iniciuara nëpërmjet bankave (shih Grafikon 98).

Grafik 98. Numri i transfereve të kreditit në formë elektronike në raport me transferet në formë letër



Burimi: BQK (2024)

Tabela 29. Numri i llogarive

Përshkrimi i llogarisë	Totali i llogarive të klientëve			Të aksesueshme nga interneti		
	2021	2022	2023	2021	2022	2023
Llogaritë e klientëve (1+2)	2,384,742	2,371,544	2,512,575	537,733	688,891	851,645
1-Llogari të rezidentëve (a+b)(%)	98.57%	98.50%	98.53%	98.50%	98.29%	98.21%
a-Indivuale (%)	92.97%	91.73%	91.10%	87.98%	89.54%	90.31%
b-afariste (%)	7.03%	8.27%	7.43%	12.02%	10.46%	9.69%
2-Llogari të jorezidentëve (c+d) (%)	1.41%	1.50%	1.45%	1.50%	1.71%	1.79%
c-Indivuale (%)	98.99%	98.95%	99.20%	97.83%	91.55%	84.80%
d-afariste (%)	1.01%	1.05%	0.80%	2.17%	8.45%	15.20%

Burimi: BQK (2024)


Shënim: BQK, Raportimet e bankave sipas "Rregullores për raportimin e statistikave të instrumenteve.

Nga totali i llogarive, në fund të vitit 2023, mbi 851 mijë llogari kishin qasje “online” nga interneti, që është një rritje prej 23 përqind e qasjes në llogari nga distanca.

Grafiku 99 tregon pjesëmarrjen e llogarive me qasje në internet, në numrin e përgjithshëm të llogarive rrjedhëse gjatë pesë viteve të fundit. Bazuar në të dhënat statistikore, zhvillimi i infrastrukturës ka vazhduar trendin rritës dhe inkurajues mbetet edhe trendi i shpejtë i rritjes së përdorimit të instrumenteve të pagesave elektronike.

IFJB-të të regjistruara për emetimin e parasë elektronike, në fund të vitit 2023 kanë raportuar 45,310 llogari të parasë elektronike, duke shënuar një rritje të shpejtë bazuar në faktin se ky është vetëm viti i katërt i operimit të tyre në treg (shih Tabelën 30). Këto institucione së bashku kanë kryer një volum prej 1,6 milion pagesa me para elektronike, me një vlerë prej rreth 617 milionë euro (Tabela 31).

Grafik 99. Numri i llogarive me qasje në internet në raport me numrin e përgjithshëm të llogarive rrjedhëse



Burimi: BQK (2024)

Tabela 30. Numri i llogarive të parasë elektronike

Përshkrimi i llogarisë	2021	2022	2023
Llogaritë e parave elektronike (E-money accounts)	11,543	25,164	45,310

Burimi: BQK (2024)

Tabela 31. Numri dhe vlera pagesave të parave elektronike

Përshkrimi	2021	2022	2023
Numri	52,779	293,097	1,620,139
Vlera	29,170,803	70,005,357	617,969,808

Burimi: BQK (2024)

Nxitja e përdorimit të instrumenteve të parasë elektronike vlerësohet me ndikim edhe në zgjerimin e përfshirjes financiare të qytetarëve duke mundësuar qasjen në shërbimet e pagesave (hapjen e një llogarie paraje elektronike/llogarie pagese, dhe zotërimin e një karteje me parapagim) nga kategori të popullsisë pa qasje në shërbime bankare, si për kategoritë që nuk janë të punësuar. Realizimi i transaksioneve elektronike konsiderohet edhe si dritarja kryesore që mund t’u lehtësojë edhe qasjen në kredi dhe shërbime tjera financiare.

6.2.5. Roli i BQK-së si katalizator i sistemit të pagesave

Në kuadër të rolit të saj si katalizator i sistemit të pagesave, BQK ka vijuar reformat për modernizimin dhe zgjerimin e tregut të pagesave dhe ka ndërmarrë disa aktivitete sa i përket zhvillimit dhe reformimit të mëtejshëm të infrastrukturës dhe shërbimeve të pagesave. Në këtë drejtim, nga 1 gushti 2023, ka hyrë në fuqi pjesa e Rregullores për Qasjen në Llogari Pagese me Shërbime Bazike që ka për qëllim t’u mundësojë të gjithë qytetarëve të marrin përfitimet që sjellë tregu financiar, të kontribuojë në rritjen e përfshirjes financiare, si dhe të nxitë pjesëmarrjen e të gjithë qytetarëve në sektorin financiar. Rregullorja u mundëson të gjithë qytetarëve të Kosovës, pa marrë parasysh rrethanat financiare të tyre, statusin e punësimit apo nivelin e të ardhurave,

që të mund të kenë qasje në llogari pagese me shërbime bazike me kosto më të ulët. Kurse, pjesa e kësaj rregulloreje që adreson grupin e konsumatorëve të kategorive të cenueshme (përfutuesit e ndihmave sociale, pensioneve), të cilët mund të marrin këto shërbime pa kosto, ka hyrë në fuqi nga 1 janari 2024.

Bazuar në të dhënat e disponueshme për llogari pagese me shërbime bazike, në fund të vitit 2023 dhe fillimin e vitit 2024 janë konvertuar 320 mijë llogari për kategoritë e qytetarëve të cenueshëm, sipas përcaktimeve të Rregullores së BQK-së për Qasjen në Llogari Pagese me Shërbime Bazike.

Vendimi i BQK-së që të kalojë nga llogaria bankare në konceptin e llogarisë së pagesave është një hap drejt përmbushjes së objektivave të saj strategjike, që të rrisë qasjen në financa dhe konkurrueshmërinë e sistemit financiar. Llogaria e pagesave mund të ofrohet edhe nga IFJB-të, që me ndryshimet e reja rregullative do të kenë IBAN të dedikuar, dhe të gjithë qytetarët do të mund të pranojnë pagesa.

Gjithashtu, Rregullorja për Strukturën dhe Përdorimin e Identifikuesit Unik të llogarisë të pagesës për transaksionet kombëtare dhe ndërkombëtare, e rregulluar në pajtim me standardet e BE-së, adreson kërkesat nga institucionet e pagesave dhe institucionet e parave elektronike jo banka, që të pajisen me kodin e identifikimit në standardin e llogarive IBAN, në pajtim me kriteret për aplikim në zonën unike të pagesave SEPA (Single Euro Payment Area; shqip: Zona Unike e Pagesave në Euro).

Në zbatim të Strategjisë Kombëtare për Pagesat me Vlerë të Vogël (2021-2026), BQK në kuadër të programit Remittances and Payments Program (RPP) (shqip: Programi për Pagesa dhe Remitenca) ka finalizuar draftimin e Ligjit për shërbimet e pagesave, përmes të cilit do të transpozohen në legjislacionin vendor tri direktivat e BE-së të rëndësishme për shërbimet e pagesave: (i) Direktiva për Shërbimet e Pagesave (e njohur si PSD2), (ii) Direktiva për Llogaritë e Pagesave (e njohur si PAD), dhe (iii) Direktiva për Institucionet e Parave Elektronike (e njohur si EMD2).

Adaptimi i këtyre direktivave në tregun vendor vlerësohet se do të kontribuojë në nxitjen e konkurrencës në tregun e shërbimeve të pagesave, në rritjen e transparencës dhe sigurisë në shërbimet e ofruara nga tregu, dhe në krijimin e një kuadri të konsoliduar për mbrojtjen e konsumatorit. Përafrimi i praktikave të rregullimit të tregut të shërbimeve të pagesave me ato evropiane përbën edhe një hap themelor dhe substancial drejt integritit dhe zbatimit të rekomandimeve që derivojnë në kuadër të lëvizjes së lirë të kapitalit dhe shërbimeve për anëtarësimin në SEPA, si objektiv i deklaruar i BQK-së për Republikën e Kosovës.

6.2.6. Bashkëpunimi me institucione tjera vendore dhe ndërkombëtare

Këtë vit, në kuadër të bashkëpunimit në Projektin për Modernizimin e Sistemeve të Pagesave të Vendeve të Ballkanit Perëndimor, nën udhëheqjen e Këshillit për Bashkëpunim Rajonal (Anglisht: Regional Cooperation Council (RCC), ekipi i BB ka qenë shumë i dobishëm në mbështetje të BQK-së. Së pari ka vlerësuar qëndrueshmërinë e programit të sigurisë kibernetike përmes mbledhjes së informacionit dhe intervistave me personelin kryesor në BQK mbi politikën dhe procedurat përkatëse. Të dhënat do të informojnë një raport gjithëpërfshirës mbi programin për sigurinë kibernetike, dhe si ai krahasohet me praktikën më të mira të përshkruara nga kornizat e njohura nga industria dhe me gjetjet/rekomandimet për veprime të bazuara në boshllëqet/dobësitë e identifikuar. Së dyti, ekipi i BB ka vazhduar punën e tij në mbështetjen e BQK-së drejt përgatitjes së parakusheve të anëtarësimit në SEPA përmes asistencës në përafrim të legjislacionit në lidhje me pagesat me Acquis të BE-së. Ky ekip ka vazhduar mbështetjen edhe në finalizimin e Ligjit të ri për Shërbimet e Pagesave, statusin e kornizës AML/CFT, dhe zhvillimeve tjera relevante të vazhdueshme ose të planifikuara brenda sistemit të pagesave.

Bashkëpunimi dhe mbështetja ka vazhduar edhe në përcaktimin e specifikimeve teknike për kodet kombëtare QR, të cilat mund të përdoren për të mbështetur metoda të ndryshme themelore të

pagesës, duke përfshirë pagesat e shpejta (instant payments). Në përmbushje të rolit të saj si katalizator, BQK ka mbështetur dhe ka organizuar edhe një sërë takimesh dhe konsultimesh me aktorë kryesor të brendshëm dhe të jashtëm të përfshirë në industrinë e pagesave.

Në nivel vendor, një hapësirë e veçantë iu kushtua gjithashtu rolit të edukimit financiar në nxitjen e përfshirjes financiare si dhe përgatitjeve për rithemelimin dhe zgjerimin e funksioneve të Këshillit Kombëtar të Pagesave.

6.3. Menaxhimi i Mjeteve

BQK realizon menaxhimin e mjeteve dhe rezervave si dhe operimin e Sistemit Qendror Depozitar (CSD) për tregtimin e Letrave me Vlerë të emetuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës. Detyrat e menaxhimit të rezervave janë specifikuar në Ligjin për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, respektivisht në Nenin 15 të Ligjit Nr. 03/L-209.

6.3.1. Menaxhimi i Investimeve

BQK menaxhon rezervat e saj për të arritur objektivat e Politikës së Investimeve, ku prioritet janë siguria dhe likuiditeti i mjeteve para kthimit nga investimet.

Instrumentet

Rezervat në portfolion e BQK-së përbëhen nga instrumentet e portfoliot të cilat klasifikohen si likuide dhe me gradë investuese. Kategoria e rezervave likuide përbëhet prej instrumenteve që mirëmbahen për të siguruar mjete të mjaftueshme për realizimin e pagesave dhe transfereve sipas nevojave të BQK-së dhe depozitorëve të saj. Ndërsa, kategoria e mjeteve investuese përbëhet nga instrumentet financiare të sigurta, me vlerësim kreditor investiv që gjithashtu janë lehtësisht të tregtueshme.


Për të siguruar mjaftueshmëri të fondeve likuide për realizimin e transfereve ndërkombëtare të depozitorëve të BQK-së, mjetet në llogarinë rrjedhëse mirëmbahen për të realizuar obligimet afatshkurtëra të BQK-së të cilat në fund të vitit 2023 arritën nivelin prej 31.9 përqind të total portfolios.

Portfolio e rezervave të BQK-së në euro sipas instrumenteve është pasqyruar në Grafikon 100 me gjendjen e 31 dhjetor 2023, ku evidentohet se 39.8 përqind e portfolios është e investuar në letra me vlerë ndërkombëtare, dhe 13.3 përqind në Letrat me Vlerë të emetuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës. Plasimi në depozita bankare participon me 15 përqind.

Portfolion investuese të rezervës së BQK-së në të gjitha valutat e përbëjnë këto instrumente financiare:

- Depozitat bankare me afat, të plasuar në bankat evropiane me rangim adekuat investues dhe në marrëveshjet afatshkurtëra të riblerjes të plasuar me bankat vendore dhe Rezervën Federale të ShBA-së;

Grafik 100. Portfolio e rezervave (EUR) të BQK-së, sipas gjendjes 31 dhjetor 2023



- Letrat me Vlerë Ndërkombëtare, respektivisht obligacione qeveritare, supranacionale, të agjencive shtetërore apo institucioneve kreditore në euro dhe dollarë amerikan me afat deri në shtatë vite;
- Obligacionet shtetërore të emetuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës, të tregtuara në tregun sekondar të letrave me vlerë me afat maturimi deri në shtatë vite.

Marrëveshjet afatshkurtëra të riblerjes (REPO) me bankat vendore të Republikës së Kosovës kanë vazhduar të plasohen edhe përgjatë vitit 2023, duke qenë një instrument i rëndësishëm i tregut vendor të parasë. Përmes këtij instrumenti, në rast nevoje, BQK u ofron likuiditet të shpejtë bankave vendore për periudhë prej një deri në dhjetë ditë kundrejt kolateralit, respektivisht, Letrave me Vlerë të Republikës së Kosovës. Ky instrument, që trajton obligacionet qeveritare si instrumente më likuide duke u ofruar mbajtësve të tyre qasje të lehtë në financim përmes kolateralit të ofruar.


Gjatë vitit 2023, BQK ka vazhduar të jetë pjesë e linjës kreditore të ofruar nga Banka Qendore Evropiane, Asistenca Emergjente për Likuiditet (Anglisht: Emergency Liquidity Assistance - ELA) përmes Deutsche Bundesbank (në emër të Eurosistemit) që do të qëndrojë në fuqi deri në datën 31 janar 2025. Përmes kësaj linje kreditore, BQE i ka ofruar mundësinë BQK-së të marrë hua nga pakoja e likuiditetit të Eurosistemit kundrejt kolateralit adekuat në euro, të përbërë nga letra me vlerë të tregtueshme të borxhit të emetuara nga qeveritë qendrore të Eurozonës dhe institucionet supranacionale. Kjo linjë kreditore adreson nevojat e mundshme të likuiditetit në euro të BQK-së në rast të kërkesave eventuale, duke i mundësuar hua nga Banka Qendore Evropiane deri në 100 milionë euro.

Valutat

Përbërja valutore e portfolios së rezervave të BQK-së konsiston në euro dhe dollar amerikanë (USD). Në vitin 2023, euro rezervat në dispozicion në portfolion e BQK-së kanë arritur në 1,332 milionë euro nga vlera prej 951 milionë euro sa ishte në vitin paraprak (shih Grafikon 101), kryesisht për shkak të lëvizjeve të fondeve të depozitorëve të BQK-së.


Rreth 1 përqind e portfolios së rezervave mbahet në USD, të investuara në plasmane një-ditore me normë interesi të kuotuar nga marrëveshjet e riblerjes me Bankën e Rezervës Federale të ShBA-ve (Anglisht: US Federal Reserve -FED), dhe letra me vlerë afatshkurtëra të emetuara dhe paguara nga Thesari Amerikan me afat maturimi deri në një vit, kjo në kuadër të Programit Automatik të Investimeve (Anglisht: Automatic Investment Programme) me FED. Në vitin 2023 nuk ka ndryshim të konsiderueshëm në nivelin e rezervave në USD, por ka rritje të lehtë nga 10.47 milionë në vitin

Grafik 101. Saldo përfundimtare e mjeteve të investuara në EUR (mil) sipas gjendjes së tyre me 31 dhjetor të viteve përkatëse



Burimi: BQK (2024)

Grafik 102. Saldo përfundimtare e mjeteve të investuara në USD (mil) sipas gjendjes së tyre me 31 dhjetor të viteve përkatëse



Burimi: BQK (2024)

2022 në 10.98 milionë në vitin 2023 (shih Grafikon 102), që i atribuohet akumulimit të interesave nga instrumentet e investuara.

Shpërndarja e asetëve në dy valutat përkatëse bëhet në bazë të përmbajtjes së rezervave të BQK-së nga depozitorët e saj, që kryesisht vijnë dhe mbahen në valutën euro.

Shpërndarja

Në përputhje me objektivat e Politikës së Investimeve të BQK-së, plasmani i investimeve të rezervave është përqendruar në instrumentet financiare të sigurta dhe likuide, respektivisht në instrumente borxhi apo obligacione me maturitet maksimal deri në shtatë vite dhe rangim kreditor adekuat.


Gjatë vitit 2023, shpërndarja e portfolios është realizuar me fokus në kategorinë e asetëve likuide, lehtësisht të konvertueshme dhe me treg të zhvilluar të letrave me vlerë sikurse janë bonot e thesarit dhe obligacionet. Rrjedhimisht, 39.8 përqind e portfolios ishte e investuar në Letra me Vlerë Ndërkombëtare, si

instrumentet kryesore likuide me pjesëmarrjen më të lartë në portfolion e BQK-së, ndërsa, 13.3 përqind e përbënin Letrat me Vlerë Kombëtare (shih Grafikon 103). Në portfolion e letrave me vlerë, rëndësi e veçantë i kushtohet shpërndarjes gjeografike dhe shpërndarjes sipas emetuesve, dhe kushtit që këto letra të njihen si kolateral i pranueshëm nga BQE. Edhe në vitin 2023, shpërndarja e portfolios së letrave me vlerë është realizuar nga kushtet e tregut dhe çmimet për obligacionet qeveritare, supranacionale, dhe agjencive dhe institucioneve kreditore të emetuara dhe paguara në euro.

Ngritja e vazhdueshme e normave të interesit gjatë këtij viti nga BQE dhe FED ka ndikuar normat e tregut ndërbankar dhe tregut të borxheve, të cilat kanë mundësuar pozicionimin në portfolion në instrumente me kthime sipas normave të tregut të Eurosistemit dhe FED-it. Norma depozitare në tregun ndërbankar në euro bazohet në normën për depozita të vendosur nga BQE, e cila gjatë vitit 2023 ka variuar nga 2.50 përqind sa ishte në shkurt deri në rritjen e fundit në 4 përqind në shtator 2023²².


Shpërndarja në Letra me Vlerë Ndërkombëtare këtë vit ka shënuar rritje krahasuar me vitin paraprak (shih Grafikon 104). Ndryshimi kryesor në strukturën e shpërndarjes së portfolios paraqitet tek depozitat bankare që si kategori asetesh ka shënuar rritje të konsiderueshme krahasuar me tri vitet paraprake si rezultat i rritjes së normës depozitare nga BQE dhe mundësie për plasmane në tregun ndërbankar të bankave qendrore dhe komerciale të Eurosistemit. Kjo

Grafik 103. Raporti i shpërndarjes së portfolios investuese në EUR të BQK-së (në përqindje)



Burimi: BQK (2024)

Grafik 104. Shpërndarja e portfolios investuese në çdo fundvit (në milionë euro)



Burimi: BQK (2024)

²² https://www.ecb.europa.eu/stats/policy_and_exchange_rates/key_ecb_interest_rates/html/index.en.html

shpërndarje i mundëson BQK-së të mbajë likuiditet të mjaftueshëm në portfolion e saj të rezervave, duke kontribuar në ruajtjen e sigurisë së portfolios të kësaj kategorie të asetëve dhe realizimit të kthimit nga investimi.

6.3.2. Performanca e portofolit

Gjatë vitit 2023, instrumentet në portfolion e BQK-së kanë treguar performancë të lartë me realizim 25.59 milionë euro të ardhurat neto në të gjitha kategoritë e asetëve të portfolios, përfshirë diferencën në mes të hyrave dhe shpenzimeve nga normat e aplikuar ndaj llogarive depozitare.

6.3.3. Menaxhimi i Rrezikut

Investimi i mjeteve të BQK-së bëhet në letrat me vlerë të emetuara nga shtetet stabile dhe të zhvilluara, agjencitë më kredibile të Eurozonës, dhe institucionet supranacionale me vlerësim të lartë kreditor investiv nga agjencitë kreditore ndërkombëtare si Standard&Poor's, Moody's, Fitch si dhe në letrat me vlerë të Republikës së Kosovës.

Rreziqet financiare gjatë investimit të mjeteve nga ana e BQK-së janë: rreziku kreditor, rreziku i normës së interesit, rreziku likuiditetit, rreziku valutor, dhe rreziku operacional.

Rreziku kreditor menaxhohet kur portfolio e investimeve është e shpërndarë në mënyrë të atillë që të mbahet rreziku kreditor në nivel të ulët. Të gjitha investimet janë realizuar në raport me kriteret e rangimit afatshkurtër dhe afatgjatë kreditor të përcaktuar në Politikën e Investimeve P-2/A-2 (Moody's/S&P) për afat të shkurtër dhe Baa2/BBB (Moody's/S&P) për afat të gjatë, si dhe në rastet e jashtëzakonshme në treg, me P-3/A-3 për afat të shkurtër dhe Baa3/BBB (Moody's/S&P) për afat të gjatë.

Rreziku i normës së interesit ulet kur menaxhimi i rrezikut të normave të interesit nga BQK kundrejt limitit të ndryshimit të normave të interesit plotësohet duke monitoruar ndjeshmërinë e mjeteve dhe detyrimeve të BQK-së ndaj skenarëve të ndryshëm standard dhe jostandard të normave të interesit.

Rreziku i likuiditetit është rreziku në përmbushjen në kohë të duhur të obligimeve nga detyrimet e saj financiare. Qëndrimi i BQK-së në menaxhimin e likuiditetit është të sigurojë likuiditet të mjaftueshëm për të përmbushur me kohë detyrimet, si në kushte normale ashtu edhe në ato të pafavorshme, pa pësuar humbje të papranueshme apo rrezikuar dëmtimin e reputacionit të BQK-së.

Rreziku valutor paraqitet si pasojë e lëvizjeve të kursit këmbimor që implikojnë vlerën e valutave në tregun financiar, ku mund të paraqitet kthimi apo humbja si rezultat i ndryshimeve të kursit këmbimor.

Rreziku operacional është rreziku i përmbushjes që ka të bëjë me plasmanin e depozitave, tregtimin e letrave me vlerë dhe pagesën me kohë të tyre.


6.3.4. Letrat me Vlerë të Qeverisë së Kosovës

Në pajtim me Ligjin për Borxhet Publike, BQK-ja vepron si agjent fiskal për MFPT-në/Thesarin në procesin e emetimit të Letrave me Vlerë të Qeverisë.

Sipas kalendarit vjetor të emetimit të Letrave me Vlerë të publikuar nga Thesari i Kosovës në kuadër të MFPT-së, gjatë vitit 2023 janë realizuar gjithsej 11 ankande për emetimin e Letrave me Vlerë të Qeverisë me afat maturimi nga një deri në shtatë vite. Gjashtë ankande janë realizuar me sukses, ndërsa, pesë ankande janë anuluar me kërkesë të Thesarit/MFPT bazuar në nenin 6,

paragrafi 3.4. të Rregullores MF-BQK Nr.01/2014 për Tregun Primar dhe Sekondar të Letrave me Vlerë të Qeverisë.

Grafik 105. Struktura e Letrave me Vlerë sipas afatit të maturimit




Grafiku 105 paraqet strukturën sipas maturimit të Letrave me Vlerë të Qeverisë në vitin 2023, të emtuara në tregun primar, ku dominojnë pjesmarrjen emetimet me afat maturimi 3 vjeçar me 50.0%, ndërsa, bankat komerciale janë investitori më i madh në Letrat me Vlerë të Qeverisë me 61.83 përqind, pasuar nga fondet pensionale me 32.66 përqind (shih Grafikon106).²³

Normat mesatare vjetore të kthimit në investim sipas maturitetit në vitin 2023 kanë shënuar rritje krahasuar me vitin paraprak (shih Grafikon 107), ndërsa, kërkesa më e madhe nga tregu ishte për Letra me Vlerë të Qeverisë me afat maturimi nga 2 deri 5 vite (shih Grafikon 108).


Gjithsej vëllimi i shitblerjeve²⁴ të Letrave me Vlerë të Qeverisë ndërmjet pjesëmarrësve në tregun sekondar gjatë vitit 2023 ishte 68.6 milionë euro, një rënie prej 27.7 përqind krahasuar me 94.8 milionë euro sa ishte vitin e kaluar.

Për qëllime të huadhënies afatshkurtër, gjithsej vëllimi i transaksioneve të riblerjeve të mbështetura në kolateral me Letra me Vlerë të Qeverisë gjatë vitit 2023 rezultoi me 67.6 milionë euro, një rënie prej 54.1 përqind krahasuar me vëllimin e vitit paraprak prej 147.3 milionë euro.


Grafik 106. Struktura e investitorëve në Ankandet e Letrave me Vlerë



Grafik 107. Normat mesatare vjetore të kthimit për vitin 2022 dhe 2023, në përqindje



Grafik 108. Ankandet e Letrave me Vlerë gjatë vitit 2023



²³ Pjesëmarrës në tregun primar të Letrave me Vlerë të Qeverisë janë bankat komerciale, fondet pensionale, siguruesit dhe personat juridik dhe fizik duke vepruar përmes bankave komerciale.

²⁴ Pjesëmarrës në tregun sekondar të Letrave me Vlerë të Qeverisë janë bankat komerciale, fondet pensionale, siguruesit, personat juridik dhe fizik duke vepruar përmes bankave komerciale, si dhe institucionet publike.

Me qëllim të menaxhimit sa më efikas të likuiditetit afatshkurtër të sektorit bankar, vëllimi i kërkesave të sektorit bankar me BQK-në në vitin 2023, bazuar në huadhënien brenda-ditore të mbështetur me kolateral Letra me Vlerë të Qeverisë, ishte gjithsej 592.5 milionë euro, duke shënuar rritje prej 6.4 përqind krahasuar me vëllimin e vitit paraprak prej 557.1 milionë euro.

6.4. Teknologjia Informative

Gjatë vitit 2023, Departamenti i Teknologjisë së Informacionit dhe Sigurisë ka vazhduar me avancimin e sistemeve të teknologjisë, sigurisë së informacionit, dhe proceseve të punës, duke u përqendruar në veçanti në ngritjen e cilësisë së shërbimeve të ofruara dhe sigurisë së tyre.

Për të garantuar vazhdimësi dhe cilësi të shërbimeve që BQK ofron për institucionet financiare, qeveritare, dhe për qytetarët e Republikës së Kosovës, është vazhduar me investimin në teknologjitë e reja dhe avancimin e zgjerimin e kapaciteteve ekzistuese të teknologjisë informative, duke futur në punë pajisjet e teknologjisë së fundit. Këto sisteme janë mirëmbajtur, monitoruar, dhe testuar në mënyrë të vazhdueshme për t'u siguruar se do të jenë operacionale edhe gjatë situatave të ndryshme dhe të jashtëzakonshme. Megjithatë, sfida në rekrutimin dhe mbajtjen e kapaciteteve profesionale janë paraqitur dhe po adresohen, sipas mundësive.

6.5. Regjistri i Kredive të Kosovës


Bazuar në Ligjin për BQK-në, BQK mund të operojë, rregullojë, licencojë, regjistrojë, dhe mbikëqyrë sistemet e informacionit të kredive me qëllim të mbledhjes dhe shpërndarjes së informacionit të kredive mes institucioneve kredidhënëse, si dhe mund të nxjerrë rregullore për zbatimin përkatës. Bazuar në këtë objektiv, që nga viti 2006, BQK ka nën menaxhim të saj sistemin e Regjistrimit të Kredive të Kosovës (RKK), i cili funksionon si një aplikacion i bazuar në internet, dhe ka për qëllim mbledhjen dhe shpërndarjen e informatave pozitive dhe negative të personave fizikë dhe juridikë me qëllim të përmirësimit të procesit vlerësues të kredimarrësve, dhe realizimin e funksionit mbikëqyrës të BQK-së.

Nga një perspektivë e përgjithshme ekonomike, Regjistri i Kredive lehtëson kredidhënien sa i përket vëllimit dhe kostove, dhe kontribuon në stabilitetin financiar në përgjithësi duke ndihmuar kredidhënësit për një vendimmarrje të drejtë, në mënyrë më të saktë dhe më objektive brenda një kohe më të shkurtër.

Në bazë të Rregullores së Regjistrimit të Kredive, anëtar në sistemin e RKK-së janë të gjitha institucionet financiare të përcaktuara nga BQK për të qenë ofrues të kredive (të gjitha bankat komerciale, IMF-të e licencuara, si dhe ato IFJB dhe kompani të sigurimeve të licencuara për t'u marrë me aktivitete të veçanta kreditore). Po konsiderohen mundësi të avancimit të qasjes elektrinike në këtë regjistër, krahas faqes aktuale të BQK-së, përkatësisht ndërlihdja eventuale me platformën shtetërore, subjekt i vlerësimeve dhe vendimmarrjes së brendshme.

Të dhënat e sistemit të RKK-së tregojnë që në vitin 2023 ishin të regjistruar 2,280 përdorues aktiv të institucioneve kredidhënëse me dominim bankat me 1,579 përdorues, IMF-të dhe IFJB-të me 670, dhe kompanitë e sigurimeve me 31 përdorues aktiv të sistemit, ku vetëm gjatë këtij viti, RKK ka regjistruar 490 përdorues të rinj.

Grafik 109. Numri i hulumtimeve në sistemin e RKK-së



Burimi: BQK (2024)

Sistemi i RKK është i dizajnuar që të sigurojë një infrastrukturë të avancuar për funksionimin e tregut të kredive duke qenë një mjet i rëndësishëm për institucionet kredidhënëse në procesin e vlerësimit të rrezikut kreditor.

Ky sistem është një aplikacion i bazuar në internet dhe mund të qaset drejtpërdrejt dhe në kohë reale nga stafi i institucioneve kredidhënëse, i cili hulumton mbi historitë kreditore të aplikantëve kreditor, ku gjatë vitit 2023 arriti në 1,462,370 hulumtime (shih Grafikon 109).

Të gjithë ofruesit e kredive në Republikën e Kosovës janë të obliguar të raportojnë në sistemin e RKK-së të gjitha aplikacionet për kredi dhe kreditë e lëshuara për klientët e tyre, në përputhje me kushtet e udhëzimit përkatës të lëshuar nga BQK.

Gjatë vitit 2023, në RKK janë raportuar 276,100 kredi ku përfshihen huatë, kredit kartelat, mbitërheqjet, kreditë hipotekare rezidenciale, linjat kreditore, garancionet, lizingu, faktoringu, dhe asetet tjera kreditore. Në raportimin për kredi të aprovuara për vitin 2023 prijnë bankat me 153,450 kredi, ndjekur nga IMF-të me 107,040, dhe kompanitë e sigurimeve me 15,610 kredi të aprovuara (shih Grafikon 110). Ndërsa, numri i


kërkesave për raportin individual kreditor të kredimarrësve në vitin 2023 ka shënuar rënie nga një vit më parë, si për personat fizik dhe juridik (Grafiku 111).

6.6. Aktivitetet në fushën e analizave ekonomike dhe stabilitetit financiar

Në funksion të realizimit të objektivit primar të saj, ruajtjes së stabilitetit financiar përmes monitorimit të rregullt të rrezikut sistemik, ndër të tjera, BQK bën identifikimin, monitorimin, dhe analizimin e rrezikut sistemik në frekuencë të rregullt mujore, tremujore, gjashtëmujore dhe vjetore. Në këtë kontekst, identifikimi i rreziqeve potenciale bëhet përmes monitorimit të vazhdueshëm të zhvillimeve ciklike dhe strukturore makroekonomike. Vlerësimi i rreziqeve dhe ndikimi i tyre potencial në stabilitetin financiar, dhe për pasojë, në stabilitetin e përgjithshëm makroekonomik, bëhet përmes analizave të rregullta kualitative dhe kuantitative, përfshirë analizimin e ecurisë së treguesve ekonomikë dhe financiarë me frekuencë të lartë, parashikimet mbi treguesit kryesorë makroekonomikë, dhe kalibrimin e analizimin e modeleve që adresojnë dimensionet ciklike, strukturore, dhe ndërsektoriale të rrezikut sistemik.


BQK ka vazhduar të jetë e fokusuar në rritjen e vëllimit dhe cilësisë së analizave që shqyrtojnë zhvillimet kryesore makroekonomike në vend, dhe atyre me fokus në vlerësimin e stabilitetit financiar. Përmes identifikimit dhe vlerësimit të rreziqeve që kanosin sistemin financiar dhe infrastrukturën e tij, me një perspektivë të analizave të bazuar në rrezik, BQK ka vazhduar të

Grafik 110. Numri i kredive të aprovuara në sistemin e RKK-së



Burimi: BQK (2024)

Grafik 111. Numri i kërkesave për raporte kreditore



Burimi: BQK (2024)

informojë publikun mbi gjendjen e sistemit financiar, të rritë transparencën dhe nxitë debatin profesional mbi zhvillimet dhe sfidat e sistemit financiar të vendit dhe infrastrukturës së tij.

Përveç analizave të ndryshme periodike dhe monitorimit të rregullt të treguesve kryesorë të zhvillimeve në sektorët përkatës të ekonomisë, BQK ka vazhduar të angazhohet në avancimin e kornizave të brendshme për projektimin e ekonomisë dhe kornizat për vlerësimin e rreziqeve si: (i) modelin makroekonomik (kornizë vjetore që gjeneron projeksionet makroekonomike në skenarë bazë dhe të rënduar), (ii) kornizën e Stres-Testit (një nga instrumentet kyçe për identifikimin e brishtësive aktuale në sektorin bankar dhe rreziqeve potenciale sistemike në vitin vijues), (iii) rishikimin e Hartës së Stabilitetit Financiar (që analizon zhvillimet në tetë dimensione të rrezikut ndaj stabilitetit financiar), (iv) modelin e Identifikimit të Bankave me Rëndësi Sistemike (instrument tipik i politikës makroprudenciale, i cili vlerëson rrezikun e shpërndarjes së efekteve negative të një institucioni sistemik në tërë sistemin), si dhe (v) modelin e Kapitalit Shtesë Kundërciklik (model i politikës makroprudenciale).

Komiteti i Makroprudences si organ këshillues i themeluar në BQK, ka si objektiv të ndihmojë në ruajtjen e stabilitetit financiar të Kosovës, me qëllim të fuqizimit të rezistencës së sistemit financiar, zvogëlimin e akumulimit të rrezikut sistemik që siguron sektor financiar të shëndosh që kontribuon edhe në rritjen ekonomike të qëndrueshme. Komiteti ka instrumentet e makroprudences dhe këshillon Bordin Ekzekutiv rreth aplikimit të në mënyre të përshtatshme. Megjithatë gjatë vitit 2023, për të qëndrueshmërisë dhe stabilitetit të sistemit financiar në tërësi, nuk ka qenë e nevojshme aplikimi i instrumenteve makroprudenciale, përveç masave mikroprudenciale që dalin nga mandati mbikëqyrës. Në kuadër të këtij Komiteti, janë zhvilluar 4 takime dhe janë dhenë 9 rekomandime, në funksion të mbikëqyrjes makroprudenciale. Pas rishikimit të termave të referencës në vitin 2024, siç planifikohet, do të zgjerohet fushëveprimi dhe ndikimi në marrjen e masave makro dhe mikroprudenciale.

Në vitin 2023, në bashkëpunim me një asistencë të fokusuar teknike të FMN-së, BQK ka rishikuar dhe avancuar një ndër veglat më të rëndësishme që ka një bankë qendrore për të vlerësuar stabilitetin e sektorit financiar, modelin e Stres-Testit. Modeli që pritet të finalizohet në vitin 2024, do të ndihmojë politikëbërjen e BQK-së përmes rritjes së kapaciteteve për të vlerësuar dimensionet e rreziqeve që kanosin stabilitetin e përgjithshëm financiar në vend. Gjithashtu, gjithmonë në funksion të avancimit të punës dhe ngritjes së kapaciteteve parashikuese dhe hulumtuese, BQK gjatë këtij viti ka rishikuar dhe avancuar kapacitetet projektuese përmes rivlerësimit të modelit makroekonomik.

Një ndër publikimet më të rëndësishme periodike është Raporti i Stabilitetit Financiar, raport që pasqyron qëndrueshmërinë e sistemit financiar duke analizuar zhvillimet e përgjithshme ekonomike, së bashku me zhvillimet në aktivitetin, performancën, dhe qëndrueshmërinë e të gjithë komponentëve të sistemit financiar të vendit. Për t'i siguruar publikut qasje sa më të shpejtë në informacionet rreth zhvillimeve në ekonominë e vendit, BQK ka vazhduar të publikojë në baza të rregullta edhe Vlerësimet Tremujore të Ekonomisë, raporte që ofrojnë një pasqyrë mbi zhvillimet kryesore makroekonomike dhe zhvillimet në të gjithë komponentët e sistemit financiar të ekonomisë në baza tremujore. Për më tepër, BQK ka vazhduar të publikojë edhe Raportin e Informatave Mujore të Sistemit Financiar, raport që paraqet një përmbledhje të indikatorëve kyç për të gjithë komponentët e sistemit financiar të Republikës së Kosovës, dhe publikohet çdo muaj.

BQK ka vazhduar të realizojë edhe Anketën e Kreditimit Bankar të Kosovës (AKBK) me bankat komerciale në baza tremujore, anketë që përveç se ka ndihmuar për të kuptuar më mirë zhvillimet në sektorin bankar, ka shërbyer edhe si input i rëndësishëm për parashikimin e rritjes ekonomike dhe të agregatëve tjerë makroekonomikë. Tutje, kundrejt objektivës së parë mandatore të BQK-së, AKBK plotësohet edhe nga seksioni që adreson pritjet e bankave komerciale për çmimet në

vend, ndërkohë që seria kohore e pritjeve të bankave për dinamikat në inflacion publikohet edhe në faqen zyrtare të BQK-së, sikurse edhe Seria kohore e Inflacionit Bazë.

6.7. Aktivitetet kryesore në fushën e statistikave gjatë vitit 2023

Në bazë të nenit 25 të Ligjit për BQK-në, BQK për përmbushjen e objektivave të saj mbledh, përpilon dhe publikon statistika dhe informacione tjera të nevojshme. BQK është prodhuese dhe përdoruese kryesore e statistikave financiare të Republikës së Kosovës dhe një nga burimet kryesore të statistikave në nivel kombëtar. Në kuadër të mandatit ligjor të saj, BQK përpilon dhe publikon statistikat e sektorit monetar, financiar, llogarive financiare dhe sektorit të jashtëm.

Për qëllime të përpilimit të statistikave, subjektet raportuese në BQK, në Departamentin e Statistikës (DS) janë personat fizik dhe juridik, përfshirë institucionet financiare (bankat komerciale, fondet pensionale, siguruesit, ndërmjetësit tjerë financiar, dhe ndihmësit financiar), ndërmarrjet në pronësi të huaj, Dogana e Kosovës, institucionet qeveritare, korporatat jofinanciare, ekonomitë familjare dhe organizatat jofitimprurëse. Në pajtim me legjislacionin në fuqi, BQK respekton konfidencialitetin në lidhje me të dhënat individuale që i siguron nga subjektet e ndryshme raportuese, të cilat i përdorë vetëm për qëllime të përpilimit të statistikave. Informatat e siguruar nga raportuesit janë të nevojshme për të përpiluar statistikat monetare dhe financiare, statistikat e sektorit të jashtëm dhe llogarive financiare në kuadër të përgjegjësive ligjore të BQK-së që burojnë nga Ligji nr. 03/L209 për BQK-në dhe Ligji nr. 04/L-036 për Statistikat Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Përpilimi i statistikave ndjekë metodologjinë e rekomanduar nga FMN, BQE, BB, Eurostat, dhe praktikat më të mira të vendeve tjera.

Publikimi i statistikave bëhet sipas afatit të publikuar paraprakisht në faqen e internetit të BQK-së, dhe në formate të ndryshme, si: seritë kohore, Buletini Mujo Statistikor, Raporti Vjetor, Faqja Përmbledhëse e të Dhënave Kombëtare, FMN, Eurostat, BB, CEFTA, etj. Statistikat në përgjegjësinë e BQK-së sipas kërkesës, përgatiten dhe shpërndahen për nevoja të njëjësive organizative brenda BQK-së, si dhe për përdoruesit e jashtëm, si: institucionet qeveritare, mediat, organizata ndërkombëtare, universitetet dhe publiku i gjerë.

Edhe gjatë vitit 2023, BQK ka vazhduar përpilimin dhe publikimin e rregullt të statistikave në kuadër të fushëveprimit të saj në harmoni me kalendarin e publikimeve. Statistikat monetare dhe financiare përfshirë nënsektorët (banka qendrore, bankat komerciale, kompanitë e sigurimit, fondet pensionale, ndërmjetësit tjerë financiarë, dhe ndihmësit financiarë), si dhe statistikat e sektorit të jashtëm (bilanci i pagesave, pozicioni i investimeve ndërkombëtare, borxhit i jashtëm, etj.) kanë vazhduar të publikohen rregullisht në faqen e internetit të BQK-së dhe organizatat ndërkombëtare. Moduli i statistikave të llogarive financiare ka vazhduar të publikohet rregullisht në baza tremujore në seri kohore në faqen e internetit të BQK-së për sektorin financiar dhe sektorin e jashtëm. Megjithatë, janë edhe tre sektorë tjerë të ekonomisë të pambuluar, për të cilët burimet e të dhënave duhet të sigurohen në bashkëpunim me institucionet tjera relevante në vend. Në këtë drejtim, për të përcaktuar ndarjen e përgjegjësive institucionale, si edhe mekanizmat e bashkëpunimit për përgatitjen e llogarive financiare, është në fazën finale arritja e Memorandumit të Bashkëpunimit ndërmjet BQK-së, ASK-së, dhe MFPT-së.

Gjatë vitit 2023, BQK ka vazhduar përafrimin e mëtejshëm të statistikave nën përgjegjësinë e saj me standardet e Bashkimi Evropian të përcaktuara me Sistemin Evropian të Llogarive Kombëtare dhe Regjionale (ESA 2010). Në baza të rregullta mujore janë raportuar statistikat mbi normat e interesit në Bankën Qendrore Evropiane (BQE), ndërsa në Eurostat në baza tremujore janë raportuar statistikat e Bilancit të Pagesave dhe Pozicionit të Investimeve Ndërkombëtare dhe në baza vjetore statistikat e investimet direkte dhe statistikat e tregtisë ndërkombëtare në shërbime.

Në kuadër të Programit IPA 2019, BQK këtë vit ka implementuar projektin “1.2 Statistikat e Tregtisë në Shërbime”, duke përbushur të gjitha detyrat e ngarkuara sipas kontratës. Në kuadër të këtij projekti ka vazhduar avancimi i raportimit duke implementuar rregullat e reja të validimit të dyfishtë, të aplikuara nga sistemi i shpërndarjes së të dhënave në Eurostat. Përveç kësaj, brenda këtij projekti është realizuar një mision i asistencës teknike nga Eurostat, një punëtori, dhe një vizitë studimore në Turqi.

Në kuadër të publikimeve të rregullta mujore të FMN-së nga BQK, për herë të parë nga muaji shkurt 2023 ka filluar publikimi i rregullt në baza mujore i raportit të konsoliduar të rezervave ndërkombëtare dhe likuiditetit valutor, më konkretisht forma “International Reserves and Foreign Currency Liquidity Data Template”(IRFCL; Shqip: Statistikat e Rezervave Ndërkombëtare dhe Likuiditetit Valutor). Kompletimi i IRFCL paraqet një mundësi të mirë për t'u përafuar me kriteret e përcaktuara nga Standardi Special i Shpërndarjes së të Dhënave (SDDS), i cili pritet të adaptohet nga Republika e Kosovës në një të ardhme të afërt.

Në kuadër të marrëveshjeve me Qeverinë e Kosovës, atë të Stand-By Arrangement (SBA), dhe Marrëveshjes së Resilience and Sustainability Facility (RSF), nga muaji qershor 2023 në DS janë shtuar raportet vijuese që duhet të dërgohen në FMN:

- Përgatitja e raportit Financial Soundness Indicators (FSI) (Shqip: Treguesit e Shëndetit Financiar) sipas Korporatave tjera Depozituese (KTD) në baza mujore;
- Përgatitja e raporteve të bilancit të gjendjes, pasqyrës së të ardhurave, kredive joperformuese, kredive sipas aktivitetit ekonomik sipas KTD-ve, sipas kërkesës së pranuar nga zyra e FMN-së në Kosovë, në baza tremujore duke filluar nga perioda qershor 2023.

Gjatë vitit 2023, BQK ka organizuar projektin e anketës me jo-rezidentët që vizitojnë Kosovën gjatë periudhës së pushimeve. Anketa është realizuar duke përdorur një sistem të avancuar të huazuar nga BB, i cili ka mundur rritje të efikasitetit të mbledhjes së të dhënave dhe përmirësim të kualitetit të tyre. Të dhënat e mbledhura janë përdorur për kalkulimin e vlerësimeve të shpenzimeve të emigrantëve në Kosovë, të cilat kanë ndikim të rëndësishëm në statistikën e shërbimeve të udhëtimit dhe disa kategori tjera që lidhen me impaktin e emigrantëve në Kosovë siç janë remitencat, investimet direkte, etj. Gjatë këtij viti është punuar edhe në automatizimin e proceseve të punës duke rritur efikasitetin dhe produktivitetin e realizimit të punëve të përditshme, sidomos rreth pranimin dhe validimit të statistikave, duke zvogëluar punën manuale, duke zvogëluar gabimet e mundshme me rastin e pranimin të raporteve nga raportuesit dhe përpiluesit, etj. Nga ky automatizim, BQK ka vazhduar punën për zhvillimin e platformës online për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave që raportohen nga korporatat jofinanciare. Me finalizimin e këtij programi, që pritet gjatë vitit 2024, synohet të rritet funksionaliteti, efektiviteti, dhe mbrojtja e të dhënave.

Përveç kësaj, BQK këtë vit është angazhuar edhe në përmirësimin e cilësisë dhe konsistencës së të dhënave të prodhuara sipas standardeve dhe metodologjisë së rekomanduar nga Eurostat dhe FMN, përditësimin e metodikës së publikuar në faqen e internetit të BQK-së, publikimin e tabelave të reja, shkurtimin e frekuencës së publikimit të treguesve statistikor, avancimin e metodave të procesimit dhe validimit të raporteve statistikore, mirëmbajtjen e faqes “Ekonomia e Kosovës në një shikim”, përpilimin dhe publikimin e kamatëvonesës në transaksionet tregtare dhe kreditore, përpilimin dhe raportimin e treguesve të shëndetit financiar, si dhe publikimin e sqarimeve të përmbledhura rreth zhvillimeve kryesore në webfaqen e BQK-së për transparencë dhe njoftim më të saktë të publikut.

6.8. Rishqyrtimi i kërkesave të institucioneve financiare të mbikëqyrura nga BQK

Gjatë ushtrimit të kompetencave të veta mbikëqyrëse, BQK vepron në pajtueshmëri me nenin 67 pika 4 të Ligjit Nr.03/L-209 për BQK-në me rastin e ndëshkimeve administrative ndaj subjektit/personit. Neni 67 pika 4 specifikon që para se të shqiptojë ndëshkime administrative, BQK i ofron një deklaratë të detajuar subjektit/personit të cilit do ti shqiptohet ndëshkimi, duke përshkruar faktet dhe ligjin që mbështesin ekzistencën e shkeljes, dhe duke i dhënë subjektit/personit mundësi të plotë të ofrojë fakte dhe argumente për mosndëshkim.

Në deklaratën/njoftimin paraprak për marrjen e masave ndëshkimore administrative të dërguara nga BQK jepet edhe këshilla juridike, ku subjekti (institucioni financiar) informohet me të drejtën që brenda 15 ditësh kalendarike nga dita e pranimit të kësaj deklarate, mund të parashtrijë kërkesë për rishqyrtim në Divizionin e Rishqyrtimit të BQK-së. Në rast se subjekti (institucioni financiar) i mbikëqyrur nga BQK vendos të ankohet, atëherë dërgon kërkesën për rishqyrtim në Divizionin e Rishqyrtimit. Divizioni i Rishqyrtimit në vazhdimësi është koordinuar me mbikëqyrjen financiare lidhur me dërgimin e Njoftimit paraprak për marrjen e masave ndëshkimore administrative nga BQK tek subjekti (institucioni financiar), si parapërgatitje, në rast eventual të parashtrimit të kërkesave për rishqyrtim të këtyre institucioneve.

Gjatë vitit 2023 janë pranuar kërkesa për rishqyrtim nga pesë subjekte (institucione financiare), të cilat janë shqyrtuar me kujdes dhe në pajtueshmëri me kornizën ligjore, duke ofruar dhe raporte me rekomandime përkatëse për vendimmarrje në Bordin Ekzekutiv. Në baza të vazhdueshme janë përcjellë zhvillimet në kornizën ligjore me qëllim të identifikimit të nevojave për ndryshim të ndonjë dispozite që do të ndërliidhej me çështjet e rishqyrtimit të kërkesave të pranuar nga institucionet financiare. Gjatë shqyrtimit të kërkesave është komunikuar me institucionet financiare që kanë parashtruar kërkesën për rishqyrtim dhe departamentet përkatëse në BQK, duke siguruar kështu materialin e nevojshëm, sqarimet e mundshme, dhe efikasitetin që kërkesat të shqyrtohen brenda afatit ligjor.

7. Zhvillimet e Brendshme

7.1. Auditimi i Brendshëm

Auditimi i Brendshëm (AB) është funksion i rëndësishëm, i cili ofron siguri të arsyeshme për Bordin e BQK-së, Komitetin e Auditimit (KA), dhe Bordin Ekzekutiv, se mekanizmat e kontrollit të brendshëm janë dizajnuar dhe funksionojnë në mënyrë efektive. Auditimi i Brendshëm (AB) së bashku me auditimin e jashtëm përmbyllin zinxhirin e llogaridhënies brenda institucionit. Korniza ligjore e BQK-së i ofron mandat të plotë AB-së që në mënyrë të pavarur të zhvillojë angazhime të auditimit me qëllim që t'i ofrojë Bordit të BQK-së, KA-së dhe Menaxhmentit, rekomandime në funksion të rritjes së efikasitetit të kontrolleve të brendshme dhe shtimit të vlerës në institucion.

Gjatë vitit 2023, Auditimi i Brendshëm ka vazhduar angazhimet/auditimet konform Planit Vjetor, i cili është përgatitur duke u bazuar në Metodologjinë e Vlerësimit të Rreziqeve, sipas Qasjes së Bazuar në Rrezik. Auditimet dhe angazhimet e kryera gjatë këtij viti ishin të natyrës financiare, të pajtueshmërisë, operacionale dhe të teknologjisë informative. Këto aktivitete janë kryer duke iu referuar Ligjit nr.03/L-209 për BQK-në, përkatësisht nenit 61 të këtij Ligji, si dhe Planit Vjetor të AB-së. Fushëveprimi i AB ka vazhduar të jetë i orientuar në drejtim të përmirësimit dhe avancimit të sistemeve/proceseve të cilat e ndihmojnë Menaxhmentin në arritjen e objektivave të përcaktuara. AB përmes aktiviteteve/auditimeve të kryera, ka dhënë rekomandime konkrete në funksion të përmirësimit të sistemeve të kontrolleve të brendshme, si dhe të rritjes së vlerës së departamenteve/divizioneve dhe fushave tjera përgjegjëse brenda BQK-së.

Përpos aktiviteteve audituese, AB-ja ka përgatitur Planin Vjetor 2024, të cilit i ka paraprirë përgatitja e Planit Strategjik të Auditimit të Brendshëm për periudhën 2024-2026. Në funksion të përmbushjes së kërkesave ligjore, Shefi i Auditimit të Brendshëm në fund të vitit 2023, e ka proceduar për diskutim tek organet përgjegjëse Planin Vjetor 2024. Ky dokument, fillimisht është diskutuar dhe ka marrë mbështetje nga KA. I njëjti, pas diskutimeve të nevojshme është miratuar nga Bordi i BQK-së. Shefi i Auditimit të Brendshëm ka vazhduar raportimin e tij të rregullt tek KA dhe Bordi i BQK-së. Gjatë këtij viti janë mbajtur gjithsej tetë takime të KA, me pjesëmarrje të rregullt të Shefit të AB, ku ndër të tjera është diskutuar mbi ecurinë e aktiviteteve të AB-së dhe mbi procesin e përcjelljes së implementimit të rekomandimeve. Këtë vit, AB i është nënshtruar procesit të vlerësimit të jashtëm nga përfaqësues të Bankës Qendrore të Holandës, ndërsa, në kuadër të shkëmbimit të përvojave, përfaqësues nga Banka Qendrore e Austrisë kanë qëndruar për vizitë një javore në BQK, për të ndarë eksperiencat e tyre me stafin e AB-së. AB ka vazhduar angazhimin lidhur me adresimin e rekomandimeve të dhëna nga vlerësimet e jashtme nga Vlerësuesit e Jashtëm të Bankës Qendrore të Holandës, FMN - Vlerësimi i Masave Mbrojtëse (Safeguards Assesment), dhe Auditorët e Jashtëm.

Aktivitetet rreth edukimit të vazhdueshëm profesional kanë vazhduar edhe gjatë këtij viti, përmes pjesëmarrjes së stafit të AB-së në disa trajnime dhe seminare. Ndërsa, në funksion të kryerjes së detyrave të saj, AB ka vazhduar komunikimin me Auditorët e Jashtëm të BQK-së.

7.2. Burimet Njerëzore

Në zbatim të objektivave strategjike të BQK-së, dhe politikave të administrimit të burimeve njerëzore, BQK është fokusuar në drejtim të përvetësimit dhe zbatimit në vazhdimësi të praktikave më të mira të menaxhimit të burimeve njerëzore që aplikohen në institucione të ngjashme. Administrimi efektiv i burimeve njerëzore i kushton rëndësi të veçantë përshtatjes së infrastrukturës rregullative të institucionit me standardet më të mira, duke ofruar mundësi për zhvillim dhe promovim për të gjithë punonjësit, me synim rritjen e profesionalizmit, performancës, dhe motivimit të punonjësve.

Në fund të vitit 2023, numri i të punësuarve në BQK ishte 225, me moshë mesatare të të punësuarve 42 vite, dhe me përfaqësim gjinor të ekuilibruar në nivel specialistësh dhe drejtuesish. Raporti i punonjëseve femra ndaj meshkujve është 53.8% - 46.2%, ndërsa, në nivel drejtues 41.5% - 58.5%.

Në strukturën e përgjithshme të BQK-së, tre punonjës ose 1.3% janë me doktoraturë, 97 ose 43.1% me edukim pasuniversitar, 103 ose 45.8% me edukim universitar, 20 ose 8.9% me edukim të mesëm, dhe 2 punonjës ose 0.9% me edukim bazik (shih Grafikun 112).

BQK vlerëson personelin si një ndër resurset me rëndësi të veçantë dhe vazhdimisht angazhohet për mbështetjen e tyre që t'u sigurojë njohuri të duhura, aftësi, ekspertizë, dhe ngritje profesionale adekuate për përmbushjen e detyrave dhe përgjegjësi sipas standardeve më të larta, për arritjen e potencialit të plotë të tyre, duke krijuar kushte për vijim të studimeve pasuniversitare, dhe pjesëmarrjes së vazhdueshme në konferenca, trajnime, kurse, punëtori, seminare, etj.

Për të arritur objektivat e veta, në pajtim me ligjin për BQK-në, për të ruajtur dhe tërhequr kuadër profesional, BQK ka rishikuar politikën e marrëdhënies së punës dhe gjatë vitit 2024 do të rishikojë edhe aktet e brendshme të nevojshme.


Nga numri i përgjithshëm i të punësuarve, deri në vitin 2023, 190 punonjës kanë marrë pjesë në trajnime profesionale të cilat kryesisht janë organizuar online nga BQE, FMN, Joint Vienna Institute (JVI), Deutsche Bundesbank, Banka e Holandës, Banka e Polonisë, Banka e Francës, Banka e Italisë, Banka e Çekisë, Istanbul School of Central Banking, Shoqata e Bankave të Kosovës, dhe Center of Excellence in Finance (CEF).

7.3. Aktiviteti i BQK-së në fushën ligjore

Me qëllim të zbatimit dhe arritjes së objektivave të përcaktuara sipas Ligjit për BQK-në, gjatë vitit 2023 BQK është fokusuar në drejtim të implementimit të kornizës ligjore ekzistuese dhe në hartimin dhe përditësimin e kornizës ligjore rregullative në pajtim me zhvillimet e fundit në sektorin financiar. Në vazhden e përpjekjeve për të harmonizuar legjislacionin primar me atë të BE-së, dhe me praktikatat dhe standardet ndërkombëtare, janë hartuar projektligjet dhe janë miratuar aktet përkatëse nënligjore. Në bashkëpunim me asistencën e ofruar nga BB, BQK ka hartuar draft-Ligjin për Shërbimet e Pagesave në pajtim me direktivat dhe rregulloret përkatëse të BE-së, i cili ofron një kornizë të përgjithshme për shërbimet e pagesave dhe aktivitetet e ndërlidhura brenda Republikës së Kosovës, që ndër të tjera ka qëllim të përcaktojë ofruesit e shërbimeve të pagesave, rregullat për emetimin e parasë elektronike, autorizimin, veprimtarinë, dhe mbikëqyrjen e institucioneve të pagesave dhe institucioneve të parave elektronike, etj. Është hartuar draftligji për banka ndërsa, në proces të hartimit nga BQK është draftligji për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia.

Për zbatimin e kërkesave ligjore përkatëse, gjatë vitit 2023, BQK ka vazhduar me avancimin e mëtutjeshëm të akteve nënligjore për mbikëqyrjen dhe rregullimin e institucioneve financiare në Kosovë. Gjatë këtij viti hyri në fuqi Rregullorja për Qasje në Llogari Pagesave me Shërbime Bazike, qëllimi i së cilës është krijimi i mundësisë për të gjithë qytetarët në funksion të përfshirjes

Grafik 112. Struktura sipas edukimit



financiare. Në kuadër të detyrave dhe përgjegjësi, organet vendimmarrëse kanë nxjerrë një sërë rregulloresh, politika, rregulla, dhe vendime tjera, në funksion të rregullimit, mbikëqyrjes, dhe mbajtjes stabil të sektorit financiar, duke siguruar një sistem të sigurt, të qëndrueshëm dhe efikas të pagesave. Miratimit të të gjitha akteve nënligjore, si dhe vendimeve tjera nga organet vendimmarrëse të BQK-së, i ka paraprirë shqyrtimi ligjor paraprak që të sigurohet zbatueshmëria në pajtim të plotë me legjislacionin në fuqi.

Më tutje, në funksion të realizimit me efikasitet të detyrave lidhur me çështjet brenda fushave të kompetencave përkatëse ligjore, BQK është angazhuar në hartimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucionet përkatëse, si vijon:

- Marrëveshje mirëkuptimi në mes të BQK-së dhe Njësisë për Inteligjencë Financiare, për bashkëpunim dhe shkëmbim të informatave nënshkruar në muajin korrik të vitit 2023;
- Marrëveshje mirëkuptimi në mes të BQK-së dhe Aflatoun International, lidhur me edukimin social dhe financiar për fëmijët dhe të rinjtë në Kosovë nënshkruar në muajin maj të vitit 2023;
- Marrëveshje mirëkuptimi në mes të BQK-së dhe Fondit Kosovar për Garanci Kreditore, në lidhje me bashkëpunimin dhe këmbimin e informatave në fushën e kreditimit dhe garancive kreditore në proces të hartimit.

7.4. Funkzioni i Menaxhimit të Rrezikut

Menaxhimi i rrezikut (MR) në BQK është i orientuar drejt arritjes së objektivave të përcaktuara me ligj dhe monitorohet dhe mbikëqyret me një qasje të strukturuar sistematike, e përcaktuar nga kuadri i përgjithshëm i MR, që përcakton edhe llojet kryesore të rrezikut (rrezikun strategjik, operacional dhe financiar), me të cilët BQK përballet dhe menaxhon. Pjesë e kuadrit janë proceset për identifikim, analizë, dhe vlerësim të rrezikut që përcillen me përgjigje adekuate ndaj rrezikut dhe monitorohet niveli i rrezikut sipas kuadrit rregullues në fuqi.

Zhvillimi i kuadrit të MR në BQK mbështetet mbi parimet të cilat mundësojnë menaxhimin efektiv dhe efikas të rrezikut në arritjen e objektivave të saj, dhe nuk është proces i pavarur nga aktivitetet dhe proceset tjera të punës, por është pjesë integrale e qeverisjes dhe e të gjitha proceseve, përfshirë planifikimin strategjik dhe menaxhimin e projekteve.

BQK konform praktikave më të mira ka adaptuar modelin e tri linjave mbrojtëse: (i) njësitë organizative/bartësit e proceseve që janë përgjegjës për MR përmes vendosjes së kontrolleve, (ii) funksioni i MR, me përgjegjësinë e monitorimit të përshtatshmërisë së MR me fushëveprimet e përcaktuara, dhe (iii) funksioni i auditimit të brendshëm, i cili kryen auditime të rregullta të proceseve të menaxhimit të rrezikut dhe sistemit të kontrolleve të brendshme. Funksioni i MR në baza periodike ka raportuar te Bordi Ekzekutiv i BQK-së rreth aktiviteteve në shërbim të avancimit të proceseve, dhe mbi profilin e përgjithshëm të rrezikut në BQK. Departamenti i MR (DMR) është i lidhur me dy komisione të BQK-së që kanë kompetenca për menaxhimin e rrezikut: Komitetin e Auditimit, dhe Komitetin për Investime.

Sistemi për Menaxhimin e Rrezikut, ka për qëllim të mbështes proceset për identifikim, vlerësim, raportim dhe monitorim me qëllim të avancimit të proceseve të menaxhimit të rrezikut në BQK. Departamenti i Menaxhimit të Rrezikut ka Sistem të Menaxhimit të Rrezikut përmes të cilit tani mbështeten proceset për menaxhim të rrezikut. Ky projekt është bazuar duke respektuar Rregullën e Menaxhimit të Projekteve të Teknologjisë së Informacionit në BQK dhe sistemi është zhvilluar nga Grupi i zhvilluesve të softuerëve në kuadër të Departamentit të Teknologjisë së Informacionit.

Janë zhvilluar programe vetëdijesimi lidhur me menaxhimin e rrezikut të cilat programe janë ekzekutuar në mënyrë periodike. Për t'i kontribuar ngritjes së vetëdijesimit rreth raportimit të

incidenteve, zhvillimit dhe raportimit të indikatorëve kyç të rrezikut dhe çështjeve tjera që kanë të bëjnë me menaxhimin e rrezikut, janë zhvilluar udhëzues dhe procedura lehtë të qasshëm për stafin. Gjatë periudhave tremujore të raportimit të vetëvlerësimeve dhe indikatorëve të rrezikut, janë mbajtur takime me të gjitha njësitë raportuese me qëllim të ofrimit të udhëzimeve për identifikim të rrezikut dhe vlerësim të kontroleve për mitigim të rrezikut. Gjithashtu, pas çdo zhvillimi dhe avancimi të proceseve dhe instrumenteve mbështetëse, janë organizuar tryeza dhe punëtori me njësitë organizative në mënyrë që të ofrohen informacionet e nevojshme për zbatim të kërkesave të reja të nxjerra përmes këtyre akteve.

Proceset për identifikim, analizë dhe vlerësim të rrezikut të cilat përcillen me përgjigje ndaj rrezikut dhe monitorohet niveli i tij, janë dizajnuar për të qenë në shërbim të arritjes së objektivave strategjike të Bankës Qendrore, duke vënë në pah mundësitë dhe rreziqet potenciale. Për të arritur këtë është bërë lidhja në mes qëllimeve strategjike, proceseve të punës që ndihmojnë arritjen e këtyre objektivave dhe rreziqeve që mund të rrezikojnë arritjen e tyre. Për secilën fazë të ciklit të menaxhimit të rrezikut janë zhvilluar procedura, forma dhe vegla për të mbështetur identifikimin, vlerësimin, raportimin dhe monitorimin e nivelit të rrezikut në institucion.

Funksioni i Menaxhimit të Rrezikut ka përgatitur raporte të konsoliduara me rezultatet e nxjerra pas analizave dhe vlerësimeve duke përdor instrumentet e zhvilluara për këtë qëllim. Raportet si produkte finale të dala pas ekzekutimit të proceseve të menaxhimit të rrezikut janë standardizuar dhe përshtatur për palët e interesit.

8. Marrëdhëniet me jashtë dhe bashkëpunimi ndërkombëtar

8.1. Marrëdhëniet Ndërkombëtare

BQK ka vazhduar bashkëpunimin e ngushtë me të gjitha institucionet vendëse dhe ato ndërkombëtare edhe gjatë vitit 2023.

BQK nën kryesimin e Guvernatorit, vazhdoi takimet e ndryshme gjatë gjithë vitit në frymën e bashkëpunimit me institucione financiare ndërkombëtare, ndër të tjera: FMN, BB, BQE, Bordin e Guvernatorëve të Rezervës Federale të ShBA-së, Komisionin Evropian, Deutsche Bundesbank, Autoritetet e Mbikëqyrjes Federale Gjermane, Autoritetin e Mbikëqyrjes Austriake, Autoritetin e Mbikëqyrjes së Britanisë së Madhe, Bankën Kombëtare të Austrisë, Bankën e Shqipërisë, Bankën Kombëtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Bankën e Lituanisë, Bankën Kombëtare të Kroacisë, Bankën e Portugalisë, Bankën e Italisë, IFC, BERZh, Këshillin e Byrove të Kartonit të Gjelbër me seli në Bruksel, me Zyrën e BE-së/Përfaqësuesin e Posaçëm të BE-së në Kosovë dhe institucione tjera. Në kuadër të praktikës së avancuar të transparencës, nga pjesa e dytë të vitit 2023 e tutje, publiku është njoftuar përtakimet dhe përmbajtjen e tyre në mënyrë efektive.

Përmes menaxhmentit të saj, BQK është përfaqësuar nga U.D. Guvernatori në Takimet Pranverore të FMN-së dhe BB, në Uashington D.C. të ShBA-ve, ku kanë zhvilluar takime me zyrtarë të lartë të FMN-së dhe BB dhe me homologë të bankave qendrore të vendeve të ndryshme. Delegacioni i BQK-së është pritur në takime nga nivelet e larta ekzekutive të BB dhe FMN-së.

Në sferën e marrëdhënieve dhe bashkëpunimit ndërkombëtar, BQK është përfaqësuar përmes menaxhmentit edhe në konferencat dhe tryezat e përbashkëta me institucionet simotra, duke përfshirë takime formale, konferenca dhe organizime tjera të nivelit adekuat për përfaqësim nga Guvernatori dhe ekipet sipas nevojës.

BQK dhe MFPT mirëpritën shtetet anëtare të Konstituencës së BB dhe FMN-së të cilat këtë vit u mbledhën në Prishtinë. Takimet e Konstituencës mbahen me përfaqësues të bankave qendrore dhe ministrive të financave nga shtetet anëtare të Konstituencës tonë si: Austria, Belgjika, Turqia, Çekia, Luksemburgu, Sllovakia, Hungaria dhe Sllovenia. Takimet u zhvilluan në disa sesione, me pjesëmarrës të nivelit të lartë të institucioneve financiare ndërkombëtare si: Grupi i BB përfshirë IFC, dhe FMN-në. Me këtë rast u diskutuan tema të ndryshme mbi zhvillimet e fundit globale dhe ekonomike, në veçanti vështrimet mbi inflacionin, ndikimi i luftës në Ukrainë, rritja ekonomike, dhe roli i këtyre institucioneve në përkrahjen e zhvillimeve ekonomike. Takimet e Konstituencës u mbajtën për herë të dytë në Prishtinë që nga shpallja e Pavarësisë në vitin 2008. Përzgjedhja e Kosovës si nikoqire për zhvillimin e këtyre takimeve tregon përkushtimin e institucioneve të Kosovës për bashkëpunimin e vazhdueshëm me institucionet më të larta financiare ndërkombëtare.

BQK u përfaqësua nga Guvernatori edhe në Forumin e Ministrave të Ekonomisë në kuadër të procesit të Berlinit në Tiranë, i titulluar "Tregu i Përbashkët Rajonal – Një Hap Drejt Tregut Unik të BE-së".

Me ftesë të Guvernatores së Bankës Kombëtare të Maqedonisë së Veriut, Guvernatori mori pjesë në Forumin Ndërkombëtar me temë "Riaktivizimi i Inflacionit dhe Realitetet e reja Gjeopolitike që Ndikojnë në Ridizajnimin e Politikës Makroekonomike" që u mbajt në Shkup.

Krahas pjesëmarrjes në Tryezën e këtij Forumi, Guvernatori mori pjesë në disa takime bilaterale me disa nga guvernatorët e bankave qendrore të shteteve të rajonit dhe Evropës, duke përfshirë guvernatorin nga Banka e Shqipërisë, Banka e Sllovenisë, Banka Kombëtare e Kroacisë, Banka e Lituanisë, Banka Kombëtare e Belgjikës, si dhe përfaqësues të lartë të FMN-së, BB dhe institucioneve tjera financiare.

Ndërsa, një delegacion i lartë i BQK-së, i kryesuar nga Guvernatori dhe me pjesëmarrjen e Kryetarit të Bordit të BQK-së mori pjesë në takimet vjetore të FMN-së dhe BB që u zhvilluan në Marakesh të Marokut. Gjatë pjesëmarrjes në këto takime të FMN-së dhe BB, delegacioni ka takuar Zëvendës-presidentin e BB për Evropën dhe Azinë Qendrore, Zëvendësdrejtorin Menaxhues të FMN-së dhe Drejtorin e Departamentit Evropian të FMN-së.

Në takimin e radhës, delegacioni i BQK-së ka takuar dhe Zëvendësdrejtorin e Departamentit të Tregjeve Monetare dhe të Kapitalit në FMN, Zëvendës-presidentin e IFC-së për Evropë, Drejtoreshën Rajonale të IFC-së dhe Drejtorin Ekzekutiv të Konstituencës në FMN.

Vlen të potencojmë edhe arritjen e një marrëveshje të rëndësishme së veçantë për BQK-në dhe jo vetëm, e cila është realizuar gjatë pjesëmarrjes në Takimet Vjetore në Maroko.

Guvernatori ka nënshkruar me Zëvendës-presidentin e BB dhe njëherësh Drejtor i Thesarit të BB marrëveshjen për anëtarësimin e BQK-së në Programin e Partneritetit për Këshillimin dhe Menaxhimin e Rezervave (RAMP) me Thesarin e BB.

Guvernatori ka përfaqësuar BQK-në në Tiranë, në konferencën e titulluar "Zhvillimi i Sektorit të Sigurimeve në Evropën Juglindore - Mundësitë dhe Sfidat", e cila u mbajt nën organizimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë të Republikës së Shqipërisë (MFE), Autoritetit për Mbikëqyrje Financiare (AMF), BB, Ambasadës së Zvicrës në Shqipëri, dhe Financat për Zhvillim (F4D).

Gjatë nëntorit 2023, një delegacion i lartë i BQK-së, i kryesuar nga Guvernatori, mori pjesë në takime të nivelit të lartë me guvernatorët dhe zëvendësguvernatorët e gjashtë vendeve të BP, të organizuara nga nikoqiri BQE, lidhur me integrimin në sistemin evropian të bankave qendrore, përkatësisht, në skemën e pagesave SEPA, dhe sistemin e pagesave të shpejta, TARGET Instant Payment Settlement (TIPS). Ndërkohë, paraprakisht, Guvernatori pati një takim mikpritës që iu rezervua nga Zëvendës-presidenti i BQE-së, i cili e falënderoi atë për bashkëpunimin e deritanishëm duke i ofruar mbështetjen e plotë të BQE-së në këtë projekt shumë të rëndësishëm, si në aspektin vendor ashtu edhe në procesin integruar të Kosovës.

Që nga dekretimi dhe marrja e detyrës, Guvernatori ka mirëpritur edhe shumë përfaqësues të korit diplomatik të akredituar në Kosovë, dhe shumë zyrtarë të institucioneve ndërkombëtare që veprojnë në Kosovë, derisa ato zhvillohen në pajtim me objektivin e planit strategjik.

8.2. Komunikimi dhe Edukimi Financiar

BQK gjatë vitit 2023 ka punuar në ngritjen e transparencës përmes informimit dhe edukimit të publikut rreth përgjegjësisë, detyrave e aktiviteteve të saj.

Gjatë vitit 2023, publiku është informuar përmes plasimit të informatave në të gjitha mënyrat e komunikimit përmes komunikatave, njoftimeve për media, publikimeve të materialeve informative e edukative në të gjitha kanalet e komunikimit të BQK-së, përfshirë web faqen zyrtare të BQK-së, intervistave të dhëna në medime nga Guvernatori apo të deleguarit e tij, pyetjeve dhe përgjigjeve të mediave, përmes emailit kontaktues të BQK-së info@bqk-kos.org, pjesëmarrjes në emisione dhe debate televizive, përfaqësimeve në radio, publikimeve të analizave e raporteve të BQK-së, konferencave për shtyp, web platformës së edukimit financiar, si dhe shpërndarjes së informatave, video mesazheve e infografikave në llogaritë e BQK-së në rrjetet sociale si LinkedIn, Facebook, X apo ish-Twitter, e YouTube.

Në fuksion të transparencës, BQK gjatë vitit 2023 shpërndau 2,059 publikime përmes të gjitha kanaleve të komunikimit zyrtar (shih Grafikonin 113).

Edukimi Financiar

Gjatë vitit 2023 janë realizuar aktivitete të vazhdueshme edukative e informuese që të kontribuohet në shpërndarjen e informatave ndërgjegjësuese mbi rëndësinë e vetëdijësimit rreth funksionimit të sistemit ekonomik e financiar. Përmes kampanjave e aktiviteteve janë shpërndarë informata, të dhëna, këshilla, mesazhe, e udhëzime në mënyrë që publiku të fitojë e rrisë njohuritë, informatat e shprehite të cilat do iu ndihmojnë në marrjen e vendimeve të matura e të drejta financiare rreth financave të tyre personale. Ndër aktivitetet më të rëndësishme që u shënuan gjatë këtij viti janë:

- Java Ndërkombëtare e Parasë 2023, u mbajt më 20 - 26 mars 2023, dhe disa nga aktivitetet që BQK i organizoi ishin:
 - Ligjëratë në BQK me nxënës të shkollës së mesme “Sami Frashëri”;
 - Aktivitet edukimi me nxënësit e komunitetit Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Organizatën “The Ideas Partnership” në Fushë Kosovë;
 - Aktivitet edukimi në Qendrën e Edukimit Financiar dhe Trajnimeve të BQK-së, me nxënës të komunitetit boshnjak nga shfmu “Svjetlost” – Manastiricë;
 - Aktivitet me nxënës të komunitetit boshnjak të shkollës së mesme ekonomike “Ymer Prizreni” në Prizren;
- 1 Qershori - Dita Ndërkombëtare e Fëmijëve, u shënuar me aktivitet edukativ me nxënësit e klasave të I-ra dhe të II-ta në shfmu “Emin Duraku” në Prishtinë;
- 31 Tetori, Dita Botërore e Kursimeve – Ligjëratë edukative në BQK me nxënësit e shm “Xhevdet Doda” në Prishtinë;
- Çmimi për Ekonomist të Ri - aktivitet të cilin BQK e organizon çdo vit me qëllim të nxitjes dhe motivimit të studentëve dhe promovimit të hulumtimeve përmes përgatitjes së punimeve rreth temave ekonomike e financiare aktuale dhe me interes. Këtë vit u përzgjodhën tri punime fituese dhe tre studentë u shpërblyer me çmimin Ekonomist i Ri.


Gjatë vitit 2023 u organizuan dy gara/konkurse për nxënës të shkollave të mesme, të cilët u ftuan të aplikojnë me punimet e tyre (Ese) me temat “Kursej me mençuri – Investoj në të ardhmen time” dhe “Planifikoni paratë tuaja, mbillni të ardhmen tuaj”.

Nga këto konkurse janë shpërblyer 17 punime/nxënës të shkollave të mesme nga komuna të ndryshme të Kosovës.

Gjatë këtij viti poashtu janë realizuar aktivitete me nxënës të shkollave fillore dhe të mesme, përfshirë edhe nxënës të shkollave nëpër komuna e fshatra të ndryshme, dhe me nxënës të komuniteteve joshumicë dhe me nxënës të komuniteteve joshumicë, si: Prishtinë, Prizren, Fushë Kosovë, Kamenicë, Ferizaj, etj.

Në funksion të informimit dhe ngritjes së njohurive për tema të ndryshme edukative e financiare, gjatë këtij viti janë përgatitur 11 materiale edukative e informuese për publikun, të cilat janë publikuar dhe shpërndarë gjatë aktiviteteve në formë të fletushkave e broshurave dhe përmes të gjitha kanaleve të komunikimit zyrtar të BQK-së, përfshi llogaritë e BQK-së në rrjetet sociale.

Grafik 113. Numri i publikimeve të BQK-së përmes kanaleve të komunikimit zyrtar, viti 2023



8.3. Asistenca teknike

Gjatë vitit 2023, BQK ka vazhduar të përfitojë në kuadër të programeve të asistencës së donatorëve nga Dukata e Madhe e Luksemburgut dhe Mbretëria e Norvegjisë që po mbështetin përpjekjet e Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe institucioneve të Kosovës për të përmbushur kërkesat e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (MSA) ndërmjet BE-së dhe Republikës së Kosovës. Ky projekt do të zgjasë deri në Prill të vitit 2024.

Në vazhdimësi të projektit KOS-18/0005, gjatë vitit 2023, BQK ka vazhduar koordinimin me projektin për Asistencë Teknike me UNOPS “Njohuritë për Veprimet Reformuese në Ballkanin Perëndimor”, financuar nga Ministria e Punëve të Jashtme Norvegjeze. Objektivi kryesor i projektit është t’u ofrojë asistencë teknike shteteve të BP në shkëmbimin e ekspertizës dhe njohurive me qëllim promovimin e reformave të integritit evropian. Shteteve të BP do t’u ofrohet ekspertizë në harmonizimin e kornizës legislative, strategjike, dhe dokumenteve tjera relevante të politikave me qëllim përafrimin me standardet dhe acquis të BE-së.

Në kuadër të bashkëpunimit ndër-institucional, në pajtim me Memorandumin e Mirëkuptimit me Bankën e Turqisë, janë mbajtur videokonferenca në të cilat janë shkëmbyer informacione rreth proceseve si: pagesat e menjëhershme; mbikëqyrja e institucioneve të pagesave, institucionet e parasë elektronike, ruajtja e fondeve të institucioneve të pagesave, dhe qasja në sistemet e pagesave ndërbankare për ofruesit e shërbimeve të pagesave jobankare. Për më shumë, në bashkëpunim me Bankën e Turqisë është mbajtur edhe videokonferenca me titull: “Operacionet me Para të Gatshme në Bankën Qendrore - Praktika e Trajtimit të Kartëmonedhave dhe Monedhave”.

Gjatë vitit 2023, BQK-ja vazhdoi të marrë pjesë si institucion përfitues në Fazën II të Programit për Forcimin e Kapaciteteve të Bankave Qendrore në Ballkanin Perëndimor me Synim të Integritit në Sistemin Evropian të Bankave Qendrore (SEBQ). Faza II e këtij programi, që u lancua në shtator 2022, gjatë vitit 2023 përfshiu zhvillimin e 8 trajnimeve dhe 1 punëtorie politikash të nivelit të lartë, në të cilat BQK-ja mori pjesë bashkë me institucionet e tjera përfituese dhe të cilat trajtuan fusha dhe tema me interes për bankat qendrore të regjionit. Po ashtu, gjatë vitit 2023 u zhvilluan edhe 5 masa bilaterale të bashkëpunimit me banka qendrore individuale të SEBQ-së, në të cilat u trajtuan aspekte të vecanta të funksioneve të bankës qendrore nga perspektiva e BQK-së. Ky program është i financuar nga BE-ja dhe zbatohet nga BQE dhe 20 banka qendrore të SEBQ, duke përfshirë edhe bankën qendrore të Gjermanisë, e cila e koordinon dhe administron atë.

Gjithashtu, BQK gjatë këtij viti ka qenë përfituese e një numri të madh të asistencave teknike të ofruara nga FMN, Banka Botërore dhe institucionet tjera ndërkombëtare në fushën e stabilitetit financiar, mbikëqyrjes bankare dhe të sigurimeve, statistikave, si dhe disa fusha tjera të operacioneve të bankës qendrore, si pagesat, operacionet me para të gatshme, menaxhimi i mjeteve etj.

8.4. Integritet Evropiane

Me qëllim të realizimit të perspektivës së vendit për anëtarësim në BE, BQK edhe këtë vit, ka vazhduar t’i përmbushë obligimet e saj në kuadër të procesit të integritit evropian. Monitorimi i zhvillimeve kryesore legislative dhe praktikave mbikëqyrëse, respektivisht, harmonizimi i legjislacionit të BQK-së me acquis të BE-së, si dhe zhvillimet e fundit makroekonomike janë raportuar në vazhdimësi përmes dokumenteve të rregullta raportuese. si dhe përmes takimeve me palët vendore dhe ndërkombëtare të përfshira në procesin e integritit evropian në Kosovë.

Gjatë këtij viti BQK ka bashkëpunuar me institucionet relevante duke ofruar mbështetje të vazhdueshme në avancimin e procesit të integritit evropian në Republikën e Kosovës, si

bashkëpunimi me Zyrën e Kryeministrit të Kosovës (ZKM), e cila është koordinatore kryesore e procesit të integritit evropian në Republikën e Kosovës, bashkëpunimi me ministri dhe institucione të tjera që veprojnë në Kosovë, si: Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Ministria e Financave, Punës, dhe Transfereve, Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë, dhe Tregtisë, si dhe Zyra e BE-së në Prishtinë. BQK gjatë vitit 2023 ka vazhduar angazhimin për zbatimin e konkluzioneve të BE-së.

Gjatë vitit 2023, BQK ka raportuar në kuadër të Programit për Reforma në Ekonomi (PRE), lidhur me konkluzionet që kanë derivuar nga dialogu ekonomik dhe financiar mes BE-së dhe BP-së e Turqisë. Gjithashtu, BQK ka bërë përgatitjet e nevojshme për t'iu raportuar strukturave të përbashkëta në kuadër të MSA-së, respektivisht Nën-Komitetit për Tregun e Brendshëm, Konkurrencën, Mbrojtjen e Konsumatorit, dhe Shëndetin Publik, si dhe Nën-Komitetit për Ekonomi, Çështje Financiare, dhe Statistika.

Përveç strukturave të lartcekura me Komisionin Evropian dhe BQE-në, BQK ka raportuar në baza të rregullta edhe në kuadër të Planit Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (PKZMSA). Në këtë kontekst, BQK-ja ka raportuar për kapitujt përbërës të PKZMSA-së që kanë për qëllim zbatimin e reformave që kërkohen me MSA. Kapitujt për të cilët BQK ka raportuar janë: kapitulli i shërbimeve financiare dhe kapitulli i lëvizjes së lirë të kapitalit. Në kuadër të MSA-së, rrjedhin detyrimet për BQK-në në fushën e shërbimeve financiare që lidhen me përgjegjësitë tjera si më poshtë:

- të drejtën e vendosjes dhe lirinë e ofrimit të shërbimeve bankare;
- lirinë e ofrimit të shërbimeve të sigurimeve dhe shërbimeve tjera në fushën financiare; dhe
- përafrimin dhe zbatimin e kuadrit ligjor dhe rregullator me legjislacionin e BE-së, dhe statutin e BQE-së dhe Sistemin Evropian të Bankave Qendrore.

Kërkesat tjera nga lëvizja e lirë e kapitalit përfshijnë:

- Legjislacioni i BE-së që përmban rregullat për pagesa ndërkufitare dhe ekzekutimin e urdhrave të transferimit në lidhje me letrat me vlerë;
- Detyrimet që rrjedhin në lidhje me çdo pagesë apo transfer në llogarinë rrjedhëse të bilancit të pagesave/kapitalit ndërmjet BE-së dhe Kosovës; dhe
- Lëvizjen e lirë të kapitalit lidhur me transaksionet tregtare ndërmjet Kosovës dhe BE-së.

Në fushën e bankave dhe konglomerateve financiare, për BQK-në rrjedhin detyrime si në vijim:

- Autorizimi, funksionimi dhe mbikëqyrja e kujdesshme e institucioneve kredituese, kërkesat në lidhje me llogaritjen e kapitalit të institucioneve kredituese dhe firmave investuese dhe standardet ndërkombëtare Bazel III.

Në fushën e sigurimeve dhe pensioneve të punës, për BQK-në rrjedhin këto detyrime:

- Direktivat evropiane që përcaktojnë rregulla lidhur me autorizimin, funksionimin dhe mbikëqyrjen e sigurimit të jetës dhe të jojetës, si dhe risigurimin e ndërmarrjeve.

Në fushën e tregut të letrave me vlerë dhe shërbimeve rreth investimeve për BQK-në ka këto detyrime:

- Direktiva 2004/39/KE mbi tregjet e instrumenteve financiare (MiFID).

Në kuadër të procesit të integritit evropian, BQK ka kryer raportime të rregullta lidhur me zhvillimet kryesore nga fushat e sipërpërmendura. Kapitujt të tjerë në të cilët BQK në vazhdimësi ka kontribuar janë: kapitulli i të drejtës së themelimit të kompanive dhe lirisë së ofrimit të shërbimeve, kapitulli i politikave ekonomike dhe monetare, kapitulli i statistikave, kapitulli i

lirisë, sigurisë, dhe drejtësisë (Neni 89: Pastrimi i Parave dhe Financimi i Terrorizmit), si dhe kapitullin e kontrollit financiar.

Në fund vitit 2023 është përgatitur drafti i konsoliduar i PKZMSA-së, në të cilin BQK ka bërë një përmbledhje të legjislacionit primar dhe akteve sekondare të cilat pritet të aprovohen gjatë vitit 2024. Drafti i PKZMSA-së për vitin 2024 përmban legjislacion që synon transpozimin e direktivave evropiane. Gjithashtu, propozimet legjislative në PKZMSA derivojnë nga kërkesat e raporteve dhe takimeve zyrtare me anëtarët e Komisionit Evropian (KE), siç janë: Raporti për vendin, takimet zyrtare me delegacionet e nivelit të lartë me anëtarë të KE (në kuadër të PRE-së), takimet në kuadër të strukturave të përbashkëta në kuadër të MSA-së, etj.

Gjatë këtij viti, BQK është koordinuar me akterët tjerë vendor lidhur me planin e veprimit të Tregut të Përbashkët Rajonal. Fushat për të cilat raporton BQK në kuadër të këtij plani të veprimit janë shërbimet financiare (me theks krijimi i tregjeve të kapitalit), dhe zhvillimin e një sistemi modern të pagesave. Me kërkesë të ZKM-së dhe në bashkëpunim me departamentet relevante, janë identifikuar veprimet që BQK duhet të ndërmarrë në funksion të ngritjes së bashkëpunimit rajonal.

BQK është e përkushtuar në adresimin e të gjeturave nga Raporti për Vendin (ish Raporti i Progresit), që si rezultat ka pasur një numër të konsiderueshëm të të gjeturave të Raportit të KE-së të vitit 2023, të cilat janë adresuar për t'u realizuar gjatë vitit 2024.

Gjithashtu, edhe të gjeturat e Raportit për Vendin (publikuar me 08 nëntor 2023), përveç disa rekomandimeve që janë identifikuar, Raporti në fjalë ka vlerësuar kontributin e BQK-së në drejtim të konsolidimit të stabilitetit makroekonomik, ruajtjes së stabilitetit financiar, përmirësimit të praktikave mbikëqyrëse dhe të përmirësimit të sistemit të pagesave në Republikën e Kosovës. BQK mbetet e angazhuar dhe e përkushtuar në realizimin e reformave prioritare strukturore me objektiv të arritjes së standardeve të kërkuara nga BE.

9. Pasqyrat Financiare

Kjo faqe është lënë qëllimisht e zbrazët



Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
Pasqyrat Financiare
më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023
me Raportin e Auditorit të Pavarur

Përmbajtja	Faqe
Raporti i Auditorit të Pavarur	1-2
Pasqyra e gjendjes financiare	3
Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave tjera gjithpërfshirëse	4
Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet	5
Pasqyra e rrjedhjes së parasë	6
Shënime për pasqyrat financiare	7 - 56

Raporti i Auditorit të Pavarur

Grant Thornton LLC
Rexhep Mala 18
10000 Pristina
Kosovo
T +383 (0)38 247 801
F +383 (0)38 247 802
E Contact@ks.gt.com
VAT No. 330086000

Për Bordin e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës ("BQK"), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2023, pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet dhe pasqyrën e rrjedhës së parasë për vitin e përfunduar, si dhe shënimet për pasqyrat financiare, duke përfshirë informacionin për politikatat materiale të kontabilitetit.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare shoqëruese paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të BQK-së më 31 dhjetor 2023, si dhe performancën e saj financiare dhe rrjedhën e parasë për vitin e përfunduar, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF-të).

Baza për Opinion

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë të përshkruara në mënyrë më të detajuar në paragrafin e raportit tonë Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare. Ne jemi të pavarur nga BQK-ja në pajtim me Kodin e Etikës për Profesionistët Kontabël të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Profesionistët Kontabël (Kodi i BSNEPK), së bashku me kërkesat etike që janë të rëndësishme për auditimin tonë të pasqyrave financiare në Kosovë, dhe ne poashtu kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë që evidenca e auditimit që ne kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të atyre të ngarkuar me qeverisjen për pasqyrat financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe prezentimin e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të, dhe për ato kontrole të brendshme, që konsiderohen të nevojshme nga menaxhmenti për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare pa anomali materiale të shkaktuara nga mashtrimi apo gabimi.

Gjatë përgatitjes së pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e BQK-së për të vazhduar se përmbushuri parimin e vijimësisë, duke shpalosur, nëse është e zbatueshme, çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë e biznesit dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë, përveç kur menaxhmenti ka për qëllim të likuidojë BQK-në ose të ndërpresë aktivitetet, ose nuk ka ndonjë mundësi tjetër përveç se të veprojë në këtë mënyrë.

Personat që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikqyrjen e procesit të raportimit financiar të BQK-së.

Përgjegjësia e Auditorit për auditimin e pasqyrave financiare

Qëllimet tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin që pasqyrat financiare në terësi nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë si pasojë e mashtrimeve ashtu edhe e gabimeve, dhe lëshimin e një raporti auditimi i cili përmban opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk është garancion i asaj që një auditim i kryer në përputhje me SNA-të, do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomali mund të lindin si rezultat i mashtrimeve ose gabimeve dhe konsiderohen materiale nëse individualisht, ose të bashkuara, mund të pritët në mënyrë të arsyeshme që të ndikojnë në vendimet ekonomike të shfrytëzuesve të pasqyrave financiare, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykim profesional dhe ruajmë skepticizëm profesional gjatë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë riskun e anomalive materiale të pasqyrave financiare, si pasojë nga mashtrimet apo edhe si pasojë e gabimeve, dizajnojmë dhe kryejmë procedura të auditimit të cilat i përgjigjen këtyre risqeve dhe marrim evidencë të auditimit të cilat janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Risku i mos-zbulimit të një anomalie materiale e cila rrjedhë nga mashtrimi është më i madh sesa i atij që rrjedhë nga gabimi, pasi që mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, lëshime të qëllimshme, keqinterpretime, ose shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm, që është relevante me auditimin në mënyrë që të dizajnojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme me rrethanat, mirëpo jo me qëllim për dhënien e një opinionimi mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të BQK-së.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël si dhe shpalosjet e bëra nga menaxhmenti.
- Nxjerrim përfundime në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës së hipotezës së vijimësisë së kontabilitetit, duke u bazuar në evidencat e auditimit, nëse një pasiguri materiale ekziston në lidhje me ngjarjet ose kushtet që mund të shkaktojnë dyshim të lartë që BQK-ja mund të vazhdojë operimin. Nëse ne vijmë në përfundim se një pasiguri materiale ekziston, ne jemi të detyruar të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit në shpalosjet e pasqyrave financiare ose nëse shpalosjet e tilla janë jo të përshtatshme, të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona janë të bazuara në evidencat tona të auditimit të siguruar deri në datën e raportit tonë. Sidoqoftë, ngjarjet ose kushtet e ardhshme mund të shkaktojnë që BQK-ja të ndërpresë së pëmbushuri parimin e vijimësisë.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare duke përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare të prezentojnë transaksionet dhe ngjarjet në to në një mënyrë që arrin paraqitjen e drejtë.

Ne komunikojmë me ata që janë të ngarkuar me qeverisjen e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, përpos të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollet e brendshme që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

Grant Thornton LLC
Prishtinë,

22 maj 2024


Suzana Stavri,
Auditor ligjor




Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Pasqyra e pozicionit financiar

Më 31 dhjetor 2023

Në mijë Euro	Shënim	2023	2022
Pasuritë			
Paraja e gatshme	7	101,932	409,426
Llogaritë rrjedhëse me bankat e huaja	8	426,077	206,359
Letra me vlerë (Bono thesari dhe Obligacione qeveritare)	9	717,814	666,597
Plasmanet në tregun e parasë	10	205,252	99,950
Mjetet e ndërlidhura me FMN	11	178,261	185,467
Prona dhe pajisjet	12	4,276	4,199
Pasuritë e paprekshme	13	896	1,042
Pasuritë tjera	14	2,476	2,709
Gjithsej pasuritë		1,636,984	1,575,749
Detyrimet			
Detyrime ndaj bankave komerciale në vend	15	590,622	594,281
Detyrime ndaj llogarive të ndërlidhura me FMN-në	16	184,217	188,640
Detyrime ndaj institucioneve qeveritare	17	511,903	585,784
Detyrime ndaj institucioneve publike dhe komerciale	18	240,202	131,137
Huamarrja/et	19	1,662	1,938
Detyrime të tjera	20	9,222	2,444
Gjithsej detyrimet		1,537,828	1,504,224
Kapitali dhe rezervat			
Kapitali i autorizuar	21	30,000	30,000
Fondi i rezervave	21a	39,507	31,444
Rezerva nga rivlerësimi	21a, 29	2,018	1,529
Fitimet e mbajtura		27,631	8,552
Gjithsej kapitali dhe rezervat		99,156	71,525
Gjithsej detyrimet, kapitali dhe rezervat		1,636,984	1,575,749

Këto pasqyra financiare janë miratuar nga organet vendimmarrëse¹ të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës më **03 maj 2024** dhe është nënshkruar në emër të tyre nga:



Ahmet Ismaili

Guvernator



Faton Ahmetaj

Drejtor,
Departamenti i Financave

Shënimet shoqëruese nga 1 deri 33 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare

¹ Sipas nenit 34 dhe 59 të Ligjit Nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave tjera gjithpërfshirëse
Më 31 dhjetor 2023

<i>Në mijë Euro</i>	Shënim	2023	2022
Të ardhurat nga interesi			
Të ardhurat nga interesi		34,526	8,574
Shpenzimet nga interesi		(9,350)	(2,668)
Të ardhurat neto nga interesi	22	25,176	5,906
Të ardhurat nga tarifatat dhe ndalesat			
Të ardhurat nga tarifatat dhe ndalesat		4,140	3,760
Shpenzimet nga tarifatat dhe ndalesat		(1,274)	(924)
Të ardhurat neto nga tarifatat dhe ndalesat	23	2,866	2,836
Të ardhurat nga aktiviteti rregullativ dhe të ardhurat tjera operative			
Të ardhurat nga aktiviteti rregullativ	24	7,849	6,954
Të ardhurat nga grantet	20, 25	81	67
Të ardhurat tjera operative	26	19	13
Fitimi / (humbja) nga kursi i këmbimit	29	(182)	542
Të hyrat operative		35,809	16,318
Shpenzimet administrative (operative)			
Shpenzimet personelit	27	(5,588)	(5,127)
Zhvlerësimi dhe amortizimi	12,13	(840)	(829)
Shpenzimet e përgjithshme dhe administrative	28	(1,697)	(1,757)
Shpenzimet administrative (operative)		(8,125)	(7,713)
		27,684	8,605
Rezultati financiar para pritjeve për fitimet / humbjet kreditore			
Provizioni për humbjet e pritura kreditore neto rritja/(zvogëlimi)	4	(53)	(53)
Fitimi / (Humbja) vjetore		27,631	8,552
Të ardhurat e tjera gjithpërfshirëse			
		-	-
Gjithsej të ardhurat gjithpërfshirëse për vitin		27,631	8,552

Shënimet shoqëruese nga 1 deri 33 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023

	Kapitali	Fondi rezervë	Rezervat e rivlerësimit	Fitimet e mbajtura	Gjithsej
<i>Në mijë Euro</i>					
Gjendja më 1 janar 2022	30,000	26,857	-	6,116	62,973
Transferimi në fondin rezervë	-	4,587	1,529	(6,116)	-
Gjithsej transaksionet e kërkuara me ligj	-	4,587	1,529	(6,116)	-
Fitimi per vitin	-	-	-	8,552	8,552
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-	-	-
Gjithsejt të ardhurat gjithëpërfshirëse për vitin	-	-	-	8,552	8,552
Gjendja më 31 dhjetor 2022	30,000	31,444	1,529	8,552	71,525
Gjendja më 1 janar 2023	30,000	31,444	1,529	8,552	71,525
Transferimi në fondin rezervë	-	8,063	489	(8,552)	-
Gjithsej transaksionet e kërkuara me ligj	-	8,063	489	(8,552)	-
Fitimi per vitin	-	-	-	27,631	27,631
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-	-	-
Gjithsejt të ardhurat gjithëpërfshirëse për vitin	-	-	-	27,631	27,631
Gjendja më 31 dhjetor 2023	30,000	39,507	2,018	27,631	99,156

Shënimet shoqëruese nga 1 deri 33 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Pasqyra e rrjedhjes së parasë

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023

<i>Në mijë Euro</i>	Shënim	2023	2022
Rrjedhja parave nga aktivitetet operacionale			
Fitimi vjetor		27,631	8,552
Rregullime për:			
Zhvlerësimin	12	555	508
Amortizimin	13	286	321
Të ardhurat nga grantet	25	(81)	(67)
Provizionet për humbjet e pritshme kreditore	4	53	53
Fitimi / humbja neto nga këmbimi valutor	29	182	(542)
Të ardhurat nga interesi	22	(34,526)	(8,574)
Shpenzimet nga interesi	22	9,350	2,668
		3,450	2,919
Ndryshime në bono thesari dhe obligacione qeveritare		(51,881)	(32,633)
Ndryshime në plasmanët në tregun e parasë		75,105	(74,984)
Ndryshime në pasuritë e ndërlidhura me FMN-në		131,205	12,507
Ndryshime në pasuritë tjera		240	(520)
Ndryshime në detyrimet ndaj bankave komerciale		(3,659)	5,182
Ndryshime në detyrimet ndaj llogarive të ndërlidhura me FMN-në		(128,345)	(11,439)
Ndryshime në detyrimet ndaj institucioneve qeveritare		(73,880)	(22,578)
Ndryshime në detyrimet ndaj institucioneve publike dhe komerciale		109,064	53,745
Ndryshime në detyrimet e tjera		6,814	85
		68,112	(67,716)
Interesa të marra		33,718	6,250
Interesa të paguara		(9,259)	(1,612)
Paraja neto e gjeneruar nga/(përdorur në) aktivitetet operacionale		92,571	(63,078)
Rrjedhja e parave nga aktivitetet investuese			
Blerja e pajisjeve	12	(632)	(147)
Blerja e aseteve të paprekshme	13	(139)	(22)
Paraja neto e përdorur në aktivitetet investuese		(771)	(169)
Rrjedhja e parave nga aktivitetet financuese			
Arkëtimet/(Ripagesat) nga/për huamarrjet	19	(224)	(230)
Arkëtimet nga grantet	20	45	8
Paraja neto e gjeneruar nga aktivitetet financuese		(179)	(222)
Rritja/(zbritja) neto në para dhe ekuivalentet e saj		91,621	(63,469)
Efkti i kursit të këmbimit (në para dhe ekuivalentet e saj)		(189)	304
Paraja dhe ekuivalentët e saj më 1 janar		640,624	703,789
Paraja dhe ekuivalentët e saj më 31 dhjetor	30	732,056	640,624

Shënimet shoqëruese nga 1 deri 33 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Shënimet mbi Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023

(në mijë Euro, nëse nuk është theksuar ndryshe)

1. Informacione të përgjithshme

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (nga këtu e tutje "BQK" ose "Banka Qendrore"), pasardhëse e Autoritetit Qendror Bankar të Kosovës, është një subjekt i pavarur juridik me kompetenca të plota si një person juridik sipas ligjit të aplikueshëm në Republikën e Kosovës. BQK është një subjekt publik i veçantë i cili ka autoritetin për të licencuar, mbikëqyrur dhe rregulluar institucionet financiare në Republikën e Kosovës. Banka vepron në përputhje me Ligjin nr. 03/L-209 "Ligji mbi Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës" të cilit tash e tutje i referohemi si ("Ligji për BQK-në"). Sipas këtij ligji objektivat kryesore të BQK-së janë si vijon:

- të nxisë dhe të mbajë një sistem të qëndrueshëm financiar, duke përfshirë një sistem të sigurt, të shëndetshëm dhe efikas të pagesave.
- të kontribuojë në arritjen dhe mbajtjen e stabilitetit të brendshëm të çmimeve.
- të mbështes politikatat e përgjithshme ekonomike të Qeverisë.

Siç është përshkruar në ligj, BQK duhet të veprojë në përputhje me parimet e një tregu të hapur me një konkurrencë të lirë, duke favorizuar ndarjen efikase të resurseve.

BQK vepron nga zyrat e saj që gjenden në Prishtinë. Adresa e regjistruar e zyrës së BQK-së është si më poshtë:

Rr. Garibaldi nr. 33
Prishtinë, Kosovë.

Bordi i Bankës Qendrore, Bordi Ekzekutiv dhe Guvernatori (organet vendimmarrëse)

Organet vendimmarrëse të BQK-së janë Bordi i Bankës Qendrore, Bordi Ekzekutiv dhe Guvernatori. Sipas nenit 34, paragrafit 2, si dhe dispozitës së përkohshme të nenit 79, paragraf 2, të Ligjit për BQK-në, Bordi i Bankës Qendrore përbëhet nga **katër anëtar jo-ekzekutiv** dhe **Guvernatori** dhe është përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të politikave si dhe mbikëqyrjen e administrimit dhe operacioneve të BQK-së.

Më 31 dhjetor 2023, Bordi i Bankës Qendrore përbëhet nga këta anëtarë:

- Bashkim Nurboja – Kryetar i Bordit (anëtar jo-ekzekutiv)
- Ahmet Ismaili – Guvernator
- Nora Latifi Jashari – Anëtare (jo-ekzekutiv)
- Nexhat Kryeziu - Anëtar (jo-ekzekutiv)
- Arta Hoxha - Anëtar (jo-ekzekutiv)

Ndërsa, me 31 dhjetor 2022, Bordi i Bankës Qendrore përbëhej nga këta anëtarë:

- Flamur Mrasori – Kryetar i Bordit (anëtar jo-ekzekutiv)
- Fehmi Mehmeti – Guvernator
- Nora Latifi Jashari – Anëtare (jo-ekzekutiv)
- Bashkim Nurboja - Anëtar (jo-ekzekutiv)
- Nexhat Kryeziu - Anëtar (jo-ekzekutiv)

Nga data 05 shkurt 2023 Kryetar i Bordit është zgjedhur z. Bashkim Nurboja, pas skadimit të mandatit të z. Mrasori. Me datë 29 mars 2023 deri në muaj gusht 2023 Bordi i BQK-së bazuar në nenin 46-të të Ligjit për BQK-në ka marr kompetencat e Bordit Ekzekutiv sipas përkufizimeve të këtij neni. Në muaj gusht 2023, janë zgjedhë organet e reja të Bordit Ekzekutiv dhe anëtarët e Bordit të BQK-së janë ri-kthyer në emërimet përkatëse si anëtar Bordi të BQK-së. Nga muaji gusht 2023 konisderohet së BQK ka pasur funksionale të dy organet vendimmarrëse.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Shënimet mbi Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023

(në mijë Euro, nëse nuk është theksuar ndryshe)

1. Informacione të përgjithshme (vazhdim)

Përkufizimet e nenit 46-të të Ligjit për BQK-në:

“Neni 46 - Mungesa apo pamundësia relativisht afatgjatë për të vepruar e Bordit Ekzekutiv:

1. Në rast rrethanash të jashtëzakonshme dhe nëse të gjithë anëtarët e Bordit Ekzekutiv mungojnë apo nuk janë në gjendje të veprojnë, posti i Guvernatorit do të merret përkohësisht nga Kryetari i Bordit të Bankës Qendrore. Dy (2) anëtarët jo-ekzekutiv të Bordit të Bankës Qendrore që janë më së gjati në post të tillë si dhe në dispozicion do të marrin përkohësisht postet e Zëvendësguvernatorëve.

2. Në rast se mungesa ose paaftësia për të vepruar e të gjithë anëtarëve të Bordit Ekzekutiv vazhdon për një periudhë prej tre (3) muaj, duhet të krijohen vendet e lira dhe do të zbatohen procedurat për emërim sipas nenit 38 të këtij ligji.”

Bordi Ekzekutiv është përgjegjës për implementimin e politikave të BQK-së dhe të operacioneve të saj. Bordi Ekzekutiv me 31 dhjetor 2023 përbëhet nga Guvernatori, i cili është Kryesues dhe një Zëvendësguvernator (dy pozita te lira si zëvendësguvernator), ndërsa po ashtu me 31 dhjetor 2022 Bordi Ekzekutiv përbëhej nga Guvernatori dhe një u.d. Zëvendësguvernator.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Shënimet mbi Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023

(në mijë Euro, nëse nuk është theksuar ndryshe)

2. Baza e përgatitjes

a) Deklarata e përputhshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (“SNRF”).

b) Baza e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur duke përdorur bazat e matjes të specifikuar nga SNRF-ja për secilin lloj të pasurive, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Bazat e matjes janë shpalosur më në detaje në politikat kontabël në shënimin 3 më poshtë.

c) Valuta funksionale dhe e prezentimit

Këto pasqyra financiare prezantohen në Euro (“EUR”), e cila është valuta funksionale e BQK-së, përveç nëse është specifikuar ndryshe në ndonjë shënim analitik. Nëse nuk është shënuar ndryshe, informacioni financiar i prezantuar është rumbullakësuar në mijëshen më të afërt.

d) Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon nga menaxhmenti që të bëjë gjykime, vlerësime dhe supozime që ndikojnë në zbatimin e politikave dhe në shumat e raportuara të pasurive dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet faktike mund të ndryshojnë nga ato të vlerësuara.

Vlerësimet dhe supozimet shqyrtohen në bazë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet dhe në periudhat e ardhshme nëse ato ndikohen. Në veçanti, informatat në lidhje me fushat e rëndësishme të vlerësimit të pasigurisë dhe vendimeve të rëndësishme për zbatimin e politikave kontabël që kanë ndikimin më të konsiderueshëm në shumat e pranuar në pasqyrat financiare janë përkrahur më poshtë në shënimin 5.

Politikat kontabël të paraqitura më poshtë janë zbatuar në mënyrë të qëndrueshme në të gjitha periudhat e prezentuara në këto pasqyra financiare.

e) Rrethanat për performimin e operacioneve të Bankës Qendrore në 2023

Po ashtu viti 2023 është përballur me inflacion në pothuajse të gjitha ekonomitë kryesore në mbarë botën. Por jo aq e theksuar sa viti krahasues. Rritja e inflacionit është rezultat dhe gershetim i disa faktorëve, duke përfshirë masat stimuluese fiskale të marra në përgjigje të efekteve pas pandemisë COVID-19, efektet e luftës në Ukrainë, pastaj efekti nga çmimet e energjisë, dhe kërkesën e fortë të konsumatorëve për mallra dhe shërbime pas hapjes të kufijve dhe lehtësimin e kufizimeve të vendosura gjatë pandemisë dhe pas pandemisë. Si dhe duhet theksuar se inflacioni ka pasur ndikim jo aq të theksuar në aktivitete e BKQ-së në vitin 2023.

Ndërsa nga ana tjetër, pas një periudhe të gjatë me norma të ulëta interesi, normat e interesit janë rritur dukshëm në vitin 2023. Kjo mund të ndikojë në vlerën e aktiveve, detyrimeve dhe shpenzimeve neto të interesit dhe të shkaktojë humbje nga zhvlerësimi në vlerën e aktiveve financiare. Megjithatë, vlera e aseteve financiare të BQK-së nuk ndikohen drejtpërdrejt nga rritja e normave të interesit, përveç rasteve kur ato modifikohen. Ndërsa, ndikimin me të madh rritja e normave në valutën euro e ka pasur të hyrat dhe shpenzimet e interesit, por me efekt pozitiv, praktikisht me një rritje pozitive të zërit *neto të hyrat nga interesi*.

Një trajtim i veçantë i është kushtuar vlerësimit të situatës së re të krijuar në nivel global pas fillimit të luftës në Evropën Lindore (Ukrainë) dhe konfliktit në lindjen e mesme si dhe shtrëngimit të sanksioneve të vendeve perëndimore kundër Federatës Ruse (si SHBA, Britania e Madhe dhe Bashkimi Evropian, një iniciativë së cilës iu përgjigj edhe Kosova). Luftat në fjalë janë akoma aktive, sidoqoftë në periudhën raportues nuk ka pasur ndikim për tu theksuar në aktivitetin e BQK-së, sidoqoftë BQK përmes trupave të saj ka në monitorim të vazhdueshëm efektet potenciale të këtyre ngjarjeve dhe do jetë shumë vigjilente në këtë aspekt, të ndjekë ngjarjet dhe të përgatitet prapakisht për ato.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Shënimet mbi Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023

(në mijë Euro, nëse nuk është theksuar ndryshe)

3. Politikat e rëndësishme kontabël

a) Transaksionet në valutë të huaj

Transaksionet në valutë të huaj vlerësohen në valutën funksionale me kursin e këmbimit në datat e kryerjes së transaksioneve. Pasuritë dhe detyrimet monetare të shprehura në valutë të huaj rivlerësohen me kursin zyrtar të këmbimit të asaj date. Fitimi apo humbja nga valutat e huaja për zërat monetarë është diferenca ndërmjet kostove të amortizuara në valutën funksionale në fillim të periudhës, e rregulluar me interesin efektiv dhe pagesat gjatë periudhës, dhe kostove të amortizuara në monedhë të huaj të rivlerësuara me kursin e këmbimit në fund të periudhës. Pasuritë dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj që maten me vlerë të drejtë rivlerësohen në monedhë funksionale në kursin e këmbimit në datën kur është përcaktuar ajo vlerë e drejtë. Diferencat nga valutat e huaja që rrjedhin nga rivlerësimi njihen si fitim ose humbje.

b) Të hyrat dhe shpenzimet nga interesi

Të hyrat dhe shpenzimet nga interesi njihen si fitim apo humbje bazuar në metodën e interesit efektiv. Norma e interesit efektiv është norma që zbrit pagesat dhe arkëtimet e pritshme në të ardhmen gjatë jetëgjatësisë së pasurisë ose detyrimit financiar (ose kur është e përshtatshme, për një periudhë më të shkurtër) deri në vlerën kontabël të pasurisë ose detyrimit financiar. Norma e interesit efektiv përcaktohet në njohjen fillestare të pasurisë ose detyrimit financiar dhe nuk rishikohet më pas.

Llogaritja e normës së interesit efektiv përfshin të gjitha komisionet dhe shumat e paguara apo kostot e transaksioneve të pranuar dhe zbritjet apo primet që janë pjesë përbërëse e normës së interesit efektiv.

Kostot e transaksioneve përfshijnë kosto shtesë të ngarkueshme drejtpërdrejtë për blerjen, emetimin apo largimin e një pasurie apo detyrimi financiar. Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesi të paraqitura në humbje apo fitim përfshijnë interesat nga pasuritë ose detyrimet financiare me kosto të amortizuar mbi bazën e interesit efektiv.

c) Tarifa dhe komisione

Të hyrat dhe shpenzimet nga tarifat dhe komisionet të cilat janë pjesë përbërëse e normës së interesit efektiv për një mjet apo detyrim financiar, përfshihen në matjen e normës së interesit efektiv.

Të hyrat tjera nga komisionet dhe tarifat, përfshirë tarifat e transaksioneve për llogaritë operative, tarifat e transferimit të fondeve dhe të licencimit njihen në momentin e kryerjes së shërbimeve të lidhura me to. Shpenzime të tjera për komisione dhe tarifa lidhen kryesisht me tarifa transaksionesh dhe shërbimesh të cilat shpenzohen në momentin që shërbimet përfitohen.

d) Përfitimet e punonjësve

BQK aplikon kontributet për sigurimet shoqërore të detyrueshme, që përcaktohen si kontributet pensionale të punonjësve kur ata dalin në pension. Këto kontribute klasifikohen sipas planeve të kontributit të përcaktuara, bazuar në legjislacionin e Kosovës. Kontributet e BQK-së ngarkohen si shpenzim në të ardhura në momentin kur ato ndodhin.

Po ashtu BQK ndan përfitime të punonjësve në baza jubilarë dhe në formë të shumës së paracaktuar në momentin e pensionimit. BQK njih këto shpenzime sipas ndodhjes së këtyre ngjarjeve sipas planeve për përfitime afatgjata.

e) Tatimi dhe shpërndarja e fitimit

BQK-ja është e liruar nga tatimi mbi fitimin sipas Ligjit nr. 03/L-209 të miratuar më 22 korrik 2010. Shih shënimin 4 (f) se si BQK-ja alokon fitimin e saj.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Shënimet mbi Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023

(në mijë Euro, nëse nuk është theksuar ndryshe)

3. Politikat e rëndësishme kontabël (vazhdim)

f) Pasuritë dhe detyrimet financiare

Pasuritë financiare të BQK-së të përfshira në këto pasqyra financiare klasifikohen si instrumente financiare me kosto të amortizuar (modeli mbaj për të mbledhur) dhe përbëhen nga paraja dhe ekuivalentët e saj, letrat me vlerë, llogaritë e depozitave në bankat jorezidente, asetet e lidhura me FMN dhe pasuritë tjera.

Një pasuri financiare matet me koston e amortizuar nëse i plotëson të dyja kushtet e mëposhtme dhe nuk është përcaktuar si në VDFH (Vlera e drejtë përmes Humbjes së Fitimit):

- pasuria mbahet brenda një modeli biznesi, qëllimi i të cilit është të mbajë pasuritë për të mbledhur flukset monetare kontraktuale; dhe
- kushtet kontraktuale të pasurisë financiare lindin në data të specifikuar tek flukset e parave që janë vetëm pagesa të principalit dhe interesit (SPPI) mbi shumën e mbetur të papaguar.

BQK-ja klasifikon të gjitha detyrimet e saj financiare të matura me koston e amortizuar duke përdorur metodën efektive të normës së interesit. Të ardhurat nga interesi ose shpenzimet e interesit nga detyrimet financiare të matura me koston e amortizuar, njihen në fitim ose humbje.

Detyrimet financiare të matura me kosto të amortizuar përfshijnë detyrimet ndaj bankave vendase, institucioneve qeveritare, subjekteve publike dhe tregtare, për shkak të FMN-së, huazimeve dhe detyrimeve të tjera financiare.

i. Njohja

Në njohjen fillestare, një pasuri financiare klasifikohet si i matur në: koston e amortizuar (KA), vlerën e drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (VDAGJ) ose vlerës së drejtë përmes fitimit ose humbjes (VDFH).

Pasuria financiare apo detyrimi financiar fillimisht matet me vlerën e drejtë, të cilës i shtohen, për zë jo me vlerën e drejtë përmes fitimit apo humbjes, kostot e transaksionit që i atribuohen direkt blerjes apo emetimit të tyre.

Siç u përmend më lartë, BQK-ja ka në librat e saj vetëm instrumente financiare me kosto të amortizuar, të cilat plotësojnë kriteret e modelit të mbajtjes për të mbledhur flukset monetare kontraktuale.

ii. Riklasifikimi

Pasuritë financiare të bankës varësisht nga rrethanat respektivisht ndryshimi i modelit të saj të biznesit për administrimin e pasurive financiare mund të ri-klasifikoj këto të fundit edhe pas njohjes fillestare të tyre.

Në qoftë se banka ri-klasifikon një pasuri financiare apo grup të pasurive financiare nga kategoria e matjes me koston e amortizuar tek kategoria e matjes me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, vlera e drejtë e tyre do të matet në datën e ri-klasifikimit. Çdo fitim ose humbje neto që rrjedh nga një diferencë midis koston së amortizuar dhe vlerës së drejtë të aktivitetit financiar njihet në fitim ose humbje.

iii. Ç'regjistrimi

BQK-ja ç'regjiston një pasuri financiare kur skadojnë të drejtat kontraktuale për rrjedhat e parave nga pasuria financiare, ose transferon të drejtat për të marrë rrjedhat e parasë kontraktuale në një transaksion në të cilin në thelb janë transferuar të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë së pasurisë financiare ose në të cilat BQK as nuk transferon dhe as mban në masë të madhe të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë dhe nuk mban kontrollin e asetit financiar.

Për ç'regjistrimin e një pasurie financiare, diferencën midis vlerës kontabël të pasurisë (ose vlerës së mbartur të alokuar për pjesën e pasurisë së ç'regjistruar) dhe shumës së (i) vlerësimit të marrë (përfshirë çdo pasuri të re të marrë më pak çdo detyrim të ri supozuar) dhe (ii) çdo fitim ose humbje kumulative që ishte njohur në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse ('OCI') njihet në fitim ose humbje. Çdo interes në pasuritë financiare të transferuara që kualifikohen për ç'regjistrim që është krijuar ose mbajtur nga BQK-ja njihet si pasuri ose detyrim i veçantë.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Shënimet mbi Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023

(në mijë Euro, nëse nuk është theksuar ndryshe)

3. Politikat e rëndësishme kontabël (në vazhdim)

f) Pasuritë dhe detyrimet financiare (në vazhdim)

BQK-ja hyn në transaksione me të cilat transferon asete të njohura në pasqyrën e pozicionit financiar, por mban në thelb të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pasurive të transferuara ose një pjesë të tyre. Në raste të tilla, pasuritë e transferuara nuk ç'regjistrohen. Shembuj të transaksioneve të tilla janë kreditimi i letrave me vlerë dhe transaksionet e shitjes dhe të riblerjes.

Në transaksionet në të cilat BQK as nuk mban dhe as transferon në thelb të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë së një pasurie financiare dhe ai mban kontrollin mbi pasurinë, BQK vazhdon të njohë pasurinë në masën e përfshirjes së tij të vazhdueshme, të përcaktuar në masën tek e cila është e ekspozuar ndaj ndryshimeve në vlerën e pasurisë së transferuar.

BQK-ja ç'regjistron një detyrim financiar kur detyrimet e saj kontraktuale përfundohen ose anulohen, ose skadojnë.

iv. *Ndryshimet në pasuritë dhe detyrimeve financiare*

Nëse kushtet e një pasurie financiare janë modifikuar, BQK vlerëson nëse flukset monetare të pasurisë së modifikuar janë thelbësisht të ndryshme. Nëse flukset e parave janë në thelb të ndryshme, atëherë të drejtat kontraktuale për flukset e parave nga pasuria financiare origjinale konsiderohen të kenë skaduar. Në këtë rast, pasuria fillestare financiare ç'regjistrohet (shiko (iii)) dhe një pasuri e re financiare njihet me vlerën e drejtë.

Nëse flukset e parave të pasurisë së modifikuar të mbartura me kosto të amortizuar nuk janë thelbësisht të ndryshme, atëherë modifikimi nuk rezulton në ç'regjistrim të pasurisë financiare. Në këtë rast, BQK-ja rillogarit vlerën kontabël bruto të pasurisë financiare dhe njeh shumën që lind nga rregullimi i vlerës kontabël bruto si fitim ose humbje e modifikimit në pasqyrën e fitimit ose humbjes. Nëse një modifikim i tillë kryhet për shkak të vështirësive financiare të huamarrësit, atëherë fitimi ose humbja paraqitet së bashku me humbjet nga zhvlerësimi. Në raste të tjera, ai paraqitet si të ardhura nga interesi.

BQK-ja ç'regjistron një detyrim financiar kur kushtet e saj modifikohen dhe flukset e parave të detyrimit të modifikuar janë thelbësisht të ndryshme. Në këtë rast, një detyrim i ri financiar bazuar në kushtet e modifikuara njihet me vlerën e drejtë. Diferenca midis vlerës kontabël të detyrimit financiar të shuar dhe detyrimit të ri financiar me termat e modifikuar njihet në fitim ose humbje. Nëse modifikimi i një detyrimi financiar nuk llogaritet si ç'regjistrim, atëherë kostoja e amortizuar e detyrimit rillogaritet duke zbritur flukset e modifikuara të parasë me normën fillestare të interesit efektiv dhe fitimi ose humbja që rezulton njihet në fitim ose humbje.

v. *Netimi*

Mjetet dhe detyrimet financiare netohen me njëra-tjetrën dhe shuma neto paraqitet në pasqyrën e gjendjes financiare atëherë dhe vetëm atëherë kur BQK-ja ka të drejtën ligjore për të netuar këto shuma dhe ka si qëllim ose t'i shlyejë në një bazë neto ose të realizojë pasurinë dhe të shlyejë detyrimin njëkohësisht.

Të ardhurat dhe shpenzimet paraqiten në bazë neto vetëm atëherë kur lejohet nga standardet kontabël, ose për fitimet dhe humbjet e krijuara nga një grup transaksionesh të ngjashme.

vi. *Matja e kostos së amortizuar*

Kostoja e amortizuar e një mjeti ose detyrimi financiar është vlera me të cilën mjeti ose detyrimi financiar matet në momentin e njohjes fillestare, duke i zbritur pagesat e principalit, plus ose minus amortizimin e akumuluar duke përdorur metodën e interesit efektiv të çdo difference ndërmjet vlerës fillestare të njohur dhe vlerës në maturim, minus çdo zbritje për efekt zhvlerësimi.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Shënimet mbi Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023

(në mijë Euro, nëse nuk është theksuar ndryshe)

3. Politikat e rëndësishme kontabël (në vazhdim)

f) Pasuritë dhe detyrimet financiare (në vazhdim)

vii. Matja e vlerës së drejtë

Vlera e drejtë (reale) është çmimi që do të arkëtohej nga shitja e një pasurie apo që do të paguhej për të transferuar një detyrim në një transaksion të rregullt mes pjesëmarrësve të tregut në datën e matjes.

Kur është e disponueshme, BQK-ja mat vlerën e drejtë të një instrumenti duke përdorur çmimet e kuotuar në një treg aktiv për atë instrument. Një treg konsiderohet si aktiv, nëse çmimet e kuotuar janë të disponueshme në mënyrë të shpejtë dhe të rregullt dhe përfaqësojnë transaksionet që ndodhin aktualisht dhe rregullisht në treg në bazë të vullnetshme midis palëve.

Nëse tregu për instrumentin financiar nuk është aktiv, BQK vendos vlerën e drejtë duke përdorur një teknikë vlerësimi. Teknikat e vlerësimit përfshijnë përdorimin e transaksioneve më të fundit midis palëve të mirë informuara dhe në formë të vullnetshme, (nëse janë të disponueshme), referimin në vlerën e drejtë aktuale të instrumenteve tjera që në thelb janë të njëjta, analizat e zbritjes së rrjedhave të parasë dhe modelet e vlerësimit të çmimit. Teknika vlerësuese e zgjedhur, përdor maksimalisht të dhënat e tregut, mbështetet sa më pak të jetë e mundur në vlerësimet specifike të BQK-së, përfshin të gjithë faktorët që pjesëmarrësit në treg do t'i merrnin parasysh në vendosjen e çmimit dhe janë në përputhje me metodologjitë e pranuar ekonomike për vendosjen e çmimit të instrumenteve financiare. Të dhënat për teknikat vlerësuese paraqesin në mënyrë të arsyeshme pritjet e tregut dhe masat e faktorëve të rrezikut që ekzistojnë në instrumentin financiar. BQK-ja kalibron teknikat vlerësuese dhe i teston ato për vlefshmërinë duke shfrytëzuar çmimet nga transaksionet aktuale të dallueshme të tregut në të njëjtin instrument apo në bazë të të dhënave tjera të dallueshme dhe të disponueshme në treg.

viii. Lejimet e humbjeve

BQK njeh lejimet e humbjeve për humbjet e pritura kreditore "HPK" për pasuritë financiare që maten sipas kostos së amortizuar. BQK-ja vlerëson lejimet e humbjes në një shumë të barabartë me HPK përgjatë jetëgjatësisë së instrumentit, përveç rasteve të mëposhtme për të cilat ato maten si HPK 12-mujore:

- letrat me vlerë të investimeve të borxhit që përcaktohen të kenë rrezik të ulët kredie në datën e raportimit; dhe
- instrumente të tjera financiare për të cilat rreziku i kredisë nuk është rritur ndjeshëm që nga njohja fillestare.

BQK-ja e konsideron një letër me vlerë të borxhit me rrezik të ulët krediti kur vlerësimi i rrezikut të kredisë është ekuivalent me përkufizimin e kuptuar globalisht "shkallë e investimit". ECL 12-mujore janë pjesa e ECL që rezulton nga ngjarjet e mospagimit të një instrumenti financiar që janë të mundshme brenda 12 muajve pas datës së raportimit. Instrumentet financiare për të cilat njihet një ECL 12-mujore referohen si instrumente financiare të Fazës 1.

HPK përgjatë jetëgjatësisë së instrumentit financiar janë HPK që vijnë nga të gjitha ngjarjet e mundshme të paracaktuar gjatë jetës së pritshme të instrumentit financiar. Instrumentet financiare për të cilat njihet një HPK gjatë gjithë jetëgjatësisë, por që nuk janë të efektuar (dëmtuara) nga humbjet kreditore, klasifikohen të "Faza 2 - Nënperformuese e instrumenteve financiare".

Matja e HPK-së

Modeli i zhvlerësimit të HPK-së është një matje e bazuar në probabilitet dhe përfshin ndikimin e rezultateve të ndryshme të mundshme. Operacionalisht, kjo mund të jetë e vështirë për t'u zbatuar dhe zgjedhja e skenarëve përkatës ekonomik mund të jetë sfiduese.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Shënimet mbi Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023

(në mijë Euro, nëse nuk është theksuar ndryshe)

3. Politikat e rëndësishme kontabël (në vazhdim)

f) Pasuritë dhe detyrimet financiare (në vazhdim)

Për implemetimin e hollësishëm të HPK-së BQK-ja përdorë metodën e thjeshtë që shfrytëzon mundësinë e parashikimit të qasjes së humbjes e cila është:

Humbjet e pritura kreditore (HPK) = Vlera a ekspozuar (VE) x Humbja e mundshme e pritur (HP) x Probabiliteti i humbjes së mundshme të pritur (PHP).

VE – Vlera e ekspozuar, është vlera kontabël bruto e pasurive financiare që bien në model për t'u rivlerësuar.

HP - Humbja e pritshme në rast të mospagimit, është pritshmëria se nga vlera e ekspozuar mund të mos kthehet nëse ndodh humbja. BQK-ja është bazuar në gjykimin e brendshëm dhe, gjithashtu është mbështetur në disa qasje ndaj rrezikut sipas përcaktimeve të Bazelit për vlerësimin e huamarrësve që dështojnë të mbyllin obligimet.

PHP - Probabiliteti i humbjes së mundshme së pritur, është variabla më e ndjeshme dhe paraqet gjasën e mos pagesës nga pala e tjetër për një periudhë të observuar (12 mujore apo gjate gjithë jetës së instrumentit).

Modeli humbjeve të pritura (HPK) është një vlerësim i ponderuar i humbjeve kreditore dhe vlerësohen si më poshtë:

- pasuritë financiare që nuk janë të provizionuara në datën e raportimit: si vlera aktuale e të gjitha pritjeve me pak të parasë së gatshme (d.m.th. ndryshimi midis rrjedhës së parave të gatshme ndaj BQK-së, në përputhje me kontratën dhe rrjedha e parave që BQK-ja pret të marrë);
- pasuritë financiare që janë vlerësuar sipas humbjeve kreditore të pritura në datën e raportimit: si ndryshim midis vlerës së tyre bruto dhe pritjes së humbjes kreditore për të njëjtat.

g) Paraja dhe ekuivalentët e saj

Për qëllimin e pasqyrës së rrjedhës së parasë, paraja dhe ekuivalentët e saj përfshijnë kartëmonedhat e gatshme, depozita me bankat dhe pasuri financiare shumë likuide me maturitet origjinal për më pak se tre muaj, të cilat janë objekt i një rreziku jo-domethënës të ndryshimeve në vlerën e tyre të drejtë dhe përdoren nga BQK-ja në menaxhimin e detyrimeve afatshkurtra.

Paraja dhe ekuivalentët e saj mbahen në pasqyrën e gjendjes financiare me kosto të amortizuar.

h) Letrat me vlerë të investimeve

Letrat me vlerë të investimeve, të përbëra nga bonot e thesarit dhe obligacionet, fillimisht maten me vlerën e drejtë plus shtesat për kostot e transaksionit direkt dhe më pas maten sipas kostos së amortizuar (mbajtja e pasurive me qëllim arkëtimin e flukseve monetare kontraktuale) duke përdorur metodën efektive të normës së interesit. Të gjitha blerjet dhe shitjet e letrave me vlerë të investimeve njihen në datën e shlyerjes, d.m.th. data kur pasuria është marrë, ose dorëzuar tek pala tjetër.

Kostoja e amortizuar/ mbajtja e pasurive me qëllim arkëtimin e flukseve monetare kontraktuale janë investime në pasuri jo derivative me pagesa fikse ose të përcaktueshme dhe maturim fiks që BQK ka qëllimet pozitive dhe aftësinë për të mbajtur deri në maturim, dhe të cilat nuk janë të caktuara në vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes.

i) Depozitat dhe huamarrjet

Depozitat dhe huazimet fillimisht maten me vlerën e drejtë minus kostot e transaksionit direkt shtesë, dhe më pas maten me koston e tyre të amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

j) Pasuritë dhe detyrimet e lidhura me FMN-në

Zërat e llogarive me FMN-në zakonisht paraqitet në zërat e Bankës Qendrore të anëtarit. Mjetet dhe detyrimet e lidhura me FMN-në fillimisht maten me vlerën e drejtë dhe më pas maten me koston e tyre të amortizuar. Fitimet dhe humbjet nga rivlerësimi i kursit të këmbimit që lindin nga rivlerësimi i mjeteve dhe detyrimeve të FMN-së njihen në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Shënimet mbi Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023

(në mijë Euro, nëse nuk është theksuar ndryshe)

3. Politikat e rëndësishme kontabël (në vazhdim)

j) Pasuritë dhe detyrimet e lidhura me FMN-në (vazhdim)

Gjate vitit 2023 BQK ka ndryshuar modelin e paraqitjes së zërave të llogarive me FMN-në. BQK-ja ka kaluar nga metoda bruto në mentoden neto dhe si rrjedhojë kerkesat ndaj qeverise dhe detyrimet përkatëse që nderlidhen me llogarinë e notave premtuese² janë hequr nga zërat e bilancit, që nënkupton llogaria notave premtuese (detyrimi) dhe kerksat përkatëse (pasuritë) të saj janë zeruar dhe praktikisht zërat e llogarive me FMN parqiten në metoden neto (të prezentuara në zërat jashtëbilancor). Dallimi qendon në faktin se tani këto vlera të notave premtuese përsëri ne do ti mbajmë por vetëm si zëra jashtë bilancorë (këto ndryshime janë të paraqitura në shenimet 11 dhe 16). Ndryshimi i kësaj politike kontabël paraqitet si me poshtë:

Pasuritë/llogaritë e ndërlidhura me FMN (shenimi 11)

	Kuota me FMN	DVT/SDR Holding	Interesi Akruar	Total_1	Fondet e huazauara nga FMN	Total_2
Saldo fillestare sipas 31 dhjetor 2022	103,491	159,169	1,158	263,818	51,745	315,563
Rregullimi sipas metodës neto	(78,351)	-	-	(78,351)	(51,745)	(130,096)
Saldo e rregulluar 2022 (riparaqitur)	25,140	159,169	1,158	185,467	-	185,467
Saldo sipas 31 dhjetor 2023	24,430	152,619	1,212	178,261	-	178,261

Detyrimet/llogaritë e ndërlidhura me FMN (shenimi 16)

	Llogaria me FMN-në Nr. 1	Llogaria me FMN-në Nr. 2	Llogaria me FMN-në e sigurimit	Shpërndarja DVT/SDR	Interesi Akruar	Total_1	FMN – pjesa e kuotës e paguar nga Qeveria	Total_2
Saldo fillestare 2022	265	6	129,831	168,563	1,201	299,866	18,870	318,736
Rregullimi sipas metodës neto	(265)	-	(129,831)	-	-	(130,096)	-	(130,096)
Saldo e rregulluar 2022(riparaqitur)	-	6	-	168,563	1,201	169,770	18,870	188,640
Saldo 2023	-	6	-	163,802	1,291	165,099	19,118	184,217

² Jane instrumente financiar që qeveria e kosoves ka leshura si zotim mbi detyrimet e ardhshme ndaj FMN-së.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Shënimet mbi Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023

(në mijë Euro, nëse nuk është theksuar ndryshe)

3. Politikat e rëndësishme kontabël (në vazhdim)

j) Pasuritë dhe detyrimet e lidhura me FMN-në (vazhdim)

Ndryshimet në gjithsej pasuri dhe detyrime

	2022 saldo fillestare	Riklasifikimi në zërat jashhtëbilancor	2022 saldo e riparaqitur
Pasuritë			
Paraja e gatshme	409,426	-	409,426
Llogaritë rrjedhëse me bankat e huaja	206,359	-	206,359
Letra me vlerë (Bono thesari dhe Obligacione qeveritare)	666,597	-	666,597
Plasmanet në tregun e parasë	99,950	-	99,950
Mjetet e ndërlydhura me FMN	315,563	(130,096)	185,467
Prona dhe pajisjet	4,199	-	4,199
Pasuritë e paprekshme	1,042	-	1,042
Pasuritë tjera	2,709	-	2,709
Gjithsej pasuritë	1,705,845	(130,096)	1,575,749
Detyrimet			
Detyrime ndaj bankave komerciale në vend	594,281		594,281
Detyrime ndaj llogarive të ndërlydhura me FMN-në	318,736	(130,096)	188,640
Detyrime ndaj institucioneve qeveritare	585,784		585,784
Detyrime ndaj institucioneve publike dhe komerciale	131,137		131,137
Huamarrja/et	1,938		1,938
Detyrime të tjera	2,444		2,444
Gjithsej detyrimet	1,634,320	(130,096)	1,504,224

k) Prona dhe pajisjet

i. Njohja dhe matja

Zërat e pronës dhe pajisjeve paraqiten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga ndryshimi në vlerë.

Kosto përfshin shpenzime që janë drejtpërdrejt të lidhura me blerjen e mjetit. Kosto e mjeteve të ndërlydhura nga vet BQK-ja përfshin koston e materialeve dhe të fuqisë punëtore të drejtpërdrejt, kosto të tjera që lidhen drejtpërdrejt me sjelljen e mjetit në gjendjen funksionale që ai të jetë i përdorshëm në mënyrën e synuar, dhe kostot e çmontimit dhe lëvizjes së pajisjeve dhe restaurimin e ambientit ku ato janë vendosur.

Programet kompjuterike të blera që janë thelbësore (pjesë përbërëse) për funksionimin e pajisjes përkatëse kapitalizohen si pjesë e asaj pajisjeje.

Kur pjesë të një elementi të pronës dhe pajisjeve kanë jetëgjatësinë e dobishme të ndryshme, ato kontabilizohen si elemente të veçanta (komponentë kryesor) të pronës dhe pajisjes.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Shënimet mbi Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023

(në mijë Euro, nëse nuk është theksuar ndryshe)

3. Politikat e rëndësishme kontabël (në vazhdim)

k) Prona dhe pajisjet

ii. Kosto pasuese

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një elementi të pronës ose pajisjeve njihet në vlerën e mbartur të elementit nëse është e mundur që përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i atij mjeti të rrjedhin në BQK, dhe kostoja e tij mund të matet me besueshmëri. Kostot e servisimit të përditshëm të pronës dhe pajisjes (pasurive afatgjata materiale) njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve në momentin kur ndodhin.

iii. Zhvlerësimi

Zhvlerësimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën lineare përgjatë jetëgjatësisë të secilës pjesë të një elementi të pasurive afatgjata materiale.

Vlerësimi i jetëgjatësisë për periudhën aktuale dhe krahasuese është si më poshtë:

	2023	2022
Investimet në objekte me qira	20 vite	20 vite
Pajisje	5 vite	5 vite
Kompjuterë	3 vite	3 vite
Automjete	5 vite	5 vite

Jetëgjatësia e pajisjeve tjera vlerësohet rast pas rasti. Metoda e zhvlerësimit, jetëgjatësia dhe vlera e mbetur rivlerësohen në datën e raportimit.

l) Asetet e paprekshme

Programet kompjuterike të blera nga BQK-ja njihen me koston historike të zvogëluar për zhvlerësimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga ndryshimi në vlerë, nëse ka.

Shpenzimet e mëvonshme për programet kompjuterike kapitalizohen vetëm kur këto shpenzime rrisin përfitimin e ardhshëm ekonomik prej këtij aseti. Të gjitha shpenzimet e tjera njihen në periudhën që ndodhin.

Shpenzimi i amortizimit njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, bazuar mbi metodën lineare të amortizimit gjatë jetës së dobishme ekonomike të programit kompjuterik, prej datës në të cilën ky program është i gatshëm për përdorim. Jeta e dobishme ekonomike e programeve kompjuterike bazohet në vlerësimin për shfrytëzimin e atij programi pa qenë nevoja për ndonjë përmirësim të madh, aktualisht nga 3 deri në 10 vite.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Shënimet mbi Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023

(në mijë Euro, nëse nuk është theksuar ndryshe)

3. Politikat e rëndësishme kontabël (në vazhdim)

m) Rënia në vlerë e pasurive jo-financiare

Vlera kontabël e pasurive jo-financiare të BQK-së, rishikohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka evidenca për ndryshim në vlerë. Nëse ka evidenca të tilla atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e pasurisë.

Humbje nga rënia në vlerë njihet nëse vlera kontabël e një aseti/pasurie ose e njësisë gjeneruese të parasë tejkalon vlerën e rikuperueshme. Njësia gjeneruese e mjeteve monetare është grupi me i vogël i identifikueshëm i asetëve që gjeneron rrjedhë të parasë që janë të pavarura nga mjetet dhe grupet e tjera. Humbjet nga rënia në vlerë njihen në pasqyrën e të ardhurave. Humbjet nga rënia në vlerë e njësive gjeneruese të parasë shpërmdahen në mënyrë proporcionale midis asetëve të tjera të njësisë (grupi të njësive) në baza proporcionale. Vlera e rikuperueshme e një pasurie ose e njësisë gjeneruese të parasë është më e madhja ndërmjet vlerës së tij në përdorim dhe vlerës së drejtë minus kostot e shitjes. Në vlerësimin e vlerës në përdorim, rrjedhjet e ardhshme të vlerësuara të mjeteve monetare zbriten në vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë zbritjeje para taksave që reflekton vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe risqet specifike për pasurinë. Humbjet nga rënia në vlerë të njohura në periudhat e mëparshme vlerësohen në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse rënia në vlerë është zbutur ose nuk ekziston më.

Një humbje nga rënia në vlerë anulohet nëse ka pasur ndryshim në vlerësimet e përdorura për përcaktimin e vlerës së rikuperueshme. Humbja nga rënia në vlerë anulohet deri në atë masë sa vlera kontabël e pasurisë nuk tejkalon vlerën kontabël që do të përcaktohej duke i zbritur amortizimin dhe zhvlerësimin, dhe sikur të mos ishte njohur ndonjë humbje nga rënia në vlerë.

n) Detyrimet financiare

Burimet e financimit të BQK-së janë depozitat nga institucionet ndërkombëtare, qeveritare, publike, bankare dhe institucione të tjera financiare. Detyrimet financiare maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e normës së interesit efektiv.

o) Të ardhurat nga grantet

Grantet qeveritare njihen fillimisht si të ardhura të shtyra kur ekziston një siguri e arsyeshme se ato do të merren dhe se BQK-ja do t'i përmbahet kushteve lidhur me grantin. Grantet që BQK-ja përfiton për shpenzime njihen si fitim ose humbje në baza sistematike në të njëjtat periudha në të cilat njihen shpenzimet. Grantet që BQK-ja përfiton për koston e një aseti njihen në fitim ose humbje në baza sistematike përgjatë jetës së përdorimit të asetit.

p) Pagat e financuara nga donatorët

Individë të caktuar të angazhuar në BQK janë ekspertë ndërkombëtar të caktuar dhe financiar për një afat të shkurtër nga organizatat ndërkombëtare. Financimi nga këto organizata ndërkombëtare ndër të tjera përfshin, por nuk kufizohet në pagesën e pagave të këtyre ekspertëve ndërkombëtar. Duke qenë se kjo ndihmë i paguhet personave të caktuar drejtpërdrejt nga organizatat ndërkombëtare, nivelet e pagesës nuk janë të njohura dhe as nuk janë të përfshira në këto pasqyrat financiare.

q) Provizionet

Provizioni njihet nëse, si rezultat i ngjarjeve që kanë ndodhur në të kaluarën, BQK-ja ka detyrime aktuale ligjore ose konstruktive që mund të vlerësohen në mënyrë të besueshme, dhe është e mundshme që një dalje e parave apo të mirave ekonomike do të kërkohej për të shlyer detyrimin. Provizionet përcaktohen duke e zbritur rrjedhjen e ardhshme të parasë me një normë para tatimit e cila reflekton vlerësimin aktual të tregut për vlerën kohore të parasë dhe kur është e përshtatshme, rreziqet specifike për detyrimet.

Provizioni për kontrata të ngarkuara njihet kur përfitimet e pritura për t'u nxjerrë nga BQK-ja nga kontrata janë më të vogla se kostoja e pashmangshme e realizimit të detyrimeve sipas kontratës. Provizioni matet në vlerën aktuale me më të voglën midis koston së pritshme të ndërprerjes së kontratës dhe koston së pritshme neto të vazhdimin të kontratës. Përpara se të njihet një provizion, BQK njih çdo humbje nga rënia në vlerë e asetit të lidhur me atë kontratë.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Shënimet mbi Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023

(në mijë Euro, nëse nuk është theksuar ndryshe)

3. Politikat e rëndësishme kontabël (në vazhdim)

r) Ndryshimet në politikat dhe shpalosjet kontabël

(i) Standardet dhe interpretimet efektive për periudhën aktuale

Ndryshimet e mëposhtme të standardeve ekzistuese të publikuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit që kanë hyrë në fuqi për periudhën raportuese:

- **SNRF 17 "Kontratat e Sigurimeve"** (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2023),
- **Ndryshimet në SNK 1 "Prezentimi i Pasqyrave Financiare" dhe Formulimi praktik SNRF 2 "Gjykimi i materialitetit"**- Shpalosja e politikave kontabël (efektive për periudhat që fillojnë më ose pas 1 janarit 2023),
- **Ndryshimet në SNK 8 "Politikat Kontabël, Ndryshimet në Vlerësimet Kontabël dhe Gabimet"** - Përkufizimi i vlerësimeve kontabël (efektive për periudhat që fillojnë më ose pas 1 janarit 2023),

Aplikimi i këtyre standardeve, ndryshimeve dhe interpretimeve nuk ka pasur ndonjë ndikim të material në pasqyrat financiare të Bankës Qendrore në periudhën raportuese.

(ii) Standardet dhe interpretimet nuk kanë datë efektive në periudhën e raportimit

Sikurse në datën e autorizimit të këtyre pasqyrave financiare, standardet e mëposhtme, rishikimet dhe interpretimet janë botuar nga BSNK, por ende nuk janë efektive për periudhën e raportimit dhe si të tilla nuk janë aplikuar akoma nga Banka Qendrore:

- **Ndryshimet në SNK 1 "Prezantimi i Pasqyrave Financiare"** - Klasifikimi i detyrimeve si detyrime afat-shkurtra ose detyrime afat-gjata (efektive për periudhat që fillojnë më ose pas 1 janarit 2024),
- **Ndryshimet në SNK 1 "Prezantimi i Pasqyrave Financiare"** – Detyrimet afatgjata me marrëveshje (efektive për periudhat që fillojnë më ose pas 1 janarit 2024),
- **Ndryshimet në SNRF 16 "Qiratë"** – Detyrimi i qirasë në një shitje dhe marrje sërish me qira (efektive për periudhat që fillojnë më ose pas 1 janarit 2024),
- **Ndryshime në SNK 7 dhe SNRF 7 "Pasqyra e fluksit të mjeteve monetare" dhe "Shpalosjet për instrumentet financiare: Dhënia e informacioneve shpjeguese"** – Ndryshimet në lidhje me rritjen e dhënies së informacioneve shpjeguese kërkesat për të rritur transparencën e marrëveshjeve financiare të furnizuesve dhe efektet e tyre në detyrimet e një njësie ekonomike, flukset monetare dhe ekspozimin ndaj rrezikut të likuiditetit (efektive për periudhat e raportimit vjetor që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2024);

Banka Qendrore ka zgjedhur të mos aplikoj këto standarde, rishikime dhe interpretime përpara datës së tyre efektive. Banka Qendrore parashikon që aplikimi i këtyre standardeve, rishikimet dhe interpretimet nuk do të ketë një ndikim të rëndësishëm në pasqyrat financiare të Bankës Qendrore.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Shënimet mbi Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023

(në mijë Euro, nëse nuk është theksuar ndryshe)

4. Menaxhimi i rrezikut financiar

a) Hyrje dhe vështrim

BQK është ekspozuar ndaj rreziqeve të mëposhtme nga zhvillimi i aktiviteteve të saj dhe po ashtu edhe nga përdorimi i instrumenteve financiare:

- Rreziku kreditor
- Rreziku operacional
- Rreziku i likuiditetit
- Rreziku i tregut

Ky shënim paraqet informacion lidhur me ekspozimin e BQK-së ndaj rreziqeve të mësipërme, objektivave, politikave dhe procedurave të BQK-së për matjen dhe menaxhimin e rrezikut si dhe administrimi aktiviteteve dhe po ashtu edhe të kapitalit nga BQK-ja. Shënime të tjera sasiore dhe cilësore janë përfshirë përgjatë këtyre pasqyrave financiare.

Struktura e menaxhimit të rrezikut

Mbikëqyrja e administrimit e aktiviteteve të BQK-së (përfshirë edhe menaxhimin e rrezikut) është përgjegjësi e Bordit të Bankës Qendrore. Bordi Ekzekutiv ka përgjegjësinë t'i identifikojë dhe t'i vlerësojë rreziqet dhe të hartojë plane, që në rast të papriturash në të ardhmen, të sigurohen vazhdimësia e veprimtarive dhe siguria e Bankës Qendrore. Menaxhmenti i BQK-së raporton rregullisht (në baza tremujore) nëpërmjet Departamentit për Menaxhimin e Rrezikut dhe Bordit Ekzekutiv të BQK-së tek Bordi i BQK-së mbi praktikën e administrimit dhe të menaxhimit të rrezikut. Bordi Ekzekutiv, Komiteti i Investimeve dhe Departamenti për Menaxhimin e Rrezikut e kanë për detyrë në kordinim me njësitë organizative të bëjnë hartimin dhe monitorimin e politikave të administrimit dhe të menaxhimit të rrezikut të BQK-së. Këto politika zbatohen më pas nga njësitë përkatëse organizative.

Politikat e administrimit dhe të menaxhimit të rrezikut të BQK-së janë krijuar për të identifikuar dhe analizuar rreziqet me të cilat përballet BQK-ja, si dhe të vendos kufizime dhe kontroll të duhur për rreziqe, dhe të monitoroj rreziqet dhe respektimin e limiteve të vendosura. Politikat dhe sistemet e menaxhimit të rrezikut rishikohen rregullisht në mënyrë që të reflektojnë ndryshimet në kushtet, produktet dhe shërbimet e ofruara të tregut. BQK-ja, me anë të trajnimeve, standardeve dhe procedurave të administrimit, synon të zhvilloj një mjedis kontrolli efektiv dhe të disiplinuar, në të cilin të gjithë punonjësit të jenë të vetëdijshëm për rolet dhe detyrimet e tyre.

Komiteti i Auditimit të BQK-së po ashtu është përgjegjës për monitorimin dhe rishikimin e pajtueshmërisë me politikën dhe procedurat e administrimit të rrezikut, si dhe për rishikimin e mjaftueshmërisë së strukturës së administrimit të rrezikut lidhur me rreziqet që përballet BQK-ja. Komiteti i Auditimit të BQK-së ndihmohet në kryerjen e detyrave të tij nga Departamenti i Auditimit të Brendshëm. Auditimi i Brendshëm ndërmerr auditime të kontrolleve dhe të procedurave të administrimit të rrezikut në mënyrë të rregullt dhe të rastësishme (ad-hoc), rezultatet e të cilave raportohen përmes Shefit të Auditimit të Brendshëm tek Komiteti i Auditimit, pastaj te Bordi i BQK-së.

b) Rreziku kreditor

Rreziku kreditor është rreziku i humbjes financiare për BQK-në nëse një palë kontraktuese e instrumenteve financiare dështon t'i përmbush detyrimet kontraktuale të saj, dhe mund të rrjedh kryesisht nga investimet e BQK-së në letra me vlerë dhe depozita (në tregjet e parasë apo llogari rrjedhëse) në banka të tjera. BQK për qëllime të raportimit të menaxhimit të rrezikut të kredisë, BQK-ja konsideron dhe konsolidon të gjithë elementët e ekspozimit të rrezikut të kredisë (siç është rreziku i vonësës së detyrimeve individuale, rreziku i vendit dhe sektorit).

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Shënimet mbi Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023

(në mijë Euro, nëse nuk është theksuar ndryshe)

4. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

b) Rreziku kreditor (vazhdim)

Menaxhimi i rrezikut kreditor

i. Investimet dhe ekspozimi ndaj rrezikut kreditor në BQK

BQK-ja e kufizon ekspozimin e saj ndaj rrezikut të kreditimit duke investuar vetëm në letra të lëshuara nga qeveritë e vendeve të BE-së dhe duke pasur depozita pranë bankave të huaja, detyrimet afatshkurtra të cilave i janë vlerësuar në një nga dy kategoritë më të larta nga agjencitë ndërkombëtare të njohura për vlerësimin e rrezikut të kreditimit. Duke pasur parasysh vlerësimet e larta kreditorë, menaxhmenti nuk pret që ndonjë nga palët kontraktuese të dështojë në përmbushjen e detyrimeve të veta.

Menaxhimi i rrezikut bëhet përmes:

- Kufizimit të fushëveprimit dhe kohëzgjatjes së instrumenteve financiare,
- Kufizimit të emetuesve të palëve, me vlerësim të pranueshëm kredie për klasën e investimit dhe me lartë,
- Kufizimit të shumës dhe përqendrimit maksimal me palët.

ii. Ekspozimi ndaj rrezikut kreditor

Ekspozimi ndaj rrezikut kreditor më 31 dhjetor 2023 dhe 31 dhjetor 2022, paraqitet nga vlera e bartur e llogarive rrjedhëse me bankat e huaja, letrave me vlerë (Bono të thesarit dhe Obligacione) dhe depozitave me bankat (përfshirë ato rezidente dhe jo rezidente). Për detaje mbi ekspozimin referohuni edhe te shënimet 8, 9 dhe 10.

Vlerësimi kreditor për instrumentet financiare që BQK ka ekspozim për periudhën që përfundon me 31 dhjetor 2023 është prej AAA deri BBB-/ Aaa deri Baa3/AAA deri BBB-.

Tabela në vijim paraqet vlerat bartëse të ekspozimit ndaj rrezikut kreditor të ndara sipas rangimit kreditor dhe të shprehura edhe pjesmarrja në përqindje me gjithsej.

Shpërndarja sipas llojit dhe vlerësimit kreditor

31 dhjetor 2023						
Rangimi kreditor (S&P/Moody's/Fitch)	Llogaritë rrjedhëse me bankat e huaja	Plasmanet në tregun e parasë	Letra me vlerë (Bono thesari dhe Obligacione qeveritare)	Llogaritë e ndërlidhura me FMN (DVT dhe shfrytëzimi i fondeve)	Gjithsej vlera bartëse	% e peshës me gjithsej
AAA/Aaa/AAA	387,109	180,216	143,867	-	711,192	46.59%
AA+/Aa1/AA+	-	-	129,489	-	129,489	8.48%
AA/Aa2/AA	-	-	-	-	-	0.00%
AA-/Aa3/AA-	-	-	190,575	-	190,575	12.48%
A+/A1/A+	6,023	-	-	-	6,023	0.39%
A/A2/A	21,178	-	15,658	-	36,836	2.41%
A-/A3/A-	10,534	25,064	200,755	-	236,353	15.48%
BBB-/Baa3/BBB-	-	-	37,836	-	37,836	2.48%
N/A (pa vlerësim - IFN)	-	-	-	178,261	178,261	11.68%
Gjithsej	424,844	205,280	718,180	178,261	1,526,565	100.00%

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Shënimet mbi Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023

(në mijë Euro, nëse nuk është theksuar ndryshe)

4. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

b) Rreziku kreditor (vazhdim)

Shprendarja sipas llojin dhe vlerësimit kreditor

31 dhejtor 2022						
Rangimi kreditor (S&P/Moody's/Fitch)	Llogaritë rrjedhëse me bankat e huaja	Plasmanet në tregun e parasë	Letra me vlerë (Bono thesari dhe Obligacione qeveritare)	Llogaritë e ndërlidhura me FMN (DVT dhe shfrytëzimi i fondeve)	Gjithsej vlera bartëse	% e peshës me gjithsej
AAA/Aaa/AAA	205,718	54,956	168,864	-	429,538	37.07%
AA+/Aa1/AA+	-	-	61,222	-	61,222	5.28%
AA/Aa2/AA	-	-	59,988	-	59,988	5.18%
AA-/Aa3/AA-	-	-	51,308	-	51,308	4.43%
A+/A1/A+	138	-	52,379	-	52,517	4.53%
A/A2/A	330	-	15,810	-	16,140	1.39%
A-/A3/A-	214	45,050	218,415	-	263,679	22.75%
BBB-/Baa3/BBB-	-	-	38,973	-	38,973	3.36%
N/A (pa vlerësim - IFN)	-	-	-	185,467	185,467	16.00%
Gjithsej	206,400	100,006	666,959	185,467	1,158,832	100.00%

Asnjë nga ekspozimet e BQK-së nuk është në vonesë. BQK-ja nuk mban asnjë kolateral apo ndonjë element tjetër avancues kreditor kundrejt ekspozimit ndaj rrezikut të kreditor.

Kriteret themelore të përcaktimit të ekspozimit janë vlerësimi kreditor. Vlerësimi kreditor merret nga agjensitë për vlerësim kreditor. Klasifikimi kreditor minimal i lejuar për investim në afat të shkurtër është P-2 (Moody's) ose A-2 (Standard & Poor's), ndërsa në afat të gjatë është Baa2 (Moody's) ose BBB (Standard & Poor's).

Ne rastet e jashtëzakonshme në pamundësi të realizimit të kthimeve pozitive, lejohet ekspozim i investimeve përmes klasifikimit afatshkurtër kreditor të emetuesit P-3 (Moody's) apo A-3 (Standard & Poor's) dhe klasifikimit afatgjatë kreditor të emetuesit Baa3 (Moody's) apo BBB-(Standard & Poor's).

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Shënimet mbi Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023

(në mijë Euro, nëse nuk është theksuar ndryshe)

4. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

b) Rreziku kreditor (vazhdim)

Modeli i dëmtimit të pasurive financiare në bazë të karakteristikave të përbashkëta të rrezikut kreditor respektivisht ndryshimeve në rrezik kreditor që nga njohja fillestare e pasurive financiare përcakton tre faza në modelin e vlerësimit të humbjeve të pritshme kreditore. Këto faza mund të përmbliidhen si më poshtë:

1. Faza 1 (Performuese) e shpërndarjes së ekspozimit - pasuritë financiare të cilat trajtohen si ekspozim me rrezik të ulët ose të mesëm përfshihen në këtë fazë në njohjen fillestare. Bazuar në procedurat e brendshme të BQK-së, nuk lejohet të investohet në ekspozime me rrezik të lartë kreditor. Bazuar në këtë, çdo investim në njohjen fillestare alokohet në Fazë 1 të ekspozimit.
2. Faza 2 (Nën-performuese) e shpërndarjes së ekspozimit - nëse kemi një rritje të konsiderueshme të rrezikut kreditor që nga njohja fillestare, pasuria financiare e cila ndodhet në fazën 1, transferohet në fazën 2.
3. Faza 3 (Jo-performuese) e shpërndarjes së ekspozimit - transferimi në fazën 3 bëhet vetëm atëherë kur ka evidenca objektive që klienti do të dështon në përmbushje të obligimeve.

Vlerësimi bëhet në njohjen fillestare dhe në datën e periudhës së raportimit. Modeli i përdorur për fazën 1 të shpërndarjes është baza 12 mujore e jetëgjatësisë, por mund të varet nga niveli i përbërë i ekspozimit kreditor nëse BQK ka ndryshime të rëndësishme në rritjen e rrezikut kreditor dhe në portofolin e provizionut të pasurive financiare.

Ndryshimi i ndjeshëm në rritjen e rrezikut të kredisë si kriter për të kaluar nga faza 1 në fazën 2, kur ai kalon nga klasa e investimit në klasën jo-investuese të shkallës së rankimit kreditor të përberjessë një portofoli.

Definicioni i dështimit:

Kriteret e dështimit duhet të bazohen në provat objektive të:

- Debitorëve, me vështirësi të konsiderueshme financiare,
- Kur është fjala për shkelje të detyrimeve kontraktuale, në lidhje me kryegjënë dhe interesin,
- Kur të ndodhë ndonjë ristrukturim të kushteve ekzistuese të përmbushjeve të detyrimit nga një instrument financiar,
- Dëshmi/probabilitet i qartë që debitori po kalon në falimentim dhe/ose likuidim,
- Shenjat e të qenit jo aktiv në tregtim (në tregjet financiare).

Në tabelën në vijim paraqiten vlerat e ekspozimit në nivel të fazave. Në datën e raportimit nuk kemi ndonjë ndryshim material në rrezik kreditor që nga njohja fillestare prandaj të gjitha pasuritë financiare janë në fazën 1.

	2023 ³			2022		
	Faza 1	Faza 2	Faza 3	Faza 1	Faza 2	Faza 3
Llogaritë rrjedhëse me bankat e huaja	424,844	-	-	206,400	-	-
Letrat me vlerë (Bono thesari dhe Obligacione qeveritare)	718,180	-	-	666,959	-	-
Plasmanët në tregun e parasë	205,280	-	-	100,006	-	-
Vlera bartëse bruto	1,348,304	-	-	973,365	-	-
Humbjet e pritura kreditore (HPK)	(512)	-	-	(459)	-	-
Neto vlera bartëse	1,347,792	-	-	972,906	-	-

³ Në vitin raportues (2023) dhe as në vitin krahasues nuk janë të përfshira instrumentet financiare për llogaritë e ndërlidhura me FMN (IMF), pasi vlerësimi/pritshmëria është se ky grup nuk është ekspozim që mbart në vete lejime për humbje të pritura kreditore (HPK).

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Shënimet mbi Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023

(në mijë Euro, nëse nuk është theksuar ndryshe)

4. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

b) Rreziku kreditor (vazhdim)

Lëvizjet e HPK përkatëse për pasuritë financiare ku BQK ka ekspozim janë si më poshtë:

	2023			
	Faza 1	Faza 2	Faza 3	Gjithsej
HPK me 1 janar 2023	459	-	-	459
Transferet në Fazën 1	-	-	-	-
Transferet në Fazën 2	-	-	-	-
Transferet në Fazën 3	-	-	-	-
HPK (zvogëlimi) / rritja për vitin	53	-	-	53
Ndikimi në fund të vitit i HPK-ve të ekspozimeve të transferuara midis fazave gjatë vitit	-	-	-	-
Lëshimi i zbritjeve (të njohura në të ardhurat nga interesi)	-	-	-	-
Ndryshimet për shkak të modifikimeve që nuk rezultojnë në ç'regjistrim	-	-	-	-
Ndryshimet në modelet dhe inputet e përdorura për llogaritjet HPK-së	-	-	-	-
Rregullimet e kursit valuator	-	-	-	-
Më 31 dhjetor 2023	512	-	-	512

	2022			
	Faza 1	Faza 2	Faza 3	Gjithsej
HPK me 1 janar 2022	406	-	-	406
Transferet në Fazën 1	-	-	-	-
Transferet në Fazën 2	-	-	-	-
Transferet në Fazën 3	-	-	-	-
HPK (zvogëlimi) / rritja për vitin	53	-	-	53
Ndikimi në fund të vitit i HPK-ve të ekspozimeve të transferuara midis fazave gjatë vitit	-	-	-	-
Lëshimi i zbritjeve (të njohura në të ardhurat nga interesi)	-	-	-	-
Ndryshimet për shkak të modifikimeve që nuk rezultojnë në ç'regjistrim	-	-	-	-
Ndryshimet në modelet dhe inputet e përdorura për llogaritjet HPK-së	-	-	-	-
Rregullimet e kursit valuator	-	-	-	-
Më 31 dhjetor 2022	459	-	-	459

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Shënimet mbi Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023

(në mijë Euro, nëse nuk është theksuar ndryshe)

4. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

c) Rreziku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit është rreziku që BQK-ja të ketë vështirësi në përmbushjen në kohë të duhur të obligimeve që rrjedhin nga detyrimet e saj financiare.

Menaxhimi i rrezikut të likuiditetit

Qëndrimi i BQK-së në menaxhimin e likuiditetit është të sigurojë, sa të jetë e mundur, që vazhdimisht të ketë likuiditet të mjaftueshëm për të përmbushur me kohë detyrimet, si në kushte normale ashtu edhe në ato të pafavorshme, pa pësuar humbje të papranueshme apo duke rrezikuar dëmtimin e reputacionit të BQK-së.

Politikat e monitorimit dhe adresimit të rrezikut të likuiditetit janë të vendosura nga Bordi Ekzekutiv i BQK-së. BQK-ja menaxhon rrezikun e likuiditetit duke investuar në depozita afatshkurtra me bankat jo-rezidente dhe duke mbajtur shumën të mjaftueshme të mjeteve monetare në kasafortat e saj. Politikat e menaxhimit të likuiditetit janë të vendosura në një mënyrë të tillë që edhe në kushte të keqësura BQK-ja të jetë në gjendje të përmbushë detyrimet e saj. Pozicioni ditor i likuiditetit monitorohet dhe testimet rregullt të likuiditetit kryhen nën skenarë të ndryshëm si për kushte të tregut normale ashtu edhe për ato më të vështira. Të gjitha politikat dhe procedurat e likuiditetit iu nënshtrohen rishikimit dhe aprovimit të menaxhmentit të BQK-së. Raportet mujore që mbulojnë pozicionin e likuiditetit të BQK-së i paraqiten rregullisht anëtarëve të Komitetit të Investimeve nga Departamenti i Menaxhimit të Mjeteve.

Ekspozimi ndaj rrezikut të likuiditetit

Maturiteti i mbetur kontraktual për pasuritë dhe detyrimet financiare, më përjashtim të pagesave të ardhshme të interesit:

31 dhjetor 2023	Shënim	Neto vlera e bartur	Më pak se 1 muaj	1-3 muaj	3 muaj deri në 1 vit	1 vit deri në 5 vite	mbi 5 vite
<i>Pasuritë jo-derivative</i>							
Paraja e gatshme		101,932	101,932	-	-	-	-
Llogaritë rrjedhëse në bankat e huaja	8	426,077	426,077	-	-	-	-
Letrat me vlerë	9	717,814	42,170	74,273	267,436	333,935	-
Plasmanët në tregun e parasë	10	205,252	130,184	75,068	-	-	-
Llogaritë në FMN	11	152,619	152,619	-	-	-	-
		1,603,694	852,982	149,341	267,436	333,935	-
<i>Detyrimet jo-derivative</i>							
Ndaj bankave komerciale në vend	15	(590,622)	(590,622)	-	-	-	-
Ndaj llogarive të lidhura me FMN	16	(163,802)	-	-	-	-	(163,802)
Ndaj institucioneve qeveritare	17	(511,903)	(511,903)	-	-	-	-
Ndaj institucioneve publike dhe komerciale	18	(240,202)	(240,202)	-	-	-	-
Nga huamarrja/et	19	(1,662)	-	-	(222)	(886)	(554)
Detyrime tjera vendore	20	(758)	(758)	-	-	-	-
		(1,508,949)	(1,343,485)	-	(222)	(886)	(164,356)
		94,745	(490,503)	149,341	267,214	333,049	(164,356)

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Shënimet mbi Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023

(në mijë Euro, nëse nuk është theksuar ndryshe)

4. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

c) Rreziku i likuiditetit

31 dhjetor 2022

	Shënim	Neto vlera e bartur	Më pak se 1 muaj	1 deri ne 3 muaj	3 muaj deri ne një vit	1-5 vite	mbi 5 vite
<i>Pasuritë jo-derivative</i>							
Paraja e gatshme		409,426	409,426	-	-	-	-
Llogaritë rrjedhëse në bankat e huaja	8	206,359	206,359	-	-	-	-
Letrat me vlerë	9	666,597	-	51,407	140,605	456,480	18,105
Plasmanët në tregun e parasë	10	99,950	14,799	40,069	45,082	-	-
Llogaritë në FMN	11	159,169	159,169	-	-	-	-
		1,541,501	789,753	91,476	185,687	456,480	18,105
<i>Detyrimet jo-derivative</i>							
Ndaj bankave komerciale në vend	15	(594,281)	(594,281)	-	-	-	-
Ndaj llogarive të lidhura me FMN	16	(168,563)	-	-	-	-	(168,563)
Ndaj institucioneve qeveritare	17	(585,784)	(585,784)	-	-	-	-
Ndaj institucioneve publike dhe komerciale	18	(131,137)	(131,137)	-	-	-	-
Nga huamarrja/et	19	(1,938)	-	-	-	-	(1,938)
Detyrime tjera vendore	20	(756)	(756)	-	-	-	-
		(1,482,459)	(1,311,958)	-	-	-	(170,501)
		59,042	(522,205)	91,476	185,687	456,480	(152,396)

Për administrimin e rrezikut të likuiditetit që rrjedh nga detyrimet financiare, BQK-ja mban mjete likuide që përfshijnë para dhe ekuivalentë të saj dhe letra me vlerë për të cilat ekziston një treg aktiv dhe likuid.

4. Menaxhim i rrezikut financiar (vazhdim)

d) Rreziku i tregut

Rreziku i tregut është rreziku që ndryshimet që përhapen në çmimet e tregut, si normat e interesit, çmimet e kapitalit, normat e kursit të këmbimit dhe kredisë (që nuk lidhen me ndryshimet në gjendjen kreditore të huamarrësit/emetuesit) do të ndikojë në të ardhurat e BQK-së apo vlerën e instrumenteve financiare të mbajtur nga ajo. Objektivi i administrimit të rrezikut të tregut është të menaxhoj dhe kontrolloj ekspozimin ndaj rrezikut të tregut brenda parametrave të pranueshëm, ndërkohë që optimizon kthimin e investimeve.

Menaxhimi i rreziqeve të tregut

Operacionet e BQK-së i nënshtrohen rrezikut të luhatjes së normave të interesit në atë masë që pasuritë dhe detyrimet që bartin interes maturohen ose riçmohen në kohë apo shuma të ndryshme. Mjetet dhe detyrimet me norma të ndryshueshme janë të ekspozuara ndaj rrezikut bazë, i cili është ndryshimi në karakteristikat e ri-çmimit të indekseve të shumëllojshme me norma të ndryshueshme.

Veprimtaritë e menaxhimit të rrezikut synojnë të optimizojnë të ardhurat neto nga interesi bazuar mbi nivelet e normave të interesit të tregut konsistent me strategjitë e veprimit të BQK-së. Ekspozimi i BQK-së ndaj rrezikut të tregut lidhet vetëm me portofolet jo të tregtueshme.

Ekspozimi ndaj rrezikut të normës së interesit - portofolet jo të tregtueshme

Rreziku kryesor ndaj të cilit portofolet jo të tregtueshme janë ekspozuar është rreziku i humbjes nga luhatja e rrjedhjeve të ardhshme të parasë apo e vlerave të drejta të instrumenteve financiare për shkak të një ndryshimi në normat e tregut. Rreziku i normës së interesit kryesisht menaxhohet duke monitoruar diferencat midis normave të interesit dhe duke pasur limite paraprakisht të miratuara për intervalet e rivlerësimit. Komiteti i investimeve është autoriteti që monitoron zbatimin e këtyre limiteve.

Një përmbledhje e pozicionit të BQK-së lidhur me diferencën midis normave të interesit të portfolios jo të tregtueshme paraqitet tabelën e mëposhtme.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Shënimet mbi Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023

(në mijë Euro, nëse nuk është theksuar ndryshe)

4. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(d) Rreziqet e tregut (vazhdim)

Ekspozimi ndaj rrezikut të normës së interesit - portofolet jo të tregtueshme

31 dhjetor 2023	Shënim	Neto vlera e	Më pak se	3-6	6-12	1-5 vite	mbi 5 vite
		bartur	3 muaj	muaj	muaj		
Llogaritë rrjedhëse me bankat e huaja	8	426,077	426,077	-	-	-	-
Letra me vlerë (obligacione dhe bono thesari)	9	717,814	116,443	103,538	163,899	333,934	-
Plasmanët në tregun e parasë	10	205,252	205,252	-	-	-	-
Mjete në llogaritë e ndërlidhura me FMN	11	152,619	152,619	-	-	-	-
Gjithsej		1,501,762	900,391	103,538	163,899	333,934	-
Detyrime ndaj bankave vendase	15	(590,622)	(590,622)	-	-	-	-
Detyrime ndaj llogarive të ndërlidhura me FMN	16	(163,802)	-	-	-	-	(163,802)
Detyrime ndaj institucioneve qeveritare	17	(511,903)	(511,903)	-	-	-	-
Detyrime ndaj entiteteve tregtare dhe publike	18	(240,202)	(240,202)	-	-	-	-
Nga huamarrja /et	19	(1,662)	-	-	-	-	(1,662)
Detyrime të tjera vendase	20	(758)	(758)	-	-	-	-
Gjithsej		(1,508,949)	(1,343,485)	-	-	-	(165,464)
Ndryshimi		(7,187)	(443,094)	103,538	163,899	333,934	(165,464)

31 dhjetor 2022	Shënim	Neto vlera e	Më pak se	3-6	6-12	1-5 vite	mbi 5 vite
		bartur	3 muaj	muaj	muaj		
Llogaritë rrjedhëse me bankat e huaja	8	206,359	206,359	-	-	-	-
Letra me vlerë (obligacione dhe bono thesari)	9	666,597	-	10,109	34,499	567,624	54,365
Plasmanët në tregun e parasë	10	99,950	24,774	30,094	35,090	9,992	-
Mjete në llogaritë e ndërlidhura me FMN	11	159,169	159,169	-	-	-	-
Gjithsej		1,132,075	390,302	40,203	69,589	577,616	54,365
Detyrime ndaj bankave vendase	15	(594,281)	(594,281)	-	-	-	-
Detyrime ndaj llogarive të ndërlidhura me FMN	16	(168,563)	-	-	-	-	(168,563)
Detyrime ndaj institucioneve qeveritare	17	(585,784)	(585,784)	-	-	-	-
Detyrime ndaj entiteteve tregtare dhe publike	18	(131,137)	(131,137)	-	-	-	-
Nga huamarrja /et	19	(1,938)	-	-	-	-	(1,938)
Detyrime të tjera vendase	20	(756)	(756)	-	-	-	-
Gjithsej		(1,482,459)	(1,311,958)	-	-	-	(170,501)
Ndryshimi		(350,384)	(921,656)	40,203	69,589	577,616	(116,136)

Pasuritë dhe detyrimet financiare që nuk bartin interes nuk janë të përfshira në tabelën më lartë.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Shënimet mbi Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023

(në mijë Euro, nëse nuk është theksuar ndryshe)

4. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(d) Rreziqet e tregut (vazhdim)

Rreziku i përgjithshëm jo-tregtar i normave të interesit jo të tregtueshme menaxhohet nga Departamenti i Menaxhimit të Mjeteve, i cili përdor investimet në letra me vlerë dhe depozitat në banka për të menaxhuar rrezikun e përgjithshëm që lind nga aktivitetet jo tregtare të BQK-së.

Menaxhimi i rrezikut të normave të interesit kundrejt limitit të ndryshimit të normave të interesit, plotësohet duke monitoruar ndjeshmërinë e mjeteve dhe detyrimeve të BQK-së ndaj skenarëve të ndryshëm standard dhe jo-standard të normave të interesit. Skenarët standard të cilët vlerësohen në mënyrë periodike, përfshijnë një rënie ose ngritje paralele në të gjitha kurbat e kthimit, prej 100 pikësh bazë ("pb"). Një analizë e ndjeshmërisë së BQK-së ndaj një rritje ose rënie të normave të interesit të tregut (duke supozuar që nuk ka lëvizje asimetrike të kurbave të kthimit si dhe një gjendje të pandryshueshme financiare) është si vijon:

2023

	100 pb Rritje	100 pb Rënie
Efekti i parashikuar në fitim (humbje)	(72)	72

2022

	100 pb Rritje	100 pb Rënie
Efekti i parashikuar në fitim (humbje)	(3,504)	3,504

Ekspozimi ndaj rreziqeve të tjera të tregut/valutor të portofoleve jo të tregtueshme

BQK-ja është e ekspozuar ndaj DVT-të lidhur me pasuritë dhe detyrimet e saj në FMN si dhe ndaj USD lidhur me pasuritë e saj në formën e llogarive rrjedhëse me bankat jo rezidente dhe investimet në letra me vlerë në dollar, të cilat i monitoron në vazhdimësi. Ekspozimi i BQK ndaj rrezikut të valutave të huaja është si vijon:

2023

	DVT		USD	
	100 pb rritje	100 pb rënie	100 pb rritje	100 pb rënie
Efekti i parashikuar në fitim (humbje)	(75)	75	99	(99)

2022

	100 pb rritje	100 pb rënie	100 pb rritje	100 pb rënie
Efekti i parashikuar në fitim (humbje)	(51)	51	98	(98)

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Shënimet mbi Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023

(në mijë Euro, nëse nuk është theksuar ndryshe)

4. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(d) Rreziqet e tregut (vazhdim)

31 dhjetor 2023	Euro	USD (Ekuivalent në Euro)	DVT (Ekuivalent në Euro)	Gjithsej neto vlera e bartur
Pasuritë				
Paraja e gatshme	101,932	-	-	101,932
Llogaritë rrjedhëse me bankat e huaja	425,818	259	-	426,077
Letra me vlerë (Obligacione dhe bono thesari)	713,321	4,493	-	717,814
Plasmanët në tregun e parasë	200,094	5,158	-	205,252
Mjete ne llogarit e ndërlidhura me FMN	1,212	-	177,049	178,261
Mjetet e tjera	2,476	-	-	2,476
Gjithsej	1,444,853	9,910	177,049	1,631,812
Detyrime				
Detyrime ndaj bankave vendase	590,622	-	-	590,622
Detyrime ndaj llogarive të ndërlidhura me FMN	1,291	-	182,926	184,217
Detyrime ndaj institucioneve qeveritare	511,903	-	-	511,903
Detyrime ndaj entiteteve tregtare dhe publike	240,202	-	-	240,202
Nga huamarrja /et	-	-	1,662	1,662
Detyrime të tjera vendore	9,222	-	-	9,222
Gjithsej	1,353,240	-	184,588	1,537,828
Pozicioni neto për valuta të huaja	91,613	9,910	(7,539)	93,984
31 dhjetor 2022				
	Euro	USD (Ekuivalent në Euro)	DVT (Ekuivalent në Euro)	Gjithsej neto vlera e bartur
Pasuritë				
Paraja e gatshme	409,426	-	-	409,426
Llogaritë rrjedhëse me bankat e huaja	206,012	347	-	206,359
Letra me vlerë (Obligacione dhe bono thesari)	661,916	4,681	-	666,597
Plasmanët në tregun e parasë	95,168	4,782	-	99,950
Mjete ne llogarit e ndërlidhura me FMN	1,158	-	184,309	185,467
Mjetet e tjera	2,709	-	-	2,709
Gjithsej	1,376,389	9,810	184,309	1,570,508
Detyrime				
Detyrime ndaj bankave vendase	594,281	-	-	594,281
Detyrime ndaj llogarive të ndërlidhura me FMN	1,207	-	187,433	188,640
Detyrime ndaj institucioneve qeveritare	585,784	-	-	585,784
Detyrime ndaj entiteteve tregtare dhe publike	131,137	-	-	131,137
Nga huamarrja /et	-	-	1,938	1,938
Detyrime të tjera vendore	2,444	-	-	2,444
Gjithsej	1,314,853	-	189,371	1,504,224
Pozicioni neto për valuta të huaja	61,536	9,810	(5,062)	66,284

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Shënimet mbi Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023

(në mijë Euro, nëse nuk është theksuar ndryshe)

4. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(d) Rreziku i tregut (vazhdim)

BQK-ja kryesisht kryen veprime me Euro, ndërsa monedhat e huaja/tjera të cilat BQK-ja ka në portfolio janë kryesisht “Të Drejtat e Veçanta të Tërheqjes” (“DVT”) dhe Dollar Amerikan (USD). Kurset e këmbimit të përdorura për përkthimin më 31 dhjetor 2023 dhe 2022 ishin si vijon:

	2023	2022
	Euro	Euro
1 DVT	1.21753	1.25291
1 USD	0.90498	0.93756

DVT-të janë pasuri rezervë shtesë si mbështetje në këmbimin/transaksionet e jashtme që përcaktohen dhe mbahen nga Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN). Edhe pse DVT-të nuk janë valutë në vete, ato përfaqësojnë një kërkesë potenciale në valuta të vendeve anëtare të FMN-së me të cilat mund të këmbehen. DVT-të janë krijuar në vitin 1969 si pasojë e mungesës së aktiveve në valutat e preferuara të kohës si dollari amerikan dhe ari, vlera e DVT-ve përcaktohet si mesatare e shportës së pesë valutave kryesore, euro, dollari amerikan, funta britanike, jeni japonez dhe renmindbi kinez.

USD-të janë mjete në llogari rrjedhëse dhe depoazita të afatizuar me Federal Rezerve New York.

(e) Rreziku operacional

Rreziku operacional është rreziku i humbjeve direkte apo indirekte që shkaktohen nga një shumëllojshmëri shkaqesh të lidhura me proceset e BQK-së, personelin, teknologjinë dhe infrastrukturën si dhe faktorët e tjerë të jashtëm përveç rrezikut kreditor, të tregut dhe likuiditetit siç janë kërkesat ligjore dhe rregullative si dhe standardet e pranuar gjerësisht të sjelljes korporative. Rreziku operacional rrjedh nga të gjitha operacionet e BQK-së dhe prek të gjitha njësitë organizative.

Objekti i BQK-së është të menaxhojë rrezikun operacional, si dhe dëshiron të balancojë evitimin e humbjeve financiare dhe dëmtimin e reputacionit të BQK-së me menaxhimin e kostove efektive.

Përgjegjësia kryesore për zhvillimin dhe implementimin e kontrolleve për monitorimin e rrezikut operacional i përket çdo njësie organizative përmes stafit menaxhues të tyre. Kjo përgjegjësi shoqërohet me respektimin e të gjitha politikave, rregullave dhe procedurave të BQK-së për menaxhimin e rrezikut operacional në fushat e mëposhtme:

- kërkesat për ndarjen e detyrave dhe përgjegjësi, duke përfshirë këtu edhe autorizimin e pavarur të transaksioneve;
- kërkesat për vlerësime dhe monitorime të transaksioneve;
- përshtatshmëria me kërkesat rregullative dhe ligjore;
- dokumentimi i kontrolleve dhe procedurave;
- kërkesat për vlerësimin periodik të rrezikut operacional dhe përshtatshmërisë së kontrolleve dhe procedurave për menaxhimin e këtij rreziku;
- kërkesat për raportimin e humbjeve operative dhe propozimit të veprimeve korrigjuese;
- zhvillimin e planeve emergjente;
- trajnimin dhe zhvillimin profesional;
- standardet etike dhe të mirësjelljes;
- zvogëlimin e rrezikut, duke përfshirë dhe sigurimin, kur kjo është efektive.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Shënimet mbi Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023

(në mijë Euro, nëse nuk është theksuar ndryshe)

4. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(f) Menaxhimi i kapitalit

Përshatshmëria me standardet dhe korinizen raportuese për zërat financiar, BQK mbështetet politikat, rregullat dhe procedurat e brendshme dhe në bazë të cilave pegatitet raportimi periodik. Pastaj këto janë të rishikuara prej Departamentit për menaxhimin e rrezikut dhe Auditimit të Brendshëm. Gjetjet e vlerësimeve si të Departamentit për menaxhimin e rrezikut ashtu edhe të Auditimit të Brendshëm diskutohen me menaxhimin e njësisë organizative me të cilën ato ndërlidhen, dhe po ashtu të njëjtat dorëzohen dhe diskutohen në Komitetin e Auditimit dhe të organet vendimmarrëse të BQK-së.

Në përputhje me Ligjin, BQK-ja krijon dhe mban një rezervë të përgjithshme. Rezerva e përgjithshme nuk mund të përdoret, përveç për qëllime të mbulimit të humbjeve që mund të rrjedhin nga aktiviteti i saj. Përveç kësaj, BQK-ja do të krijojë llogari të rezervës së rivlerësimit për akumulimin e fitimeve të përealizuara që rrjedhin nga fitimet dhe rrjedhimisht mbulimin e humbjeve të përealizuara për shkak të pozicioneve të saj me valuta të huaja, ari, instrumente financiare dhe aktive tjera.

Sipas Ligjit nr. 03/L-209, të ardhurat neto ose humbja neto e BQK-së llogariten në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Fitimet në dispozicion për shpërndarje do të përcaktohen:

- duke zbritur nga fitimi neto, shumën totale të ardhurave të përealizuara të rivlerësimit, dhe duke ndarë një shumë ekuivalente në llogarinë përkatëse të përealizuara të rezervës së rivlerësimit, dhe
- duke zbritur nga llogaria e duhur e përealizuar e rezervës së rivlerësimit dhe duke shtuar në fitimet e shpërndara shumën e çfarëdo fitimi të përealizuar që është zbritur nga fitimi neto për një ose më shumë vitet e mëparshme dhe u realizuara gjatë vitit aktual financiar.

Humbjet e përealizuara nga rivlerësimi do të transferohen në llogaritë përkatëse rezervë të përealizuara të rivlerësimit deri në kohën kur këto llogari rezervë rivlerësimi kanë një bilanc zero, pasi që këto humbje do të mbulohen nga fitimi i vitit aktual, atëherë nga ana e rezervave të përgjithshme dhe më pas duke i autorizuar llogarisë kapitale.

Sipas nenit 56, paragrafi 1.1. të ligjit nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, të ardhurat neto së pari do të shpërndahen në rezervën të përgjithshme derisa shuma totale e kapitalit fillestar dhe rezervat e përgjithshme barazohen me pesë për qind (5%) të detyrimeve monetare të Bankës Qendrore.

Pjesa prej 50% e bilancit neto të të ardhurave të realizuara që mbeten pas përmbushjes së kriterit të 5% të përmendur më lart, duhet t'i transferohet Ministrisë së Financave. Ndërsa 50% që mbetet nga të ardhurat e realizuar duhet t'i alokohet llogarisë së rezervës së përgjithshme të BQK-së.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Shënimet mbi Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023

(në mijë Euro, nëse nuk është theksuar ndryshe)

4. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(f) Menaxhimi i kapitalit (vazhdim)

Të ardhurat e ndashme

Përshkrimi	2023	2022
Gjithsej të ardhurat gjithëpërfshirëse për vitin	27,631	8,552
Nga të cilat janë fitimet / humbjet e perealizuara nga rivlerësimi (shënimi 29)	-	542
Të ardhurat e ndashme	27,631	8,010

Kapitali, llogaria e rezervës së përgjithshme dhe të ardhurat e ndashme

	2023	2022
Kapitali	30,000	30,000
Rezervat e përgjithshme	39,507	31,444
Të ardhurat e ndashme	27,631	8,010
Gjithsej Kapitali, llogaria e rezervës së përgjithshme dhe të ardhurat e ndashme	97,138	69,454

Gjithsej detyrimet monetare

	2023	2022
Ndaj bankave komerciale vendore	590,505	594,281
Ndaj institucioneve qeveritare	511,705	585,784
Ndaj llogarive të lidhura me FMN	182,925	187,704
Ndaj institucioneve publike dhe komerciale	240,163	131,137
Huamarrjet	1,662	1,938
Ndaj detyrimeve tjera monetare	757	756
Gjithsej detyrimet monetare⁴	1,527,718	1,501,600
Raporti sipas nenit 56, paragrafi 1.1.	6.36%	4.63%

Kapitali dhe rezervat (neni 56, p.1.1.)	97,138	69,454
Kapitali dhe rezervat (neni 56, p.1.1.) - Limiti 5%	76,386	75,080
Të ardhura të ndashme mbi liimit 5%	20,752	-
50% i të ardhurave të ndashme	10,376	N/A

(g) Menaxhimi i asetëve

Në pajtim me Ligjin 03/L-209 dhe Ligjin 03/L-048, BQK-së i është caktuar përgjegjësia për bërjen dhe menaxhimin e investimeve të autorizuar në emër të Ministrisë së Financave.

5. Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare përfshin përdorimin e vlerësimeve dhe supozimeve të pasigurta lidhur me ngjarjet e ardhshme që ndikojnë në shumën e njohura për aktivet, detyrimet, të ardhurat dhe shpenzimet. Menaxhmenti diskuton me Bordin e Bankës Qendrore zhvillimin, zgjedhjen dhe paraqitjen e politikave dhe vlerësimeve kritike kontabël të BQK-së, dhe aplikimin e këtyre politikave dhe vlerësimeve. Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën historike dhe faktorë të tjerë, duke përfshirë pritshmërinë e ngjarjeve të ardhshme të cilat besohet të jenë të arsyeshme në rrethanat të caktuara. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga ato të vlerësuara. Vlerësimet dhe supozimet shqyrtohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve njihen në mënyrë prospektive.

⁴ Përfshijë akrualet.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Shënimet mbi Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023

(në mijë Euro, nëse nuk është theksuar ndryshe)

5. Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Burimet kryesore të pasigurisë në matje

Lejimet për humbjet e pritura kreditore

Pasuritë e regjistruara me kosto të amortizuar vlerësohen në baza të vazhdueshme për të identifikuar rënien e mundëshme në vlerë të pasurisë. Pasiguri në vlerësim të cilat mund të rezultojnë në një rregullim material në periudhë raportuese, paraqiten në rastin e: përcaktimit të të dhënave për modelin e matjes të HPK-ve, përfshirë informacionin mbi të ardhmen dhe supozimet kryesore të përdorura në vlerësimin e flukseve të rikuperueshme monetare.

Përbërësit specifik në totalin e provizioneve për rënie në vlerë të pasurive financiare të vlerësuara individualisht dhe bazohet në vlerësimin më të mirë të menaxhimit të vlerës aktuale të rrjedhjeve të pritshme të parasë që pritet të pranohen. Për të llogaritur këto rrjedhje të parave, menaxhmenti gjykon mbi situatën financiare të palës në transaksion dhe vlerës neto të realizueshme të çdo kolaterali të vendosur.

Zhvillimet tjera globale

Në pasqyrat financiare të vitit 2022 dhe 2023 rezervat ndërkombëtare të Bankës Qendrore, të përbërë nga letra me vlerë me rangim të lartë dhe depozita bankare afatshkurtra (në valutën euro), nuk janë ndikuar materialisht nga ngadalësimi ekonomik në nivel global respektivisht përkeqësimi i kushteve të tregut si rezultat i pandemisë, inflacionit dhe krizave tjera të këtyre viteve në nivel global. Si dhe po ashtu BQK nuk vlerëson se do ketë ndikim edhe në vitin pasues pas vitit raportues.

Gjykime kritike kontabël në aplikimin e politikave kontabël të BQK-së

Gjykimet kritike kontabël të kryera gjatë aplikimit të politikave kontabël të BQK-së përfshijnë:

Klasifikimi i pasurive dhe detyrimeve financiare

Politikat kontabël të BQK-së krijojnë mundësinë që pasuritë dhe detyrimet të vendosen që në fillim në kategori të ndryshme kontabël sipas rrethanave të caktuara.

Në klasifikimin e pasurive financiare si të mbajtura për t'u arkëtuar rrjedhat e kontraktuara të parasë, BQK-ja ka treguar se ka qëllimin pozitiv dhe aftësinë për t'i mbajtur mjetet deri në datën e maturimit, siç kërkohet nga politikat kontabël.

Poashtu gjykimet e bëra në zbatimin e politikave kontabël, që kanë një ndikim domethënës në shumat e njohura në pasqyrat financiare janë: përcaktimi i kriterëve për të vlerësuar nëse rreziku kreditor i një pasurie financiare është rritur ndjeshëm që nga njohja fillestare, përcaktimi i metodologjisë për përfshirjen e informacionit mbi të ardhmen në matjen e Humbjeve të Pritshme Kreditore (HPK) dhe përzgjedhja dhe miratimi i modeleve të përdorura për të matur HPK-të.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Shënimet mbi Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023

(në mijë Euro, nëse nuk është theksuar ndryshe)

6. Pasuritë dhe detyrimet financiare (klasifikimet kontabël dhe vlerat e drejta)

Tabela më poshtë paraqet klasifikimin për çdo klasë të pasurive dhe detyrimeve financiare të BQK-së, si dhe vlerat e drejta të tyre. Të gjitha pasuritë financiare janë të mbajtura në koston e amortizuar (të mbajtura për të arkëtuar).

31 dhjetor	Shënim	2023		2022	
		Kostoja e amortizuar	Vlera e drejtë	Kostoja e amortizuar	Vlera e drejtë
Paraja e gatshme	7	101,932	101,932	409,426	409,426
Llogaritë rrjedhëse me bankat e huaja	8	426,077	426,077	206,359	206,359
Letrat me vlerë	9	717,814	705,860	666,597	645,095
Plasmanët në tregun e parasë	10	205,252	205,252	99,950	99,950
Pasuritë lidhur me FMN	11	178,261	178,261	185,467	185,467
Pasuritë tjera	14	145	145	176	176
		1,629,481	1,617,527	1,567,975	1,546,473
Detyrime ndaj bankave vendase	15	590,622	590,622	594,281	594,281
Detyrime ndaj llogarive të ndërlidhura me FMN	16	184,217	184,217	188,640	188,640
Detyrime ndaj institucioneve qeveritare	17	511,903	511,903	585,784	585,784
Detyrime ndaj entiteteve tregtare dhe publike	18	240,202	240,202	131,137	131,137
Nga huamarrja /et	19	1,662	1,662	1,938	1,938
Detyrime të tjera vendase	20	758	758	756	756
		1,529,364	1,529,364	1,502,536	1,502,536

7. Paraja e gatshme

Paraja e gatshme

	2023	2022
Paraja e gatshme	101,932	409,426
Gjithsej vlera	101,932	409,426

8. Llogaritë rrjedhëse me bankat e huaja

Këto llogari mbahen në bankat e mëposhtme:

	2023	2022
Deutsche Bundesbank	319,333	142,288
Raiffeisen Zentralbank	6,023	330
Deutsche Bank	10,534	214
Banque centrale du Luxembourg	67,529	63,102
Commerzbank AG	1,078	138
Bank of Lituania	20,101	-
Federal Reserve Bank (FED-NY)	246	328
Gjithsej vlera bartese	424,844	206,400
Humbjet e pritura kreditore (HPK)	(117)	(41)
Gjithsej vlera neto	424,727	206,359

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
Shënimet mbi Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023
(në mijë Euro, nëse nuk është theksuar ndryshe)

8. Llogaritë rrjedhëse me bankat e huaja (vazhdim)

Llogaritë rrjedhëse me bankat e huaja
 interesi akrual

	2023	2022
Deutsche Bundesbank	1,077	-
Raiffeisen Zentralbank	-	-
Deutsche Bank	-	-
Banque Centrale du Luxembourg	208	-
Commerzbank AG	-	-
Bank of Lituania	64	-
Federal Reserve Bank (FED-NY)	-	-
Llogaritë rrjedhëse me bankat – akrualet	1,349	-
Llogaritë rrjedhëse me bankat - Gjithsej	426,077	206,359

Norma e interesit për periudhën raportuese është ndërmjet 0.9% dhe 4%. Ndersa në periudhën krahasuse kanë qenë ndërmjet 1.85% dhe 2%.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Shënimet mbi Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023

(në mijë Euro, nëse nuk është theksuar ndryshe)

9. Llogaritë rrjedhëse me bankat e huaja (vazhdim)

Lëvizjet e HPK përkatëse për llogaritë rrjedhëse me bankat e huaja janë si më poshtë:

	2023			
	Faza 1	Faza 2	Faza 3	Gjithsej
HPK me 1 janar 2023	41	-	-	41
Transferet në Fazën 1	-	-	-	-
Transferet në Fazën 2	-	-	-	-
Transferet në Fazën 3	-	-	-	-
HPK (zvogëlimi) / rritja për vitin	76	-	-	76
Ndikimi në fund të vitit i HPK-ve të ekspozimeve të transferuara midis fazave gjatë vitit	-	-	-	-
Lëshimi i zbritjeve (të njohura në të ardhurat nga interesi)	-	-	-	-
Ndryshimet për shkak të modifikimeve që nuk rezultojnë në ç'regjistrim	-	-	-	-
Ndryshimet në modelet dhe inputet e përdorura për llogaritjet e HPK-së	-	-	-	-
Rregullimet e kursit valuator	-	-	-	-
Më 31 dhjetor 2023	117	-	-	117
	2022			
	Faza 1	Faza 2	Faza 3	Gjithsej
HPK me 1 janar 2022	32	-	-	32
Transferet në Fazën 1	-	-	-	-
Transferet në Fazën 2	-	-	-	-
Transferet në Fazën 3	-	-	-	-
HPK (zvogëlimi) / rritja për vitin	9	-	-	9
Ndikimi në fund të vitit i HPK-ve të ekspozimeve të transferuara midis fazave gjatë vitit	-	-	-	-
Lëshimi i zbritjeve (të njohura në të ardhurat nga interesi)	-	-	-	-
Ndryshimet për shkak të modifikimeve që nuk rezultojnë në ç'regjistrim	-	-	-	-
Ndryshimet në modelet dhe inputet e përdorura për llogaritjet HPK-së	-	-	-	-
Rregullimet e kursit valuator	-	-	-	-
Më 31 dhjetor 2022	41	-	-	41

9. Letrat me vlerë (bonot e thesarit dhe obligacionet qeveritare)

Të dy kategoritë që bëjnë pjesë në kuadër të grupimit janë letra të borxhit të lëshuara nga vendet e Bashkimit Evropian, Amerika dhe nga Kosova dhe janë të matura në koston e amotuar / modelin e mbajtjes për tu arketuar. Bonot e thesarit të shpalosura me poshtë kanë maturitetet deri në një vit. Ndërsa ato të obligacioneve qeveriate deri në 7 vite. Norma efektive e interesit në letra me vlerë variron ndërmjet -0.014% deri në 5.104% vjetore në vitin 2023 (2022: -0.014% deri në 3.023% vjetore).

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Shënimet mbi Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023

(në mijë Euro, nëse nuk është theksuar ndryshe)

9. Letrat me vlerë (bonot e thesarit dhe obligacionet qeveritare) (vazhdim)

Shpalosje analitike e letrave me vlerë sipas llojit dhe sipas shteteve emetuese:

Sipas shteteve:

Shteti	2023			2022		
	Vlera e bartur	Humbjet e pritura kreditore	Neto vlera	Vlera e bartur	Humbjet e pritura kreditore	Neto vlera
Gjermani	80,242	(32)	80,210	95,693	(40)	95,653
Francë	69,396	(33)	69,363	59,988	(28)	59,960
Holandë	49,337	(15)	49,322	48,956	(18)	48,938
Finlandë	60,578	(19)	60,559	51,251	(18)	51,233
Sloveni	20,695	(15)	20,680	21,021	(13)	21,008
Luksemburg	9,795	(2)	9,793	13,520	(1)	13,519
Belgjikë	89,857	(44)	89,813	51,308	(22)	51,286
Danimarkë	-	-	-	6,014	(1)	6,013
Austri	68,911	(17)	68,894	9,971	(2)	9,969
Irlandë	31,322	(2)	31,320	52,379	(4)	52,375
Amerikë	4,493	(1)	4,492	4,681	(1)	4,680
Itali	37,836	(28)	37,808	38,973	(24)	38,949
Poloni	15,658	(28)	15,630	15,810	(35)	15,775
Kosovë	180,060	(131)	179,930	197,394	(156)	197,239
Gjithsej	718,180	(367)	717,814	666,959	(362)	666,597

Sipas llojit:

	2023			2022		
	Vlera e bartur	Humbjet e pritura kreditore	Neto Vlera	Vlera e bartur	Humbjet e pritura kreditore	Neto vlera
Bono thesari	74,018	(20)	73,998	24,642	(6)	24,636
Obligacione qeveritare	644,162	(347)	643,816	642,317	(356)	641,961
Gjithsej	718,180	(367)	717,814	666,959	(362)	666,597

Lëvizjet e HPK përkatëse për letrat me vlerë të borxhit me kosto të amortizuar janë si më poshtë:

	2023			
	Faza 1	Faza 2	Faza 3	Gjithsej
HPK me 1 janar 2023	362	-	-	362
Transferet në Fazën 1	-	-	-	-
Transferet në Fazën 2	-	-	-	-
Transferet në Fazën 3	-	-	-	-
HPK (zvogëlimi) / rritja për vitin	5	-	-	5
Ndikimi në fund të vitit I HPK-ve të ekspozimeve të transferuara midis fazave gjatë vitit	-	-	-	-
Lëshimi i zbritjeve (të njohura në të ardhurat nga interesi)	-	-	-	-
Ndryshimet për shkak të modifikimeve që nuk rezultojnë në ç' regjistrim	-	-	-	-
Ndryshimet në modelet dhe inputet e përdorura për llogaritjet HPK-së	-	-	-	-
Rregullimet e kursit valuator	-	-	-	-
